

ASPEKTE LIGJORE TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI

Aida Saraçi

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, profili e Drejtë Biznesi, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës Shkencor: Prof. Asoc. Dr. Genta Tafa (Bungo)

Numri i fjalëve: 53. 208

Tiranë, Qershor 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Në përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar nga unë sipas kërkesave të Shkollës Doktorale të Universitetit Europian të Tiranës, nuk është paraqitur asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban materiale të shkruara nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

© E drejta e autorit: **Aida Saraçi**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Nuk lejohet shumëfishimi me çdo mjet apo formë pa lejen me shkrim të autorit.

Tiranë, 2016.

ABSTRAKT

Përvoja europiane dëshmon se prania e investimeve të huaja direkte (IHD) luan një rol kyç në procesin e integritit global dhe konsiderohen si një faktor përcaktues i rritjes dhe zhvillimit ekonomik, veçanërisht për vendet në zhvillim ku bën pjesë dhe Shqipëria. Për këtë arsye dhe vëmendja e shtetit shqiptar është e përqendruar në tërheqjen dhe në rritjen e flukseve hyrëse të IHD-ve, duke ndërmarrë nisma të shumta për krijimin e një mjedisi sa më të favorshëm për investitorët e huaj. Një nga faktorët përcaktues për garantimin e sigurisë së një investimi është siguria ligjore, e cila ofrohet nëpërmjet: përmirësimit të kuadrit institucional dhe ligjor, trajtimit të barabartë, garantimit të konkurrencës së ndershme në treg ndërmjet firmave të huaja me ato lokale, marrjes së masave kundër evazionit fiskal.

Është diskutuar pak për efektin e kuadrit ligjor ndaj IHD-ve. Për këtë arsye, ky studim ka për qëllim të analizojë ndikimin që ushtrojnë efektet ligjore në prurjet e IHD-ve në Shqipëri dhe kërkon t'u japë përgjigje pyetjeve bazë kërkimore të ngritura për trajtimin e situatës reale të IHD-ve: Cilët janë faktorët ligjorë ndikues në përthithjen e IHD-ve në vendin tonë? Sa ka ndikuar kuadri ligjor në prurjet e IHD-të në Shqipëri dhe a është favorizues dhe transparent për investuesit e huaj? A po bëhet progres nga ana e ligjvënësit shqiptar në përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon marrëdhënien midis investitorëve të huaj dhe shtetit shqiptar?

Kampioni i studimit përbëhet nga 30 subjekte që i përkasin grupit të investuesve të huaj që investojnë në Shqipëri. Mbledhja e të dhënave është realizuar nëpërmjet intervistës së strukturuar. Rezultatet e këtij kërkimi ndihmojnë që të identifikohen problematikat kryesore të kuadrit ligjor në fuqi për funksionimin e IHD-ve, si dhe nxisin rekomandime për zgjidhjen e tyre.

ABSTRACT

The European experience shows that the presence of foreign direct investments plays a key role in the global integration process. In addition to this fact, the FDI are considered a determining factor for the economic growth and development for all states. But, this is particularly true for the developing countries such as Albania. For this reason, the attention of the Albanian state has been focusing in the action of attraction and increased inflows of foreign direct investments, by taking a number of initiatives in order to create a more favorable and comfortable environment for foreign investors.

One of the key factors to ensure the safety of an investment is the safety of law which is offered by: improving the institutional and legal framework, offering the equality of treatment and guarantee fair competition in the market, among local firms and foreign ones, and finally by refining the measures taken against tax evasion. Little has been discussed about the effect of the legal framework on foreign direct investments. Therefore, this study aims to analyze the impact that the legal effects exercise on the FDI flows in Albania and seeks to give answer to the fundamental research questions which are raised in order to manage the real situation of FDI in the most optimal possible way. Questions such as: what are the legal factors that influence the absorption of the FDI in our country? How much has influenced the legal framework on foreign direct investments in Albania and can we affirm its conduciveness and transparency in relation to this context? Is the Albanian legislator making progress in improving the legal framework governing the relation between foreign investors and the Albanian state?

The study sample consist of 30 subjects belonging to the group of foreign investors who are investing in Albania. Data collection was carried out using the structured interview. The results of this research help identify the main issues of the legal framework actually into force that apply to the operation of FDI, and also promote new recommendations for their solutions.

DEDIKUAR

Mamasë sime të dashur

FALËNDERIME

Gjatë studimit “Aspekte ligjore të investimeve të huaja direkte në Shqipëri” herë-herë u përballa me vështirësi të cilat m’u dukën të pakapërcyeshme. Tani që u finalizua me sukses, dëshiroj të falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët dhe miqtë e mi më të mirë, pa ndihmën e të cilëve do ta kisha patur të vështirë të arrija deri këtu.

Një falënderim për rrugënisjen dhe finalizimin e këtij punimi e kam për udhëheqësen prof.as.dr. Genta Tafa (Bundo), e cila falë besimit që pati tek unë, tregoi përkushtim për të më ndihmuar, duke më mbështetur me optimizëm.

Gjatë këtij rrugëtimi kam pasur mbështetjen nga kolegët e administratës së Bashkisë Elbasan, ndaj të cilëve shpreh vlerësim e mirënjohje për mbështetjen që më kanë dhënë gjatë studimeve të doktoraturës.

Falënderoj të gjithë profesorët e Universitetit European të Tiranës, të cilët me përkushtim dhe këmbëngulje na udhëhoqën në rrugën e pafundme të dijes.

Falënderoj për ndihmën e pakursyer investuesit e huaj, të cilët pranuan të bëhen pjesë e intervistës sime, duke më ndihmuar në këtë kërkim.

Falënderoj prof.as.dr. Teuta Toska, pedagoge në departamentin e gjuhësisë, UE “A.Xhuvani”, e cila u tregua e gatshme për të më ndihmuar në redaktimin e këtij punimi.

Dhe në fund, por jo nga rëndësia, falënderoj familjen time të shtrenjtë, e cila më ka frymëzuar në çdo formë gjatë këtyre viteve, duke qenë forca ime më e madhe.

Ju faleminderit!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I. HYRJE	I
1.1. Parathënie	1
1.2. Metodologjia e përdorur në punim.....	3
1.2.1. Qëllimi i punimit.....	3
1.2.2. Hipoteza	4
1.2.3. Metodologjia e kërkimit.....	5
1.2.4. Objektivat e studimit.....	6
1.2.5. Kufizimet metodologjike	7
1.3. Struktura e punimit.....	8
KAPITULLI II. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË VËSHTRIM TEORIK	10
2.1. Investimet e Huaja Direkte (IHD).....	10
2.2. Teoritë e zhvilluara ndër vite rreth IHD-ve.....	16
2.2.1. Teoria makroekonomike.	16
2.2.2. Teoria mikroekonomike	17
2.2.3. Teoria e IHD-ve sipas Aliberit.....	19
2.2.4. Teoria e ndërkombëtarizimit të IHD-ve.....	19
2.2.5. Teoria ekletike (OLI)	23
2.2.6. Teoria e ciklit të produktit.....	25
2.3. “Diamanti” i Michael Porterit	26
2.4. Treguesit më të rëndësishëm të IHD-ve.....	28
2.5. Format bazë të Investimeve të Huaja Direkte	29
2.6. Klasifikimi i IHD-ve sipas kriterëve dhe pikëpamjeve të ndryshme	30
2.6.1. Llojet e IHD-ve nga këndvështrimi i investitorit	31
2.7. Korporatat multinacionale (KMN).....	31
2.8. Faktorët nxitës të IHD-ve.....	34

KAPITULLI III. IHD-TË NË SHQIPËRI NË KËNDVËSHTRIMIN HISTORIK	37
3.1. Vështrim ndër vite rreth IHD-ve	37
3.2. Panorama e pasurive natyrore në Shqipëri si mundësi për zhvillimin e IHD-ve ..	39
3.3. Ecuria ndër vite e IHD-ve në Shqipëri dhe “Konventa e ICSID”	40
3.4. Prejardhja e IHD-ve në Shqipëri	50
3.5. Faktorët nxitës për IHD-të	51
3.6. Importet dhe eksportet në Shqipëri	55
3.7. Ndikimi i krizës globale tek IHD- të në Shqipëri	57
3.8. Investuesit potencialë në Shqipëri.....	59
3.9. Qasje Shqipëri – Kosovë - Ballkani Perëndimor	62
3.9.1. Reformat e të bërit biznes në Kosovë	66
3.10. Krahasimi i IHD-ve në Shqipëri me vendet e Ballkanit Perëndimor	68
3.11. Rëndësia e IHD-ve në vendin pritës.....	70
KAPITULLI IV: LEGJISLACIONI PËR FUNKSIONIMIN E IHD-VE NË SHQIPËRI	79
4.1. Ligji i parë për IHD-të në Shqipëri	80
4.2. Agjencitë shqiptare për IHD-të	86
4.3. Themelimi i shoqërive tregtare	89
4.4. Krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të Licencimit.....	90
4.5. Pronat në Shqipëri dhe investimet e huaja	91
4.5.1. Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	92
4.6. Koncesionet, si mundësi të mëdha investimi	95
4.7. Sistemi tatimor në Shqipëri.....	98
4.8. Sistemi doganor në Shqipëri	101
4.9. E drejta e autorit	103
4.10. Investimet strategjike në Shqipëri	104

4.11. Shqipëria dhe normat e së drejtës ndërkombëtare (ICSID, OBT, CEFTA, EFTA, NATO, SEECP, NAFTA, MSA)	106
4.11.1. Konventa e ICSID-së	106
4.11.2. Shteti shqiptar dhe paditë në ICSID.....	107
4.11.3. OBT, CEFTA, EFTA, NATO, SEECP, NAFTA, MSA	108
4.11.4. E drejta Ndërkombëtare Private dhe Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar për zgjidhjen e konflikteve	113
4.12. Reforma e re administrative territoriale në Shqipëri.....	115
KAPITULLI V. ANALIZË E STUDIMIT EMPIRIK.....	117
5.1. Përgjigjet e subjekteve	121
5.2. Analiza e përgjigjeve të të intervistuarve.....	124
5.3. Diskutime rreth rezultateve të përgjithësuara	155
KAPITULLI VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	158
6.1. Përfundime	158
6.2. Rekomandime	162
LITERATURË TEORIKE	171
SHTOJCA 1	180
SHTOJCA 2	183
Intervista.....	183

LISTA E TABELAVE

Tabela 5.1.1 Numri i investuesve të intervistuar, sipas vendit të investimit.....	122
Tabela 5.2.1 Sektori ku vepron investuesi i huaj.	124
Tabela 5.2.2 Koha që investuesi i huaj ushtron aktivitetin në Shqipëri.	126
Tabela 5.2.3 Kapitali i investuar nga investuesit e huaj.....	127
Tabela 5.2.4 Favorizimi i kuadrit ligjor në fillim të investimit.....	129
Tabela 5.2.5 Numri i personave të punësuar.....	130
Tabela 5.2.6 Karakteristikat më të rëndësishme për ecurinë e aktivitetit.	132
Tabela 5.2.7 Tiparet kryesore të nxitjes së investuesve të huaj.	134
Tabela 5.2.8 Barrierat kryesore në fillim të investimit.	136
Tabela 5.2.9 Zbatimi i praktika të mira në 5 vitet e fundit.....	137
Tabela 5.2.10 Ndikimi i kuadrit ligjor (i miratuar së fundmi).	139
Tabela 5.2.11 Të ardhurat vjetore.	140
Tabela 5.2.12 Burimet financiare të investimit.....	141
Tabela 5.2.13 Numri i punonjësve që mund të shtohen në tri vitet e ardhshme.	143
Tabela 5.2.14 Vlerësimi i situatës ekonomike aktuale në Shqipëri.	144
Tabela 5.2.15 Përballimi i taksave nga investorët e huaj.....	146
Tabela 5.2.16 Korrektësia e shlyerjes së pagesave.	147
Tabela 5.2.17 Mendimi lidhur me progresin e kuadrit ligjor.	149
Tabela 5.2.18 Transparenca e sistemit tatimor në Shqipëri.	150
Tabela 5.2.19 Sigurisë ligjore në Shqipëri.	152
Tabela 5.2.20 Rekomandim i Shqipërisë për investim	153
Tabela 3.3.1 Përbërja e prurjeve të IHD-ve për periudhën 2006-2011.....	180
Tabela 3.3.2 IHD-të hyrëse sipas aktivitetit kryesor ekonomik.....	180
Tabela 3.3.3 Numri i projekteve të IHD-ve sipas aktiviteteve të biznesit	180
Tabela 3.3.4 Deficiti i përgjithshëm fiskal të PBB-së	180

Tabela 3.3.5 Tabela e bankave si investime të huaja	181
Tabela 3.3.6 Totali investimeve publike.....	181
Tabela 3.3.7 Financimi i IHD-ve.	182
Tabela 3.4.1 Prejardhja e IHD-ve.	182

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 5.1.1 Vendi ku ushtrojnë aktivitetin investuesit e intervistuar (në numër).....	122
Grafiku 5.1.2 Vendi ku ushtrojnë aktivitetin investuesit e intervistuar (në përqindje).	123
Grafiku 5.2.1 Investuesve të huaj sipas sektorit që ushtron aktivitetin (në numër).....	125
Grafiku 5.2.2 Investuesit e huaj sipas sektorit që ushtrojnë aktivitetin (në përqindje).	125
Grafiku 5.2.3 Koha që investuesi i huaj ushtron aktivitetin në Shqipëri (në numër)....	126
Grafiku 5.2.4 Koha që investuesi i huaj ushtron aktivitetin në Shqipëri (në përqindje).	127
Grafiku 5.2.5 Kapitali i investuar nga investuesit e huaj (në numër).	128
Grafiku 5.2.6 Kapitali i investuar nga investuesit e huaj (në përqindje).....	128
Grafiku 5.2.7 Favorizimi i kuadrit ligjor në fillim të investimit (në numër).	129
Grafiku 5.2.9 Numri i personave të punësuar (në numër).....	131
Grafiku 5.2.10 Numri i personave të punësuar (në përqindje).....	131
Grafiku 5.2.11 Tiparet kryesore të nxitjes së investuesve të huaja.	135
Grafiku 5.2.12 Barrierat kryesore në fillim të investimit.....	136
Grafiku 5.2.13 Zbatimi i praktika të mira në 5 vitet e fundit (në numër).	138
Grafiku 5.2.15 Ndikimi i kuadrit ligjor (i miratuar së fundmi) (në numër).	139
Grafiku 5.2.16 Ndikimi i kuadrit ligjor (i miratuar së fundmi) (përqindje).....	140
Grafiku 5.2.17 Të ardhurat vjetore (në numër).	140
Grafiku 5.2.18 Të ardhurat vjetore (në përqindje).	141
Grafiku 5.2.20 Burimet financiare të investimit (në përqindje).....	142
Grafiku 5.2.21 Numri i punonjësve që mund të shtohen në tre vitet e ardhshme (në numër).	143
Grafiku 5.2.22 Numri i punonjësve që mund të shtohen në tre vitet e ardhshme (në %).	143

Grafiku 5.2.23 Vlerësimi i situatës ekonomike aktuale e huaj në Shqipëri (në numër).	145
Grafiku 5.2.24 Vlerësimi i situatës ekonomike aktuale e huaj në Shqipëri (në përqindje).	145
Grafiku 5.2.25 Përballimi i taksave nga investitorët e huaj (në numër).	146
Grafiku 5.2.26 Përballimi i taksave nga investitorët e huaj (në përqindje).....	147
Grafiku 5.2.27 Korrektësia e shlyerjes së pagesave (në numër).	148
Grafiku 5.2.28 Korrektësia e shlyerjes së pagesave (në përqindje).	148
Grafiku 5.2.29 Mendimi lidhur me progresin e kuadrit ligjor (në numër).....	149
Grafiku 5.2.30 Mendimi lidhur me progresin e kuadrit ligjor (në përqindje).....	150
Grafiku 5.2.31 Transparenca e sistemit tatimor në Shqipëri (në numër).	151
Grafiku 5.2.32 Transparenca e sistemit tatimor në Shqipëri (në përqindje).	151
Grafiku 5.2.33 Sigurisë ligjore në Shqipëri (në numër).....	152
Grafiku 5.2.34 Sigurisë ligjore në Shqipëri (në përqindje).	153
Grafiku 5.2.35 Rekomandim i Shqipërisë për investim (në numër).	154
Grafiku 5.2.36 Rekomandim i Shqipërisë për investim (në përqindje).	154
Grafiku 3.3.1 Totali investimeve publike.	181
Grafiku 3.3.2 Financimi i IHD-ve.....	182

LISTA E SHKURTIMEVE

ACIT - Albanian Centre of International Trade

AIDA - Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

AKKP - Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

AMECO - Annual Marco-Economic database of the European Comission

APP - Agjencia e Prokurimit Publik

ASYCUDA - Automated System for Customs Data

ATP – Agjencia e Trajtimit të Pronës

BB - Banka Botërore

BE - Bashkimi European

BEI - Banka Europiane e Investimeve

BERZH - Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

BITs - Traktateve Dypalëshe të Investimeve

BSH - Banka e Shqipërisë

CC - Control of Corruption (Kontrolli i Korrupsionit)

CEB - Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës

CEFTA - Central European Free Trade Agreement

CEFTA, EFTA - Qasje e lirë në tregje – Marrëveshjet e tregtisë së lirë

CRI - Cumulative Reform Index (Indeksi i Reformës Kumulative)

DAC - Komiteti i Ndhmës për Zhvillim

DAP - Departamenti i Administratës Publike

DBSKNH - Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj

DEA - Data Envelopment Analysis (Analiza e zhvillimit të të dhënave)

DPD – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

EBRD - European Bank for Reconstruction and Development (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim)

ECF - Elbasan Cement Factory

EES - Eurostat European Statistics (Statistikat e Eurostatit European)

ERRU - Enti Rregullator i Ujit

FIAA - Foreign Investors Association in Albania (Shoqata e Investuesve të Huaj në Shqipëri)

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

FSHZH - Fondi Shqiptar i Zhvillimit

GATT - General Agreement on Tariffs and Trade

GDP - Prodhimi i Brendshëm Bruto

GE - Government Effectiveness (Efektiviteti i qeverisë)

GFS - Government Finance Statistics (Statistikat e financës së qeverisë)

GSP - Programi i Sistemit të Gjeneralizuar të Preferencave

H-O-S- Modeli Hecksher-Ohlin-Samuel

IBRD - Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

ICT - Sistemi i Skedarëve

IFAD - Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor

IFN - Institutet Financiare Ndërkombëtare

IHD - Investimet e Huaja Direkte

IIP - International Investment Position

INSTAT - Instituti i Statistikave

IPA - Instrumenti i Paraaderimit

KE - Komuniteti Europian

KIS - Komisioni i Investimeve Strategjike

KESH - Korporata Elektroenergjetike Shqiptare

KM – Këshilli i Ministrave

KMN- Kompani multinacionale

KPP – Komisioni i Prokurimit Publik

MAI - Marrëveshje Shumëpalëshe të Investimeve

MASH- Ministria e Arsimit dhe Shkencës

MB - Ministria e Brendshme

MBUMK - Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

MD - Ministria e Drejtësisë

METE - Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

MF - Ministria e Financave

MFP - Menaxhimi i Financave Publike

MI - Ministria e Integrimit

MPI - Masterplani i Investimeve

MPJ - Ministria e Punëve të Jashtme

MPPTT - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

MSA - Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim

MSH - Ministria e Shëndetësisë

MTKRS - Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

NAFTA - Marrëveshja e Tregtisë së Lirë

NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior

NJQV - Njësia e qeverisjes vendore

NJZP - Njësia e zbatimit të projektit

NVM- Ndërmarrje të vogla të mesme

OBPI - Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

OBT - Organizata Botërore e Tregtisë

OECD - Organization for Economic Co-Operation and Development (Organizata për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik)

OLI – Ownership Location Internalise

PBA - Programi i buxhetit afatmesëm

PBB - Produkti i Brendshëm Bruto

PBP - Përfaqëse me bazë programi

PBS - Përfaqëse me bazë sektori

PEF - Program ekonomik dhe fiskal

PPP – Partnetiteti Privat Publik

PSA - Procesi i Stabilizim-Asociimit

PSP - Public Sector Performance (Performanca e sektorit publik)

PT – Politika Tatimore

QKL - Qendra Kombëtare e Licencimit

QKR - Qendra Kombëtare e Regjistrimit

RSH- Republika e Shqipërisë

SEE - Vendet e Evropës Juglindore

SEECp - Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore

SIK - Sipërmarrjet e investimeve kolektive

SKZHES - Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social

SKZHI - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

SME - Small and Medium Enterprises (Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme)

SPS - Standardet Sanitare dhe Fitosanitare

STD - Sekretariati Teknik i Donatorëve

SWA - Qasja sektoriale

TBT - Barrierat teknike në tregti

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

TTF - Trajtimi tarifor favorizues

TVSH - Tatimi mbi vlerën e shtuar

UNCITRAL - United Nations Commission on International Trade Law (Rregullore e Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin Ndërkombëtar Tregtar).

UNCTAD - United Nation Conference on Trade and Development (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim)

UNDP - United Nation Development Programme (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)

USAID - Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

WIR - World Investment Report (Raporti Botëror i Investimeve)

WTO - World Trade Organization

ZQRPP - Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

ZRKKP - Zyra Rajonale e Kthimit e Kompensimit të Pronave

ZVKKP - Zyra Vendore e Kthimit të Kompensimit të Pronave

ZVRPP - Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

FJALORTH JURIDIKO-EKONOMIK

Disbursime: të gjitha të ardhurat nga çdo donator në favor të projektit përkatës.

Disbursime direkte: të gjitha të ardhurat që vijnë fizikisht në vendin tonë.

Disbursime indirekte: të gjitha të ardhurat disponibël që adresohen për llogari të projektit e shpenzohen direkt nga donatori ose kreditori pa u bërë hyrje në Shqipëri.

Shpenzime: konsiderohen të gjitha pagesat e kryera në emër të projektit.

Shpenzime direkte: pagesat që kryhen nga njësia e zbatimit të projektit nga llogaritë operative në bankat e nivelit të dytë.

Shpenzime direkte: pagesat që kryhen direkt nga donatori ose kreditori.

Shpenzimet indirekte: Llogaria në lekë që është në bankën e nivelit të dytë.

Investitori Direkt: mund të jetë një individ, një sipërmarrje, një korporatë ose jo, qoftë kjo publike apo private.

Investimi Direkt: sipërmarrja nga e cila investitori blen 10% ose më shumë të aksioneve të zakonshme apo të fuqisë së votimit.

Investimi i huaj direkt për brenda: quhen ato investime të bëra nga sipërmarrësit e huaj në ekonominë raportuese.

Investimi i huaj direkt për jashtë: quhen ato investime të kryera nga sipërmarrësit vendas drejt vendeve të huaja.

IHD horizontale: ndërmerret me qëllim prodhimin e produkteve të njëjta ose të ngjashme me ato që prodhohen në vendin e origjinës.

IHD vertikale: ndërmerret me qëllim prodhimin e produkteve të ndryshme.

IHD konglomerat: përzierje e investimeve horizontale e vertikale në një industri.

IHD burimkërkuese: këto përqendrohen në vende të pasura me burime natyrore.

KAPITULLI I. HYRJE

1.1. Parathënie

Në këtë punim trajtohen një sërë çështjesh që lidhen me investimet e huaja direkte (IHD) në Republikën e Shqipërisë (RSH). Është parë me interes trajtimi i kësaj teme, nisur nga ndikimi që investimet e huaja kanë në rritjen e standardeve ekonomike të vendit si dhe nga dëshira për të thelluar edhe më shumë njohuritë mbi një fushë kaq të rëndësishme e aktuale.

Në fokus të këtij kërkimi janë gërshetimi i investimeve të huaja direkte me aspektet ligjore në Shqipëri. Punimi nuk është gjithëpërfshirës, pasi sikurse sugjeron edhe titulli i temës, janë trajtuar aspekte të bazës ligjore që kontribuojnë për të parë funksionimin e investimeve të huaja në vendin tonë. Punimi përpiqet që të njohë lexuesin me mënyrat e investimit, për këtë qëllim një sërë aktesh ligjore i janë nënshtruar analizës për të parë nivelin e mbrojtjes së të drejtave të investitorëve.

Struktura e punimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet plotësisht qëllimit të përzgjedhjes së kësaj teme, duke nxjerrë në pah elementet më tipike që lidhen me aspektet ligjore të investimeve të huaja direkte.

Duke iu referuar përvojës europiane, vërehet se gjatë dekadave të fundit prania e investimeve të huaja direkte financiare përmirëson sistemin financiar vendas, falë aftësisë rristrukturuese që ato kanë dhe ky është kanali kryesor nëpërmjet të cilit përçohen efektet në rritjen ekonomike, duke lejuar transferimin e teknologjisë, shkëmbimin e përvojave, mbledhjen e taksave nga këto biznese, uljen e papunësisë, duke ndihmuar në zhvillimin e burimeve njerëzore, etj.

Gjatë këtij studimi është vënë re se arsyet që i shtyjnë operatorët ekonomikë për të kryer investime të huaja direkte janë të shumta, por ajo që sot kryesisht i nxit ato, është fakti se kërkojnë sa më shumë hapësira për të maksimalizuar fitimet e tyre, duke u gjendur shpesh në një pozicion monopolistik për të ofruar shërbime, teknologji apo produkte që nuk gjenden në vendin tjetër ku ato ndërmarrin investimin. Gjithashtu duke iu referuar

arsyeve të kësaj nisme, nuk mund të lihet pas dëshira e tyre për të marrë kontrollin e një veprimtarie të caktuar të prodhimit jashtë vendit.

Gjatë këtij kërkimi ka dalë në pah dhe një aspekt tjetër: për vendin pritës janë të shumta përfitimet të cilat vijnë njëkohësisht bashkë me investimet e huaja, ndër të cilat mund të përmendim lejimin e qarkullimit të lirë të parasë për t'i mundësuar biznesit të operojë atje ku është perspektiva më e mirë për të investuar. IHD-të ulin, sigurisht pa mundur të çojnë deri në eliminim, efektet negative që politika ushtron në vend, si nepotizmi apo ryshfetet. Investimi i huaj, që fiton interes në ndërmarrjet që funksionojnë jashtë territorit të vendit të investitorit, përfshin një marrëdhënie afatgjatë dhe reflekton një interes të qëndrueshëm të një njësie ekonomike që operon dhe qëndron në një vend (investitori) në një njësi ekonomike që zhvendoset në një vend tjetër. Vitet e fundit investuesit e huaj po tregojnë interes të madh për destinacione që janë të pashfrytëzuara më parë nga investimet. Ndërkohë që në vende të Europës këto investime e kanë kaluar kufirin e tyre, tashmë vendet ballkanike janë kthyer si destinacion për të investuar. Në këto vende bën pjesë dhe Shqipëria, e cila pas viteve '90 është kthyer në një nga ndalesat kryesore të investitorëve.

Tashmë edhe shteti ynë e ka të qartë se të mbështesësh investimet e huaja direkte, do të thotë të mbështesësh ekonominë e vendit, pasi rritja e flukseve hyrëse të tyre do të thotë rritje dhe përmirësim i aktiviteteve të ndryshme, siç është punësimi, teknologjia etj. Të orientosh përqendrimin e vëmendjes së një shteti ndër të tjera tek investimet e huaja, është një hap mjaft i rëndësishëm, pasi investimet e huaja janë një temë që i intereson jo vetëm botës së investuesve të huaj, por edhe biznesit vendas, botës së punësimit, botës së zhvillimeve të fushave të ndryshme, siç është turizmi, infrastruktura, energjia, bujqësia etj.

Të tërheqësh investimet e huaja do të thotë t'i japësh një mbështetje shumë të rëndësishme ekonomisë së vendit, prandaj kjo çështje shikohet me prioritet të lartë nga qeveritë e çdo vendi dhe masat që ndërmerren nga shtetet për tërheqjen e IHD-ve janë të shumta, duke filluar nga ulja e taksave dhe barrierave administrative, përmirësimi i legjislacionit, krijimi i klimës së favorshme për zhvillimin e biznesit, promovimi i vendit etj.

Shteti shqiptar, për tërheqjen e investimeve të huaja, promovon vendin¹ duke u mbështetur tek avantazhet e tij kokurruese që janë:

1. Pasuritë natyrore në jugperëndimore të Shqipërisë, e cila është e pasur me naftë dhe gaz natyror, në verilindje gjenden rezerva të konsiderueshme të mineraleve, ndër të cilat mund të përmenden bakri, kromi, hekur-nikeli.
2. Klima mesdhetare, si faktor primar për zhvillimin e një sektori të tillë parësor të ekonomisë, të prodhimit të produkteve bujqësore, si dhe burimet ujore të pastra, të cilat përbëjnë një nga potencialet natyrore më të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë së turizmit.
3. Ekzistenca e bregdetit shqiptar (gati 450 kilometra i gjatë), i liqeneve, lumenjve janë një mundësi shumë e mirë për tërheqjen e sa më shumë investitorëve. Përmendim atraksione si Kanionet e Osumit, një sërë parqesh kombëtare, si potenciale të rëndësishme ekologjike në fushën e turizmit, madje dhe ekoturizmit, qytetet historike.

1.2. Metodologjia e përdorur në punim

Nëpërmjet këtij seksioni të punimit, lexuesi njihet me mënyrën se si është realizuar studimi. Duke përmendur këtu të gjithë përbërësit të cilët kanë ndikuar në përfitimin e rezultateve. Falë qasjes metodike dhe metodave këkimore bëhet gjithashtu dhe prezantimi se sa të përshtatshme kanë qenë këto metoda në temën kërkimore.

1.2.1. Qëllimi i punimit

Për efektin e kuadrit ligjor ndaj IHD-ve, është diskutuar pak. Për këtë arsye, **ky studim ka për qëllim të analizojë ndikimin që ushtrojnë efektet ligjore në prurjet e IHD-ve në Shqipëri**. Qëllimi kryesor i këtij punimi është t'u japë përgjigje pyetjeve hulumtuese si pjesë e rëndësishme e një studimi, duke qenë se ato shprehin qëllimin e hartimit të

¹ Për promovimin sa më të mirë të këtyre vlerave, janë marrë masa të shumta, ku së fundmi është ngritur grupi i punës për hartimin dhe përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Udhëzim nr. 12, datë 02.02.2012. Investimet gjithashtu zënë vend të konsiderueshëm në strategjinë për periudhën 2013-2020, si strategji pasardhëse e asaj të viteve 2007-2013, e cila ishte mjaft e suksesshme në zbatim.

punimit si dhe drejtojnë procesin e kërkimit shkencor. Pyetjet thelbësore për të cilat është me vlerë të diskutohet në këtë kërkim janë:

- *Sa ka ndikuar kuadri ligjor në prurjet e IHD-të në Shqipëri?*
- *A është favorizues dhe transparent për investuesit e huaj kuadri ligjor i vendit?*
- *A po zbatohen në vendin tonë praktika të mira për të përmirësuar klimën e biznesit dhe rritjen e investimeve?*
- *A po bëhet progres nga ana e ligjvënësist shqiptar në përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon marrëdhënien midis investorëve të huaj dhe shtetit shqiptar?*

Nuk është e lehtë, të argumentosh se në ç'masë ndikon legjislacioni në prurjet e IHD-ve, pasi ky nuk është i vetmi faktor ndikues, aq më tepër nuk mund ta konsiderojmë thjesht një katalizator që përshpejton investimet e huaja direkte. Kjo është dhe arsyeja pse në këtë punim është bërë përpjekja që të shqyrtohet teorikisht dhe praktikisht çështja në fjalë. Në përgjigje të këtyre pyetjeve, punimi ka përgjithësisht natyrë përshkruese dhe shpjeguese.

1.2.2. Hipoteza

Hipoteza e ngritur në këtë punim ka të bëjë me shqyrtimin e marrëdhënies shkakore, pra pohimit se ndryshimi në “A” shkakton një ndryshim në “B” (Metthews, Ross, 2010, 59). Duke shpresuar që vendi ynë të bëhet lider në fushën e IHD-ve në të ardhmen, hipoteza që ngrihet në këtë kërkim është: ***Nëse në Shqipëri funksionon një kuadër ligjor lehtësues ndaj investimeve, atëhere do të vërehet ndikim dhe në rritjen e flukseve hyrëse të IHD-ve***². Rëndësi për kuadrin ligjor të një vendi ka dhe stabiliteti i tij, si një nga elementët kyç për një mjedis politik që mbështet klimën e investimeve³. Gjithashtu, rritja e flukseve hyrëse të IHD-ve në Shqipëri varet dhe nga një faktor tjetër mjaf i rëndësishëm që ka të bëjë me zgjidhjen e problematikave që lidhen me çështjen e pronës⁴.

² Hipoteza bazë e kërkimit (H.0).

³ Hipoteza H.1.

⁴ Hipoteza H.2.

1.2.3. Metodologjia e kërkimit

Punimi nis me një trajtim teorik të IHD-ve, së pari në lidhje me përcaktimin, rëndësinë, format, efektet, teoritë e zhvilluara ndër vite. Për hartimin e këtij punimi është përdorur një literaturë e gjerë, e cila konsiston në materiale dhe punime të shumë autorëve vendas dhe të huaj, në studime me karakter kombëtar dhe rajonal, në përdorimin e një numri të madh burimesh informacioni nga faqet zyrtare të institucioneve të rëndësishme. Më tej vazhdohet me një analizë ndër vite të IHD-ve në Shqipëri, ndërsa pjesa më e rëndësishme i lihet kuadrit ligjor.

Nxitja për kryerjen e një studimi të tillë erdhi si përpjekje për të krijuar lidhje mes kuadrit ligjor në ndryshim dhe IHD-ve si një variabël kryesor i intervistës të realizuar për nxjerrjen e rezultateve të kërkimit. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur intervista e strukturuar, e cila përmban pyetje me shumë alternativa si dhe të mbyllura. Kampioni i studimit përbëhet nga subjekte që i përkasin grupit të investuesve të huaj që investojnë në Shqipëri. Administrimi i intervistimit është bërë nga autorja. Kërkimi është zhvilluar gjatë periudhës mars 2015 – maj 2015.

Në kuadër të kësaj analize janë përdorur tabela dhe grafikë⁵ për të ilustruar më mirë përfundimet dhe nga ana empirike përmes intervistës së strukturuar me pjesëmarrje të investitorëve të huaj. Kjo intervistë, e cila u përzgjedh pas një reflektimi në lidhje me faktin se cila metodë do të ishte më e përshtatshme në arritjen e rezultateve optimale, duke qenë se kjo metodë të lejon marrjen e informacioneve, opinionëve nëpërmjet përdorimit të pyetjeve dhe dialogut ndërveprues.

Pra, për mbledhjen e të dhënave është përdorur metoda e përzier, duke bërë kombinimin e metodës cilësore me atë sasiore për të arritur më mirë qëllimin e kërkimit. Zgjedhja e kampionit ka qenë e fokusuar tek zgjedhja e rasteve të një numri të vogël të investuesve,

⁵ Edhe pse tema synon të lërë jashtë çfarëdolloj analize financiare, ekonomike, është parë me vend përfshirja e disa grafikëve e tabelave për të dhënë një përmbledhje të vijueshmërisë së investimeve të huaja në vendin tonë, duke e lidhur këtë fakt dhe me ndikimin që kanë pasur aspektet ligjore, si dhe për të pasqyruar të dhënat e intervistës.

që kanë bërë të mundur eksplorimin e pyetjeve hulumtuese në thellësi dhe përpunimin e mbledhjen e të dhënave, pra kampioni ka qenë i qëllimshëm (homogjen).

Nisur nga përfundimet se investimet e huaja direkte ndikohen nga legjislacioni në funksion të lehtësirave që u krijohen atyre, analiza thellohet më tej në situatën e kënaqësisë së investorëve të huaj për disa IHD-ve aktive në vend, si dhe në përcaktimin e faktorëve të tjerë lehtësues të tyre, mbështetur në opinionin dhe vizionin e vetë kompanive të huaja. Ajo çfarë studiohet më tej në punim është dhe lidhja pritshmëri-realizim-reflektim.

Këta faktorë janë analizuar duke matur përvojën me pritshmëritë e firmave para se të bënin investimin, tregues ky së pari, në lidhje me informacione të përgjithme, për trajtimin e situatës reale të IHD-ve në lidhje me legjislacionin, disa nga pyetjet e ngritura në intervistë janë:

- *Cilët janë faktorët ligjorë ndikues në përthithjen e IHD-ve në vendin tonë?*
- *A ndryshon trajtimi që bën ligji për kompanitë e huaja në raport me ato shqiptare?*
- *Çfarë ecurie parashikohet për këto investime në një të ardhme të afërt?*

1.2.4. Objektivat e studimit

Ideja për realizimin e këtij punimi i atribuohet vendit, për përshpejtimin e përmirësimit të kuadrit ligjor, për tërheqjen e IHD-ve në RSH.

Për hartimin e materialit teorik puna është bazuar në legjislacionin për IHD-të në RSH. Në këtë kërkim janë analizuar efektet e masave të ndryshme të aplikuara nga shteti shqiptar, që nxisin të huajt për të investuar në Shqipëri si një vend i përshtatshëm për IHD-të. Gjithashtu, nëpërmjet këtij kërkimi është vlerësuar se sa të kënaqur janë realisht investorët e huaj nga ecuria e aktivitetit të tyre në Shqipëri. Në këtë kontekst disa nga objektivat që synon të realizojë ky punim janë:

- Të analizohen pikëpamje të ndikimit të shtetit ndaj IHD-ve, duke evidentuar rrugët e kësaj ndërhyrjeje nëpërmjet treguesve të ecurisë së reformave ligjore.

- Të identifikohen mënyrat që shërbejnë për një avantazh konkurrues të qenësishëm në rajon në lidhje me IHD-të.
- Të identifikohen problemet reale me të cilat përballen IHD-të në Shqipëri, duke i përcaktuar ato më pas si sfida për t'u përmirësuar në të ardhmen.
- Të analizohet në mënyrë empirike impakti i IHD-ve në Shqipëri, duke parë nivelin e performancës së IHD-ve që ndikon dukshëm në cilësinë e shërbimeve.

Pra, si një studim eksplorues, ky punim, ndër të tjera, synon të hulumtojë nëse kanë ndryshuar perceptimi i investuesve të huaj për Shqipërinë ndër vite, për stabilitetin politik të saj, klimën e favorshme të biznesit dhe përmirësimin e infrastrukturës, si disa nga politikat nxitëse që ndjekin qeveritë e vendeve pritëse për të thithur një numër të ndjeshëm të IHD-ve.

Nga ana e qeverisë shqiptare janë hartuar dhe zbatuar një sërë politikash nxitëse për të tërhequr investitorët e huaj.

1.2.5. Kufizimet metodologjike

Realizimi i këtij punimi, u ndesh me vështirësi jo të vogla, që kryesisht buronin nga mungesa e literaturës së përshtatshme në treg dhe në biblioteka. Gjithashtu dhe mungesa e përvojës në drejtimin e aspekteve ligjore të investimeve të huaja, ishte pjesë e kësaj vështirësie. Duhet theksuar se ka patur një mungesë të ndjeshme të praktikës gjyqësore vendase në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë më investuesit e huaj, e cila mund ta plotësonte edhe më tepër punimin, duke i dhënë një karakter praktik trajtimit teorik. Në këto kushte, është synuar që të bëhet një trajtim jo vetëm teorik i legjislacionit vendas, por interpretativ dhe praktik, duke kaluar më pas në hulumtime në terren, për të kuptuar më mirë konceptet dhe institucionet e përfshira në gjithë kuadrin tonë ligjor që rregullon marrëdhënien midis shtetit shqiptar dhe investuesve të huaj. Një vështirësi tjetër për realizimin e këtij punimi ka qenë dhe gjetja e kontakteve me investitorët e huaj e më pas marrja e përgjigjigjeve për një pjesë të rëndësishme të punimit siç është ajo e realizimit të intervistës. Kjo për shumë arsye, ku ndër më të rëndësishmet përmendet vendndodhjen e investuesve dhe angazhimet e tyre të shumta, të cilat kufizonin komunikimin me to.

1.3. Struktura e punimit

Struktura e punimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet plotësisht qëllimit të përzgjedhjes së kësaj teme, duke nxjerrë në pah elementët më tipikë që lidhen me aspektet ligjore të investimeve të huaja direkte.

Realizimi i këtij punimi është organizuar në gjashtë kapituj, ku secili kapitull është i ndërthurur me tjetrin, duke krijuar kështu një vijueshmëri të mendimit dhe qëllimit kryesor të punimit.

Kapitulli i parë bën prezantimin paraprak me përmbajtjen e kërkimit, më pas është dhënë qëllimi i studimit, pyetjet kërkimore të ngritura dhe metodologjia e përdorur për realizimin e tij, si dhe kufizimet metodologjike.

Kapitulli i dytë bën një panoramë të mbi literaturën për IHD-të. Fillimet e investimeve të huaja direkte dhe evoluimi i tyre deri në ditët e sotme, trajtohen gjithashtu në këtë kapitull. Për studimin e investimeve të huaja direkte në vendin tonë, punimi nis me një trajtim teorik të IHD-ve në përgjithësi dhe në mënyrë të detajuar në Shqipëri. Ky kapitull na njeh me impaktin që investimet e huaja kanë kështu ndërr vite në Shqipëri, duke përmenduar edhe disa prej investorëve më të mëdhenj që kanë zgjedhur vendin tonë si destinacion për projektet e tyre. Gjithashtu në këtë kapitull bëhet një qasje midis situatës së investimeve në Kosovë dhe asaj në Shqipëri. Krahasimi i Shqipërisë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor është një tjetër çështje që trajtohet në këtë kapitull, krahasim ky i cili na bën të kuptojmë rolin e IHD-ve në këto vende.

Kapitulli i tretë është një tablo e plotë në kohë për rritjen e fluksit të IHD-ve në vendin tonë, duke filluar me një analizë të IHD-ve në lidhje me veçoritë dhe rolin që ato kanë në ekonominë e vendit tonë. Viteve të fundit, IHD-ve u është kushtuar një interes i veçantë, gjë që e shohim edhe te politikat nxitëse që janë ndërmarrë nga qeveria për të përthithur një numër më të madh të tyre. Gjithashtu në këtë kapitull është studiuar ndikimi që shteti ka në rritjen e prurjeve të IHD-ve.

Në kapitullin e katërt paraqitet një përmbledhje e legjislacionit shqiptar për investimet e huaja, duke e parë atë në një vështrim analitik si dhe krahasues për sa u përket

ndryshimeve që ka pësuar ndër vite. Punimi vazhdon më pas me një analizë krahasuese të faktorëve motivues të ligjit shqiptar përballë IHD-ve, duke arritur në disa përfundime konkrete.

Në kapitullin e pestë analizohet opinioni i investorëve të huaj në Shqipëri duke marrë në intervistë 30 kompani investuese të huaja, bazuar në përvojën e tyre në lidhje me mjedisin e biznesit, veprimtarinë konkrete. Të dhënat e këtyre intervistave analizohen me tabela e grafikë, duke u ilustruar me opinionin e investuesve të huaj.

Në mbyllje të studimit, pra në kapitullin e gjashtë, jepen përfundimet e nxjerra gjatë studimit, si dhe rekomandime se si IHD-të të gjejnë lehtësira në kushtet e një vendi pritës siç është Shqipëria.

Konceptet kryesore në studim: IHD-të, teoritë, treguesit e IHD-ve, aspekte ligjore, agjencitë shqiptare etj.

KAPITULLI II. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË VËSHTRIM TEORIK

Në këtë kapitull do të trajtohen, së pari IHD-të, format, përcaktimet e tyre, teoritë e zhvilluara ndër vite, si ajo makroekonomike⁶ e mikroekonomike⁷. Do të vazhdohet me teorinë e Aliberit, teorinë e ndërkombëtarizimit të IHD-ve, teorinë ekletike, teorinë e ciklit të produktit, teorinë e “diamantit” të Michael Poter, treguesit më të rëndësishëm të IHD-ve, pa lënë mënjanë format bazë të IHD-ve, klasifikimin e tyre sipas kritereve dhe pikëpamjeve të ndryshme, si dhe ndarjen e IHD-ve nga këndvështrimi i investitorit, e të gjitha këto në kuadër të rëndësisë që kanë për IHD-të.

2.1. Investimet e Huaja Direkte (IHD)

- *Çfarë është Investimi i Huaj Direkt (IHD)?* Sipas përkufizimit që bën FMN⁸, Investimi i Huaj Direkt reflekton synimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm të një njësie rezidente në një ekonomi (investuesi direkt) në një njësi rezidente të një ekonomie tjetër (ndërmarrja e investimit direkt). Qëllimi i investitorit është që të ketë një ndikim të konsiderueshëm në administrimin e procesit të vendimmarrjes në ndërmarrjen e investimit direkt⁹.

Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara investimi i huaj direkt është:

“Një investim që përfshin një marrëdhënie afatgjatë e që reflekton nga ana e një subjekti, rezident në një ekonomi, një interes të qëndrueshëm dhe kontrollin mbi një ndërmarrje rezidente në një ekonomi që nuk është e investitorit”.

⁶ Makroekonomia është një degë e ekonomisë politike që studion sistemin ekonomik në tërësi. Krijuesi i saj ishte John Mynard Keynes, i cili është konsideruar edhe si një ndër ekonomistët më të mëdhenj të shek. XX për kontributin që i ka dhënë teorisë ekonomike.

⁷ Mikroekonomia është degë e ekonomisë që studion sjelljet individuale të agjentëve ekonomikë, apo sistemet me një numër të kufizuar agjentësh. Për më shumë lexo: Dominick Salvatore (2012) Microeconomia: teoria e applicazione.

⁸ Fondi Monetar Ndërkombëtar, (FMN) është një organizatë ndërkombëtare e 184 vendeve me seli në Uashington me qëllim bashkëpunimin ndërkombëtar midis këtyre vendeve

⁹ Për më shumë shiko përcaktimin e Investimit të Huaj Direkt nga pikëpamja e FMN-së, “The International Monetary Fund’s Balance of Payments Manual” <http://www.imf.org/external/index.html>.

Pra, mund të thuhet që investimi i huaj direkt është procesi ku njësia rezidente e një vendi (vendi i origjinës) merr pronësinë e aseteve, me qëllim kontrollin e prodhimit, të shpërndarjes dhe të veprimtarive të tjera të një kompanie rezidente në një vend tjetër (vendi pritës). Duhet vënë re që në përcaktimet që jepen për IHD-të përdoret shumë shpesh termi “afatgjatë” dhe “kontroll”, me qëllimin e vetëm që të bëhet sa më e lehtë dallimi mes IHD dhe investimeve të portofolit. Ky i fundit nuk kërkon një kontroll mbi ndërmarrjen, është një ngjarje afatshkurtër dhe përfshin një qarkullim të lartë të letrave me vlerë.

Një tjetër përkufizim i rëndësishëm është ai që nënvizon rëndësinë e nocionit të pjesëmarrjes në administrim (Rugman & Hodgetts, 1995: 15)” *“Investim i huaj direkt është pronësia dhe kontrolli i aseteve të huaja, që nënkupton pronësinë e plotë ose të pjesshme të një kompanie në një vend të huaj”*.

Razin (Razin, 1999: 27) argumenton se elementi i kontrollit u jep investitorëve direkt një përparësi informative mbi investitorët e huaj të portofolit dhe mbi kursimtarët e brendshëm. Shumica e firmave janë të gatshme të kryejnë investime të huaja vetëm në ato raste kur kanë 100% pronësi kapitali dhe kontroll. Të tjerët pranojnë të bëjnë investime të tilla vetëm nëse kanë të paktën kontrollin e shumicës, që është p.sh. 51% të aksioneve. Në vitet e fundit ka pasur një tendencë në marrëveshjet bashkëpunuese të IHD-ve, ku disa firma marrin pjesë së bashku duke ndarë dhe aksionet. Në këtë mënyrë, kontrolli i shumicës nuk mbahet nga asnjëra nga ndërmarrjet. Ky është shembulli i sipërmarrjeve të përbashkëta (joint ventures)¹⁰. Në këtë kontekst ia vlen të përmenden dhe disa terma të tjerë të rëndësishëm që plotësojnë kuptimin e nocionit të Investimit të Huaj Direkt, si: *investitori direkt, investimi direkt, IHD për brenda dhe IHD për jashtë*.

Fillim i shekullit XXI ka rritur shkajshmërisht mundësitë për shkëmbimet tregtare, pa kufij gjuhe apo largësie në kontekstin e globalizimit (Falco, 2012: 14). Kështu, IHD-të të cilat datojnë që në fillimet e shekullit XIX, e me ritëm më të shpejtë pas Luftës së

¹⁰ Joint Venture përkufizohet si kontratë me të cilën dy apo më shumë kompani, që mund t’u përkasin shteteve të ndryshme marrin përsipër të bashkëpunojnë në zbatimin e një projekti për të ndarë rreziqet dhe për të shfrytëzuar kompetencat e ndërsjella. Këto kompani që vendosin të bashkëpunojnë kanë për qëllim krijimin e një projekti të përbashkët të natyrës industriale, tregtare etj. dhe që vë në përdorim burimet e kontribuara nga secila ndërmarrje, duke ndarë në mënyrë të barabartë edhe rreziqet që vijnë nga investimi, humbjet si dhe fitimet.

Dytë Botërore¹¹, përfaqësojnë një alternativë që u përgjigjet më së miri nevojave të ekonomive të vendeve.

Nisur nga ndryshimet teknologjike, konkurrenca globale dhe liberalizimi i tregut, IHD-të besohet që mund të luajnë një rol kyç në procesin e integritit ekonomik global dhe këto arsye kanë motivuar përpjekjet për të krijuar teori nga më të ndryshmet që shpjegojnë shkaqet dhe efektet e IHD-ve. Arsyeja e parë është rritja e shpejtë në investimet e huaja direkte dhe ndryshimi që karakterizon shpesh modelet e zhvillimit të tyre.

Në vitet 1990, IHD-të përbënin rreth një të katërtën e flukseve dalëse të kapitalit ndërkombëtar (Instat 1991:32). Rritja e shpejtë e IHD-ve ka rezultuar nga konkurrenca globale, por edhe nga tendencat për t'i lënë sa më të lirë faktorët financiarë. Vihet re se IHD-të vazhdojnë të zgjerohen edhe kur tregtia botërore e ngadalëson ritmin e saj si pasojë e barrierave tregtare, por IHD-të mund të rriten pasi bëjnë të pamundurën për të anashkaluar pengesat (Moore, 1993:120-137). Edhe në rastin kur investimet e portofolit shterojnë, si në rastin e krizës aziatike të viteve 1990, flukset e IHD-ve nuk u prekën në mënyrë të konsiderueshme (Jeon, 1992:128). Në fakt (Lipsey, 1999) IHD-të kanë qenë burimi më i qëndrueshëm i investimeve ndërkombëtare për vendet pritëse. Kjo gjë mund të konfirmohet dhe nga të dhënat e OECD-së¹².

Arsyeja e dytë e këtij interesimi për IHD-të është lidhja me shkaqet dhe pasojat që rrjedhin nga pronësia e huaj dhe pikëpamjet mbi këtë çështje janë aq të ndryshme sa kalojnë nga njëri ekstrem në tjetrin. IHD-të nuk janë vetëm një transferim i pronësisë, pasi ato zakonisht përfshijnë edhe transferimin e faktorëve plotësues të kapitalit, përfshirë këtu ato të menaxhimit, teknologjive dhe aftësive organizative. Arsyeja e tretë përfshin faktin se IHD-të shërbejnë për të kanalizuar një pjesë të mirë të burimeve financiare drejt vendeve në zhvillim. Gjatë krizës së madhe ekonomike që kemi

¹¹ Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore shënoi dhe lulëzimin e fenomenit të IHD-ve për dy arsye themelore: Së pari, zhvillimi i teknologjisë favorizoi transportin dhe komunikacionin, gjë që krijoi mundësinë e kontrollit në distancë si kusht për zhvillimin e IHD-ve dhe, së dyti, vendet e Evropës dhe Japonia kishin nevojë për kapitalin e SHBA-së për rikonstrukcion. Në këtë periudhë SHBA miratoi një sistem taksimi që favorizoi investimet jashtë.

¹² Për më shumë shiko: <http://www.oecd.org/corporate/mne/statistics.html>.

përjetuar këto vitet e fundit, por edhe gjatë krizës së borxhit ndërkombëtar të viteve '90, IHD-të shërbyen si një nga burimet më të rëndësishme të fondeve ekonomike.

Rëndësia e tyre mund të shpjegohet dhe me faktin se IHD-të përfshijnë një lëvizje të fuqishme jo vetëm të kapitalit financiar, por edhe sepse janë të lidhura mjaft shpesh me ofrimin e teknologjisë, me aftësitë menaxheriale, me aftësitë teknike dhe ato të marketingut. Kështu, për nga pikëpamja e ekonomive ku investohet, ky fenomen mund të konsiderohet si një penetrim i huaj në çdo instancë të ekonomisë, duke përfshirë këtu si aspektin teknologjik, ashtu edhe atë organizativ. Kjo për vetë faktin që IHD-të sjellin kapitalin e nevojshëm, rrisin produktivitetin e ekonomisë nëpërmjet transferimit të njohurive dhe teknologjisë, ndikojnë në hapjen e tregjeve të reja, rrisin konkurrencën ekonomike, reduktojnë ndikimin në deficite, rritjen e punësimit dhe, mbi të gjitha, ndikojnë në mirëqenien e popullsisë.

Si rrjedhojë, mund të thuhet që IHD-të kanë mundësi ta ristrukturojnë një shoqëri dhe prania e tyre mund të cilësohet si një nga kanalet kryesore nëpërmjet të cilave transmetohen frytet e rritjes ekonomike dhe zhvillimit të një vendi. Së fundmi, IHD-të mendohen të luajnë një rol shumë të rëndësishëm për transformimin e vendeve ish-komuniste, sikurse në rastin e Shqipërisë, pasi ato plotësojnë investimet e brendshme, duke kontribuar kështu në investimet totale të vendit pritës.

Për më tepër, në rastin e ekonomive në tranzicion shihet një ndikim i rëndësishëm veçanërisht i IHD-ve, duke qenë se një nga problemet ekonomike të këtyre vendeve është fakti që nuk kanë kursime të mjaftueshme kombëtare për të financuar investimet e tyre. Si rrjedhojë, këto vende kanë nevojë të vazhdueshme për kapitale të huaja, prandaj përndjekja dhe aplikimi i tyre përfaqëson një nga politikat kryesore ekonomike.

Rritja e investimeve të huaja është një objektiv kyç për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe prioritet strategjik i qeverive, gjë që kërkon politika dhe strategji të përcaktuara mirë, si dhe përmirësime e ndryshime të vazhdueshme në kuadrin ligjor dhe institucional.

Dunning-u argumenton se motivet dhe faktorët përcaktues të IHD-ve kanë ndryshuar në kohë. IHD-të drejt vendeve në zhvillim janë zhvendosur nga kërkues tregu drejt IHD-ve

kërkues të burimeve e të rendimentit (vertikal) (Dunning, 1993: 26). Sipas tij vendet në zhvillim duhet t'i tërheqin IHD-të duke shfrytëzuar:

Hapjen e vendit. Nga njëra anë, prirja më e vogël në hapje mund të shoqërohet me një rritje të IHD-ve horizontale, sepse firma investuese përfiton nga shmangia e barrierave investuese, duke ngritur filiale prodhuese jashtë. Ndërsa tendenca e rritjes së hapjes ndikon në rritjen e fluksit të IHD-ve vertikale siç mund të pritej në një sektor për të cilin flukset ndërkombëtare të tregtisë në mallra të ndërmjetëm dhe kapitale janë të rëndësishme (Resmin, 2000). Edhe orientimi drejt eksportit duket si shumë tërheqës ndaj IHD-ve dhe kjo lidhet me rritjen e tregtisë dhe të fluksit të IHD-ve.

Përmasat e tregut dhe rritjen potenciale - Vendet me tregje të mëdha mund të shoqërohen me rritje të IHD-ve për shkak të kërkesës potenciale dhe kostove më të ulëta që lidhen me ekonominë. Studimet e bëra nga Resmini (Resmini 2000: 15-68), duke analizuar IHD-të në sektorët përpunues, arrijnë në përfundimin se vendet e Europës Qendrore dhe Lindore me popullsi të madhe tentojnë të jenë më tërheqëse për IHD-të. Të njëjtën gjë mendojnë dhe Bevan dhe Estrin (2000:10). Sipas tyre, ekonomitë në tranzicion kanë tendencë të tërheqin më shumë IHD-të.

Vlerësimi i kursit të këmbimit. Një kurs i dobët këmbimi tenton të rrisë IHD-të vertikale, pasi firma ka avantazhin e çmimeve relative më të ulëta në vendet pritëse për të blerë objekte. Një kurs i fortë këmbimi pritet të rrisë stimujt ndaj kompanive të huaja për të prodhuar në vend, duke qenë se është në një farë mënyre një barrierë për të hyrë në treg dhe që drejton më shumë drejt IHD-ve horizontale.

Efektet “Clustering” apo “efekti mbledhës”. Firmat e huaja duket se organizohen me njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve të ndryshme. Projektet shihen si një sinjal i një klime të mirë biznesi për investitorët e huaj. Kështu, investitorët imitojnë vendimet e investitorëve të tjerë, duke zgjedhur të investojnë në të njëjtin drejtim apo sektor. Ky efekt është pozitiv për investitorët e rinj, të cilët përfitojnë nga përvoja pozitive e investitorëve ekzistues në ekonominë pritëse. Ky fenomen është bërë i njohur nga Mody (Mody, 1992:17), por edhe nga studimi i rastit amerikan Barrell dhe Pain (Barrell, Ray & Pain, 1999: 925).

Cilësia e institucioneve është faktor përcaktues i pëlqyeshëm i investitorëve të huaj, veçanërisht në vendet më pak të zhvilluara. Kjo për disa arsye, së pari, sepse një qeverisje e mirë është e shoqëruar me rritje ekonomike, e cila është tërheqëse për fluksin hyrës të IHD-ve. Së dyti, se institucionet e varfra tentojnë të jenë lehtësisht të korruptueshme, duke rritur kështu kostot e investimit dhe uljen e fitimeve. Kjo i bën investitorët shumë të ndjeshëm ndaj pasigurive, duke përfshirë këtu dhe pasiguritë që rrjedhin nga institucione të brishta. Nga perspektiva e këtyre vendeve, investimet e huaja përbëhen nga burime të huaja kapitali që u shtohen burimeve të brendshme, me qëllim financimin dhe zhvillimin e këtyre të fundit. Për më tepër, investimet e huaja, duke qenë jo vetëm kapital, por dhe një paketë e gjerë burimesh, mund të sjellin përfitime më të mëdha në ekonominë pritëse, të tilla si transferimi i teknologjisë, rritja e punësimit, përmirësimi i aftësive apo ai i performancës së eksportit.

Për sa i përket ekonomisë së vendit pritës, Investimi i Huaj Direkt jo vetëm që siguron efekte të tërthorta në strukturën teknike të prodhimit, por edhe në menaxhimin dhe organizimin e aktiviteteve që ndërmerr. Efektet në vendet pritëse janë të rëndësishme për diversitetin dhe për rëndësinë ekonomike, politike dhe sociale që ato gjenerojnë. Përfitimi i këtyre efekteve nuk vjen automatikisht, por ndikohet nga zbatimi i disa kushteve të veçanta, si: përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe institucional, stabiliteti ekonomik dhe rritja e qëndrueshme, përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës etj. Politikat ekonomike i shtojnë zakonisht vendet në zhvillim që t'u drejtohen bankave tregtare për të marrë kredi, me qëllim që të zbatojnë reformat. Por me krizën e krijuar nga borxhet, IHD-të duken si mënyra më e lehtë për të tërhequr kapitalin e huaj në mënyrë konstante dhe pa ndërmarrë ndonjë rrezik financiar.

Qëndrueshmëria politike. Qëndrueshmëria politike dhe ajo makroekonomike është një nga çështjet kyç për sa i përket vendimit lidhur me investimet e huaja potenciale. Mospatja e një stabiliteti politik e bën një vend shumë pak tërheqës ndaj investitorëve të huaj, pavarësisht avantazheve të tjera që mund të ofrojë ai vend. Edhe pse ky stabilitet përmendet i fundit, nuk është më pak i rëndësishëm se faktorët e tjerë të listuar para tij.

2.2. Teoritë e zhvilluara ndër vite rreth IHD-ve

Dëshira për të marrë kontrollin e një veprimtarie të caktuar të prodhimit jashtë vendit të origjinës vjen si pasojë e fitimit të lartë ekonomik e financiar (Imbriani, Pittiglio, 2014), gjë e cila ka çuar në një influencë të gjerë të kësaj dukurie dhe në faktorët e ndryshëm që qeverisin politikatat aktive të një vendi.

Për këto arsye rreth IHD-ve janë zhvilluar teori të ndryshme ndër vite, që kanë si qëllim të shpjegojnë krijimin apo shfaqjen e këtyre ndërmarrjeve shumëkombëshe. Teoritë ndahen në dy grupe të ndryshme: *teoria makroekonomike*, e cila përpiket të japë një shpjegim në aspektin ekonomik në tërësi; dhe *teoria mikroekonomike*, që kërkon të gjejë dhe të shpjegojë kushtet e ndryshme individuale në të cilat një ndërmarrje funksionon (Caves, 1996: 12).

2.2.1. Teoria makroekonomike

Në grupin e parë të teorive makroekonomike duhet të përmendet kontributi nga Mundell në vitin 1957 (Acocella, 1994). Mundelli, për të shpjeguar lindjen e kompanive shumëkombëshe, eliminon një nga supozimet kryesore të modelit: palëvizshmërinë ndërkombëtare të faktorëve të prodhimit. Për më tepër, ai përdor disa elemente të tjera, siç janë teoritë neoklasike (Ferraro, 2012), mes tyre modeli Heckscher–Ohlin–Samuel (H-O-S). Kjo do të thotë që jo domosdoshmërisht shteti që disponon kapital më të madh të specializohet në prodhimin intensiv të të mirave kapitale, duke bërë të mundur që kapitali të eksportohet dhe të përdoret atje ku ka më shumë mungesë. Kompania shumëkombëshe sipas Mundellit është një alternativë e procesit të specializimit.

Edhe kontributi që ka dhënë Kojima në vitin 1978 vlen të përmendet në kuadër të teorive neoklasike të tregtisë ndërkombëtare. Ai gjithashtu shpjegon fenomenin shumëkombësh të kompanive përmes faktorit të vendit, sidomos faktorit të kapitalit, i cili është i ndryshëm nga ai i kapitalit në kuptimin financiar. Ai i referohet konceptit të kapitalit qoftë fizik, qoftë jomaterial, pra grupit të të gjitha atyre strukturave teknologjike dhe organizative që disponon një vend.

Sipas Kojimas (Kojima, 1978)¹³, duke marrë parasysh të dy vendet (vendi që kryen investimin dhe vendi që pret investimin), investimi direkt është realizuar nga kompania e vendit që ka avantazhet konkurruese në prodhimin e së mirës materiale në krahasim me vendin tjetër të cilit avantazhet i lindin nga njohuri të veçanta të praktikave teknologjike dhe / ose organizative që vendin pritës nuk i disponon. Pra, nga arrijmë në përfundimin se vendi në të cilin është kryer investimi ka përparësi të tjera konkurruese në përdorimin e së mirës së prodhuar. Është e qartë se Kojima këtu i referohet mbi të gjitha në prodhimin e mallrave të ndërmjetëm. Si pasojë, në qoftë se me konceptin e kapitalit jomaterial njihet teknologjia në dispozicion të një vendi, në realitet edhe kjo teori mund të konsiderohet një variant i modelit H-O-S me të cilin është braktisur hipoteza e funksioneve të prodhimeve identike (Giannetti, 2000: 8).

2.2.2. Teoria mikroekonomike

Në grupin e dytë, atë të teorive mikroekonomike vlen të përmendet kontributi që ka dhënë Hymeri (Hymer, 1960). Në këtë rast vëmendja zhvendoset tek vetë ndërmarrja, në veçanti tek zgjedhjet që kjo e fundit bën dhe tek arsyet që i justifikojnë këto zgjedhje. Sipas autorit, ndërmarrja që vendos të fillojë aktivitetin e prodhimit jashtë vendit, kuptohet që e merr vendimin duke analizuar përparësitë që ajo ka mbi tregun e vendit ku do të investojë.

Këto përparësi mund të lidhen me prodhimin e mallrave, shitjen ose dhe organizmin e brendshëm të ndërmarrjes. Të gjitha këto bëjnë të mundur që të përballet më së miri me konkurrencën që i vjen nga bizneset e vendit pritës, pavarësisht të gjitha disavantazheve që mund të lindin nga ushtrimi i aktivitetit në një “tokë të huaj”. Këto avantazhe nuk mund t’i ketë çdo ndërmarrje që operon në atë sektor.

Avantazhet lidhen ngushtësisht me një ndërmarrje të caktuar dhe për këtë arsye përkufizohen si “avantazhe në pronësi”. Edhe pse Hymer nuk është shprehur ndonjëherë rreth fenomenit të shumëkombësisë, tek teoria e tij del ky fenomen, i cili është prezantuar fillimisht nga Coase (Coase, 1937: 386-405), për ndërmarrjet si alternativë

¹³ Kojima Kiyoshi, (1978), *Direct Foreign Investment: A Japanese Model of Multinational Business Operation*, Croom Helm, Londër.

ndaj tregut, që do të thotë se ndërmarrjet zhvillohen aty ku verifikohet dështimi i tregut vendas. Është pikërisht kjo ideja që qëndron në bazë të teorisë që u zhvillua më pas nga Buckley dhe Casson “teoria e ndërkombëtarizimit” (Buckley dhe Casson, 1976: 20-50).

Në këtë rast, nuk konsiderohet thelbësore ekzistenca e avantazheve të pronësisë, por mjafton të jetë i pranishëm në tregun që do të investohet një lloj mungese efikasiteti. Kjo mungesë efikasiteti e bën atë më të përshtatshëm, ose më pak të kushtueshëm për realizimin e transaksioneve ndërkombëtare të mallrave në kuadër të përfitimeve të firmës e jo të tregut të jashtëm. Kjo teori synon më tepër të shpjegojë fenomenin e integritit vertikal¹⁴ të prodhimit sesa atë horizontal (Romeo, 2007: 23-47).

Shkurtimisht, përmbajtja e punimeve të disa prej autorëve, veprimtaria e të cilëve na bën të kuptojmë më mirë natyrën komplekse të IHD-ve na ndihmon të perceptojmë rëndësinë e tyre.

Vitet e fundit, studiuesit argumentojnë se IHD mund të nxisin teknologjinë e nivelit të lartë, duke ndikuar në rritjen ekonomike të vendit pritës, gjë që justifikon tërheqjen më të madhe të investimeve të huaja. Kështu, për shembull, Wang dhe Blomstrom (1992) i kushtojnë rëndësi transferimit të teknologjisë nëpërmjet kompanive shumëkombëshe dhe bashkëveprimit ndërmjet firmave të huaja dhe firmave vendase.

Xu (2000) argumenton se transferimi i teknologjisë nëpërmjet kompanive shumëkombëshe ndihmon në rritjen e produktivitetit në vendet e zhvilluara, por jo në vendet më pak të zhvilluara. Edhe Borensztein, De Gregorio & Lee (1995) trajtuan lidhjen ndërmjet IHD-ve dhe kapitalit human dhe arritën në përfundimin se IHD-të kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike vetëm nëse vendet zotërojnë një nivel të caktuar të kapitalit human. Lidhja ndërmjet IHD-ve dhe kapitalit human është matur nga Borenstein, De Gregorio & Lee (1998) në mënyrë empirike. Hansoni (2001) argumenton se nëse kapitali i huaj dhe vendas plotësojnë njëri-tjetrin, ndikimi përfundimtar i IHD-ve në normën e rritjes do të jetë edhe më i madh.

¹⁴ Integrimi vertikal është një shprehje që në mikroekonomi dhe në menaxhimin strategjik përshkruan zgjedhjen e një ndërmarrjeje prodhuese ose grumbulluese për një produkt të caktuar, për të integruar brenda aktiviteteve të tyre një numër sa më të madh të “hapave të ndërmjetëm” të nevojshëm për të marrë produktin e përfunduar. Kompanitë e integruara vertikalisht janë të bashkuara përmes një hierarkie dhe kanë një pronar të përbashkët. Zakonisht secili anëtar i hierarkisë merret me hapa të ndryshëm dhe produktet në fund përbushin një nevojë të përbashkët.

Punimet e të gjithë këtyre autorëve na orientojnë për të kuptuar natyrën e IHD-ve dhe rolin që kanë ato në ekonominë e vendeve pritëse.

2.2.3. Teoria e IHD-ve sipas Aliberit

Aliberi (Aliber, 1970) u përpoq t'i shpjegonte IHD-të nëpërmjet marrëdhënieve të tregjeve financiare dhe modeli i tij mund të shihet si sugjerim për firmat e huaja investuese.

Këto firma duhet të përballojnë mangësitë e tregjeve të kapitalit dhe të kurseve të këmbimit. Vite më pas, Aliberi trajtoi një pikëpamje të re për korporatat shumëkombëshe (Aliber, 1993), shpjegoi fluksin e IHD-ve që në vitet '80 të shekullit të kaluar drejt ShBA-së. Për më tepër ai shpjegoi se ndryshimet në normat relative të rritjes ekonomike të vendeve kanë një ndikim të rëndësishëm mbi vendimet dhe praktikatat e firmave investuese. Aliberi argumentoi se gjatë periudhave që normat reale të interesit janë të larta, edhe fitimet që sigurojnë firmat janë të larta. Në punimin e tij trajtohen edhe konfliktet ndërmjet qeverive të vendeve pritëse dhe korporatave shumëkombëshe.

Sezeri trajtoi argumentin e Aliberit, atë që IHD-të kanë prirje të rrjedhin nga shtetet me monedhë të fortë në shtetet me monedhë të dobët, për të marrë përparësi nga fuqia më e madhe blerëse (Haluk, 2006: 186-222). Studimet empirike e mbështesin pohimin se IHD-të mund të tërhiqen nga norma e lartë e rritjes dhe kërkesa e fortë në vendin pritës dhe mund të japim si shembull suksesin e vendeve të Azisë Juglindore në tërheqjen e IHD-ve, e cila ka ndodhur jo vetëm prej politikave të përshtatshme qeveritare, por më tepër falë rritjes ekonomike të shpejtë dhe të qëndrueshme të këtyre vendeve.

2.2.4. Teoria e ndërkombëtarizimit të IHD-ve

Duke iu referuar teoricienëve ekonomikë Buckley dhe Casson (1976: 186-222), vërejmë se ata e kritikojnë teorinë e Aliberit se IHD-të kanë tendencë të rrjedhin nga shtetet me monedhë të fortë në shtetet me monedhë të dobët, pasi kjo teori, sipas tyre, nuk arriti ta shpjegonte rritjen e kompanive shumëkombëshe evropiane dhe japoneze. Ata (Buckley

dhe Casson)¹⁵, në punimin e tyre “*E ardhmja e kompanive shumëkombëshe*”, analizuan rritjen e kompanive shumëkombëshe dhe nxitjen e tyre për të tërhequr investimet e huaja direkte, të cilat për të maksimalizuar fitimet e tyre, duke reduktuar kostot e prodhimit, duhet të krijojnë një treg të brendshëm. Buckley dhe Casson ishin ndër autorët e parë që futën përparësitë specifike të ndërkombëtarizimit në analizën e IHD-ve.

Në atë kohë IHD-të po rriteshin në industritë prodhuese të teknologjisë së lartë, ku integrimi i kërkimit dhe i zhvillimit me prodhimin dhe marketingun ishin kërkesa kryesore, si dhe theksuan rëndësinë e mangësitë në tregjet e prodhimeve të ndërmjetme, veçanërisht ato të njohurive teknike të patentuara dhe të kapitalit human, si dhe u thelluan në punimin e tyre në drejtimin e industrisë dhe në përcaktuesit kryesorë të flukseve të investimeve ndërkombëtare (Paul & Wooster, 2008: 123-246).

Këta përcaktues mund të grupohen në tri grupe kryesore:

- Maksimalizimi i fitimeve në tregje joperfekte;
- Krijimi i tregjeve të brendshme për prodhimet ndërmjetëse;
- Internalizimi¹⁶ i tregjeve brenda kufijve ndërkombëtare.

Ndërsa për krijimin e tregjeve të brendshme, Buckley dhe Casson përcaktuan katër faktorë kryesorë:

- Faktorët specifikë të industrisë në lidhje me natyrën e prodhimit dhe struktura e tregut të jashtëm;

¹⁵ Williamsoni në 1975 zhvilloi një teori që shpjegon ekzistencën e ndërmarrjeve shumëkombëshe dhe IHD-së atë të “Kostos së transaksionit/trupëzimit” (Transaction Cost/Internalisation), e cila më vonë u zhvillua nga Buckley dhe Casson (1976). Williamsoni shpjegon pse mund të jetë më me përparësi përqendrimi në aktivitete të caktuara brenda firmës sesa mbështetja në mekanizmat e tregut (si për shembull, të licencojë apo të nënkontraktojë) për të arritur të njëjtët objektiva. Ai argumenton se kur kostot e ndryshme të transaksionit, të përfshira në operimin me mekanizmat e tregut, janë më të larta sesa ato që burojnë nga ndërmarrja e aktiviteteve brenda firmës, do të preferohej trupëzimi (internalisation) – që mund të bëhet duke krijuar një filial të huaj. Buckley dhe Casson (1976) e aplikuan të njëjtin model për tregjet ndërkombëtare. Ata shpjegojnë se ndërmarrjet shumëkombëshe krijohen kur kostot shtesë të trupëzimit nëpërmjet IHD-së, janë më të vogla se përfitimet nga kostot më të ulëta të transaksioneve.

¹⁶ Internalizimi ndodh atëherë kur firma vendos të investojë në një vend përkatës, me qëllim që të mbajë nën kontroll informata dhe kompetenca bazike brenda firmës, që realisht janë burimi kryesor i konkurrueshmërisë së firmës.

- Faktorët specifikë të rajonit, për shembull, largësia gjeografike dhe aspekti social dhe kulturor;
- Faktorët specifikë të kombit, si faktorët politikë dhe fiskalë;
- Faktorët specifikë të firmës, si drejtimi, organizimi dhe menaxhimi.

Buckley dhe Casson analizuan ecurinë e progresit të studimit “*E ardhmja e kompanive shumëkombëshe*”, të bërë në vitin 1976, ku trajtohet koncepti i kompanive shumëkombëshe, analiza e hyrjes së kompanive në tregjet e huaja, ndikimi i inovacionit në zgjerimin e korporatave dhe roli i kulturës në biznesin ndërkombëtar, e cila, e kombinuar me teorinë e tregtisë dhe me teorinë organizative për të shpjeguar sipërmarrjet ndërkombëtare të përbashkëta, si dhe me teoritë e inovacionit për të shpjeguar llojet e industrisë në të cilat do të operojnë firmat, është një arritje e autorëve.

Analizimi i progresit të teorisë së ndërkombëtarizimit mbulon pesë fusha kryesore, të cilat janë:

1. Testimi i teorisë;
2. Analiza e hyrjes së firmave në treg të huaj dhe strategjitë e zhvillimit;
3. Ndërmarrjet e përbashkëta “Joint Venture”¹⁷;
4. Dinamika, risitë dhe mundësitë reale;
5. Roli i kulturës në biznesin ndërkombëtar.

Duke ndjekur të njëjtën logjikë, Hood-i dhe Young-u i konsiderojnë IHD-të si rrjedhim i mungesës së perfeksionit të tregjeve vendase në të gjithë botën (Brean, 1980:532-534). Sipas modelit të tyre, përparësitë që këto tregje joperfekte krijojnë, u japin mundësi ndërmarrjeve shumëkombëshe të konkurrojnë në një ambient të huaj.

Këto përparësi mund të burojnë nga:

- Aftësitë teknologjike e marketingu;
- Struktura e sjellje oligopolistike¹⁸ e tregjeve;

¹⁷ “Joint Venture” përkufizohet si kontratë me të cilën dy apo më shumë kompani, që mund t’i përkasin shteteve të ndryshme marrin përsipër të bashkëpunojnë në zbatimin e një projekti për të ndarë rreziqet dhe për të shfryrëzuar kompetencat e ndërsjella. Këto kompani që vendosin të bashkëpunojnë kanë për qëllim krijimin e një projekti të përbashkët të natyrës industriale, tregtare, etj. dhe që vë në përdorim burimet e kotribuara nga secila ndërmarrje, duke ndarë në mënyrë të barabartë edhe rreziqet që vijnë nga investimi, humbjet si dhe fitimet.

- Kapacitet administrues me shumicë;
- Faktorë financiarë e monetarë që përfshijnë kapital të lirë e diversifikim investimesh;
- Mundësi përdorimi të lëndëve të para etj.

Hood-i dhe Young-u (në vitin 1979) shkojnë më tej duke argumentuar se kur një firmë e ka krijuar një pozicion në një pjesë të veçantë të tregut, firmat konkurrense do ta ndjekin atë për të parandaluar rritjen e përparësive të krijuara tashmë nga kjo firmë. Gjithsesi, kjo teori nuk shpjegon arsyet e investimit të firmës që shkon e para drejt tregjeve të huaja.

Për më tepër, edhe Buckley ka shpjeguar që kjo teori duhet parë më shumë si paradigmë, sepse format e ndryshme të papërsosura të tregut mund të çojnë në forma të ndryshme ndërkombëtarizimi.

Si shembull mund të përmendim faktin që, paaftësia e tregut për t'i siguruar tregtarit që merret me shitjen e mallrave të ndërmjetëm një nivel të mjaftueshëm të kontrollit mbi cilësinë e produktit përfundimtar. Kjo mund të shërbejë si nxitje për të zëvendësuar transaksionet me integrimin e partnerit që ndodhet në fund të linjës së prodhimit. Por ndodh edhe e kundërta, që perceptimi i një rreziku, si ndërprerja e furnizimit, mund të motivojë strategjinë e integritit në fillim të linjës së prodhimit, me qëllim sigurimin e furnizimit.

Këta shembuj tregojnë që teoria e ndërkombëtarizimit është më e përqendruar në shpjegimin e funksionimit të shkëmbimeve ndërkufitare mes ndërmarrjeve dhe arsyeve që i shtojnë ato për të përvetësuar tregun e mallrave të ndërmjetëm, sesa në aftësinë e tyre për të realizuar vlerë të shtuar në nivel ndërkombëtar përmes koordinimit të aktiviteteve të shumta të prodhimit. Kjo është një nga arsyet që kjo teori nuk është e mjaftueshme për të shpjeguar nivelin dhe strukturën e prodhimit të një kompanie jashtë kufijve kombëtarë.

¹⁸ Oligopolistika është një nga llojet konkurrencës jo të plotë, e cila ka të bëjë me një strukturë të tregut në të cilën dominojnë shumë pak tregtues në shitjen e produktit dhe ku hyrja në treg e tregtuesve të tjerë është shumë e vështirë ose e pamundur.

Në mënyrë që të shpjegohen plotësisht vëllimi dhe drejtimi i aktiviteteve ndërkombëtare të kryera nga kompanitë, në fakt është e nevojshme që të integrohen variablat që kanë të bëjnë me procesin e ndërkombëtarizimit me faktorët specifikë të vendndodhjes, dhe nëse do t'i referoheshim Dunning-ut, ai është ekonomisti i parë i cili u përpoq që t'i përdorte së bashku këto lloje të ndryshme të variablave për të shpjeguar procesin e ndërkombëtarizimit në një perspektivë dinamike me anë të “paradigmës ekletike” që do të diskutohet në paragrafin që vijon.

2.2.5. Teoria ekletike (OLI)

Dunning-u është një nga autorët që e ka trajtuar më së shumti natyrën e kompanive shumëkombëshe dhe IHD-të. Këtë ai e ka bërë nëpërmjet asaj që ai quan “paradigma ekletike”. E quan kështu pasi, sipas tij, një teori e vetme nuk mjafton për të shpjeguar një fenomen aq kompleks sa ai i prodhimit ndërkombëtar. IHD-të duhet të kenë kryesisht tri përparësi specifike, në mënyrë që të jenë të suksesshme në tregjet e vendeve pritëse (Dunning, 1992). Kjo teori njihet ndryshe dhe si modelit OLI¹⁹, e cila tregon kushtet e nevojshme të ndërkombëtarizimit. Kjo paradigmë na orienton në tri përparësi specifike për suksesin e tregut.

1. *Përparësitë e pronësisë* - Firmat e huaja duhet të zotërojnë përparësi në raport (*vis-à-vis*) me firmat vendase. Për shembull, kompanitë investuese mund të kenë teknologji më të përparuar se kompanitë vendase, të cilat i transferojnë ato lehtë në vendin që do të investojnë. Gjithashtu, nëse kompanitë e huaja investuese do të kishin përparësi në burimet natyrore, në tregjet e kapitalit dhe në ekonomitë e shkallës, atëherë këto kompani do të siguronin fitime të mëdha.

2. *Përparësitë e vendndodhjes* - Një ndër arsytet pse kompanitë e huaja zgjedhin të investojnë në ekonomitë pritëse ka lidhje me përparësitë që zotërojnë këto vende. Burimet natyrore, madhësia e tregut dhe politikat qeveritare janë përcaktuesit kryesorë që nxisin IHD-të në vendet pritëse. Gjithashtu, në këto përparësi bën pjesë dhe niveli i pagave, pasi bën të mundur investimin në ato vende ku kostoja e punës është e ulët, si dhe politikat fiskale dhe shumë faktorë të tjerë të cilët investuesit i “hetojnë” para se të

¹⁹ OLI: Ownership - Pronësi, Location -Vendndodhje, Internalization- Ndërkombëtarizim.

investojnë në një vend. Megjithatë, jo të gjithë faktorët të cilët janë thelbësorë në investim njihen para se investimi të kryhet. Atëherë ndodh që investuesit t'i referohen opinionit të atyre që kanë kryer investim në atë vend. Kjo mund të konkretizohet si më poshtë në rastin e IHD-ve në Shqipëri. Një ndër rastet që investuesit nuk e njohin si problematike deri në momentin që ato investojnë, është çështja e pronave. Kjo lidhet me mbivendosjen e pronave dhe me shumë problematika të tjera që kanë të bëjnë me pronësinë. Kjo ka ndodhur kryesisht në ato investime që kanë të bëjnë me ndërtimin fabrikave, hoteleve, investime në infrastrukturë apo çdo objekt tjetër që ka lidhje me pronësinë e tokës. E gjitha kjo sjell që investuesit të mos i përfundojnë këto projekte, pasi nuk është e ditur se kujt mund t'i përkasë toka.

3. Përparësitë e ndërkombëtarizimit - Përparësia e tretë lidhet me mënyrën si kompania shfrytëzon kompetencat e saj kur tregjet janë joperfekte. Kompanitë e huaja investuese shfrytëzojnë fuqinë e tyre në treg, përparësitë e pronësisë dhe kontrollin në vendin pritës. Përparësitë e përvetësimit lidhen edhe me trajnimet dhe specializimet që kompanitë investuese u bëjnë personave që ato kanë në personelin e tyre.

Siç shihet edhe nga tri përparësitë e paradigmes së OLI-t, e dyta ka të bëjë me trajtimin e politikave përthithëse vendase dhe, nëse këto janë favorizuese, kushtëzojnë më së miri një kusht për realizimin e një investimi të huaj direkt dhe për më tepër IHD-të kërkojnë të investojnë kryesisht në ato vende ku kanë burime natyrore të pashfrytëzuara (Castellett & D'Acunto, 2006: 55-75). Madhësia e tregut është një tjetër faktor që duhet të disponojnë vendet pritëse. Efikasiteti i motivon firmat t'i shfrytëzojnë ato tregje ku nëpërmjet ekonomive të shkallës ato mund të minimizojnë kostot e prodhimit. Dhe së fundmi, IHD-të që kërkojnë asete strategjike duhet të shfrytëzojnë përparësitë specifike për të rritur fuqinë e tyre në treg. Pra, tri përparësitë kryesore të paradigmes eklektike për të shpjeguar IHD-të sipas Dunning (2000: 234) janë:

- 1. Përparësitë konkurruese që disponon një firmë krahasuar me firmat e vendeve të tjera;*
- 2. Shkallën që perceptojnë firmat për të përvetësuar tregjet;*
- 3. Vendet që gjejnë këto firma për të zgjeruar aktivitetet e tyre.*

Pavarësisht se paradigma OLI ka patur shumë kritika, ajo mbetet një nga teoritë më universale që shpjegon veprimtarinë e kompanive shumëkombëshe dhe analizon përcaktuesit kryesorë të prodhimit ndërkombëtar. Edeni, për shembull, paraqiti ecurinë e zhvillimit të paradigmes ekletike (Lorraine, 2003). Pas një analize të gjithanshme, ajo arriti në përfundimin se paradigma OLI-t është teoria që i ka qëndruar më së miri kohës, pasi ajo ende vazhdon t'i ruajë vlerat e saj.

2.2.6. Teoria e ciklit të produktit

Teoria e ciklit të produktit shpjegon ndërveprimet ndërmjet përparësive specifike të pronësisë dhe atyre të vendndodhjes (Vernon, 1966:190), sipas të cilit cikli jetësor i produktit kalon nëpër këto faza:

- *Inovacionit (daljes së prodhimeve të reja);*
- *Maturimit,*
- *Standardizimit,*
- *Rënies.*

Kjo teori përshkruan më së miri rolin e teknologjisë në tregtinë ndërkombëtare, duke trajtuar rolin e kompanive shumëkombëshe amerikane në vitet '50 të shekullit të kaluar, të cilat, duke qenë se përveç përparësive të tjera kishin edhe teknologji të përparuar, filluan të hynin në tregjet evropiane.

Sipas teorisë së ciklit të produktit, në fazën e parë kompanitë kanë teknologji të përparuar, e cila shihet si një nga përparësitë e tyre kryesore, pasi ato mund të hedhin në tregje prodhime të reja dhe me një kosto të ulët. Këto shfaqen në fillim në vendet e zhvilluara, pasi vetëm këto vende mund t'i sigurojnë teknologjitë e përparuara. Rritja e prodhimit të këtyre mallrave mund t'u ofrohet edhe tregjeve të huaja nëpërmjet eksportit.

Kur prodhimi fillon të zgjerohet, si pasojë e rritjes së kërkesës nga ana e konsumatorëve, ai hyn në fazën e maturimit. Në këtë fazë vihet re edhe një rritje e numrit të firmave prodhuese, fakt ky që ndikon në rritjen e konkurrencës dhe në uljen e

çmimit të mallit në treg. Në fazën e standardizimit, të gjitha firmat përpiqen të ofrojnë mall me çmim sa më të lirë që të jetë e mundur.

Në këtë mënyrë, firmat evropiane filluan të prodhonin mallra me cilësi të ngjashme me mallrat amerikane. Kjo teori arriti të shpjegojë investimet e kompanive amerikane në Evropën Perëndimore ndërmjet viteve 1950-1970. Sipas hipotezës së ciklit të prodhimit, firmat që kërkojnë të operojnë në tregjet e huaja duhet të kenë përparësi monopolistike ose oligopolistike. Në të kundërt, firmat duhet të kenë përparësi të tjera krahasuar me firmat vendase, në mënyrë që ato të mos operojnë në kushte pasigurie në tregjet e huaja.

Madje cikli i prodhimit fillon me supozimin se firmat duhet të ofrojnë mallra që nuk prodhohen në ekonomitë e vendeve pritëse, por në të njëjtën kohë, firmat e huaja mund të shfrytëzojnë burimet që ofrojnë vendet pritëse, që mund të luajnë një rol të dyfishtë, pasi jo vetëm shërbejnë si nxitëse për firmat e reja, por mund të jenë dhe të favorshme për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të firmave investuese.

2.3. “Diamanti” i Michael Porterit

Michael Porteri, profesor në Harvard, një nga kontribuuesit kryesorë në teorinë e strategjisë menaxheriale, i fokusuar në analizën dhe zbatimin e modeleve teorike, ka përcaktuar se si një kompani mund të arrijë një avantazh konkurrues. “*Diamond Porter*” është një model ekonomik i teorizuar nga Michael Porter në librin e tij “*The Competitive Advantage of Nations*” më 1990, i cili mund të përdoret për të identifikuar faktorët kryesorë që janë çelësi i suksesit për një vend në një sektor industrial të caktuar. Më pas ky model është miratuar e aplikuar gjerësisht në botën akademike. Sipas tij, strategjia për sjelljen e risive është e ndikuar nga dy veçori të ambientit: *konteksti kombëtar dhe pozita e kompanisë në lidhje me konkurrencën*.

Konteksti kombëtar ndikon në një sërë alternativash në dispozicion për të përfituar nga mundësitë që krijohen dhe për t’u përballur me rreziqet. “Teoria e diamantit” (Diamond Theory) (Porter, 1990) bazohet në katër faktorë që përkufizohen si përcaktuesit e vendit: *kushtet e faktorëve; kushtet e kërkesës; industritë e lidhura mbështetëse; strategjia, struktura dhe rivaliteti i firmës*.

Së bashku me rolin e qeverisë në ekonomi dhe rolin e ngjarjeve të rastësishme, promovohen ose ndalohen krijimi i kushteve konkurruese për ndërmarrjet dhe në rastin ku synohet të trajtohet impakti i kuadrit ligjor në IHD-ve në Shqipëri, vihet re nga kjo teori se politikat e një shteti janë vendimtare për përthithjen e IHD-ve.

Ndërsa pozita e kompanisë në krahasim me konkurrentët e saj ndikon në mundësitë dhe rreziqet që duhen përballuar në përdorimin e teknologjisë, sipas Porterit, shkalla e ndikimit të kontekstit kombëtar mbi aftësinë e kompanive për sjelljen e risive mund të kuptohet duke analizuar disa elemente, që së bashku përbëjnë të ashtuquajturin "diamantin" konkurrues të kompanisë. Për të krijuar modelin, Porteri si fillim identifikoi grupe të kompanive të përsosura që operojnë në të njëjtin sektor në dhjetë vende të ndryshme, pastaj vazhdoi me një analizë për të identifikuar arsyet që i kanë çuar në sukses.

Nga kjo ai përfitoi gjashtë faktorë kryesorë:

1. Kushtet e faktorëve, një grup burimesh dhe infrastrukturash të pranishme në mënyrë të konsiderueshme në vendin e zgjedhur.
2. Kushtet e kërkesës, kërkesa e fortë e brendshme për produkte dhe shërbime të çon në sjelljen e shpejtë të risive dhe futjen periodike të produkteve të reja, në mënyrë që të mbajë përparësi konkurruese.
3. Sektorët industrialë të lidhur dhe të mbështetur, të cilët rezultojnë se janë veçanërisht të avancuar dhe ndikojnë në mënyrë aktive në sjelljen e risive dhe janë stimulues për rritjen.
4. Strategjia, struktura dhe rivaliteti i kompanisë, i cili rezulton shumë i avancuar, duke shkaktuar një konkurrencë të fortë të brendshme, që stimulon sektorin.
5. Qeveria, e cila është ajo që mund të ndikojë në të katër faktorët e përmendur më lart, duke favorizuar prodhimin dhe rritjen e kërkesës, në mënyrë që të marrë një përfitim ekonomik të brendshëm dhe gjithashtu të përfitojë rritje të eksportit.
6. Rasti, i cili përbën një grup faktorësh të jashtëm të pakontrollueshëm nga vetë ndërmarrja dhe që shkaktojnë suksesin ose rënien e sektorit.

Përparësitë e kësaj teorie qëndrojnë në faktin që Porteri kërkoi të integronte tri perspektiva kërkimore: ndërmarrjet, sektorët dhe vendet, përmes një analize të

përbashkët të marrëdhënieve reciproke, ku dinamikat nuk janë spontane, sepse ato pranojnë një qeveri në nivelin institucional. E madje nga arsyeja e pestë shohim se qeveria mund të ndikojë në katër faktorë. Pra, për sa u përket limiteve, kuptohet që aftësitë konkurruese të ndërmarrjeve kushtëzohen nga sistemi kombëtar.

2.4. Treguesit më të rëndësishëm të IHD-ve

Për sa u përket treguesve të IHD-ve, do të veçohen flukset, stoqet dhe të ardhurat nga IHD-të. Flukset e IHD-ve janë investimet e reja të bëra gjatë periudhës, të cilat regjistrohen në bilancin e pagesave. Për më tepër flukset totale të IHD-ve ndryshojnë në varësi të llojit të instrumentit të përdorur për të bërë investimin:

- *Kapitali*, përbëhet nga kapitali në degë dhe aksionet e partnerëve dhe ato të filialeve (përveç aksioneve të preferuara që janë konsideruar si tituj borxhi dhe janë përfshirë në zëra të tjerë të kapitalit të IHD) dhe kontribute të tjera.
- *Fitimi i pashpërndarë*, i cili konsiston në pjesën e fitimit të investitorit direkt të pashpërndarë nga kompania. Fitimi i pashpërndarë regjistrohet me shenjë të kundërt mes të ardhurave nga IHD-të. Shenja negative tregon se të ardhurat janë marrë nga investitori dhe, në të njëjtën kohë, janë hedhur sërish si investim në sipërmarrje.
- *Burime të tjera kapitali* (huat), që përfshijnë gjithë fondet e marra hua, si ato në letra me vlerë, ashtu edhe kreditë e ndryshme tregtare investor-sipërmarrës.
- *Stoku i IHD-ve* përbën vlerën e investimit në fund të periudhës dhe kjo vlerë regjistrohet në IIP (International Investment Position) dhe për IHD-të për jashtë është i regjistruar si aset i ekonomisë që raporton, ndërsa stoku i IHD-ve për brenda, si detyrim i saj dhe janë të ndara sipas llojit të investimit.

Në këtë rast ka vetëm dy kategori:

- *Kapitali vetjak dhe fitimi i pashpërndarë*, që tregon vlerën e kapitalit të vet dhe rezervave të grumbulluara të fitimit të pashpërndarë nga periudhat e kaluara. Rezervat nga fitimi i pashpërndarë nuk paraqiten të ndara nga zërat e tjerë të kapitalit të vet si në rastin e flukseve.

- *Burime të tjera kapitali*, që përbëjnë stokun e borxhit mes investitorit direkt dhe investimit.

Duke iu referuar FMN-së, transaksionet e IHD-ve duhet të regjistrohen në bilancin e pagesave me vlerën e shtuar, sipas përkufizimit “*Transaksionet regjistrohen kur vlera ekonomike është krijuar, transformuar, transferuar, këmbyer apo asgjësuar*”.

Kështu që flukset e regjistruara nuk duhet të përputhen domosdoshmërisht me flukset e parasë të marra apo të dhëna. Në praktikë është shumë e vështirë të përdoret vlera e shtuar si parim për regjistrimin e disa transaksioneve, ndaj në shumicën e rasteve ato regjistrohen në momentin e kryerjes së pagesës. Të ardhurat nga IHD-të përbëjnë pjesën e të ardhurave të rritura të investitorit gjatë periudhës së raportimit të regjistruara në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave dhe të ndara sipas llojit të tyre, si:

- *Dividentët*, e degëve që i kalojnë investitorit direkt, para taksave, ku përfshihen si dividendët e ndarë aksionerëve të zakonshëm, si atyre preferencialë, të pagueshëm brenda periudhës dhe përfitimet.
- *Fitimi i pashpërndarë*, i cili përfaqëson pjesën e përfitimeve të realizuara nga investimet që mbahet nga investitorët për qëllime riinvestimi, i cili redukton pjesën e rezultatit që shpërndahet si dividend, si dhe
- *Interesat e huave*, të marra gjatë periudhës para taksave.

Duke iu referuar treguesve të IHD-ve, mund të kalohet në një tjetër moment për të njohur format bazë të IHD-ve.

2.5. Format bazë të Investimeve të Huaja Direkte

Natyrisht është e rëndësishme që të përcaktohen format bazë të IHD-ve në varësi të masës së zotërimit të aksioneve apo të fuqisë së votës në një sipërmarrje, dhe këto forma mund të jenë tre: *filiale, partnerë dhe degë*.

Filiali është një sipërmarrje e inkuorporuar në të cilën investitori i huaj kontrollon direkt ose indirekt (përmes një filiali tjetër) me shumë se 50% të aksioneve me të drejtë vote,

për shembull, të drejtën për të emëruar ose shkarkuar shumicën e punonjësve të administratës.

Partneri është një formë e investimit e inkorporuar, në të cilin investitori zotëron midis 10% dhe 50% të aksioneve me të drejtë vote dhe nuk ka kontroll mbi sipërmarrjen.

Dega përfaqëson një formë investimi të painkorporuar me pronësi plotësisht të huaj apo të përbashkët.

Vlen për t'u theksuar se zgjedhja mes tre llojeve të investimeve në një vend të huaj varet nga shumë faktorëve të tjerë, por edhe nga baza rregullatore që ka vendi mëmë ose pritës. Rregullat kombëtare shpesh janë më të forta për filialet sesa për degët, por kjo nuk ndodh gjithmonë, prandaj jo gjithmonë mund të merren në konsideratë.

2.6. Klasifikimi i IHD-ve sipas kriterëve dhe pikëpamjeve të ndryshme

Nëse do t'i referoheshim një klasifikimi për IHD-të, duhet të dimë se një i tillë mund të bazohet në atë çka sjell investitori nga jashtë dhe atë që blen në vendin pritës. Të tilla janë:

1. *Greenfield IHD*, ku firma e vendit mëmë vendos lehtësirat e prodhimit në vend.
2. *Aquisition IHD*, ku firma e vendit mëmë blen një pjesë apo të gjitha mundësitë e prodhimit të vendit të huaj.
3. *Joint venture*, ku firma e vendit mëmë ngre një biznes të ri të shkëputur nga vendi mëmë, që është në bashkëpronësi me një biznes të vendit të huaj.

Arsyet që mund të shtyjnë një firmë të zgjedhë njërën formë apo tjetrën mund t'i gjejmë në studime të bëra në këtë fushë. Kështu sipas Hill, Hwang dhe Kim firmat investuese marrin në konsideratë tre faktorë për vendimet e tyre: *nivelin e kontrollit*, *nivelin e burimeve të angazhuara* dhe *nivelin e përhapjes së riskut*. Kjo e fundit ka të bëjë me mundësinë që një firmë e huaj të marrë teknologjinë dhe metoda të tjera si *know-how*-të, të dijë se si përdoren në vendin pritës dhe t'i përdorë ato për të krijuar avantazhe vetjake. Këta tre autorë shprehen:

“Fatkeqësisht, në qoftë se një firmë i jep të drejtën e licencës një firme të huaj për të përdorur mënyrat e veta know-how në prodhim apo tregti, ajo vë në rrezik këtë licencë, duke krijuar mundësinë për t’i shpërndarë këto mënyra dhe për ta përdorur atë për qëllime të tjera, të ndryshme nga ato origjinale”.

2.6.1. Llojet e IHD-ve nga këndvështrimi i investitorit

Në përgjithësi, IHD-të mund t’i klasifikojmë në:

- *IHD horizontale*²⁰ (Moosa, 2002), të cilat prodhojnë në vendet pritëse të njëjtin produkt që prodhohet në vendet e tyre mëmë, por me një kosto më të ulët, për shkak të potencialeve që zotërojnë vendet pritëse;
- *IHD vertikale*²¹, si kërkuese të eficiencës, të minimizimit të kostos nëpërmjet shfrytëzimit të faktorëve të prodhimit;
- *IHD burimkërkuese apo konglomerat* (Caves, 1971: 20), që janë investime në vende të pasura me burime natyrore, që nuk ndodhen në vendet e tyre ose që janë në pronësi të konkurrentëve të tjerë, për shembull shfrytëzimi i rezervave minerale, pyjore, të naftës dhe të energjisë elektrike.

Në përgjithësi, IHD-të horizontale kryhen për të shfrytëzuar më tepër disa përparësi monopoliste apo oligopoliste, të tilla si: patentat apo produktet e diferencuara, veçanërisht nëse zgjerimi në shtetin mëmë nënkupton shkeljen e ligjeve, kurse IHD-të vertikale mund ta kryejnë procesin e prodhimit nëpërmjet fazave të ndryshme.

2.7. Korporatat multinacionale (KMN)

Është e vështirë të japësh një përkufizim të detajuar apo të identifikosh termin “shoqëri shumëkombëshe” apo “korporata multinacionale”. Gjithsesi, rëndësia e tyre është e veçantë, pasi pjesa më e madhe e IHD-ve kryhen po nga këto korporata, të cilat me

²⁰ Bashkimet horizontale kryhen nga firmat, të cilat kryejnë procese të njëjta prodhimi ose prodhojnë produkte homogjene. Këto bashkime shpesh çojnë në ekonomi me shkallë rritëse.

²¹ Bashkimet vertikale realizohen nëpërmjet firmave që operojnë në faza të ndryshme të zinxhirit të prodhimit.

kalimin e kohës janë të njohura për një pjesë të mirë të shoqërisë së globalizuar me fjalë dhe etiketime të reja, si “ndërkombëtare”, “transkombëtare” apo “globale”.

Kompanitë shumëkombëshe kanë si qëllim kryerjen e veprimtarive të ndryshme nëpërmjet degëve ose filialeve në shtete të tjera, janë gjithmonë të diskutueshme nga ekonomistët, ndikojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike të vendit. Në shumë botime të huaja, studiues të ndryshëm e vënë theksin te transferimi i teknologjisë që kryhet nga ana e KMN-ve në vendet pritëse, në të cilat ato investojnë. UNCTAD me anë të Raportit të Investimeve Botërore e ka përcaktuar shoqërinë shumëkombëshe (ose korporata transnacionale, si titullohet në raport) si një *“ndërmarrje të inkorporuar ose të pakorporuar, e cila përbëhet nga ndërmarrje mëmë, kompani vartëse dhe filialet e huaja”* (UNCTAD, 1999).

Ndërmarrja mëmë është ajo *“ndërmarrje që kontrollon pasuritë e subjekteve të tjera në vendet e huaja, zakonisht duke pasur në pronësi një pjesë të caktuar të kapitalit të tyre”*.

Filialet e huaja përcaktohen si:

“një ndërmarrje e inkorporuar ose e pakorporuar, në të cilat një investitor, rezident në një ekonomi tjetër, zotëron një pjesë në menaxhimin e saj dhe që i lejon të mbajë një interes të qëndrueshëm që zgjat në kohë”.

Filialet e huaja mund të jenë ose degë të kontrollueshme ose bashkëpunuese. Kompania vartëse, sipas UNCTAD-it përsëri, është një:

“ndërmarrje e inkorporuar në vendin pritës, në të cilën më shumë se gjysma e fuqisë votuese të aksionarëve zotërohet direkt nga një tjetër subjekt, i cili ka të drejtën të vendosë ose të heqë shumicën e anëtarëve të administratës ose organit mbikëqyrës”.

Ajo që vihet re është se ndërmarrja apo shoqëria shumëkombëshe ka evoluuar me kalimin e kohës. Ky evoluim vjen si pasojë e ndryshimeve në natyrën e operacioneve të biznesit ndërkombëtar. Këto të fundit, zakonisht u referohen aktiviteteve ndërkufitare të import-eksportit, ku mallrat prodhohen në tregun e brendshëm dhe më pas eksportohen jashtë vendit ose e anasjella.

Implikimet financiare të këtyre transaksioneve kanë të bëjnë me procesin e pagesës midis blerësit dhe shitësit gjatë kufijve kombëtare. Gjatë zgjerimit të operacioneve ndërkombëtare, ndërmarrja ndërkombëtare shtyhet nga fakti që të jetë sa më afër konsumatorit të produktit që prodhon. Si rrjedhim, prodhimi do të kryhet si në vendin e origjinës për konsumatorin vendas, por edhe jashtë kufijve për konsumatorin e huaj.

Në këtë mënyrë korporata krijon një prani në vendet e huaja me anë të filialeve dhe ndërmarrjeve të përbashkëta (*joint venture*). Këto ndërmarrje të përbashkëta apo filiale do të shërbejnë si “krahët” e shoqërisë shumëkombëshe apo korporatës multinacionale, edhe pse do të kenë një bazë të ndryshme monetare dhe një monedhë tjetër funksionale, që do të jetë monedha e vendit ku ato janë vendosur.

Meqenëse aktiviteti ndërkufitar zgjerohet edhe më shumë, dallimi midis termave “brenda” dhe “jashtë” bëhet dhe më i paqartë, duke bërë që të lindin vështirësi të tjera në lidhje me identifikimin e termit “vendi i origjinës”. Ajo që krijohet në këtë rast është pikërisht një korporatë multinacionale. Si përfundim, del i qartë fakti që një ndërmarrje mund të quhet shoqëri shumëkombëshe ose transnacionale kur ajo merr përsipër të kryejë IHD dhe zotëron ose, në një farë mënyre kontrollon, aktivitete me vlerë të shtuar në më shumë se një vend (Dunning, Lundan, 2008: 21).

Nga kjo pikëpamje, IHD-të paraqesin një zgjerim të brendshëm organizativ nga ana e korporatave multinacionale. Vitet e fundit, sidomos pas rënies së iniciativës për të krijuar një Marrëveshje Shumëpalëshe të Investimeve (MAI) (De Jonquieres, 1998) në kuadër të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) ka pasur një shtim të Traktateve Dypalëshe të Investimeve (BITs) (Stiglitz, Charlton, 2005).

Këto marrëveshje janë hartuar qëllimisht për të siguruar mbrojtje më të madhe për investitorët ndërkombëtarë, në mënyrë që të inkurajohen investimet ndërkufitare (Hallvard-Driemeier, 2003). Këto politika bashkëkohore na japin një paraqitje të shkurtër, por mjaft efikase, të rëndësisë së shoqërive shumëkombëshe, por kjo gjë nuk duhet të çojë në një anashkalim të aspektet ligjore dhe etike të ekzistencës së tyre.

Gjithashtu, një përfitim tjetër që ofrojnë KMN-të, është kualifikimi dhe trajnimi i punonjësve, me një personel të organizuar, i cili jep ndihmesën e tij duke organizuar dhe menaxhuar veprimtaritë e ndryshme në vendet pritëse për rritjen e numrit të të

punësuarve. Për shkak të numrit të madh të kompanive që operojnë në të gjithë botën, numri i të punësuarve në to është shumë i madh. Kjo përbën një nga arsyet pse qeveritë e vendeve pritëse i përkrahin këto kompani.

Një korporatë multinationale nuk duhet të ekzistojë vetëm për hir të fitimit. Në përputhje me parimet e sistemit të tregtisë së lirë, nuk mund të vazhdojë të ekzistojë pa qenë fitimprurëse e produktive e njëkohësisht pa ushtruar përgjegjësitë që rrjedhin nga pozicioni i saj. Si një subjekt aktiv i arenës ndërkombëtare, ndikimet e saj nuk kufizohen vetëm në shoqërinë ku zhvillon aktivitetin, por edhe në shumë vende të tjera.

Kjo do të thotë që, përveç fitimit, është e rëndësishme që korporata të ekzistojë dhe si një përparësi për pjesën tjetër të shoqërisë.

Gjithashtu, është e vërtetë se korporatat multinationale kanë luajtur një rol në përmirësimin e standardeve të jetesës, ndërkohë që me operacionet e tyre kanë kontribuar në shkatërrimin e mjedisit, dëm ky më tepër i pakujdesisë në garën e fitimit më të lartë, sesa diçka e planifikuar.

Në këtë këndvështrim, është thelbësore për vetë korporatat që të mos perceptohen sikur veprojnë vetëm në interesin e tyre personal, por që të kontribuojnë, përtej fitimit, në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e interesave të mjedisit, por dhe duke përmirësuar cilësinë e jetesës.

Si përfundim, pas këtij trajtimi përmbledhës të korporatave multinationale duket qartë se rëndësia e tyre qëndron në faktin e thjeshtë që ato dominojnë me praninë e tyre të jashtëzakonshme jo vetëm në investimet ndërkombëtare, por edhe në prodhimin ndërkombëtar, në tregjet, financën dhe teknologjinë globale. Prandaj çdo analizë e strukturës së marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare do të ishte e parëndësishme dhe joreale nëse nuk e merr parasysh këtë fenomen.

2.8. Faktorët nxitës të IHD-ve

Një listë e faktorëve nxitës që i shtynë investitorët e huaj për të bërë investime në vendet pritëse janë:

- *Stabiliteti politik dhe masat që merren nga ana ligjore për nxitjen e IHD-ve;*
- *Mungesa e korrupsionit dhe nxitja e konkurrencës ndërmjet firmave;*
- *Madhësia e tregut dhe perspektivat e rritjes së tij;*
- *Niveli i pagës dhe produktiviteti i punës;*
- *Infrastruktura e mirë;*
- *Përmirësimi i mjedisit të investimeve, si: regjistrimi i biznesit, procedurat e licencimit, lehtësia e të bërit biznes, mjedisi i përshtatshëm për biznes;*
- *Struktura e taksave, e cila ka një ndikim të konsiderueshëm në perspektivat e investimeve të huaja etj. (Tafa, 2007:112)*

Përveç këtyre faktorëve, investitorët, gjithashtu, theksojnë rëndësinë e faktorëve të tjerë që mund të ndikojnë tek IHD-të. Ndër faktorët të tillë, që investitorët e huaj të marrin në konsideratë, përmendim:

- *Nevoja për tregje;*
- *Nevoja për efikasitetin e prodhimit;*
- *Burimet natyrore ose materialet e papërpunuara që ndodhen në vendin pritës, si: burime nëntokësore, pyjore, burime energjie etj.*
- *Nevoja për informacion dhe teknologjia i motivon IHD-të kryesisht drejt vendeve të zhvilluara si: kompanitë e kompjuterëve, kompanitë farmaceutike etj.*
- *Sistemi i taksave - nëse politikat tatimore bazohen tek taksat e ulëta, nga ana e investitorëve të huaj mund të ketë pritshmëri më të kënaqshme. (Tafa, 2007: 388)*
- *Emri i mirë dhe ruajtja e reputacionit. Kompanitë me emër përpiqen të ruajnë reputacionin edhe në vendet e tjera ku ato operojnë, e vlefshme kjo për bankat dhe institucionet e tjera financiare, kur kompania mëmë vendos të zgjerohet.*

Nga trajtimi i bërë te ky kapitull, arrihet në përfundimet e mëposhtme:

Nga sa është trajtuar më sipër në këtë kapitull, vërehet se nga rëndësia që IHD-të mbartin, ato kanë tërhequr vëmendjen e të gjithë aktorëve të përfshirë, duke u bërë kështu objekt studimi e duke zhvilluar shumë teori ndër vite. Ky kapitull renditi treguesit më të rëndësishëm të IHD-ve, format bazë të tyre, si dhe është paraqitur klasifikimi i IHD-ve nga këndvështrimi i investitorit, por nuk janë anashkaluar faktorët

nxitës të IHD-ve dhe kjo për të trajtuar më tej rëndësinë e legjislacionit dhe ndikimin lehtësues që ky i fundit ka në përthithjen e IHD-ve.

KAPITULLI III. IHD-TË NË SHQIPËRI NË KËNDVËSHTRIMIN HISTORIK DHE KRAHASUES

Në këtë kapitull do të trajtohen çështje të cilat lidhen me ecurinë e IHD-ve ndër vite në vendin tonë, duke parë dhe ndikimin që kanë sjellë në ekonominë e vendit. Së pari, do të bëhet një vështrim në kohë për të parë se cilat kanë qenë format e para të investimit, baza ligjore që i ka përkrahur ato që me ardhjet e flukseve të para, duke përmendur këtu “*Konventën e ICSID*”.

Në vendin tonë ka një sërë burimesh tërheqëse që janë bërë objekt i IHD-ve, për të cilat do të paraqitet një përmbledhje në këtë kapitull. Hyrjet dhe tendencat e IHD-ve në vite si dhe masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare në kuadrin e programit për vitet 2014-2016 do të analizohen në këtë kapitull. Në këtë kapitull do të njihemi me investimet dhe investitorët më të mëdhenj në Shqipëri. Më tej do të vazhdojmë me një krahasim të shkurtër mes Kosovës dhe Shqipërisë, duke analizuar dhe aspekte ligjore për funksionimin e investimeve të huaja në Kosovë, si dhe reformat e të bërit biznes në këtë vend. Krahasimin e IHD-ve në Shqipëri me vendet e Ballkanit Perëndimor, nuk do të anashkalohet, por do të paraqesim rëndësinë e veçantë të mbrojtjes së investitorit në Shqipëri e më pas duke kaluar në mbrojtjen e investitorit në rajon.

3.1. Vështrim ndër vite rreth IHD-ve

Në Shqipëri IHD-të kanë qenë dhe janë një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen ekonomike. Ato po ndikojnë pozitivisht për zhvillimin e ekonomisë, duke sjellë uljen e papunësisë, përmirësimin e teknologjive, shkëmbimin e eksperiencave si dhe rritjen e standardeve të jetesës. Prandaj shpeshherë me të drejtë janë konsideruar dhe si “lokomotiva e vendit”.

IHD-të, edhe pse gjatë viteve kanë pasur një ecuri të qëndrueshme drejt rritjes, janë një fenomen mjaft i ri në kontekstin e ekonomisë shqiptare, sidomos e krahasuar kjo me vendet e tjera të rajonit.

Pas shembjes së një sistemi ku mbizotëronte centralizimi i çdo hallke ekonomike, politike, shoqërore etj., në duart e shtetit, Shqipëria u ballafaqua menjëherë me një sërë problematikash të ndryshme, si: thesari pothuajse i zbrazur, njësitë prodhuese në falimentim, dështim të strukturës ligjore e politike, si dhe një konfuzion që ishte përhapur në të gjithë shoqërinë. Por vendi arriti t'i bëjë ballë një situatë të tillë falë ndihmës ekonomike të lëvruar nga Perëndimi dhe duke tejkaluar parashikimet e shumë njerëzve brenda dhe jashtë vendit, Shqipëria u përcaktua si një zonë me mundësi për investime të drejtpërdrejta nga bota dhe si një ndër vendet me ritme më të larta të rritjes së produktit të përgjithshëm të brendshëm në Europë.

Impakti i parë i tranzicionit për ekonominë e tregut shkaktoi shumë probleme makroekonomike gjatë viteve 1991-1992, prodhimi i brendshëm bruto ra 40%, inflacioni arriti nivelin 226% dhe norma e papunësisë u rrit në 27.9% (Angjeli, 2013). Shqipëria trashëgoi një situatë në të cilën kishte njësi prodhuese me një teknologji të vjetër dhe makineri të amortizuara, mungesë e theksuar e infrastrukturës në përgjithësi, një sistem ligjor i paplotë, një burokraci shtetërore agresive, pra në një vend që nuk të ofronte tërheqje për të investuar dhe kjo falë tranzicionit që po kalonte.

Sigurisht që nuk mund të mos merren në konsideratë dhe të mirat që u trashëguan bashkë me një sërë problematikash. Në këtë kohë në Shqipëri ekzistonte një forcë e re punëtore e gatshme dhe plot dëshirë për të ndërtuar të ardhmen e vendit.

Reforma e plotë stabilizuese dhe strukturore filloi të zbatohet në mes të vitit 1992, me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Programi i stabilizimit u mbështet në paketën standarde që konsistonte në liberalizimin e çmimeve, në politikën fiskale që synonte balancimin e deficitit buxhetor, në politikën shtrënguese monetare nëpërmjet kontrollit të rritjes së ofertës monetare dhe në liberalizimin e tregtisë së jashtme. Paralelisht me paketën stabilizuese u ndërmorën reforma strukturore për privatizimin, rrjetin e mbrojtjes sociale në investime, në sistemin e taksave, në sistemin financiar e bankar, si dhe në krijimin e një kuadri ligjor për një ekonomi tregu.

3.2. Panorama e pasurive natyrore në Shqipëri si mundësi për zhvillimin e IHD-ve

Burimi kryesor i të ardhurave të një kombi është shfrytëzimi i pasurisë së tij natyrore dhe potenciali njerëzor në funksion të saj. Njohja e veçorive fizike dhe statusit ligjor të pronës, bashkëveprimi midis tyre për të përfituar sa më tepër produkte dhe të mira materiale, përbën bazën më të fuqishme arsyetuese për rritjen e produktit kombëtar e për rrjedhojë edhe të mirëqenies së komunitetit (Tafa (Bungo, 2007:21). Shqipëria është e begatë me pasuri natyrore të shumta (MASH, 2003)²² krahasuar me sipërfaqen e saj të vogël.

Pjesa jugperëndimore e vendit është e pasur me naftë dhe gaz natyror. Ndërsa në verilindje gjenden rezerva të konsiderueshme të mineraleve, ndër të cilat vlen të përmenden: kromi, hekur-nikeli, bakri, qymyri dhe burime hidrotermale, që ndodhen në ofiolitet e Shqipërisë. Për më tepër mund të përmendim edhe rezervat e naftës dhe gazit bruto. Këto rezerva janë objekt investimi i shoqërive të huaja, të cilat sipas legjislacionit përkatës mund të marrin të drejtën për të investuar në miniera.

Shqipëria dallon për pasuritë e mëdha të rinovueshme, gjithashtu edhe për klimën mesdhetare²³, e cila është në vetvete një pasuri natyrore dhe një faktor i ndihmës për zhvillimin e një sektori të tillë parësor të ekonomisë siç është prodhimi i produkteve bujqësore. Prej vitesh, ky lloj investimi, në vendin tonë është përqaftuar nga investues italianë. Shqipëria është mjaft e pasur me burime ujore: ajo ka dy dete me dalje të gjerë në bregdet, shumë liqene e lumenj, të cilët, në këtë kuadër, paraqesin rëndësi të veçantë për zhvillimin e turizmit. Veç hidrocentraleve ekzistuese mbi lumin Drin, janë bërë hulumtime, që potenciali i lumenjve të rrëmbyeshëm të shfrytëzohet për ndërtimin e disa hidrocentraleve me të cilat vendi do të bëhet eksportues i madh i energjisë elektrike²⁴.

²² Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Akademia e Shkencave (2003), Programi Kombëtar për Kërkim e Zhvillim, "Pasuritë Natyrore".

²³ Shqipëria përfshihet në brezin me klimë tipike mesdhetare dhe dallon për sasi të konsiderueshme të rrezatimit diellor, që janë nga më të lartat në Europë. Sasia mesatare vjetore e rrezatimit diellor është 1460 KWR/m², ndërsa zgjatja e diellzimit luhetet mesatarisht nga 2841 orë në vit në Fier deri 2000 orë në vit në Kukës.

²⁴ Shqipëria dallon për një rrjet të pasur dhe të zhvilluar të hidrografisë, që është i përbërë nga lumenj, burime, liqene, si dhe nga ujërat e hapësirës bregdetare në Adriatik e Jon. Kjo bën të mundur që

Ekzistojnë një sërë parqesh kombëtare, të cilat përbëjnë potenciale të rëndësishme ekologjike, që mund të shfrytëzohen mjaft mirë edhe në fushën e ekoturizmit (Bakiu, 2006:8-25). Pasuria kulturore, qytetet artistike ose historike, janë gjithmonë e më të privilegjuarat nga pikëpamja e vëzhguesve dhe ruajtësve të artit dhe kulturës, bashkë me ruajtjen e ndërtesave dhe pasurisë arkeologjike, artistike, që përforcojnë interesat e këtyre zonave urbane, duke shtuar investimet dhe përfitimet ekonomike.

Flukset turistike japin kontributin e tyre, duke e përqendruar vështirimin në aspektet ekonomike dhe të punësimit, duke nënvizuar vlerën e aktiviteteve kulturore dhe kontributin e tyre në ndërthurjen dhe mbarëvajtjen e raporteve sociale, në identitetin rajonal dhe në zhvillimin e komunitetit në kontekstin urban.

Gjithnjë e më shumë turizmi po shndërrohet në furnizuesin kryesor të ekonomisë me të ardhura, si: turizmi bregdetar, me: Durrësin, Vlorën, Sarandën, Divjakë, Velipojën, Shkodrën; turizmi malor, me: Voskopojën, Razmën, Vermoshin, Bogën dhe Vuklin, unike për bukurinë natyrore, si dhe parqet kombëtare të Luginës së Valbonës, të Thethit, të Dajtit etj.

3.3. Ecuria ndër vite e IHD-ve në Shqipëri dhe “Konventa e ICSID”

Në Shqipëri deri në vitet '90, ishte e pamenduar që të mund të flitej për eliminim kufijsh, lëvizje të lirë të mallit apo investime të huaja, dhe ajo konsiderohej si vendi më i varfër i Evropës Juglindore. Ekonomia e vendit gjatë asaj kohe ishte e bazuar në

Shqipëria, për sa i përket potencialit të saj ujqor, të radhitet ndër vendet e para në Evropë (Vjollca Bakiu “Turizmi në Shqipëri”, 2006).

Shqipëria është shumë e pasur edhe me burime të ndryshme nëntokësore: Struktura dhe përbërja litologjike e territorit me praninë e shkëmbinjve, me përshkueshmëri të lartë ujore, si shkëmbinjtë karbonatikë (gëlqerorë dhe dolomitë) sulfatikët (gipse, anhidrite) etj., të cilat zbulohen në një sipërfaqe prej 6500 km ose në rreth $\frac{1}{4}$ e territorit, bëjnë që vendi ynë të dallojë për një pellg të fuqishëm hidrogeologjik. Tregues të pasurive ujore të vendit tonë janë dendësia dhe ujshmëria e madhe e rrjetit hidrografik (vlerat e larta të volumit ujqor vjetor, të koeficientit, modulit dhe shtresës së rrjedhës). Kushtet e përshtatshme gjeografike të vendit tonë për një pasuri të tillë janë shtrirja e gjerë e shkëmbinjve karbonatikë të përshkueshëm (23% e sipërfaqes së vendit) dhe atyre mesatarisht të përshkueshëm nga shkalla e lartë e tektonizimit (58 % të sipërfaqes), shkalla e lartë e copëtimit të relievit (1,7-3 km /km²) reshjet e shumta (mesatarja 1480 mm) dhe regjimi i tyre tipik mesdhetar, degradimi i mbulesës bimore dhe prania e mbulesës bimore gjetherënëse etj. Rrjedhojë e zhvillimit të këtyre kushteve në vendin tonë është zhvilluar një rrjet hidrografik me gjatësi 49027 km me një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 43306 km² (Vehbi Velija, “Për ku je nisur Shqipëria ime?”, 1996).

pronën shtetërore, e centralizuar dhe e komanduar nga shteti dhe jo vetëm që nuk njohu rritje, por pësoi rënie deri në gjendje kolapsi. Megjithatë gjatë regjimit komunist, për sa u përket investimeve të huaja, njihet vetëm suksesi i lëshimit të koncesioneve disa kompanive të huaja për shfrytëzimin e burimeve natyrore, kompani që hynë në Shqipëri në mesin e viteve 1980.

Në vitin 1991²⁵ qeveria e asaj kohe vendosi të pranojë anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Gjithashtu me këtë anëtarësim, qeveria u autorizua të nënshkruajë dhe të ratifikojë “Konventën e ICSID”,²⁶ e zgjidhjes së konflikteve në investimet midis shtetit dhe shtetasve të huaj. Në atë kohë u autorizua Ministria e Financave, ose ndonjë person tjetër i caktuar prej këtij institucioni, për të nënshkruar origjinalet e neneve të marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare dhe Shoqatën së Konventës themeluese të Agjensisë dhe Konventën e ICSID dhe për të ekzekutuar e depozituar çdo instrument të pranimi dhe dokumentet e tjera që mund të kërkoreshin për atë qëllim.

Konventa e ICSID është Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve për Investimet në Uashington. Kjo është një strukturë ndërkombëtare brenda kuadrit të grupit të Bankës Botërore dhe funksionon në bazë të Konventës së Uashingtonit. Kjo qendër ka natyrën e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, por përfshirja e saj në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën tregtare kushtëzohet nga dy gjëra: së pari, nga fakti nëse shteti shqiptar ka lidhur marrëveshje për mbrojtjen e investimeve me shtetin nga i cili është pala paditëse dhe, së dyti, nga fakti nëse pala paditëse është investuese.

Që në fillim të viteve ‘90 fluksi i investimeve mori një tjetër zhvillim, falë reformave që u ndërmorën. Shqipëria pati një ecuri ekonomike të qëndrueshme, por fenomeni i IHD-ve për një vend postkomunist ishte i ri dhe nuk ishte hasur ndonjëherë, ndaj edhe legjislacioni mungonte. Kështu, për t’u dhënë një provë sigurie e garancie faktorëve ndërkombëtarë, në nëntor të vitit 1993 vjen ligji “Për Investimet e huaja”, i pari në këtë

²⁵ Ligji “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtimin dhe Zhvillimin, në Korporatën Financiare Ndërkombëtare, në Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, në Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konflikteve të Investimit”, 10.01.1991.

²⁶ Do të trajtohet më gjerësisht në kapitullin IV.

drejtim. Për të parë ndikimin që kanë pasur faktorë të ndryshëm, si: futja e një sistemi të ri, e legjislacionit dhe përmirësimit të tij, nismat e ndërmarra nga qeveritë etj., më poshtë do të analizojmë ecurinë e IHD-ve ndër vite.

Nga të dhënat e Ministrisë së Ekonomisë, totali i hyrjes së IHD-ve në Shqipëri për periudhën 1992-1999 ishte afërsisht 458 milionë USD (ME, 2005). Kjo shifër është cilësuar si relativisht i vogël. Kjo ndoshta lidhet me faktorët politikë e historikë të përmendur më sipër. Megjithatë, ligjvënësi në këtë periudhë është kujdesur për ndërmarrjen e nismave për të përthithur sa më shumë IHD, kjo pasi nga viti 1992-1996 firmat e huaja që investonin në Shqipëri, ishin të përjashtuara nga pagimi i tatim-fitimit, nga detyrimet doganore për linjat e prodhimit dhe makineritë e ndërtimit, që investoheshin në vendin tonë. Ky lloj përjashtimi ngjalli interes tek investuesit, duke e bërë vendin edhe më tërheqës dhe duke sjellë rritje të numrit të investimeve. Këto lloj “*pushimesh tatimore*” zgjatën deri në 28 dhjetor ‘98, kohë kur hyri në fuqi ligji i ri i Tatimit mbi të Ardhurat (Ligji 8438, 1998). Duke parë shifrat e flukseve të IHD-ve gjatë viteve të tranzicionit, është e qartë se që prej fillimit të tij e deri në vitin 1996, ka pasur një tendencë rritëse të kapitalit të huaj në Shqipëri.

Në vitin 1997 vendi hyri në një periudhë paqëndrueshmërie ekstreme, që erdhi si pasojë e përmbykses së skemave piramidale. Pas periudhës së vështirë të vitit 1997, investimet e huaja pësuan një rënie prej 50% në krahasim me ecurinë e tyre gjatë viteve 1995-1996. Imazhi i Shqipërisë në arenën botërore gjatë kësaj kohe linte për të dëshiruar dhe përmirësimi i situatës dukej i vështirë, thuajse i pamundur. Pas krizës së vitit ‘97 qeveria e asaj kohe filloi zbatimin e një programi të mbështetur dhe nga donatorët ndërkombëtarë, duke thelluar reformat strukturore, sidomos në fushën e privatizimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, gjë e cila ndihmoi në ecurinë e përgjithshme ekonomike të vendit.

Sipas Bankës së Shqipërisë, IHD-të janë rritur në mënyrë të konsiderueshme nga 1998 në 2003, kryesisht si rezultat i privatizimeve (BSH, 2004). Periudha 1993-2000, për sa u përket IHD-ve, ka pasur luhatje të vazhdueshme dhe kjo si pasojë e gjendjeve politike të shtjelluara më sipër. Në vitin 2000 IHD-të ishin në nivelin e 190 milionë USD dhe vazhduan të rriteshin edhe në vitin pasardhës. Ato po shënonin një arritje të kënaqshme, ku vlera e investimeve përbënte 3,8% të PBB si rezultat i privatizimit nga të huajt i disa

ndërmarrjeve të rëndësishme të ekonomisë kombëtare, si: AMC-ja, Banka Kombëtare Tregtare, Fabrika e Çimentos Fushë-Krujë, Fabrika e Qumështit “Ajka” etj., si dhe falë investimeve nga kompanitë telefonike “Cosmote” dhe “Vodafone”. Viti 2004 vazhdon të shënonte rritje të IHD-ve në 340 milionë USD. Kjo rritje erdhi si pasojë e shitjes së Bankës së Kursimeve për 200 milionë USD, e cila u ble nga “Raiffeisen Bank”. Deri në fund të vitit 2004 pothuajse të gjitha ndërmarrjet e mesme shtetërore u privatizuan, më pas viti 2005 u shoqërua nga një rënie e nivelit të IHD-ve. Vitet që pasuan 2006, 2007 dhe 2008 u karakterizuan nga një rritje e theksuar e IHD-ve, e cila vinte si pasojë e procesit të privatizimit dhe krijimit të zonave e parqeve industriale, si dhe përmirësimit në fushën e legjislacionit²⁷. Për sa i përket rritjes së IHD-ve të shërbimeve financiare që vihet re gjatë vitit 2008, kjo është pasojë e blerjes së aksioneve të Bankës Popullore dhe “Union Bank nga investitorët e huaj. Edhe vitet në vazhdim 2009 dhe 2010 u shoqëruan me rritje të IHD-ve në shifrën 793 milionë euro në fund të vitit 2010. Po në këtë vit, Shqipëria renditej e dyta për sa u përket prurjeve të IHD-ve midis vendeve të Evropës Juglindore pas Serbisë. Meqenëse Shqipëria ishte në fazat fillestare të përthithjes së IHD-ve, pjesa më e madhe e tyre kanë qenë në formën e kapitalit aksionar në biznese të reja, por edhe si shtesa kapitali në sipërmarrjet ekzistuese me investime të huaja. Nga kjo kuptohet që kanë marrë formën e kapitaleve aksionere, fitime të riinvestuara, por dhe forma të tjera kapitali. Kapitali aksionar dhe fitimet e riinvestuara përbëjnë pjesën më të madhe të prurjeve të IHD-ve në Shqipëri. Vlera e tyre arriti në rreth shifrën 97% në fund të vitit 2009 (Raporti vjetor i BSH-së, 2009). Në vitin 2010, forma e kapitalit aksionar arriti afërsisht në masën 80 për qind dhe kjo shifër u rrit më tepër në vitin 2011. Këto dy vite janë konsideruar si vite të begata për sa u përket IHD-ve, pasi flukset hyrëse të tyre kanë qenë në rritje. Ky fakt mund të lidhet dhe me ndryshimet që pësoi ligji “Për Investimet e huaja”, duke shtuar konceptin e “Mbrotjtjes së posaçme”. Krahasuar me formën e kapitalit aksionar, fitimet e riinvestuara përbëjnë një pjesë më të vogël, ndërsa format e tjera të kapitalit janë pothuajse të papërfillshme. Fitimet e riinvesturara përbëjnë afërsisht 20% të investimeve hyrëse, ndërsa format e tjera të kapitalit në vitet 2009 dhe 2011 dolën me vlera negative. Këto prurje janë edhe si pasojë e privatizimit që ka ndodhur gjatë këtyre viteve në Shqipëri, përfshirë këtu edhe

²⁷ Tabela 3.3.1 Shtojca 1, faqe 180.

privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Siç mund të shihet²⁸, përbërja sektoriale e IHD-ve ka pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë viteve, sidomos nga 2006 deri në 2011. Fillimisht, ka pasur një rritje të shpejtë të investimeve në industri, përfshirë këtu minierat dhe manufakturën. Me kalimin e kohës, e pikërisht gjatë vitit 2011, ka pasur rritje në sektorët e energjetikës, të gazit. Ndërsa sektorët e tjerë kanë pësuar rënie krahasuar me vitet e mëparshme. Sipas BSH-së, ndër vite ka pasur boom-e të investimeve të huaja direkte. Lloji i IHD-ve që kanë hyrë deri tani në vendin tonë është përqendruar kryesisht tek prodhimi i shërbimeve për tregun vendas, por ka pasur IHD hyrëse në sektorin e manufakturës, të minierave dhe të energjisë, që kanë siguruar edhe eksporte. Do të ishte më e favorshme për Shqipërinë që të siguroheshin ato IHD që gjenerojnë më shumë eksporte dhe shërbime.

Për sa u përket projekteve të reja, numri më i madh i tyre nisi fillimisht në sektorët e shitjes dhe marketingut, ndjekur nga sektorët e transportit dhe shërbime të tjera biznesi. Përgjithësisht, numri më i madh i projekteve të investimeve ka qenë në sektorin e shërbimeve. Sasitë më të mëdha të fondeve për investime kanë qenë në fushat e energjetikës, të prodhimit të materialeve të ndërtimit²⁹, siç është rasti i firmës “Bechtel & Enka”, me ndërtimin e aksit më kryesor në Shqipëri, të aksti Durrës-Kukës. Ndër marrëveshjet kryesore që përfshijnë investimet e huaja direkte në Shqipëri gjatë vitit 2009-2010, mund të përmendim: shitjen e 12.6% të aksioneve të kompanisë së telefonisë së lëvizshme AMC grupit grek të telekomunikacionit “Cosmote” për 48.2 milionë euro. Shitja e 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike (OSSHEE), kompanisë ceke CEZ për 102 milionë euro. Investime në industrinë e çimentos nga kompania “Antea Cement” (Itali), “Colacem Shqipëria” (Itali) dhe “Cementos Aguila” (Itali). Licenca e katërt e celularëve iu shit Post-Telekomit të Kosovës për 7.5 milionë euro. Po sipas BSH-së, në analizën e saj të sektorit të jashtëm të ekonomisë për tremujorin III të vitit 2014, rezultoi një zvogëlim neto prej 140.7 milionë eurosh gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, kjo sepse flukset neto hyrëse financuan rreth 44.5% të deficitit gjatë kësaj periudhe, me rritje me 98.5% në vitin 2013 dhe u vlerësua në rreth 5.7% në raport ndaj PBB-së nominal, nga rritja e flukseve neto hyrëse në formën e investimeve të tjera. Si rezultat, totali i mjeteve

²⁸ Tabela 3.3.2 Shtojca 1, faqe 180.

²⁹ Tabela 3.3.3 Shtojca 1, faqe 180.

vendase rezultoi në rënie me 31.4% për këtë periudhë dhe përcaktuesi kryesor i zhvillimeve jashtë ishte rënia e mjeteve në formën e investimeve të tjera. Kështu IHD-të neto shënuan një rënie me rreth 38.5%.

Vlerësimi i investimeve të huaja direkte me frekuencë tremujore gjatë vitit mbështetet mbi të dhënat që merren nga bankat dhe nuk përfshin informacionin mbi huat në marrëdhënien e investimit të huaj direkt në Shqipëri (Dokumenti i Programit Ekonomik dhe fiskal (PEF), 2014 – 2016). Investimet e huaja direkte hyrëse, duke hequr privatizimet me kapital të huaj, shënojnë një rënie më të moderuar, si rezultat i privatizimeve më të larta. Kështu mjetet vendase të investuara në trajtën e investimeve të huaja direkte jashtë rezultuan në rritje prej 18.4 milionë eurosh, në krahasim me rënie prej 8.5 milionë eurosh të shënuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013 dhe IHD-të neto u vlerësuan në rreth 7.6%, raport ky rreth 5.5 për qind më i ulët, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (Dokumenti PEF, 2014 – 2016). Sipas instrumentit të përdorur për investime, në trajtën e “kapitalit dhe aksionet në fondet e investimeve”, u IHD-të u vlerësuan në rënie me rreth 32.8% në terma vjetorë. Në anën tjetër, IHD-të neto në trajtën e “fitimeve të riinvestuara” rezultuan më të larta. Investimet direkte në trajtën e “instrumenteve të borxhit” vlerësohen të jenë përdorur pak gjatë këtij viti. Nëse gjatë vitit 2013, trajtat më të përdorura të investimeve të huaja direkte ishin në formën e “kapitalit dhe aksioneve në fondet e investimeve” dhe të “instrumenteve të borxhit”, këtë vit investimet në formë borxhi janë zëvendësuar me fitime të riinvestuara (Dokumenti PEF, 2014 – 2016). Duke filluar prej vitit 2013, IHD-të përbëjnë burimin kryesor të financimit të deficitit të sektorit të jashtëm të vendit tonë. Për tremujorin e tretë të vitit 2014, raporti i flukseve neto të IHD-ve kundrejt deficitit të regjistruar korrent vlerësohej në nivelin 59.7%. Investimet e portofolit neto për tremujorin e tretë të vitit 2014 shënuan një bilanc negativ prej 14.2 milionë eurosh, sepse në këtë periudhë mjetet e rezidentëve (korporatat depozituese) të investuara jashtë kanë shënuar rënie me rreth 21.1 milionë euro. Gjithashtu, detyrimet në formën e investimeve të portofolit shënuan një pozicion negativ prej rreth 6.9 milionë eurosh (Dokumenti PEF, 2014 – 2016).

Llogaria e investimeve të tjera u mbyll me një bilanc negativ prej rreth 91.6 milionë eurosh, por mjetet e investuara jashtë rezultuan në rritje me rreth 44.2 milionë euro. Kjo

përfaqëson një zvogëlim në terma vjetorë, meqenëse mjetet e investuara jashtë gjatë tremujorit të tretë të vitit të kaluar ishin rreth 248.5 milionë euro. Në kahun e detyrimeve, jorezidentët kanë rritur investimet në vendin tonë përgjatë gjithë vitit, ku kontribuuesi kryesor ishte nënzëri “hua”. Rritja e huamarrjes nga qeveria qendrore përgjatë vitit 2014 ishte faktori kyç në zgjerimin e detyrimeve në formë të huas. Dokumenti PEF, 2014 – 2016, paraqet një informacion të qartë të politikave afatmesme në kuadrin e reformave strukturore që po zbatohen gjatë periudhës 2014-2016, të cilat synojnë stabilitetin makroekonomik dhe sigurimin e një rritjeje ekonomike relativisht të lartë e të qëndrueshme, si dhe ngritjen e një kuadri rregullator dhe politikave sektoriale në përputhje me standardet evropiane. Ai është i bazuar dhe në përputhje me ligjin nr. 185, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014” dhe me Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2015 - 2017 (Dokumenti PEF, 2014 – 2016).

Politika fiskale për periudhën 2014 - 2016 është e orientuar në një trajektore të konsolidimit fiskal. Ajo synon, më së pari, vendosjen e financave publike në një trajektore të qëndrueshme, si një prej shtyllave kryesore të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Hartimi i politikës fiskale për periudhën afatmesme në vijim është konsultuar ngushtësisht dhe me FMN-në dhe me BB-në. Ajo është, gjithashtu, në përputhje të plotë me gjetjet dhe rekomandimet e KE-së (Dokumenti PEF, 2014 – 2016). Synimi madhor afatmesëm i politikës fiskale është rimëkëmbja e rritjes ekonomike të vendit në nivelet e saj potenciale dhe qëndrueshmëria e saj në kohë. Objektivi kryesor i kornizës së politikës fiskale për periudhën afatmesme është niveli i deficitit strukturor, i cili siguron qëndrueshmërinë e borxhit publik në periudhën afatmesme dhe afatgjatë dhe minimizion efektet negative afatshkurtra në rritjen ekonomike. Objektivi kryesor operacional sasior i politikës fiskale në kuadrin makrofiskal aktual është ruajtja e deficitit të përgjithshëm fiskal, për çdo vit³⁰. Zbatimi i reformave kyçe strukturore do të jetë, gjithashtu, një levë kryesore për shfrytëzimin e potencialeve të ekonomisë së vendit. Gjithashtu synohet përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator e funksionimit të biznesit dhe klimës së përgjithshme të biznesit, reformimi i administratës publike, përmirësimi i sektorit financiar, reformimi në sistemin e pensioneve dhe vijueshmëria e reformave në tregun e punës si dhe rritja e konkurrencës.

³⁰ Tabela 3.3.4 Shtojca 1, faqe 180.

Me lidhje të forta ekonomike me Italinë dhe Greqinë, kriza në këto vende u reflektua në uljen e të ardhurave dhe eksporteve në ekonominë shqiptare, të cilat çuan në një ngadalësim të rritjes ekonomike dhe veçanërisht të të ardhurave buxhetore (Dokumenti PEF, 2014 – 2016). Hyrjet në llogarinë kapitale e financiare ishin gjerësisht të mjaftueshme për të mbuluar deficitin e ekonomisë, si pasojë e nivelit të lartë të IHD-ve. Pozicioni neto i llogarisë korrente gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2013 ishte në një deficit prej 713.1 milionë eurosh, ose rreth 9.8% në terma të PBB-së nominale, duke u zvogëluar disi prej nivelit 10.8% të regjistruar gjatë vitit 2012. Ngushtimi i bilancit tregtar ka qenë përcaktuesi kryesor i zhvillimeve në llogarinë korrente gjatë vitit 2012 dhe nëntë muajve të parë të vitit 2013, ku tkurrja e deficitit të të ardhurave neto, kryesisht përmes daljeve më të ulëta të të ardhurave nga IHD-të, pati ndikim pozitiv në ngushtimin e deficitit të llogarisë korrente. Në anën tjetër, bilanci i llogarisë së shërbimeve është ndikuar në një masë të madhe nga zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, duke dhënë efekt në tremujorin e tretë të vitit. Kjo besohet të ketë rritur pasigurinë dhe të ketë ndikuar direkt në flukset hyrëse të llogarive të shërbimeve. Për shkak të një rënijeje progresive të regjistruar në flukset hyrëse të remitancave, bilanci i transfertave është kontraktuar dhe ka kontribuar negativisht në bilancin e përgjithshëm të llogarisë korrente (Dokumenti, PEF 2014 – 2016). Përmirësimi i deficitit tregtar rezultoi më i përshpejtuar. Vlerësimet më të fundit projektojnë një nivel më të lartë të deficitit të llogarisë korrente krahasuar me pritjet e mëparshme, si pasojë e rishikimit të suficitit të transfertave korrente. Por flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare rezultuan në rreth 626.6 milionë euro gjatë nëntë muajve të vitit 2013, përkundrajt 867.3 milionë euro në vitin 2012, ndaj në raport ndaj PBB-së ato u vlerësuan rreth 8.6% gjatë tre tremujorëve të parë të 2013-ës, krahasuar me rreth 9.2% në vitin 2012. Në vitin 2013, llogaria kapitale shënoi një suficit më të ulët në terma vjetorë. Në anën tjetër, suficiti i llogarisë financiare u rrit me rreth 8.1% në terma vjetorë. Privatizimi gjatë tremujorit të dytë ka luajtur një rol të rëndësishëm në rrjedhën e IHD-ve gjatë vitit 2013 dhe investimet e huaja neto ishin rreth 690.7 milionë euro, 25.5% në terma vjetorë. Sidoqoftë, nëse përjashtohen arkëtimet nga privatizimet, norma e rritjes së IHD-ve është më shumë se e përgjysmuar në rreth 11.7% në terma vjetorë. Investimet neto të portofolit tregojnë një bilanc negativ, kryesisht nga rritja me rreth 145.9 milionë euro e mjeteve tona të investuara jashtë vendit. Bilanci i investimeve të tjera ka shënuar një

vlerë negative prej 13.0 milionë euro në terma neto, duke reflektuar rritjen e konsiderueshme të mjeteve të investuara jashtë vendit. Gjatë vitit 2013, IHD-të kanë ndjekur një prirje pozitive rritëse kryesisht si pasojë e privatizimit prej kompanish me kapital të huaj të katër hidrocentraleve të mesëm në vend. Në të ardhmen, disa zhvillime të pritura mendohet të ndikojnë mbi ecurinë e IHD-ve në Shqipëri. Shqipëria është përfshirë së fundmi në projektin TAP, i cili pritet të transportojë gaz natyral dhe naftë prej Azerbajxhanit për në Evropën Perëndimore me anë të një sistemi të integruar infrastrukturor dhe një segment pritet të kalojë përmes Shqipërisë së Jugut. Megjithëse ky projekt madhor është në fazat e tij të para, ai pritet të kontribuojë në rritjen e IHD-ve veçanërisht në sektorët e ndërtimit, transportit, komunikimit dhe ndërmjetësimit financiar. Duke qenë se një pjesë e madhe e stokut të IHD-ve ka hyrë në formë privatizimi dhe është përqendruar në kompani ekzistuese dhe aktive, politika të reja strukturore mund të drejtojnë aktivitetin e ri investues drejt projekteve që parashikojnë ndërtimin nga pika e fillimit të aktivitetit ekonomik në Shqipëri (Green Field Investment). Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2013, llogaria e investimeve të tjera neto regjistroi një bilanc negativ prej 13.0 milionë euro, pas dy vitesh të njëpasnjëshme me bilanc neto pozitiv. Bilanci negativ i këtij nënzëri të llogarisë financiare u përcaktua prej rritjes së nivelit të mjeteve të investuara jashtë, kryesisht në formën e monedhave dhe depozitave të sektorit bankar të investuara jashtë. Hyrjet financiare borxhkrijuese kanë ndjekur një prirje rënëse që prej vitit 2012 dhe regjistruan një vlerë prej 100.6 milionë eurosh gjatë vitit 2013. Një rritje e huamarrjes së jashtme e propozuar prej qeverisë qendrore pritet të rrisë hyrjet financiare borxhkrijuese në vitet në vazhdim dhe pritet gjithashtu të rrisë borxhin e jashtëm bruto të Shqipërisë. Zhvillimet në pozicionin ndërkombëtar neto të investimeve të Shqipërisë vijojnë të karakterizohen prej rritjes së moderuar të stokut të mjeteve financiare dhe rritjes së përsheptuar të stokut të detyrimeve financiare. Stoku i mjeteve financiare jashtë vlerësohet në nivelin 36.5% ndaj PBB-së, rreth 3.6 pikë % më shumë krahasuar me një vit më parë dhe vlerësohet në përafërsisht -41.4% ndaj PBB-së. Investimet direkte në Shqipëri dhe investimet e tjera në formën e huave përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve, duke u vlerësuar me përkatësisht 42.7% dhe 37.7% ndaj totalit të detyrimeve me jashtë. Në krahun e mjeteve financiare, mjetet e rezervës në valutë (kryesisht bono) përbëjnë rreth 53.7% të totalit të mjeteve financiare jashtë. Duke parë situatën nga analiza e gjendjes së shumë faktorëve

të cilët kontribuojnë në rritjen ekonomike, u duk qartë se ka një lidhje të fortë të IHD-ve dhe rritjes së të ardhurave të një vendi³¹. Në vitin 2013, vlera e tyre në vendin tonë arriti në nivele rekord, 923 milionë euro dhe pjesa më e madhe e kësaj shume ka qenë riinvestimi i kapitalit të përfituar nga operimi i kompanive të huaja në vendin tonë. Ndërkohë, në vitin 2014, investimet e huaja nisin të shënojnë rënie në Shqipëri. Sipas statistikave të bilancit të pagesave të publikuara nga Banka e Shqipërisë, për periudhën janar – shtator të vitit 2014, investimet e huaja direkte në vendin tonë kapin një vlerë prej 536 milionë euro, me një rënie prej 26% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në tremujorin e parë të vitit 2014, vlera e investimeve të huaja arriti në 193 milionë euro, ndërsa në të njëjtën periudhë të një viti më parë ato arrinin në 115 milionë euro dhe deri vitin e kaluar në mars ecuria ishte pozitive. Raporti rënës i investimeve të huaja fillon në tremujorin e dytë të vitit 2014, duke arritur në 144 milionë euro, pra gjysma e 12 muajve më parë, e cila regjistronte 271 milionë. Sipas Bankës së Shqipërisë, peshën kryesore në investimet e huaja në këtë periudhë e zënë në vitin 2014 hidrokarburet që kanë pasur një tendencë në rritje, ndërsa nuk ka prurje të kapitalit të ri, por vetëm riinvestim të fitimit të kompanive. Me gjithë krizën e thellë ekonomike që po kalon prej më shumë se gjashtë vitesh, Greqia mbetet investitori më i madh i huaj në Shqipëri³².

Të dhënat zyrtare tregojnë se në fund të vitit 2014 stoku i investimeve të huaja që janë realizuar ndër vite, ose ndryshe asetet totale të ekonomisë që zotërohen nga të huajt, ishte rreth 4 miliard e 553 milionë euro. Nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë, shikojmë se 26 % e këtij stoku, ose mbi 1.1 miliard euro, u përkasin kompanive greke. Përveçse ka stokun më të madh kumulativ të investimeve në ekonominë shqiptare, Greqia vazhdon të jetë edhe investitori më i madh korrent. Sipas Bankës së Shqipërisë, në 2014, investimet e huaja direkte ishin 869 milionë euro. Nga këto, 121 milionë euro ose 14 % ishin kapitale me origjinë greke, një tregues i cili ilustron ndikimin e madh që ekonomia helene ka mbi atë shqiptare. Pas Greqisë, investitori i dytë më i madh në Shqipëri është Kanadaja, me 17 % të totalit, ndërsa në vendin e tretë vjen Italia, e cila zë 12 % në stokun e investimeve. Përgjatë viteve 2004-2016 mesatarisht 63% e investimeve publike është financuar nga burime të brendshme, ndërsa 37% nga burime

³¹ Tabela 3.3.5 Shtojca 1, faqe 181.

³² Tabela 3.3.6 dhe Grafiku 3.3.1 Shtojca 1, faqe 181.

të jashtme. Gjatë vitit 2015³³ IHD-të në ekonominë shqiptare pësuan rënie me 11 %. Fluksi i tyre zbriti në 720 milionë euro. Por sipas projekteve të FMN-së parashikohet që viti 2016-2017 të ketë rritje për shkak të kulmit të punimeve në dy vepra të mëdha, Gazsjellësi Trans Adriatik dhe projekti i hidrocentraleve të kompanisë “Statkraft” në Devoll. Për pasojë Fondi parashikon rritje të hyrjeve valutore të investimeve me 19 % në 2016 dhe në 2017 me 45 %. Ndërsa pritet që kuota e IHD-ve të kthehet në rënie gjatë viteve 2018-2019.

Nga analiza që ka bërë BSH, investimet për herë të parë kryesohen nga energjetika, kryesisht hidrocentralet, ku ndikim më të madh vlerësohet të ketë dhënë Devolli Hydropower. Prurjet në tremujorin e parë të vitit 2016 kanë ardhur nga sektori i energjetikës me rreth 61 %, e më pas nga ai i hidrocentraleve me rreth 21%, të ndjekur nga sektori bankar dhe ai i telekomunikacionit, që kanë tërhequr përkatësisht 8% dhe 2% të flukseve hyrëse të IHD-ve. Çdo vit investimet publike janë dominuar nga nivele të larta të financimit të brendshëm, me përjashtim të vitit 2012, ku vetëm 44.5% e investimeve publike janë financuar nga burime të brendshme³⁴.

3.4. Prejardhja e IHD-ve në Shqipëri

IHD-të në Shqipëri vijnë kryesisht nga vendet fqinje, si p.sh. Italia Greqia etj. Janë pikërisht këto vende që kanë treguar interes për të investuar në Shqipëri³⁵.

Afërsia gjeografike e Shqipërisë me vende si Italia dhe Greqia dhe bashkëpunimi i fuqishëm ekonomik me BE-në janë dy arsyt kryesore të dominimit të investitorëve të huaj nga këto vende. Investimet italiane janë të përqendruara në perëndim të vendit, në afërsi të detit Adriatik. Pjesa më e madhe e investimeve italiane tenton ndërmarrje të vogla e të mëdha, të cilat operojnë kryesisht në sektorin e ndërtimit (35%), në industrinë tekstile dhe atë të prodhimit të këpucëve (21%), në tregti dhe shërbime (16%) dhe në industrinë e prodhimit ushqimor (8%). Investimet greke janë më tepër të përqendruara në telekomunikacion, në sektorin e bankës, të ndërtimit dhe të prodhimit lëkurë-këpucë

³³ Statistikë e Qeverisë Shqiptare, përpunuar nga FMN-ja.

³⁴ Tabela 3.3.7 dhe Grafiku 3.3.2 Shtojca 1, faqe 182

³⁵ Tabela 3.4.1, Shtojca 1, faqe 182.

dhe këto të fundit janë të përqendruara në jug të vendit, si p.sh. në Korçë, Gjirokastrë, Sarandë.

Zonat ku janë përqendruar më shumë investimet e huaja janë zona me të ardhura të larta dhe infrastrukturë më të zhvilluar. Pjesa e brendshme qendrore dhe verilindore janë zonat më pak të preferuara nga investorët e huaj. Përveç infrastrukturës së pazhvilluar dhe marketingut të munguar, një rol të rëndësishëm mendohet të ketë luajtur migrimi i brendshëm dhe ai i jashtëm, i cili vështirëson gjetjen e fuqisë punëtore në këto zona. Investimet e huaja janë më tepër të përqendruara në qytetet kryesore, si: Tiranë, Durrës. Vetëm këto qytete kanë tërhequr afërsisht 67% të shoqërive tregtare me pjesëmarrje të huaj. Në rastin e Durrësit, qyteti favorizohet edhe për faktin se ka portin më të madh në vend. Investime të tjera janë ato në fushën e telekomunikacionit, ku dominon Vodafone dhe Telecom Albania (ish-AMC) me kapital grek, Eagle Mobile me kapital turk, apo Lockheed Martin me kapital amerikan. Investime të tjera janë ato që mbulojnë fushën e sigurimeve, si përfaqësues të sektorit financiar, duke përfshirë këtu edhe atë bankar, ku dominon kapitali grek dhe ai austriak.

3.5. Faktorët nxitës për IHD-të

Më poshtë do të listohen disa veçori që e bëjnë Shqipërinë një destinacion shumë tërheqës e ndër më të preferuarit për të investuar në Ballkanin Perëndimor:

- *Vendndodhje strategjike e shkëlqyer.*
- *Në 2006, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE.*
- *Shqipëria ka një kuadër të liberalizuar ekonomik dhe kushtet për të bërë biznes dhe për të tërhequr IHD-të janë duke u përmirësuar vazhdimisht.*
- *Qasje e lirë në tregje – Marrëveshjet e tregtisë së lirë (CEFTA , EFTA).*
- *Anëtare e FMN-s që nga viti 1991, e OBT-së nga viti 2000, e NATO-s nga viti 2009 (AIDA, 2015).*

Për sa i përket forcës punëtore, ajo është dinamike, e arsimuar dhe konkurruese dhe karakterizohet nga faktorët e mëposhtëm:

- Mbi 1 milionë profesionistë të rinj të arsimuar mirë;
- Më shumë se 57% e popullsisë nën moshën 35 vjeç;
- Më shumë se 116 292 studentë në arsimin e lartë;
- Njohje e mirë e gjuhëve të huaja, kryesisht asaj angleze dhe italiane; gjuha gjermane dhe frënge janë të përfshira në sistemin arsimor, kurse gjuhë të tjera të vendeve të rajonit fliten gjerësisht;
- Paga minimale në Shqipëri është 21 000 lekë (140 Euro);
- Sigurimet shoqërore përbëjnë 27,9% të pagës bruto, nga të cilat 16,7% paguhet nga punëdhënësi dhe pjesa tjetër prej 11,2% paguhet nga punëmarrësi³⁶
- Paga mesatare (në sektorin publik dhe atë privat) është 36.075 lekë (260 euro).

Ndërsa mjedisi rregullator miqësor ndaj biznesit karakterizohet nga këta faktorë:

- Licencim sipas modelit “One stop shop” nga Qendra Kombëtare e Licencimit;
- Regjistrim i biznesit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;
- Sistem online për taksat dhe pagesat e tyre;
- Kuadër ligjor për biznesin në përputhje me legjislacionin e BE-së (AIDA, 2015).

Ruajtja e të dhënave:

- ICT-sistemi i skedarëve.

Ky sistem po rritet me shpejtësi, duke u bërë një nga industritë më dinamike të vendit³⁷. Vitet e fundit masat e ndërmarra nga qeveria janë aplikuar nëpërmjet Strategjisë Ndërsëktoriale të Shoqërisë së Informacionit, kjo për të bërë të mundur futjen e Shqipërisë në epokën digjitale. Është liberalizuar legjislacioni për industrinë e Telekomit, duke e harmonizuar atë me kuadrin rregullator të BE-së për komunikacionin dhe duke nxitur konkurrencën.

Në vitin 2007 u krijua Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, e cila synon të përshpejtojë zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe shërbimet e-government.

³⁶ Marrë nga: www.ambasadat.gov.al/belgium/sq/investoni-ne-shqipëri

³⁷ Pjesa më e madhe e skedarëve janë skedarë të zakonshëm, që ruajnë të dhëna, si për shembull skedarë tekst, skedarë të ekzekutueshëm etj., sikurse ka gjithashtu edhe disa tipa të veçantë skedarësh.

Pothuajse 80% e shërbimeve bazë në nivelin e qeverisjes qendrore janë të aksesueshme nëpërmjet internetit në nivelin e parë dhe të dytë të sofistikimit, ndërsa më shumë se 50% e shërbimeve qeveritare për biznesin ofrohen në nivele interaktive sofistikimi.

- *Potencial i lartë investimesh në sektorë prioritarë:*

Në ata sektorë ku Shqipëria ka potencial të pashfrytëzuar, sektorë të cilët do të vazhdojnë të mbetet prioritet për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë. Energjetika, turizmi, agrobiznesi, industria e minierave, ICT janë sektorë prioritarë për investime në Shqipërinë.

- *Përmirësimi i shpejtë i infrastrukturës*

Ka qenë një prioritet për qeverinë shqiptare dhe është konkretizuar përmes realizimit të veprave infrastrukturore kryesisht në rrjetin rrugor, me qëllim shfrytëzimin maksimal të potencialit të plotë të pozicionimit strategjik të Shqipërisë.

- *Cilësia e jetesës*

Vlerësohet ndër më të lartat në rajon në bazë të treguesve të Cilësisë së Jetesës dhënë nga International Living Magazine. Shqipëria ofron një mjedis të sigurt për të jetuar, me mundësi të mëdha zbavitëse dhe argëtuese.

Së fundmi, vlen të përmendet një aspekt legjislativ shumë i rëndësishëm, ai i *mbrojtjes së posaçme*. Të investuarit në Shqipëri është një privilegj i veçantë për të huajt, pasi atyre i krijohet mundësia e mbrojtjes së posaçme. Kjo do të thotë se në raste kur investitorëve të huaj u lindin mosmarrëveshje, shteti u bëhet palë dhe i përfaqëson ata në marrëdhëniet me të tretët, kjo sipas ndryshimeve të ligjit “Për Investimet e huaja”, hartimi i të cilit ka qenë detyrim i Marrëveshjes së Asociim-Stabilizimit, të firmosur nga përfaqësues të qeverisë shqiptare. Investimet e huaja në Shqipëri do të jenë të mbrojtura nga qeveria në lidhje me problemet me pasuritë e paluajtshme me të cilat janë përballur. Me këto ndryshime në ligj është vërtetuar edhe një herë se investimet e huaja direkte janë prioritet i lartë i qeverisë shqiptare dhe se vendi do të bëjë çdo gjë të nevojshme e të mundur për mbrojtjen e të drejtave të investitorëve të huaj, duke i inkurajuar ata për të bërë biznes në Shqipëri.

Që nga ky moment, falë këtyre ndryshimeve, qeveria shqiptare filloi t’i garantojë investimet e huaja dhe do të përballlet me çdo pretendim lidhur me pronësinë e tokës, me qëllim që investitorët e huaj të vazhdojnë me projektet e tyre pa u ndeshur në

problematika të ndryshme. Këto ndryshime përfshijnë shtim të përmbajtjes së nenit 8 të ligjit 7764, datë 02.11.1993.

Nëse një investim ka marrë statusin e mbrojtjes së posaçme shtetërore, gjykatat shqiptare nuk mund të marrin asnjë masë sigurimi padie, siç mund të jetë pezullimi i aktivitetit apo sekuestrimi. Pas dhënies së këtij statusi, sigurimi i padisë mund të bëhet vetëm mbi pasuri publike. Për dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore është kusht që ajo mund të jepet për investimet e huaja që kryejnë apo pritët të kryejnë investime jo më pak se 10 milionë euro në fushën e infrastrukturës publike, turizmit, energjetikës apo bujqësisë ose mbi një pasuri të paluajtshme, të vënë në dispozicion të investitorit të huaj nga shteti shqiptar, ose koncesione sipas një kontrate koncesioni shtetëror.

Mbrojtja e posaçme shtetërore jepet vetëm pasi ka lindur mosmarrëveshja juridike civile me palët e treta private dhe asnjëherë *a priori*, si dhe vetëm për mosmarrëveshje individualisht të përcaktuara dhe përfundon me zgjidhjen me mirëkuptim ose me gjyq të këtyre mosmarrëveshjeve ose, sipas rastit, me ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Megjithatë, kjo mbrojtje nuk është një e drejtë ligjore për investitorin e huaj, pasi dhënia ose refuzimi i saj është në diskrecionin e Këshillit të Ministrave.

Afati për shqyrtimin dhe dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore është 45 ditë nga data e marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues nga investitori i huaj. Projektvendimi për propozimin e dhënies së mbrojtjes së posaçme shtetërore dhe dokumentacioni shoqërues i paraqiten Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Në qoftë se gjykata, me një vendim të formës së prerë, hedh poshtë të drejtat e investitorëve të huaj mbi pasurinë e patundshme dhe ua ka njohur këto të drejta palëve të treta, objekt i investimeve të huaja, KM mund të vendosë shpronësimin për interes publik të palëve të treta private, si dhe t'ua kalojë pasuritë investitorëve të huaj, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Gjithashtu, për sa i përket mbulimit të shpenzimeve, parashikohet se investitorët që zgjedhin të përfaqësohen nga shteti shqiptar në mosmarrëveshjet juridike do të kompensohen nga shteti për dëmin e shkaktuar si rezultat i mosmarrëveshjes juridike në proces.

Mund të thuhet që IHD-të kanë një rëndësi të madhe për ekonominë shqiptare, kjo në lidhje me punësimin, prodhimin dhe aktivitetet e investimit. Përmirësimi i këtyre

elementeve mund të çojë drejt një niveli më të lartë të konkurrencës ekonomike në Shqipëri. Shpërndarja e tyre nuk është uniforme, për këtë arsye duhen vendosur kushte që të thithen IHD edhe në ato vende ku kryhen më pak investime. Kjo kërkon standarde më të larta trajnimi dhe përmirësime të kompetencave të burimeve njerëzore. Një tjetër kusht për rritjen e IHD-ve mund të përbëhet nga zhvillimi i infrastrukturës. Gjithsesi, duhet theksuar që një pjesëmarrje e huaj në nivele tepër të larta në disa sektorë të caktuar të ekonomisë vendase, siç është ai i industrisë, është në të njëjtën kohë shprehje dobësie e ekonomisë së këtij vendi.

Rrjedhimisht, politikat qeverisëse duhen të punojnë dhe në këtë drejtim për të krijuar kushte që ndihmojnë kompanitë e vogla e të mesme vendase që të zhvillohen sa më shumë, në mënyrë që të nxiten dhe IHD-të dalëse.

3.6. Importet dhe eksportet në Shqipëri

Në fushën e liberalizimit të tregtisë, si edhe në atë të nxitjes së investimeve dhe importeve/eksporteve, është arritur progres e dukshme nga qeveria e Shqipërisë përmes përpjekjeve efektive të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, dhe agjencive shtetërore përkatëse, në bashkëpunim me partnerët e tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Zhvillime në fusha dhe degë të ndryshme janë fokusuar për të shndërruar strukturën jo vetëm ekonomike në vendin tonë, si një strukturë të orientuar drejt IHD-ve, por edhe duke nxitur kështu liberalizimin ekonomik, e madje në krijimin e një klime më të ndjeshme ndaj tërheqjes së investitorëve të huaj. Reformat strukturore në fushën administrative, fiskale si edhe ligjore kanë si qëllim jo vetëm liberalizimin e tregtisë, por edhe të gjitha mundësitë për të lehtësuar hapat e fillimit që të huajt të ndërmarrin për të bërë biznes, duke rritur besimin e investitorëve të huaj ndaj Shqipërisë, të cilët, pikë së pari, do të jenë ata që promovojnë rrugën për të tjerë në të ardhmen.

Nëse do t'i referohemi turizmit, energjisë së rinovueshme, infrastrukturës, agrobiznesit dhe shërbimeve, mund të pohojmë me siguri të plotë se Shqipëria ka një kuadër ligjor tolerant për sa u përket investimeve të huaja. Ky kuadër është hartuar jo vetëm për të krijuar një klimë të favorshme për investimet, por edhe për të rritur nivelin ekonomik të

vendit me anë të teknologjisë moderne të Perëndimit, vendeve të cilat e kanë kaluar këtë fazë të ekonomisë tyre dhe të cilat kanë nevojë për tregje të reja, promovimin e emrit të firmës së tyre, krah pune të lirë, burime të para të lira, të cilat mundësojnë fitimin maksimal të tyre.

Një nga format e IHD-ve më të rëndësishme janë ato të import-eksporteve, të cilat sigurojnë të ardhura nëpërmjet doganës. Nëse do t'u referoheshim të dhënave për partneritet e BE-së, import-eksportet vazhdojnë të jetë partneri kryesor në lidhje me tregtinë me Shqipërinë, duke i siguruar vendit tonë 64.1% të importit dhe madje duke përfituar 72.5% të ardhura të eksportit shqiptar. Duke iu referuar vendeve me të cilat eksportojmë dhe importojmë në lidhje me volumin për tregtinë gjatë vitit 2011, shohim se Shqipëria importon kryesisht nga Greqia, Kina, Italia, Turqia, Gjermania dhe eksporton në Kosovë, Itali, Turqi, Spanjë, Greqi dhe Gjermani. Greqia dhe Italia, dy nga vendet më afër Shqipërisë, përfaqësojnë respektivisht 16.6% dhe 47.7% të importeve, ndërsa nga ana tjetër 7.1% dhe 73.3% të eksporteve.

Gjithashtu, po t'u referohemi taksave, importi i mallrave nuk i nënshtrohet ndonjë detyrimi taksor, përveçse detyrimit doganor. Nisur nga kjo, qartësojmë se vetëm importi i mallrave është subjekt i TVSH-së dhe disa produkte, si pijet alkoolike, lëndët djegëse, duhani janë subjekt i akcizës.

Pra, furnizimi i mallrave dhe shërbimeve për eksport dhe transport ndërkombëtar trajtohen me TVSH 0% dhe me të drejtën e kreditimit të TVSH-së së paguar në blerje.

TVSH-ja zbatohet në masën 0%:

- Për mallrat që eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë;
- Për transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve dhe furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me të. Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit kanë të drejtë të caktojnë me udhëzim të përbashkët cilat janë furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.

- Për furnizimet e mallrave a shërbimeve në lidhje me veprimtaritë tregtare ose industriale në det³⁸.

Nuk mungojnë reforma strukturore në fushën fiskale, ligjore, administrative, me qëllim që të arrihet liberalizimi i tregtisë dhe lehtësia e të bërit biznes, gjë që ka rritur besimin e investitorëve të huaj ndaj vendit tonë.

Siç e përmendëm më lart, fokusi i mëtejshëm për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë shqiptare, duke iu referuar vendeve të zhvilluara, natyrisht që do të mbetet në tërheqja e IHD-ve me një vëmendje në sektorë të tillë ku ekonomia shqiptare jo vetëm që ka potenciale të pashfrytëzuara, si në aspektin e burimeve natyrore, ashtu edhe në zhvillimin e sektorëve të tillë që janë ende të pazhvilluara, si turizmi, agrobiznesi, shërbimet dhe energjia e rinovueshme, infrastruktura.

3.7. Ndikimi i krizës globale tek IHD- të në Shqipëri

Edhe ata që nuk janë ekspertë të sektorit ekonomik mund t'i përshkruajnë pasojat e krizës financiare. Kriza financiare nisi në gjysmën e dytë të vitit 2006 me rënien e kthimit të borxheve hipotekare në SHBA (subprime), ku shumë kredimarrës nuk ishin të aftë t'i kthenin borxhet e tyre. Në shkurt 2007 kriza kaloi tek bankat kryesore, duke bërë që të kalonin në krizë financiare, banka të cilat përfshinin kreditë më të mëdha hipotekare që nga vera e viti 2007 (Capuano, 2013: 5-9). Kjo krizë shkaktoi rënien e tregut të bursës në verën e vitin 2007. Kjo rënie e tregut të bursës qe shumë më e ulët në krahasim me rënien e thellë të tregut të bursës së vitit 2008³⁹.

Nga ky moment kriza dalëngadalë po përhapej edhe larg kontinentit të Amerikës, duke ndryshuar formën e saj, dhe po paraqitet si krizë e superprodhimit. Sektori i industrisë

³⁸ Marrë nga www.financa.gov.al.

³⁹ Gjatë vitit 2003 dhe 2004, Banka e Rezervave Federale Amerikane, "*Federal Reserve Bank*", aplikonte përqindje të interesit shumë të ulët për të stimuluar konsumin, për të nxitur familjet amerikane për të investuar në blerjen e shtëpive. Kjo bankë mjaftohej thjesht që të shprehej dëshira e blerjes së shtëpisë. Edhe pa të ardhura mund të blije shtëpinë duke, e akorduar kredinë edhe me 110% të vlerës reale të shtëpisë. Këto kushte sollën edhe rritjen e kërkesave nga familjet për këto kredi dhe blerjen e shtëpive, çka rrjedhimisht solli edhe rritjen e çmimeve të tregut imobiliar.

automobilistike ishte ai që u përfshi me shpejtësi, e më pas edhe të gjithë sektorët e tjerë (Postone, 2013: 5-30).

Kjo situatë e paqartë globale ekonomike e financiare pati ndikim dhe në vendin tonë, duke krijuar nevojën e ridimensionimit të rolit të institucioneve, përfshirë dhe atë të Bankës Qendrore. Prej një periudhe disavjeçare ekonomia e vendit është nën ndikimin e krizës globale, duke sjellë ngadalësimin e aktivitetit ekonomik. Edhe pse me këto zhvillime, ekonomia shqiptare ka arritur të ruajë stabilitetin e çmimeve dhe të ekuilibrave të përgjithshëm makroekonomikë e financiarë të vendit. Sistemi financiar shqiptar ka treguar një shkallë të lartë imuniteti. Pavarësisht ngadalësimit të rritjes ekonomike, ky sistem mbetet në tërësi, i mirëkapitalizuar dhe fitimprurës, kjo falë edhe kujdesit të treguar nga Banka e Shqipërisë. Megjithatë, kriza solli ndikim në disa sektorë të jetës ekonomike të vendit, duke pasur parasysh dhe atë të IHD-ve. Kjo pasi në Shqipëri kemi të pranishme grupe bankare nga vende të Bashkimit Evropian që u prekën thellë nga kriza dhe, sikurse dihet, stabiliteti financiar i një vendi ka lidhje të ngushtë me sistemin bankar. Ekspertë të bankave, financierë dhe jo vetëm, kanë analizuar edhe ndikimin e krizës në Itali e Greqi, duke pasur parasysh faktin se një numër i madh i investuesve në Shqipëri vijnë nga këto vende. Ata janë shprehur se ekonomia shqiptare, edhe pse këto vende janë prekur nga kriza, është e qëndrueshme dhe sistemi bankar është i fortë. Por sikurse pritej, mundësia që vendi të përballëj me rënie të investimeve nga këto vende u shfaq kur u vu re një ulje e konsiderueshme e dërgesave të emigrantëve.

Megjithatë, FMN-ja është shprehur se Shqipëria konsiderohet si një vend në zhvillim dhe jashtë mundësive për t'u prekur nga pasojat e shpejta të krizës ekonomike botërore. Në raportin e vitit 2015 mbi ekonominë shqiptare, FMN-ja vlerëson aftësinë e Shqipërisë për përballimin e krizës globale falë politikave të shëndosha financiare të miratuara gjatë viteve para krizës, të cilat ofruan hapësira për të zbutur efektet e saj⁴⁰.

⁴⁰ Shih: <http://www.imf.org>.

3.8. Investuesit potencialë në Shqipëri

Vitet 2007-2013 kanë qenë mjaft të rëndësishme për përthithjen e investimeve potenciale në vend. Duke iu referuar METE-s, vërejmë se gjatë periudhës nëntor 2007 e deri në korrik 2013, institucioni ka shqyrtuar dhe procesuar deri në 1200 dosje për privatizim e koncesione. Madje vetëm për privatizimin si dhe dhënien me koncesion për ndërtime të reja të hidrocentraleve janë regjistruar saktësisht 727 kërkesa të bëra. Kështu, janë dhënë 388 koncesione në energjetikë dhe nga këto deri tani janë vetëm 53 hidrocentrale në masë të vogla e të mëdha, të cilat funksionojnë sipas fazave të rënies së shirave me kapacitet të plotë apo më pak, ose janë ende në fazën e ndërtimit, pra më pak se 18 % e totalit të koncesioneve të dhënë në energjetikë. Nëse do të marrim në konsideratë nga viti 2006 e deri më sot, saktësisht nga biznesi vendas dhe i huaj janë marrë 110 koncesione për ndërtimin dhe funksionimin e rreth 390 HEC-eve, me fuqi të konsiderueshme prej 1 300 megavatesh. Kjo vlerë investimi arrin deri rreth 3 miliardë eurosh dhe deri tani vetëm 10 prej tyre kanë përfunduar së ndërtuari, duke lidhur kontratën e duhur me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, e cila lejon dhe mundëson veprimtarinë e tyre. Sot, vendi ynë arrin të shfrytëzojë vetëm 40% të burimeve ujore-hidrike të tij, këto për prodhimin e energjisë së rinovueshme, por duhet përmendur se, edhe pse ofrohen nga shteti shqiptar mundësi të cilat krijojnë lehtësi në fillimin e aktivitetit, nuk janë shfrytëzuar e nuk janë vënë aspak në përdorim gjatë viteve të fundit. Prandaj, situata në lidhje me energjetikën edhe pse duhej të ishte shumë më e mirë, është gati e neutralizuar dhe pa asnjë investim. Madje, për pjesën më të madhe të koncesioneve nuk është realizuar investimi ose ka pasur vonesa të mëdha që në lidhje me ndërtimet. Janë identifikuar dhe ndaluar rreth 15 raste të tilla kur kompanitë kanë qenë “fantazmë”.

Nëse do të arrinim në një përfundim për këto kompani, do të thoshim se gjithë kjo do të përkthehej në bllokim fondesh dhe që nuk janë injektuar në ekonominë e vendit.

Edhe pse ndër vite Shqipëria ka hasur në problematika për shkak të asaj që u përmend më sipër, shohim që sërish investues seriozë e potencialë kanë ardhur me nismat e tyre dhe me një aktivitet i cili është pozicionuar më së miri në vend. Me anë të këtyre nismave dhe investimeve ekonomia e vendit ka pasur ndikim pozitiv dhe madje kanë sjellë përfitime, jo vetëm për rritjen ekonomike të vendit, por edhe në përmirësimin e

shumë faktorëve të tjerë të cilët ndihmojnë drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë në mirëqenien e vendit. Disa nga kompanitë më të mëdha të huaja në vend, të cilat kanë investuar në një kapital të konsiderueshëm, për një kohë relativisht të gjatë, i listojmë si më poshtë:

Telecom Albania (ish-AMC): Kjo kompani konsiderohet si një nga investimet më të mëdha në fushën e telekomunikacionit, e cila disponon një lloj shërbimi të domosdoshëm sa personal e ndërpersonal, si komunikim, aq edhe lehtësues për bizneset në Shqipëri, që nga viti 1995. Telecom Albania (ish-AMC) është bashkimi i Cosmote (Greqi) dhe Telenor (Norvegji). Konsorciumi që zotëron 85% të aksioneve dhe që nga privatizimi i saj, Telecom Albania, është një nga ndërmarrjet kryesore private, jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë në rajon. Që në fillim, kjo kompani u regjistroi 20 000 klientëve numrat përkatës pas fillimit të një game më të gjerë shërbimesh, e cila nuk ishte më parë në Shqipëri, dhe bëri që ajo të kishte pozitë dominuese në treg, duke krijuar një monopol në industrinë e vendit deri në daljen në treg të Vodafone, e më tej Eagle Mobile. Ndërkohë sot ajo regjistron më shumë se 1 milionë abonentë dhe investimi i bërë nga Telecom Albania në mirëmbajtje, teknologji, zgjerim linje i tejkalon 200 000 000 euro.

Seament Shqipëri Ltd: kompani anëtare e International Holding Seament Group, e cila është jo vetëm e pranishme në më shumë se 20 shtete, por prej vitesh është pozicionuar mirë edhe në Shqipëri. Seament Shqipëria ka operuar dhe zhvilluar aktivitetin e saj në tregun shqiptar nga viti 1994, si një kompani importuese e vendosur në portin e Durrësit dhe nga ka vendosur një terminal me kapacitet prej 1.000.000 ton/vit, një sasi kjo mjaft e konsiderueshme.

Gjatë procesit të privatizimit, në mars 1997, kompania bleu 70%, pra një të tretën e Fabrikës së Çimentos në Elbasan dhe 70% të guroreve. Më tej në nëntor 1999, rezervat e këtyre kompanive u rritën përkatësisht me 7% dhe 16%, gjë që tregon një aktivitet serioz dhe fitimprurës.

Në vijim, në korrik të vitit 2000, Elbasan Cement Factory (ECF)⁴¹ fitoi madje të drejtën e privatizimit të Fabrikës së Çimentos në Fushë-Krujë, e cila operon si një degë mbështetëse në këtë vend.

Vodafone Shqipëri: Sikurse e përmendëm edhe më sipër, kjo kompani vepron në Shqipëri që nga viti 2001. Në treg pati një ndikim të konsiderueshëm, sepse rrëzoi monopolin e krijuar në atë kohë nga e vetmja kompani Telecom Albania (ish-AMC), duke ulur çmimin e shërbimeve për klientët shqiptarë. Vodafone njihet si një nga kompanitë më të mëdha të shërbimit celular në botë, ndaj kjo kompani dha ofertën më të madhe, 38 milionë USD, në lidhje me tenderin ndërkombëtar për licencën e dytë të komunikimit celular në Shqipëri. Vodafone International Holding zotërohet në 51% e kapitalit nga Vodafone Shqipëri dhe 49% në pjesë nga Panafon - Vodafone (Greqi). Nga të dhënat shohim se investimet e Vodafone Shqipëri tejkalojnë shifrën e 65 000 000 eurove, duke ofruar dhe shtrirjen e rrjetit 4G, shtrirjen e rrjetit të internetit, si dhe shërbime të tjera lehtësuese për klientin.

Kurum International Ltd: Kjo firmë, edhe pse në mars të vitit 2016 ka kërkuar shpalljen e falimentimit, ka qenë një firmë e fuqishme turke, e cila operonte në industrinë e rëndë metalurgjike, jo vetëm në Turqi, por dhe në Kosovë.

Raiffeisen Bank (Banka e Kursimeve): Kjo bankë rezultoi një investim i suksesshëm i regjistruar në vitin 2003 në kuadër të IHD-ve, që erdhi nga privatizimi i Bankës së Kursimeve nga një bankë austriake, Banka Raiffeisen, me një ofertë prej 126 000 000 USD. Privatizimi e saj natyrisht që solli jo vetëm një zhvillim të mëtejshëm të sistemit tonë bankar si nga pikëpamja teknologjike, ashtu edhe nga aftësitë menaxheriale, si nga përvojat e një ndër bankave më të njohura dhe më të fuqishme në Evropë.

Albtelecom dhe Eagle Mobile⁴²: Kjo ishte kompania e vetme e telefonisë fikse në Shqipëri deri së fundi, që operon në kushte monopoli në tregun e vendit. Nga ana e historikut të saj, Albtelecom u privatizua nga konsorciumi i kompanisë turke “Calik Energy Telekomunikacion” dhe “Turk Telekom” për 120 milionë euro.

⁴¹ <http://www.elbasanfactory.com/>

⁴² <https://www.albtelecom.al>

Në renditje mund të pohojmë se është operatori i tretë i telefonisë celulare në Shqipëri, i cili u themelua më 23 tetor 2003 nga qeveria shqiptare. Një pjesë sa integrale e operatorit të telefonisë fikse në Shqipëri, privatizimi i Albtelecom-it filloi në vitin 2005 dhe u finalizua më 28 shtator 2007, kur “Cetel Telekom”, nga një nga kompanitë e mëdha në Turqi, nga “Çalik Group” në 80% të aksioneve dhe nga “Turk Telekom” me 20%, bleu 76% të aksioneve, së bashku me partnerin e saj Turk Telekom dhe pjesa tjetër e aksioneve prej 24%, zotërohet nga qeveria shqiptare si dhe aksionerë të tjerë të saj.

Spitali Amerikan⁴³: Ky spital e merr fondin e investimeve nga “Balkan Alliance”, i cili ishte aksioneri kryesor i saj. Që në vitin 2008 aksioner kryesor do të bëhet fondi amerikan i investimeve “Bedminster Capital Menagment”, i cili është me qendër në Nju-Jork, i njohur tashmë për investime në fushën e shëndetësisë, siguracioneve dhe telekomunikacionit. Shuma e parave të investuara në shëndetësinë shqiptare arriti vlerën e 100 milionë USD. “Bedminster”, në vitet e fundit në Evropën Juglindore, ka investuar një shumë që arriti vlerën e 400 milionë USD. Spitali Amerikan 2 është konsideruar si investimi më i madh i aksionerëve të këtij lloji në Shqipëri, i cili e kalon shifrën e 20 milionë eurove. Natyrisht që funksioni i ndërtesës së Spitalit Amerikan 2 iu referohet standardeve ISO si dhe standardeve të autoritetit më të lartë ndërkombëtar akreditues për shërbimin spitalor në Shqipëri.

Spitali “Hygea Tirana”⁴⁴: është një nga investimet private më të mëdha e më moderne, e pajisur me teknologjinë më bashkëkohore në fushën e shëndetësisë, duke arritur vlerën e investimit në 60 milionë euro. Ky spital iu mundëson pacientëve shqiptarë të përfitojnë benefite në lidhje me shërbimin për shërimin e sëmundjeve me mjete dhe medikamente apo ndërhyrje bashkëkohore.

3.9. Qasje Shqipëri – Kosovë - Ballkani Perëndimor

Shteti më i ri i Ballkanit, Kosova, nuk e ka pasur të lehtë mikpritjen dhe tërheqjen e IHD-ve. Kjo pasi, mbas përfundimit të luftës (me Serbinë), ajo është përballuar me

⁴³ <http://www.spitaliamerikan.com/al/>

⁴⁴ <http://www.hygeia.al/>.

problematika të shumta e deri diku të njëjta me ato që ka hasur dhe Shqipëria. Nisur nga fakti që IHD-të kanë ndikim të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë së vendit, kuptohet që mungesa e IHD-ve ka ndikuar negativisht në disa aspekte të jetës ekonomike, sociale, politike, si dhe kulturore të këtij shteti. Kështu, pas Shpalljes së Pavarësisë⁴⁵, Kosova nisi marrëdhënie të reja me shtetet e tjera. Vendi tani po mban marrëdhënie të qëndrueshme duke pasur bashkëpunim me organizmat ndërkombëtarë, si edhe me vendet e tjera të rajonit. Por edhe pas Shpalljes së Pavarësisë, marrëdhëniet e saj me Serbinë ende janë të vakëta, kjo pasi një fakt të tillë Serbia nuk e ka pranuar dhe nuk e ka njohur ende⁴⁶.

Megjithatë, për sa i përket legjislacionit vendas, gjithnjë e më shumë është bërë progres. Kosova ka një kushtetutë 10 vjet më të re se ajo e shtetit shqiptar, e cila ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2008⁴⁷. Shteti i ri është në proces përafrimi të legjislacionit të vendit me atë të BE-së për sa i përket fushave të ndryshme, si ajo e doganave, energjisë, punësimit, e luftës ndaj korrupsionit, krimit të organizuar etj. Gjithashtu, progres është bërë edhe në implementimin e reformës në administratën publike, duke përfshirë edhe reformën në shërbimin civil⁴⁸. Kosova është pjesë e PSA-së (Procesi i Stabilizim-Asociimit, PSA për Kosovën, 2002)⁴⁹. Gjatë këtyre viteve të pavarësisë, Kosova ka siguruar nga BE-ja asistencë financiare, duke pasur kështu një ekonomi të re dhe dinamike. E dalluar në Evropën Juglindore, ekonomia e Kosovës është pjesë e integritimeve ekonomike të konsiderueshme të këtij rajoni, të cilat ofrojnë mundësitë e zgjerimit të tregut në një hapësirë mjaft të gjerë. Tani, baza e saj ekonomike është transformuar: nga e centralizuar dhe e drejtuar, në një ekonomi të hapur drejt tregut, transformim ky i cili u përjetua më së shumti pas vitit 1999. Një ndër sfidat me të cilat ajo u përball gjatë dekadës së fundit është edhe procesi i privatizimit, i cili është një qëllim më vete nga rritja e konkurrencës së kësaj ekonomie. Duke rritur kapacitetin e saj

⁴⁵ Shkurt të vitit 2008.

⁴⁶ Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë.

⁴⁷ Komisioni Kushtetues e ka dorëzuar kushtetutën e propozuar Presidentit të Republikës së Kosovës më 7 prill 2008.

⁴⁸ Republika e Kosovës, Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian, “Tryezë tematike për administratën publike, Kosova 2020”.

⁴⁹ Kosova në politikën e jashtme të BE-së për Ballkanin Perëndimor është Mekanizmi Përcjellës i PSA-së (STM). Ky mekanizëm është themeluar në nëntor të vitit 2002, me qëllim që të ndihmojë autoritetet kosovare që të përfitojnë maksimalisht nga elementet themelore të PSA-së, pra nga asistenca e BE-së, udhëzimet mbi politikat, monitorimi i standardeve europiane dhe koncesionet tregtare.

eksportues, për të zvogëluar deficitin tregtar, Kosova, ashtu sikurse dhe Shqipëria, është anëtare e CEFTA-s (Handjiski dhe Sestovic, 2011), si dhe është anëtarësuar në FMN dhe BB. Gjatë muajit qershor 2013 është shënuar një arritje tjetër për këtë vend, duke u pranuar anëtare e plotë në CEB⁵⁰, bankë kjo e cila është degë autonome e KE-së, dhe gjithashtu aspiron në mekanizma të tjerë të fuqishëm ekonomiko-financiar, si OBT etj.

Kosova ka arritur progres të madh dhe në shumë fusha të zhvillimit, si në: rritjen e stabilitetit politik, ngritjen e nivelit të sigurisë, ka ekonomi të stabilizuar si dhe me rritje të vazhdueshme, plotësim të legjislacionit etj. Kështu, Kosova është bërë pjesë e rëndësishme e iniciativave të bashkëpunimit rajonal, përmes të cilave është arritur krijimi i tregut të përbashkët rajonal, eliminimi i tarifave doganore, eliminimi i barrierave tregtare, si dhe hapja e perspektivave të reja. Gjithashtu është krijuar një mjedis i stabilizuar makroekonomik, si sistem i qëndrueshëm financiar. Për më tepër janë bërë reforma në politikën fiskale në aplikimin e normave më të ulëta tatimore në rajon. Përmendim gjithashtu se është arritur progres i konsiderueshëm në ngritjen e infrastrukturës sa moderne dhe tradicionale, si brenda Kosovës, po ashtu edhe në lidhje me rajonin, ku vlen të përmendet këtu lidhja me Shqipërinë përmes autostradës së ndërtuar. Kjo rrugë ka rëndësi të madhe, pasi Kosovës i krijohet distancë shumë e afërt me portin në Adriatik, përmes të cilit ajo lidhet me transportin detar. Ky benefit i ka siguruar kështu Kosovës edhe më shumë mundësi për hyrjen e investimeve të huaja. Ndërtimi i autostradave të cilat e lidhin Kosovën me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Serbinë, ka filluar dhe paraqet mundësi mjaft të favorshme për investitorët e huaj.

Vitet e fundit investuesit e huaj po tregojnë interes të lartë për destinacione që janë të pashfrytëzuara më parë nga investimet, sidomos të burimeve. Pjesë e këtij interesi, ashtu sikurse dhe Shqipëria, është dhe Kosova, ku pas viteve '90 kanë qenë në fokus të sipërmarrësve nga Europa Perëndimore dhe vende të tjera të zhvilluara (Tempera, 2013: 27-63), *Le piccole e medie imprese nei Balcani occidentali..* Në kuadër të ndryshimeve ekonomike që po ndodhin në tregun ndërkombëtar, Kosova ka përshtatur një legjislacion për investimet e huaja direkte, duke synuar krijimin e një klimë shumë favorizuese për investitorët e huaj, duke mos i diskriminuar nga investuesit vendas dhe duke i ofruar gëzimin e të njëjta të drejtave si këto të fundit. Një ndër hapat më të

⁵⁰ Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës.

rëndësishëm për inkurajimin dhe ofrimin e sigurisë ndaj investitorëve të huaj është miratimi i ligjit *“Për Investimet e huaja”* në Kosovë (Ligji Nr. 02/L-33, 2005). Sipas këtij ligji, investuesi i huaj është çdo person i huaj që bën investim në Kosovë, madje këtu vihet re edhe trajtimi që ligji i bën termit *“investitor i huaj”*, duke e trajtuar këtë koncept në mënyrë më të vakët se trajtimet që i bën legjislacioni shqiptar. Në vitin 2014 vjen Ligji nr. 04/L-220 (Ligji Nr. 04/L-220, 2014) me ndryshime të dukshme ndaj atij të mëparshmit. Ky ligj, ashtu sikurse ligji shqiptar për investimet e huaja, kërkon t’u përcjellë sa më shumë hapësira dhe siguri investimeve dhe investuesve të huaj. Ky ligj ka për qëllim ofrimin e mbrojtjes për investuesit e huaj, edhe pse në këtë rast nuk jemi në kushtet e mbrojtjes së posaçme që ofrohet në ligjin shqiptar. Ajo që spikat në këtë ligj është se mbështet parimin e *“mosdiskriminimit”*:

“Republika e Kosovës trajton në mënyrë të njëjtë investitorët e huaj, pavarësisht bazës së shtetësisë, origjinës, vendbanimit, vendit të themelimit të afarizmit ose kontrollit (Neni 4 i Ligjit 04/L-220, 2014).

Ligji u siguron qëndrueshmëri regjimit të investimeve.

“Nëse investitori i huaj ka bërë investim në Republikën e Kosovës dhe brenda periudhës pesë (5)-vjeçare, menjëherë pas bërjes së investimit, ndonjë dispozitë e këtij ligji ndryshohet ose revokohet, dhe kjo ka ndikim negativ në investitorin e huaj ose investimin e tij, atëherë investitori i huaj ka të drejtë në kompensim nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas nenit 8 paragrafi 2. të këtij ligji, për të gjitha dëmet dhe shpenzimet e shkaktuara si pasojë e ndryshimit, revokimit ose nxjerrjes së një akti të tillë (Neni 6 i ligjit 04/L-220, 2014).

Në këtë ligj vërehet, sikurse dhe në legjislacionin shqiptar, se kërkohet një qasje sa më afër praktikave të Komunitetit Europian dhe këtë gjë e ka pasqyruar dhe në ndryshimet e fundit që ka pësuar. Ashtu sikurse në ligjin shqiptar, ligji për investimet e huaja në Kosovë e ndalon shpronësimin e investimeve të huaja, si në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu edhe në mënyrë të tërthortë. Në rast të kundërt i njeh investuesve të drejtën e kompensimit kundrejt një vlere reale.

3.9.1. Reformat e të bërit biznes në Kosovë

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë në Kosovë dhe institucionet e tjera përkatëse janë të përkushtuara të përmirësojnë mjedisin e të bërit biznes, duke ndërmarrë nismat e mëposhtme:

- Regjistrimin e bizneseve pa pagesë dhe brenda një afati të shkurtër kohor;
- Mbrojtjen e investitorëve duke ndikuar, ndër të tjera, edhe tek kërkesat për publikimin e transaksioneve. Kështu, në rast të konfliktit të interesit mes zyrtarëve të korporatave, arrin duke u mundësuar aksionerëve që t'i mbulojnë dëmet e shkaktuara si pasojë e transaksionit, si dhe duke i mundësuar gjykatës ta zhvlerësojë transaksionin nëse aksionerët e realizojnë kërkesën me sukses;
- Përmirësimi i dukshëm i lejes së ndërtimit pasi koha është shkurtuar 80 % dhe janë ulur shpenzimet për regjistrimin, përkatësisht ndërtimin e objektit;
- Krijimi i një mjedisi sa më të përshtatshëm për investitorët. AKP-ja⁵¹ vijon me një program të përsheptuar të privatizimit të ndërmarrjeve dhe aseteve përmes një procesi të tenderimit transparent dhe konkurrues, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Ky proces është tërheqës për investitorët, sepse i mundëson pronarit të ri të bëjë investime të menjëhershme si dhe të bëjë përzgjedhjen e fuqisë së re punëtore, si edhe duke ofruar pronësi të pastër pa ndonjë borxh të trashëguar, pa ndërhyrje të kreditorëve dhe pretendentëve të mundshëm.

Investuesit e huaj, nëse investojnë në Kosovë, kanë edhe disa përfitime të tjera, ndër të cilat me kryesoret janë:

- Taksat e ulëta.
- Sistemi tatimor është mbajtur në një nivel të tillë që është jashtëzakonisht i thjeshtë.
- Popullsia e re, e motivuar, me shpirt dhe aftësi të forta ndërmarrëse dhe gjithashtu njohuri të përgjithshme të shumicës së gjuhëve të huaja, 70% nën moshën 35-vjeçare.
- Burimet natyrore (Kosova ka pasuri të mëdha nëntokësore, me 14 700 milionë ton, ajo zë vendin e pestë në botë për rezervat e linjtit prej të cilit prodhon

⁵¹Agjencia Kosovare e Privatizimit, (www.pak-ks.org).

sasinë më të madhe të energjisë elektrike. Dhe vetëm gjatë vitit 2008 ka prodhuar 4738 miliard kw/h dhe ka shpenzuar 515 6 miliard kw/h energji elektrike).

- Në përkrahjen e bizneseve ofron institucione moderne.
- Për regjistrimin e bizneseve (brenda 3 ditëve) ka krijuar një procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë.
- Ka një sistem të sigurt bankar (sektori bankar në Kosovë vlerësohet ndër sektorët me performancën më të mirë në ekonomi. Vetë depozitat bankare dhe kreditë janë në rritje, ndërsa shkalla e shërbimeve financiare po shënon zgjerim tani e më tej).
- Ofron strukturë moderne ligjore dhe në pajtim me legjislacionin e BE-së.
- Falë monedhës zyrtare, që në Kosovë është euro, ndihmohet një balancim për eliminimin e rrezikut të eurozonave.
- Kosova është e pasur me tokë bujqësore dhe blegtorale, ku 53% e sipërfaqes totale është tokë e punueshme.
- Tekstili ka qenë sektor shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në Kosovë, ndërsa kulmin e zhvillimit të saj e kanë 15 ndërmarrjet shoqërore të prodhimit të tekstilit, të cilat kanë punësuar më shumë se 1 000 njerëz dhe kanë arritur shitje deri në 35 milionë euro;
- Industria e ndërtimit, e cila është bërë një ndër sektorët më të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, ofron mundësi të shumta për investim.
- Turizmi (potenciali i zhvillimit të turizmit në Kosovë lidhet ngushtë me pozitën gjeografike të saj, e rrethuar nga të gjitha anët me male, dhe në qendër të Ballkanit; vendi kështu ka potencial për turizëm dimëror).

Kosova po punon për krijimin e tregut të kapitalit financiar, në të cilin do të gjejnë hapësirë investitorët të cilët duan të investojnë në aksionet e kompanive të ndryshme.⁵² Të gjitha këto që u përmendën më sipër e veçojnë Kosovën si një vend mjaft tërheqës, duke ofruar mundësi investimi në sektorë të ndryshëm⁵³.

⁵² Banka Qendrore e Kosovës, <http://www.bqk-kos.org>.

⁵³ Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (<http://www.investks.org/sq/Investo-në-Kosovë>)

3.10. Krahasimi i IHD-ve në Shqipëri me vendet e Ballkanit Perëndimor

Tashmë Shqipëria tashmë është një nga partnerët rajonal, që kontribuon në ruajtjen e stabilitetit si politik ashtu dhe ekonomik të rajonit me një rol aktiv, të moderuar dhe konstruktiv në procesin e bashkëpunimit rajonal. Shqipëria, mbështet dhe promovon parimin e gjithëpërfshirjes, si parim bazë të procesit të bashkëpunimit rajonal, pasi bashkëpunimi rajonal shkon përtej fqinjësisë së mirë dhe merr kuptim nëpërmjet përpjekjeve dhe parimeve për krijimin e një infrastrukture të përbashkët rajonale. Fuqizimi i një rrjeti infrastrukturor rajonal me akse që përshkojnë linjat kryesore të qarkullimit dhe fluksit të shkëmbimeve, si dhe lidhja e tyre me rrjetet infrastrukturore evropiane dhe euro-aziatike, ndikon në proceset pozitive në rajon, duke e bërë atë më të siguritë, duke rritur dimensionin e tij gjeo-ekonomik, duke zgjeruar në përmasa të konsiderueshme tregun dhe duke rritur interesin për investime të huaja. Dihet që Ballkani Perëndimor është jo vetëm një term gjeopolitik që i referohet Shqipërisë, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës, Serbisë, Kroacisë, Malit të Zi dhe së fundi Kosovës. Shpesh vendet e Ballkanit Perëndimor sa në kontekstin politik aq dhe në atë ekonomik përshkruhen si “*vrina e zezë*” e Europës nga pasoja e mungesës së bashkëpunimit me pjesën tjetër të Europës dhe procesit sa të ngadaltë të reformimit drejt modernizimit dhe demokratizimit të shoqërive të tyre. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë tërhequr shumë më pak IHD krahasuar me vendet e Evropës Qendrore Lindore. Paqëndrueshmëritë ekonomike dhe politike në Ballkan dëmtojnë atraktivitetin e këtij rajoni karshi investitorëve të huaj. Flukset e IHD-ve ishin në përgjithësi të ulëta deri në vitin 2000 me përjashtim të Kroacisë, e cila tërhoqi flukse IHD-sh të konsiderueshme nga viti 1997 e më pas.

Vihet re se më shumë se gjysma e totalit të flukseve të IHD-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pasur si destinacion Kroacinë.

Gjatë viteve të fundit Shqipëria, Bosnja, Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi kanë arritur të kenë më shumë stabilitet, tranzicioni drejt ekonomisë së tregut në këto vende është akoma jo i plotë dhe pjesa më e madhe e investitorëve të huaj vazhdojnë t'u qëndrojnë larg këtyre vendeve.

IHD – të janë tërhequr kryesisht nga privatizimet p.sh: një e treta e IHD – ve në Kroaci në vitin 2000 dhe 2/3 e fluksevetë IHD – ve në Shqipëri gjatë të njëjtit vit u siguruan nga shitja e një banke dhe dhënia e një license të telefonisë celulare.

Shitja e operatorit shtetëror të telefonisë fikse të Maqedonisë në vitin 2001, siguroi aq flukse të IHD – ve sa dhjetë vitet e mëparshme të marra së bashku. Një pjesë shumë e vogël e investimeve të huaja në këtë rajon janë të orientuara nga eksportet, ndërkohë që IHD – të në investimet “Greenfield” dhe në kompanitë private janë akoma të ulëta.

Sipas Ranierit (2007:5-30), edhe pse këto vende mund të karakterizohen nga problematika të ndryshme, ato arrijnë të shfaqin disa avantazhe të përbashkëta në lidhje me IHD-të:

- Ofrojnë strukturë konkurruese të kostove (toka dhe shërbimet publike janë më të lira si antarët më të rinj të BE-së);
- Tregu i punës është sa i lirë dhe cilësor, forca e punës është relativisht e mirë, e arsimuar dhe me eksperiencë;
- Vendndodhja strategjike dhe afërsi (hyrje në Adriatik dhe fqinjësi gjeografike sa me Europën Perëndimore aq dhe atë Qendrore);
- Gjetja e lëndëve të para në territorin e tyre (druri, metalet, minerale, produktet bujqësore);
- Përmirësimi i politikave si fiskale dhe atyre nxitëse etj.

Si sektorët më interesantë për tërheqjen e IHD-ve në këto vende listohen:

Në Kroaci: *Turizmi; Teknologjia e informimit dhe komunikimit (Siemens, Ericsson janë tashmë prezent në tregun kroat); Farmaceutika (Pliva, Belupo, GlaxoSmithKline); Bioteknologjia; Shërbimet e biznesit (p.sh. përpunimi i të dhënave, call center, telemarketingu etj).*

Në Bosnje dhe në Hercegovinë: *Industria e tekstileve dhe e këpucëve; Metalet; Industria e makinave (Skoda, Volksagen); Industria e përpunimit të drurit dhe agrobiznesi; Turizmi (malor-lojrat olimpike të Sarajevës); Teknologjia e informimit dhe komunikimit; Privatizimi (shërbimet publike); Infrastruktura etj. .*

Në Shqipëri: *Industria tekstile dhe e këpucëve; Agrikultura, industria e përpunimit të ushqimeve dhe pijeve; Turizmi; Sektorë të tjerë prodhues; Privatizimi i sektorëve strategjikë.*

3.11. Rëndësia e IHD-ve në vendin pritës

Zhak Shirak është shprehur se “*Globalizimi nuk e përmirësoi jetën dhe të ardhurat që kishte premtuar*”, (Stiglitz, 2007) por mund të themi se globalizimi me synimet e tij kryesore, atë të eliminimit të kufijve dhe zhvillimit të tregtisë së lirë duke “shembur” kufijtë midis shteteve, ka ndikuar në zhvillimin e ekonomisë dhe në rritjen e IHD-ve. IHD-të nga rëndësia që ato kanë dhe efektet pozitive që sjellin kanë tërhequr vëmendjen e shumë aktorëve shoqërorë, politikë dhe kryesisht ekonomikë.

Rëndësia e avantazheve që krijohet falë IHD-ve, është diskutuar në çështjet e mësipërme, por listës së tyre i shtohet dhe një tjetër element i rëndësishëm, po aq sa ai i zhvillimit ekonomik që është ai i bashkëpunimit ndërkombëtar që mundëson krijimin e marrëdhënie më të ngushta midis kombeve, duke shërbyer dhe si katalizator për tensione dhe mosmarrëveshje që mund të jenë të pranishme.

Prania e IHD-ve që lindin si një marrëveshje midis investuesve dhe vendeve pritëse ka ndier të domosdoshme krijimin e institucioneve për t’i mbikëqyrur ato, dhe ndër më të rëndësishmet që janë të pranishme dhe në shtetin tonë përmenden:

- Themelimi i Qendrës Ndërkombëtare për Rregullimin e Investimeve të Huaja, të themeluar në Washington në vitin 1966.
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë (NAFTA).
- Banka Botërore⁵⁴ me dy institucionet e saj: 1. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (AID ose IDA).
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Ndikimi pozitiv i IHD-ve, është i njohur nga të gjithë, ndaj ato mikpritën nga çdo instancë e një vendi, që nga qytetarët e deri te politikëbërësit, që ndërmarrin hapa nga më të ndryshmet për të rritur numrin e prurjeve të tyre. Përfitimet e vendeve pritëse nga

⁵⁴ Ajo është krijuar në 27 dhjetor 1945 me emrin e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim pas nënshkrimit të marrëveshjes Bretton Woods. Për të luftuar varfërinë duke dhënë ndihma, financime dhe këshilla për shtetet që janë në vështirësi. Grupi i Bankës Botërore është në vetvehte i përbërë prej pesë institucioneve. Selia e saj është në Washington. Presidenti zgjidhet për 5 vjet prej Këshillit të Administratorëve të Bankës, me një mandat të rinovueshëm. Sipas një rregulle të pranuar në heshtje, drejtori i FMN caktohet prej qeverive evropiane, ndërsa presidenti i BB caktohet prej qeverisë amerikane, meqënëse Shtetet e Bashkuara janë aksioneri kryesor i BB. Ajo bën pjesë në institucionet e specializuara të sistemit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

flukset e IHD-ve në ekonomitë e tyre nuk kanë vetëm natyrë të pastër ekonomike, por gërshetohen edhe me elementë të tjerë social.

- *Investimet e huaja direkte ndikojnë në forcimin e kapitalit:*

Në kohën që kompanitë e huaja mobilizojnë burimet brenda sistemit të tyre, filialet në vendet e huaja mund të rrisin fondet përmes obligacioneve, huave etj. Duke pasur parasysh se këto fonde rrisin nivelin e kapitalit në tregjet ndërkombëtare, sjellin gjithashtu edhe një prurje më të madhe të hyrjeve të flukseve financiare të huaja të nevojshme për zhvillimin. Ndërkaq meqenëse këto ndërmarrje shumëkombëshe kanë akses në një shumëllojshmëri më të gjerë mundësie financimi, kostoja e korrigjuar me riskun e kapitalit do të jetë më e ulët për to sesa për firmat e vetë vendeve në zhvillim. Ky avantazh i mundëson atyre të jenë më të hapur se firmat e tjera ndaj mundësive investuese. Si rrjedhim, ato mund të ndërmarrin projekte për të cilat firmat vendase nuk kanë kapacitetet e nevojshme ose konsiderohen si shumë të rrezikshme për këto të fundit. Në këtë mënyrë ato zgjerojnë frontin e investimeve për vendet pritëse.

Me kalimin e kohës, për firmat vendase mund të krijohen kushte lehtësuese për investimin në aktivitete që për momentin janë përtej mundësive të tyre. Në të tilla raste IHD-të shërbejnë për të stimuluar investimin vendas duke rritur kështu më shumë investimet totale të vendit pritës. Më e rëndësishmja është se IHD-të nuk janë vetëm një shtesë e burimeve të jashtme të financimit për zhvillimin e vendeve pritëse, por ato shërbejnë edhe për stabilizimin e këtyre flukseve, më shumë se format e tjera të financimit. IHD-të bazohen në një studim afatgjatë të tregut, potencialin e rritjes dhe karakteristikat strukturore të vendeve pritëse.

Kështu IHD-të janë qartësisht një formë financimi më e qëndrueshme sesa format e tjera të investimit. Këtë e provojnë edhe vërtetimet kryera nga Banka Botërore për mbi 136 vende për të cilat të dhënat janë të disponueshme, ku vetëm për 27 prej tyre, paqëndrueshmëria e flukseve të IHD-ve është më e lartë sesa e format e tjera të financimit të jashtëm në vitet 1980 dhe ky numër shkoi në 22 duke iu afruar viteve 1990.

Gjithashtu duhet theksuar se edhe pse IHD-të kanë një komponent borxh-krijues, ato mbeten një investim i mirë. Përfitimet riadhesohen vetëm kur gjithë të ardhurat apo një pjesë e tyre nga ky investim riinvestohen në vendin pritës.

Kështu pjesa më e madhe e riskut mbahet nga aksionerët e kompanisë së huaj. Ky është një avantazh i dukshëm mbi huat nga bankat të cilat duhet të paguhen me interesa fikse pavarësisht nga performanca e projektit për të cilin kjo hua është përdorur.

IHD-të ndikojnë në forcimin e kapitalit, si dhe në marrëdhëniet midis vendeve, herë si borxhe krijuese e herë si fitimprurëse.

- *Investimet e huaja direkte ndikojnë në rritjen e produktivitetit:*

Sipas mendimit ekonomik tradicional, norma e rritjes së produktivitetit mat kontributin e ndryshimeve teknologjike të jashtme në rritjen ekonomike.

Në varësi të llojit të teknologjisë (punë apo veprime me kapitalin), strukturës së ekonomisë dhe lehtësisë të zëvendësimit të faktorëve të prodhimit, ndryshimet teknologjike mund të jenë më të mëdha apo më të vogla se rritja e produktivitetit. Në të njëjtën kohë, rëndësia që merr zhvillimi teknologjik, organizimi, praktikat e menaxhimit, shtimi i njohurive të ndryshme si dhe faktorë të tjerë, gjithnjë e më shumë po njihet si pjesë përbërëse e rëndësishme e të gjithë procesit, duke kontribuar kështu në rritje të produktivitetit (Federica Saliola, Zanfei, 2007). Pavarësisht nga niveli i saktë i kontributit të avancimit teknologjik në rritjen ekonomike, rëndësia e këtij kontributi është e vërtetuar prej shumë kohësh.

Kështu rritja ekonomike e shpejtë e vendeve në zhvillim në gjysmën e dytë të shekullit XX, erdhi nga përvetësimi i risive teknologjike që sillnin vendet e zhvilluara. Këto vende, të cilat, në të vërtetë më shumë sesa të shpiknin nga e para atë që kishte ekzistuar më parë, kanë imituar dhe importuar praktikat më të mira nga ekonomitë më të zhvilluara, kanë përjetuar një rritje ekonomike të papërsëritur më parë. Transferimi dhe përshtatja sa më e shpejtë e “praktikave më të mira” përtej kufijve është esenca e zhvillimit ekonomik.

Praktikat më të mira mund të transferohen përmes disa mekanizmave. Blerësit e huaj të eksporteve mund të sigurojnë kërkesën për të rritur nivelin teknologjik për firmat vendase. Mallrat kapitale të importuar mbartin përmirësim teknologjik (Zanfei, 2011).

Për më tepër mënyra më e mire e transferimit të këtyre “praktikave më të mira” është përmes investimeve të huaja direkte, pasi këto investime përbëjnë një mekanizëm që i integron elementë nga të gjithë mënyrat e përmendura më sipër.

Në fakt, përfitimi më i madhe i IHD-ve është se ai siguron përmes burimeve financiare, akses në gjithë gamën e aseteve teknologjike, organizuese dhe njerëzore, po aq sa edhe tregu i kompanisë mëmë. Me përjashtime të pakta pjesa më e madhe e ekonomive me rritje të shpejtë u mbështet fuqishëm tek IHD-të për të filluar dhe përballuar transformimin e tyre ekonomik. IHD i transmetojnë praktikat më të mira në dy mënyra: së pari me anë të transferimit të brendshëm të teknologjive dhe aftësive në filialin e huaj të vendit pritës dhe së dyti me anë të shpërndarjes teknologjike në një masë të gjerë të kompanive dhe institucioneve në vendet pritëse.

Megjithëse transferimi i brendshëm i praktikave më të mira përmirëson fillimisht filialet, duke bërë që firmat në pronësi të huaj të performojnë më mirë sesa ato të ngjashme vendase, prania e tyre gjithsesi përbën një aset për vendin pritës. Kjo për dy arsye:

Së pari, shumë nga risitë teknologjike sillen përmes IHD-ve në vendet pritëse;

Së dyti, meqenëse filialet e huaja janë përgjithësisht të parat që sjellin teknikat e reja menaxheriale dhe organizuese, standardet e kontrollit të cilësisë dhe metodat e marketingut, kanë tendencën që të përthithin praktikat më të mira më mirë sesa firmat vendase. Falë dështimeve të pakta në përvetësimin e njohurive, filialet mund të shërbejnë si baza testimi për këto risi.

Së fundi, për shumë vende në zhvillim, të qenët pjesë e rrjetit të një kompanie internacionale, është rruga më e lehtë për të fituar akses në tregjet rajonale apo globale.

Gjithsesi impakti përfundimtar i IHD-ve në rritjen e ekonomisë vendase varet nga shkalla e përhapjes dhe përthithjes së praktikave më të mira në të gjithë këtë ekonomi (Serti, Tomasi, Zanfei, 2008).

Për vendet në zhvillim kanali më i rëndësishëm është përgjithësisht ai që ka të bëjë me blerjen e inputeve dhe shërbimeve nga furnitorët lokalë në vend të atyre të huaj.

Duke i mbajtur gjithë elementët e tjerë të pandryshuar, zgjedhja e furnitorëve lokalë është ajo që ka kosto më të ulët të transaksioneve dhe që krijon mundësi për specializim dhe fleksibilitet më të madh. Shtrirja me të cilën filialet e huaja vendosin lidhjet me furnitorët lokal shkon nga industria në industri dhe nga vendi në vend.

Megjithëse është krijuar ideja se aksesimi në ekonominë e vendit pritës për filialet e huaja është e limituar, ekzistojnë të dhëna empirike që tregojnë se, në qoftë se furnitorët në një ekonomi kanë kapacitete të mjaftueshme, lidhjet me filialet e huaja mund të jenë më të forta se ato me firmat vendase.

Shpërndarja e praktikave më të mira në vendet pritëse varet si nga mënyra e funksionimit të tregut të tij ashtu edhe nga kapacitetet përthithëse të firmave vendase. Atje ku nxitësit strukturorë të tregut janë të shtrembëruar, flukset e IHD-ve do t'i sjellin më pak përfitime vendeve pritëse. Në mënyrë të ngjashme, kur baza e njohurive të vendeve pritëse është e dobët dhe informacioni është asimetrik, pak kanale transmetimi të praktikave më të mira do të jenë të vlefshme.

- Krijimi i mekanizmave për zhvillimin social:

Siç u studiua më lart, IHD-të janë një stimul i rëndësishëm për rritjen ekonomike duke mundësuar zhvillimin e shpejtë të vendeve të cilët mund të kalojnë më vrullshëm stadet më të ulëta të zhvillimit për të kapur ato të ekonomive më të avancuara. Në të njëjtën kohë IHD-të sigurojnë mekanizma të cilat përmirësojnë normat sociale. Në këtë kuadër ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një vendi në një spektër shumë më të gjerë sesa thjesht ai ekonomik. Dy aspektet më të rëndësishme të zhvillimit social janë punësimi dhe mjedisi.

1. Punësimi dhe standardet e punës.

Për vendet në zhvillim, rritja e nivelit të përfitimeve financiare dhe sigurisë në punë ka qenë gjithmonë një objektiv kryesor për politikatat sociale.

Këto dy elemente janë mjeti kryesor për të arritur barazinë në shpërndarjen e të ardhurave dhe standarde më të larta të mirëqenies për pjesën më të madhe të popullsisë. Për shkak të karakteristikave të tyre të veçanta, (tendenca për të qenë sa më të zgjeruar, me një teknologji sa më të sofistikuar, ushtrimi i presionit konkurrues në tregjet e

produkteve të tyre, mundësitë më të mëdha të manovrimit në veprimet e tyre krahasuar me firmat vendase), IHD-të luajnë një rol të pazëvendësueshëm në krijimin e vendeve të punës dhe ngritjen e vendit në nivele më të larta zhvillimi.

Ekzistojnë tre mekanizma bazë mes të cilëve IHD-të gjenerojnë punësimin në vendet pritëse: *Së pari*, filialet e huaja punësojnë individë në operacionet e tyre të përditshme. *Së dyti*, nëpërmjet lidhjeve të shkuara dhe të ardhshme, punësimi krijohet në subjekte të cilët shërbejnë si furnitorë, nënkontraktorë apo sigures shërbimesh për to. *Së treti*, duke qenë se industritë e lidhura me IHD-të zgjerohen dhe ekonomia vendore rritet, punësimi krijohet edhe në sektorë dhe aktivitete që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me këto IHD.) Të dhënat e plota në lidhje me rolin e IHD-ve në krijimin e vendeve të punës në vendet në zhvillim, mungojnë. Vlerësimet e bëra vendosin punësimin direkt të krijuar nga filialet e huaja në nivelin 2% të forcës së punës në shumicën e vendeve në zhvillim.

Punësimi indirekt i krijuar nga filialet e huaja mund të jetë më i gjerë atje ku bashkëveprimi mes investitorëve të huaj dhe ekonomisë lokale është i fortë. Bazuar në një seri prej tetë rastesh studimi si të vendeve të zhvilluara ashtu edhe të atyre në zhvillim, në një nga këto raste u vlerësua se, kur merrej në konsideratë vetëm punësimi i gjeneruar nga lidhjet e krijuara, çdo vendi pune të krijuar direkt nga filialet e huaja i përgjigjeshin 1.6 vende pune të krijuara indirekt nga IHD-të.

Ndërsa sasia e vendeve të punës të krijuara nga IHD-të është në nivele të larta në agjendën politike të vendeve në zhvillim, cilësia e tyre ka të njëjtën peshë për politikëbërësit.

Pavarësisht nga ideja e krijuar se investitorët e huaj tërhiqen nga vendet në zhvillim vetëm ose kryesisht nga kosto e ulët e fuqisë punëtore, realiteti tregon të kundërtën. Në fakt qarkullon një mendim i përbashkët se kompanitë shumëkombëshe sigurojnë punësim në kushtet të favorshme me praktikën ekzistuese të vendeve pritëse. Në veçanti, korporatat shumëkombëshe me themele të forta orientohen nga standardet ndërkombëtare të punës dhe aplikojnë praktika të mira pune. Kështu për shkak të madhësisë së tyre, sofistikimit teknologjik, kërkesës për të arritur standarde të larta të produkteve, dhe ekspozimit ndaj mbikëqyrjes ndërkombëtare, filialet e huaja pritet të

ofrojnë shpërblime më të larta, kushte më të mira punësimi, dhe mundësi më të mëdha për të rritur kualifikimin dhe formimin për punonjësit më shumë sesa firmat vendase.

Ashtu si edhe praktikat më të mira në lidhje me teknologjinë, praktikat më të mira të punësimit mund të transferohen në vendet pritëse kur filialet e huaja janë të integruara mirë në ekonominë lokale.

Në lidhje me këtë çështje, përhapja e gjithanshme e teknikave moderne menaxheriale dhe organizuese, ndikimin më të madh e ka në kushtet e punësimit dhe në zhvillimin e burimeve njerëzore në vendet pritëse.

Përmes krijimit të një modeli pune më produktiv dhe eficient, IHD-të ndihmojnë në vendosjen e normave të reja të punësimit dhe standardeve më të larta të punës në industritë e lidhura me to. Në Kinë për shembull përmes IHD-ve u prezantua një formë e re e sistemit të kontraktimit të punonjësve në fund të viteve 80-të, i cili lidhte pagat dhe bonuset me produktivitetin e punës. Ky sistem i ri i shpërblimit rezultoi, aq i suksesshëm, sa u bë baza e reformave në tregun e punës (Maddaloni, 2008).

Së fundi, nuk mund të neglizhohjmë faktin se si pjesë e transferimit ndërkufitar të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore, IHD-të gjithashtu sjellin marrëdhënie moderne industriale, që kanë përparësinë më të madhe në vendet e zhvilluara (më e theksuar kjo për IHD-të nga Europa Perëndimore). Në përgjithësi, investitorët e huaj përshtatin sistemin e tyre të marrëdhënieve industriale me legjislacionin dhe praktikat e vendeve pritëse.

Duke bërë këtë, përjasja e tyre në marrëdhëniet e menaxhimit të punës, është e ndikuar nga sjellja e qeverisë së vendit pritës. Gjithsesi, karakteri global i IHD-ve bën që kompanitë e mëdha të huaja të kërkojnë praktika të cilat ndryshojnë në disa aspekte nga ato të ndjekura nga firmat vendase.

Është konstatuar një tendencë e përgjithshme drejt intensifikimit të komunikimit mes nivelit menaxherial dhe punonjësve, e parë kjo në rang ndërkombëtar.

Meqenëse korporatat shumëkombëshe janë firma që investojnë në forcën e tyre të punës dhe bëjnë vazhdimisht marrëveshje me organizatat e punonjësve (sindikatat) për të arritur dhe mbajtur marrëdhënie të mira dhe efektive, vështirësitë në marrëdhëniet

industriale nuk do të jenë më të shumta dhe të shpeshta në filialet e huaja krahasuar me firmat vendase.

Anasjelltas duke qenë se praktikat e tyre të punës janë më të mira për shkak të eksperiencës së tyre ndërkombëtare, modeli i marrëdhënieve industriale të filialeve të huaja shpesh bëhet një guidë për firmat vendase dhe për pjesën e paorganizuar të forcës së punës.

2. Standardet e mjedisit

Degradimi i mjedisit në vendet në zhvillim ka ardhur si një efekt i kombinuar i pasojave të strukturës së prodhimit dhe konsumimit, si në tregun vendas, ashtu edhe në atë të eksportit. Në një ekonomi të globalizuar, impakti i këtyre dy efekteve amplifikohet.

IHD-të shërbejnë si një kanal tjetër, megjithatë, ndërsa është e pamohueshme që ka pasur raste ku kompani të fuqishme kanë zhvendosur prodhimin ndotës në vende apo rajone me standarde të ulëta të mjedisit apo që nuk merreshin fare në konsideratë, nuk mund të nxjerrim si përfundim që këto janë normat, rregullat e funksionimit.

Para së gjithash flukset e IHD-të shkojnë atje ku përfitimi neto është më i madh dhe jo ku kosto është më e ulët. Kjo është arsyeja pse një pjesë e konsiderueshme e flukseve të IHD-ve shkojnë në vendet e zhvilluara, ku faktorët e prodhimit kanë kosto më të lartë, dhe standardet sociale janë më të rrepta, duke shkaktuar kështu një nivel ndotjeje të mjedisit, më të lartë në këto vende. Për sa i përket mbështetjes së argumenteve se IHD-të po ushtrojnë presion mbi vendet në zhvillim për të ulur standardet e mjedisit në mënyrë që të mos humbin investimet dhe më e rëndësishmja, vendet e punës, nuk ka evidenca të forta.

Rreth testimit të hipotezës së “parajsës së ndotjes”, janë bërë disa studime, ku të gjitha përjasjet korrelative që analizojnë lidhjen mes flukseve dalëse të IHD-ve dhe standardeve të mjedisit të vendeve pritëse, dhe përjasjen e zgjedhjes së vendit i cili fut si përcaktues të IHD-ve rregullat për mjedisin, dështuan në mbështetjen e kësaj hipoteze.

Burimet e mjedisit janë input në procesin e prodhimit. Impakti i aktiviteteve industriale në mjedis është kështu i lidhur ngushtë me efikasitetin në prodhim të firmave dhe

kapacitetin e tyre në menaxhimin e riskut të lidhur me mjedisin (Navaretti , Venables 2004). Dëmet mjedisore janë më të mëdha në operacionet pak produktive, në të cilat përdoren teknologji të vjetruara, metodika pune të prapambetura, menaxhim i dobët i burimeve njerëzore. Në këtë kontekst, duke marrë në konsiderate fuqinë teknologjike dhe menaxheriale të tyre, IHD-të janë pozicionuar më mirë në lidhje me standardet e mjedisit dhe nivelin e kërkuar të tyre në krahasim me firmat vendase. Vërtet ka evidenca që tregojnë se shumica e kompanive të huaja rrallë sillen më keq sesa ato vendase. Për më tepër ato kanë tendencën të përkrahin praktikat më të mira në lidhje me mjedisin dhe kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit lokal.

Për të gjithë arsyet e përmendura më lart, IHD-të në vend që të shikohen si një shkak për “kthimin në fillim” të përpjekjeve të vendeve në zhvillim për të gjeneruar rritjen, ato duhet të konsiderohen si një forcë që sjell standarde më të larta të mjedisit. Për shkak të lidhjeve të tyre me botën e zhvilluar, ku tregjet janë më të rrepta në lidhje me standardet e mjedisit, IHD-të mund të shërbejnë si një kanal për transferimin e teknologjive të pastra dhe të sistemeve të menaxhimit të mjedisit në ekonomitë pritëse të tyre.

- *Përforcimi i integritetit në nivel rajonal dhe global:*

IHD-të bazohen në marrëdhëniet me natyrë ekonomike midis dy vendeve që marrin pjesë në të. Duke qenë kështu ato intensifikojnë lidhjet me njëri-tjetrin, hyjnë në marrëveshje të ndryshme, krijojnë kushte për lehtësimin e transaksioneve dhe rritjen e efikasitetit të aktivitetit.

Pra, të gjitha këto ndikojnë në integrimin e vendit mëmë me të gjithë vendet e tjera nga të cilët “zbarkojnë” investitorët. Për vendet në zhvillim ky është një fenomen shumë i rëndësishëm dhe njëkohësisht një target i vendosur nga të gjithë politikëbërësit në to. Për këtë arsye qeveritë e vendeve në zhvillim vazhdimisht punojnë dhe lidhin marrëveshje apo krijojnë një kuadër rregullator i cili lehtëson procedurat dhe detyrimet në lidhje me IHD-të në mënyrë që këto të fundit të kenë një efekt sa më të fortë në drejtim të integritetit.

KAPITULLI IV: LEGJISLACIONI PËR FUNKSIONIMIN E IHD-VE NË SHQIPËRI

Sikurse u përmend dhe në kapitullin paraardhës, IHD-të mbartin avantazhe që i përcjellin në vendin pritës. Qeveritë e çdo vendi i shikojnë dhe i trajtojnë me prioritet investimet që i bëhen vendit të tyre dhe për këtë arsye ndërmarrin nisma për t'i favorizuar sa më shumë ato. Gama e shtrirjes së këtyre nismave është mjaft e gjerë, por ato më të rëndësishmet dhe që i ofrojnë siguri investuesit janë aspektet ligjore. Për këtë arsye, në këtë kapitull do të trajtojmë bazën ligjore për funksionimin e IHD-ve në Shqipëri. Do të bëhet një kalim i hollësishëm i legjislacionit shqiptar si dhe marrëveshjeve, traktateve, konventave etj., të cilat vendi ynë ka nënshkruar e ratifikuar duke u bërë pjesë e tyre. Është pikërisht ky kapitull i cili nxjerr në pah qëllimin e këtij kërkimi. Duke iu referuar dhe titullit të temës së punimit, kuptohet rëndësia e këtij kapitulli, kjo pasi janë pikërisht këto aspekte që kanë ndikim në rritjen e IHD-ve nisur nga transparenca e siguria që i përcjellin investuesit të huaj. E thënë kjo pasi në këtë kapitull bëhet një analizë interpretuese dhe analitike e aspekteve ligjore. Punimi pas kësaj vazhdon me një analizë krahasuese të faktorëve motivues të ligjit shqiptar kundrejt IHD-ve.

Ky kapitull fillon me trajtimin e ligjit *“Për Investimet e huaja”* në Shqipëri, me çështje të së drejtës së pronës duke iu referuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë e duke përshkruar mënyrën e kalimit të pronësisë si dhe të veprime kontraktore. Qëllimisht në këtë pjesë të punimit i është kushtuar vëmendje Agjencive Shqiptare për IHD-të, kryesisht Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, pasi kjo agjenci ka pasur një ndikim mjaft pozitiv në rritjen e flukseve hyrëse të IHD-ve në vendin tonë si një ndër mbështetjet kryesore për investitorët. Gjithashtu, janë trajtuar nismat e rëndësishme të ndërmarra nga qeveritë në Shqipëri ndër vite, si ajo e krijimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), Agjencia e Prokurimit Publik (APP), krijimi i së cilës ka sjellë transparencë në çështjet e prokurimit publik. Në këtë kërkim ka shërbyer dhe ligji *“Për Themelimin e shoqërive tregtare”*, duke specifikuar dhe format e krijimit të këtyre shoqërive që një mund të zgjidhen për investim, ai për të

drejtën e autorit, duke pasur parasysh investimet në pasuritë intelektuale, ligji për koncesionet nisur nga fakti se investime të shumta janë bërë në këtë drejtim. Punimi gjithashtu na paraqet sistemin tatimor në Shqipëri ndër vite dhe ndikimi që ai ka pasur në investime si dhe sistemin e doganave. Nisur nga vëmendja që ka marrë reforma administrative territoriale dy vitet e fundit si dhe ndikimi i saj në investime, është parë e arsyeshme që të jetë pjesë e këtij kapitulli, duke e mbyllur më pas për sa i përket legjislacionit shqiptar me nismën më të re të qeverisë atë të ligjit *“Për Investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”*. Normat e së drejtës ndërkombëtare janë trajtuar në këtë kapitull duke analizuar ndikimin që ato kanë pasur tek investimet e huaja pasi vendi ynë është bërë pjesë e OBT, CEFTA, EFTA, NATO, SEECP, NAFTA, MSA, ICSID bashkë me Arbitrazhin Ndërkombëtar si dhe të Drejtën Ndërkombëtare Private si format e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

4.1. Ligji i parë për IHD-të në Shqipëri

E shkuara e një Shqipërie diktatoriale bëri që ajo të ishte e izoluar në shumë drejtime e sigurisht dhe në atë të investimeve të huaja. Ardhja e një sistemi të ri solli me vete dhe interesin për tërheqjen e IHD-ve. Por në këtë kohë në lidhje me investimet, baza ligjore ishte shumë e vakët për të mos thënë që nuk ekzistonte.

Ligji i parë “Për Investimet e huaja” erdhi në një moment kur tashmë investuesit e huaj kishin filluar të investonin në Shqipëri. Ai fillimisht shërbeu, jo vetëm për të rregulluar aspektet ligjore midis investuesve të huaj dhe shtetit shqiptar, por edhe për t’i dhënë investuesve një provë sigurie e garancie. Ndryshimet që ligji solli në vitin 2010⁵⁵ ishin të shumta e për pasojë ndezën polemika të konsiderueshme.

Me ardhjen në fuqi të këtij ligji e më pas me ndryshimet që ai pësoi, është vërejtur një rritje reale në investimet që janë bërë në sektorë të ndryshëm. Duke iu referuar dhe të dhënave nga institucione zyrtare viti 2010 ka qenë më i begatë për sa i përket IHD-ve. Megjithatë, edhe pse këto ndryshime krijojnë një klimë të favorshme për investimet dhe ndikojnë në inkurajimin e tyre, nuk ka lënë më pas dhe polemikat. Kritikët e këtij ligji janë shprehur se me këto ndryshime, investuesit të huaj i serviret një mjedis shumë më

⁵⁵ Fletorja zyrtare nr.136, faqe: 7435.

komod për të investuar, sesa investuesit vendas duke e “diskriminuar” në një farë mënyre këtë të fundit. E thënë kjo për faktin se ndryshimet në ligj sjellin efekt mbi konkurrencën, duke qenë se investimet shqiptare apo ato të subjekteve nga burime shqiptare, janë në pozicion më pak të favorshëm, siç do ta shohim dhe më poshtë.

Synohet që gjykata ta ketë të ndaluar të marrë masa për sigurimin e padisë, kur këtij procesi gjyqësor i është ofruar mbrojtja e posaçme shtetërore, ndërkohë që një mbrojtje e tillë nuk i sigurohet investuesit vendas edhe pse investimi i tyre mund të jetë në kapital shumë të lartë. Megjithëse ndryshimet në ligj ishin të shumta ato nuk zgjidhën çdo lloj problematike që mund të krijohet gjatë një investimi. Kjo pasi në ligj, nuk trajtohet se cili do të ishte pozicionimi i shtetit shqiptar, në ato rastet kur lind një konflikt ndërmjet dy investitorëve të huaj. Në këtë mënyrë ligji sjell një vakuum për sa i përket zgjidhjes së rastit në fjalë.

Gjithashtu, në traditën dhe precedentin e ligjeve të kësaj natyre në ekonomitë e vendeve në zhvillim kanë krijuar instrumentet bazë promovues për IHD-të dhe për më tepër kryesisht ato tentojnë të lehtësojnë procedurat administrative dhe ambientin që i ofrohet investues. Kjo ka të bëjë me respektimin e dispozitave ligjore; me procedurat e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit; me shpejtësinë e konstatimit të problematikave që lidhen me burokracinë dhe ndëshkimin e tyre në tërësi, veçanërisht në rastet e marrjes së licencave teknike dhe joteknike; me garantimin e standarde evropiane dhe ofrimin e një stabiliteti në respektimin e legjislacionit që ndikon mbi investitorët dhe zbatimin uniform të tij; me zbutjen apo heqjen e barrierave tatimore dhe jotatimore; me krijimin e një sistemi tatimor të thjeshtë dhe neutral; me përjashtime tatimore; me vënie në dispozicion të aseteve shtetërore që nuk janë të përfshira në ndonjë konflikt të mundshëm privat apo shtetëror, kundrejtë një çmimi të ulët ose në rastet më ideale falas dhe së fundmi e mbi të gjitha, me respektimin e kontratave të investitorëve nëpërmjet shtetit ligjor e funksional.

Ndërsa ndryshimet që ka pësuar ligji kanë të bëjnë më shumë me aplikimin e mbrojtjes së posaçme shtetërore se sa me këto elemente të sipërpërmendur që janë të qenësishëm për të tërhequr investuesit. Megjithatë duhet pranuar fakti se edhe pse ligji nuk i ka pasqyruar ndryshimet e mësipërme, falë ndryshime të tjera ka pasur ndikim në rritjen e flukseve të IHD-ve. Kjo pasi në krahasimin me ligjin e mëparshëm të

pandryshuar, investimit i është servirur një mjedis shumë komod nga ai që ishte më parë. Një gjë e tillë ka ndodhur pasi ligji ofron garanci për të gjithë të huajt qoftë persona fizikë qoftë juridikë të gatshëm për të investuar në Shqipëri.

Për të investuar në Shqipëri nuk nevojitet asnjë autorizim paraprak dhe investuesit mund të zgjedhin çfarëdo lloj sektori për projektet e tyre pasi asnjë sektor sipas ligjit nuk është i mbyllur për to. Gjithashtu ligji shqiptar për investimet e huaj nuk i kufizon investimet as për pjesën e përqindjes së pjesëmarrjes së huaj. Ajo çfarë është më e rëndësishme ka të bëjë me faktin se me përjashtim të rasteve të veçanta, falë një interesi të lartë publik të përcaktuar në ligj, investimet e huaja nuk mund të shpronësohen ose shtetëzohen në mënyrë direkte ose indirekte. Kuptohet se asnjë nuk do të dëshironte që të investonte një kapital të lartë e më pas për një projekt të dytë investimi i tyre të shpronësohej. Ndaj kjo është një pikë e fortë e ligjit për të tërhequr sa më shumë investime. Gjithashtu ligjvënësi shqiptar nuk nxjerr asnjë lloj pengese për sa i përket transferimit të fitimeve nga investimi, pasi investorët e huaj mund të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të gjitha fondet dhe kontributet në natyrë që kanë të bëjnë me një investim të huaj.

Investimeve u sigurohet një mbrojtje dhe siguri e plotë pasi në të gjitha rastet dhe në çdo kohë, ato kanë trajtim të barabartë e të paanshëm. Në çdo rast investimet e huaja kanë një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që i sigurojnë normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare.

Investuesve të huaj u sigurohet mbrojtje të posaçme shtetërore nëpërmjet zëvendësimit me të drejta të plota të investitorit të huaj nga ana e shtetit shqiptar në konfliktin juridiko-civil me palë të treta private.

Ky regjim liberal legjislativ bën përjashtim për pronësinë mbi tokën⁵⁶. Pasi toka bujqësore nuk mund të blihet nga të huajt kjo duke iu referuar ligjit *“Për shitblerjen e trojeve”* i ndryshuar (Ligji 7980, 1995)⁵⁷, dhe ligjit *“Për kalimin në pronësi të tokës*

⁵⁶ Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. Mënyra kryesore për fitimin e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme është kontrata e blerjes e saj.

⁵⁷ Fletore Zyrtare nr.19, Faqe:447, 1997.

bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”⁵⁸ i ndryshuar (Ligji 8337, 1998) ku është parashikuar kufizimi në lidhje me të drejtën e të huajve për të blerë pasuri të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar. Personat fizikë apo juridikë të huaj u lind e drejta të blejnë truall, vetëm pasi të kenë arritur kryerjen e investimeve në përputhje me lejen e ndërtimit. Tokat bujqësore, pyjet, kullotat dhe livadhet nuk mund të blihen nga personat e huaj fizikë ose juridikë, por ato kanë të drejtë t’i marrin me qira për një periudhë deri në 99 vjet. Për sa i përket pronës shtetërore mund t’i jepen bizneseve private në katër mënyra:

1. *Shitje nëpërmjet privatizimit;*
2. *Koncesione;*
3. *Dhënie me qira;*
4. *Enfiteozë.*

Ndërsa, për sa i përket blerjes së pronës private të banimit legjislacioni shqiptar nuk ka përcaktuar asnjë kufizim për të huajt. Kjo ka sjellë që mjaft investues të akomodohen me banim në vendin tonë pa hasur asnjë lloj problematike. Prona private mund të blihet nga të huajt ashtu sikurse nga shtetasit shqiptarë në përputhje me rregulla të përcaktuara në legjislacionin shqiptar. Nëpërmjet kryerjes së veprimit juridik të vlefshëm, që do të thotë:

“Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to, duhet të behet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht në ligj. Në rastet e tjera veprimi juridik është i vlefshëm por nuk mund të provohet me dëshmitarë” (Neni 83 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, 2009:35).

Për ta bërë veprimin juridik të vlefshëm duhet të plotësohen tri elemente:

1. Palët që kryejnë veprimin juridik duhet të kenë zotësinë për të vepruar⁵⁹; (Neni 6 i Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, 2009:12).

⁵⁸ Fletore Zyrtare nr.12, Faqe:442, 1998.

⁵⁹ Ligjvënësi kërkon zotësinë për të vepruar të palëve për shkak të prezumimit se vullneti i një të pazoti nuk mund të jetë i saktë. Zotësia për të vepruar është zotësia e personit që me veprimet e tij fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime. Zotësia për të vepruar nënkupton ekzistencën e zotësisë juridike dhe merr

2. Vullneti i brendshëm i palëve në një veprim juridik duhet të përputhet me shfaqen e tij të jashtme⁶⁰;
3. Veprimi juridik duhet të realizohet në formën e kërkuar nga ligji⁶¹, (Në rastin e transferimit të pasurive të paluajtshme forma është element thelbësor për vlefshmërinë e veprimit juridik, mungesa e të cilës e bën të pavlefshëm veprimin juridik).

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi në rast të mungesës së njërit prej këtyre elementeve do të ndodhemi përpara rastit të pavlefshmërisë së veprimit juridik.

Pavarësisht, se parimi i përgjithshëm i sistemit modern të kontratave është ai i lirisë së formave, duke bërë që kontratat të mund të realizohen që nga deklaratimet e shprehura deri në kontratat e heshtura, legjislacioni shqiptar në rastin e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme kërkon në mënyrë eksplicite dhe të domosdoshme formën si një element shumë të rëndësishëm të vlefshmërisë së veprimit juridik.

Kontrata për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme duhet të bëhet me akt noterial, dhe kjo për faktin e thjeshtë se është pikërisht noteri ai i cili vërteton me anë të formaliteteve të kërkuara nga ligji “Për noterinë”, vullnetet e deklaruara të palëve në prani dhe përpara tij⁶². Vetëm në këtë mënyrë investuesit e huaj dhe poseduesit e pasurisë bëjnë të mundur kalimin e pronësisë, duke shprehur në këtë mënyrë vullnetin e tyre në një veprim juridik siç është ai i tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, duke e bërë atë të ligjshëm dhe të plotë. Kjo, pasi pronësia mbi një pasuri të paluajtshme, kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të pasurisë. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës duke fituar dhe të

formën e saj të plotë kur personat arrijnë moshën 18 vjeç. Zotësia për të vepruar është e lidhur jo vetëm me arritjen e një moshe të caktuar por edhe me aftësinë mendore.

⁶⁰ Veprimi juridik nuk është gjë tjetër veçse shfaqja e ligjshme dhe e lirë e vullnetit të personit fizik ose juridik. Shfaqja e vullnetit është e lidhur ngushtë me dëshirën e personit për të kryer veprimin juridik. Shfaqja e vullnetit synon në ardhjen e pasojave të caktuara, në lindjen ndryshimin ose shuarjen e të drejtave ose detyrimeve civile. Është më se e domosdoshme që personi fizik ose juridik jo vetëm të shfaqë vullnetin e tij të lirë, por edhe ky vullnet të jetë i ligjshëm.

⁶¹ Një nga kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik është edhe veshja e tij me formën e kërkuar ligjore, mungesa e së cilës sjell si pasojë pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik. Në rastin e transferimit të pasurive të paluajtshme forma është element thelbësor për vlefshmërinë e veprimit juridik, mungesa e të cilës e bën të pavlefshëm veprimin juridik.

⁶² Fletore Zyrtare nr. 171 9, Faqe: 7628, 2009.

gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qënien e tij si pronar mbi këtë pasuri. Kjo pasuri më pas duhet të regjistrohet⁶³, në përputhje me nenin 44, të K.C:

“Sendet e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Regjistrohen dhe ato sende të luajtshme për të cilat kërkohet shprehimisht në ligj” (Neni 144 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, 2009: 52).

Për sa i përket rregjistrimit të sendeve të paluajtshme i referohemi nenin 192 të Kodit Civil të R.SH, ku shprehimisht citohet:

“Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji” (Neni 192 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, 2009: 67).

Pra, transkriptimi/regjistrimi në regjistrat përkatës publike kërkohet për veprimet juridike që janë kontratat që tjetërsojnë pasuritë e paluajtshme, për veprime juridike që kanë lidhje me të drejtat reale mbi sende të caktuara, siç janë kontrata e qerasë mbi 9 vjet, si dhe për sende të luajtshme të një kategorie të veçantë siç janë anije, aeroplanë, automjete etj. Megjithatë, kontrata si veprim juridik i dyanshëm në rast se plotëson kushtet për vlefshmërinë e saj edhe në rast se nuk regjistrohet në regjistrin e pasurive të

⁶³ Regjimi i transkriptimit ose regjistrimit realizohet nëpërmjet mbajtjes së regjistrit publik dhe ka si objekt regjistrimin e akteve që krijojnë, ndryshojnë ose përfundojnë të drejta reale mbi pasuritë e paluajtshme dhe pasuritë e luajtshme të regjistruara. Si regjim imponues transkriptimi ose regjistrimi karakterizohet nga dy parime bazë: 1. Parimi i deklarimit që nënkupton se regjistrimi ka vlerë deklarative, njohëse dhe nuk ka vlerë krijuese. Regjistrimi nuk ka vlerë krijuese, në kuptimin që regjistrimi nuk është një element i perfeksionimit të kontratës dhe as kusht për fitimin e të drejtës mbi pasurinë e paluajtshme. Regjistrimi nuk eliminon nulitetin apo pavlefshmërinë e kontratës, si veprim juridik i regjistruar në regjistrin publik. Regjistrimi nuk siguron vlefshmërinë dhe efikasitetin e titullit të pronësisë. Sistem siguron vetëm faktin që shitësi figuron si pronar në bazë të të dhënave të regjistrimit, por nuk garanton në mënyrë absolute vlefshmërinë e të drejtës së pronarit, dhe se ky i fundit është pronar i ligjshëm, pasi sistemi i regjistrimit nuk krijon të drejta, por është një sistem i publikimit deklarativ. 2. Parimi i prioritetit në kohë që nënkupton se akti që regjistrohet i pari në regjistrin publik ka vlerë mbizotëruese. Regjistrimi është shërbim publik, që i lejon kujt do të marrë të dhëna mbi aktet që transkriptohen. Pikërisht, marrja e saktë e informacionit nëpërmjet publikimit krijon siguri në qarkullimin e pasurive të paluajtshme duke mundësuar që përfituesi i të drejtave mbi sendin të jetë i garantuar për sendin që blen dhe të drejtat reale përkatëse. Sipas legjislacionit shqiptar sistemi i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk ka efekt krijues, por publikues, njohës.

paluajtshme është plotësisht e vlefshme mes palëve që e kanë realizuar atë. Kjo pasi është kontrata ajo që transferon mes palëve pronësinë e sendit të paluajtshëm, krijon të drejta reale mbi sendin dhe legjitimon pronarin të kërkojë dhe mbrojë këto të drejta.

4.2. Agjencitë shqiptare për IHD-të

Në fillimet e viteve '90 Shqipëria ishte e ndërgjegjshme për ndryshimet që po ndodhnin në ekonominë europiane dhe madje dhe në atë botërore. Për këtë kishte si qëllim tërheqjen e IHD-ve si rruga e duhur drejt rritjes ekonomike të vendit.

Fluksi i investimeve të huaja gjithnjë po vinte në rritje, ndaj u pa e nevojshme që përkrah ligjit *“Për Investimet e Huaja”* të funksiononte dhe një strukturë tjetër për të tërhequr investimet. Kjo strukturë u quajt *“Albinvest”*. Albinvest ka qenë agjencia që ka pasur sukses në bashkëpunimin e saj me Ministrinë e Ekonomisë në periudhën mars-qershor 2007, për projektin e *“Fondi i granteve të konkurrueshmërisë”*.

Albinvest ishte organizimi i qeverisë të asaj kohe, që tërhiqte investimet e huaja direkte në Shqipëri. Ajo ishte ndër strukturat e para që solli një promovim të pasurive natyrore si dhe mundësive për të investuar në Shqipëri. Bëri të mundur prezantimin e vendit si një mundësi që i vinte investuesve për rritjen e kapitalit të tyre. Ajo ndihmoi kompanitë të planifikonin dhe të investonin në Shqipëri⁶⁴. Kjo strukturë u zëvendësua nga një tjetër strukturë me funksion dhe formë disi të njëjtë. Mbështetur në ligjin *“Për krijimin dhe organizimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”* (Ligji 10303, 2010)⁶⁵ u themelua Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). AIDA është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, dhe ka një bord drejtues⁶⁶ si dhe ka për qëllim maksimizimin e flukseve të investimeve të huaja dhe vendase nëpërmjet rritjes së aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri duke nxitur inovacionin dhe kapacitetet teknologjike të tyre. AIDA i kushton një fokus të veçantë zhvillimit ekonomik të vendit nëpërmjet:

⁶⁴ Marrë nga: <http://www.arkivalajmeve.com>, parë më 11 shkurt 2012.

⁶⁵ Ligji Nr.10 303, datë 15.07.2010 *“Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”*. Shpallur me dekretin nr. 6653, datë 26.07.2010, www.ligjet.org.

⁶⁶ Neni 2 i ligjit 10303 jepet përkufizimi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

a) Lehtësimit dhe mbështetjes së investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime, duke i ofruar shërbime dhe mbështetje investitorëve ekzistues ose potencialë;

b) Rritjes së aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, duke mundësuar rinovimin dhe përmirësimin e produkteve e të shërbimeve, si dhe të teknologjisë që ato përdorin, nëpërmjet ofrimit të mekanizmave që bazohen te rritja e kapaciteteve teknike dhe e aftësive rinovuese. Në funksion të tërheqjes dhe rritjes së investimeve në RSH, kjo agjenci:

a) identifikon dhe promovon mundësitë e investimeve në Shqipëri, si dhe zhvillon veprimtari në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë, në nivel ndërkombëtar;

b) përgatit dhe zbaton dokumentin e politikave 3-vjeçare të promovimit të investimeve, e cila miratohet me vendim të bordit drejtues;

c) përgatit dhe zbaton planin vjetor të veprimit e të marketingut, ku përcaktohen grupet e interesit, të cilëve u drejtohet, sipas sektorëve dhe zonave gjeografike të interesit;

ç) nxit, tërheq dhe mbështet investimet e drejtpërdrejta, nëpërmjet ofrimit të asistencës dhe shërbimeve;

d) ndërton dhe mban një bazë të dhënash, ku ruhen dhe përditësohen informacionet për investitorët e huaj e investimet e tyre, me qëllim identifikimin dhe ndihmën ndaj tyre, si dhe publikon të dhënat zyrtare për investimet e huaja;

dh) kryen funksion këshillimor dhe ofron ekspertizë për mundësitë për realizimin e investimeve, si për investitorët, ashtu edhe për organet e pushtetit qendror dhe vendor; (Neni 6 i Ligjit 10303, 2010).

AIDA vepron si një agjenci shtetërore e specializuar për të ofruar informacion dhe shërbim ndaj investitorëve vendas dhe të huaj, mbi mundësitë e investimit apo zhvillimit të biznesit. Kjo agjenci financohet nga Buxheti i Shtetit, si një nënprogram i veçantë në buxhetin e ministrisë që mbulon ekonominë, me të ardhura të krijuara nga

veprimtaria e saj dhe donacionet. Gjithashtu agjencisë, në përputhje me ligjin i njihet e drejta të ofrojë shërbime dhe të realizojë të ardhura, në funksion të qëllimit e të veprimtarisë së saj. Sektori i Shërbimit ndaj Investitorit ngritur pranë AIDA-s, organizon dhe lehtëson vizitat e investitorëve në Shqipëri duke promovuar njëkohësisht agjencinë si “ofrues zgjidhjesh”. Në punën e tij të përditshme stafi pranë këtij sektori, asiston investitorët për të përshtatur planin e biznesit sipas kërkesave ligjore dhe rregullave të përcaktuara në Shqipëri, ashtu si dhe të garanton asistencë përgjatë hapave proceduralë dhe ligjore të jetësimit të investimit në Shqipëri. Ndër veprimtarinë e tij të përditshme, stafi i After Care ndihmon investitorët për të siguruar më shpejt lejet, licencat ose çdo akt administrativ të nevojshëm për biznesin e tyre. Një ndër detyrat kryesore i këtij sektori është lançimi i “mjeteve inteligjente” (pyetësorë për investitorë të huaj), në kudër të identifikimit të problematikave të klimës së investimeve në Shqipëri. Duke u bazuar në të dhënat e siguruar nga investitorët ekzistues dhe potencial, stafi i After Care harton dhe zbaton strategji për kujdesin e mëtejshëm për investitorët në Shqipëri, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të klimës së investimeve, duke i inkurajuar investitorët për të zhvilluar më tej veprimtarinë e tyre. Krijimi dhe mirëmbajtja e një regjistri të dhënash të investitorëve të huaj ekzistues dhe vizitave të tyre, vënia në kontakt me autoritetet shtetërore apo me partnerë të mundshëm shqiptarë, ndjekja dhe ruajtja e korrespondencës me investitorë potencialë duke iu përgjigjur në mënyrë të detajuar e profesionale kërkesave spontane për informacion si follow-up i takimeve e zhvilluara, janë gjithashtu një listë e detyrave që ky sektor ndjek me profesionalizëm dhe dedikim të plotë. Tanimë prej vitesh AIDA është bërë një mbështetje shumë e rëndësishme për investitorët e huaj, si pika e parë e kontaktit që investuesit e huaj kanë në momentin që kërkojnë të investojnë. AIDA këshillon dhe orienton investimet në sektorë të ndryshëm në varësi të dëshirës së investuesit dhe asaj që mjedisi i investimeve ofron në Shqipëri (<http://www.aida.gov.al/> 2013).

Për investuesit e huaj do të ishte akoma më e lehtë, nëse në qytete të ndryshme kjo agjenci do të përhapte filiale. Në varësi të shpërndarjes së IHD-ve, pra në ato vende ku dhe mundësia për të investuar është e madhe për shembull në zonat bregdetare, në qytetet e mëdha e me infrastruktura më të mirë, mund të ngrihen filialet të kësaj agjencie dhe AIDA të funksiononte si agjenci mëmë.

Agjencitë e ngritura mund të shërbejnë si zyra “mikpritjeje” për investorët e huaj, duke i siguruar mbështetje në drejtime të ndryshme. Këto drejtime mund të jenë nga këshillimet e orientimet në sektorët më të favorshëm për të investuar e deri në asistencën në procedurat burokratike.

Në këtë mënyrë për investuesit të cilët synojnë të investojnë në Shqipëri do të bëhej akoma më lehtë dhe vendi do të ishte shumë më tërheqës duke qenë se një ndër faktorët që ndikon në rritjen e investimeve është lehtësia e të bërit biznes.

4.3. Themelimi i shoqërive tregtare

Kjo çështje po trajtohet, pasi në Shqipëri janë ndërmarrë vërtetë një sërë hapash lehtësuese për procedurat e investuesve të huaj të cilët mund të themelojnë shoqëri tregtare me dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik dhe këtë e mundëson neni 3 i ligjit shqiptar (Neni 3 i ligjit 9901, 2008).

Format që mund të marrë veprimtaria tregtare përfshirë këtu dhe veprimtarinë e investimeve të huaja sipas legjislacionit shqiptar janë: *person fizik, shoqëri e thjeshtë, shoqëri kolektive, shoqëri komandite, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare, degë ose zyrë përfaqësimi*. Investuesit e huaj mund të zgjedhin të krijojnë shoqëritë e tyre me njërin nga këto format e sipërpërmendura të shoqërisë, duke iu përmbajtur legjislacionit shqiptar për krijimin e shoqërive tregtare. Krahas këtyre shoqërive ligji shqiptar njeh edhe krijimin e sipërmarrjeve kolektive, që sipas ligjit “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” (SIK) do të kuptojmë:

“Çdo person juridik ose bashkim asetesh konsiderohet sipërmarrje investimesh kolektive, pavarësisht formës ligjore, kur pjesëmarrja nëpërmjet aksioneve, kuotave ose të drejtave të tjera ofrohet për qëllime të rritjes së pjesëmarrjes në para dhe, në mënyrë të shprehur, synon të investojë mbi 60 për qind të kësaj pjesëmarrjeje në portofol titujsh, depozita dhe në të gjitha llojet e tjera të aseteve, ku investorët nuk mbikëqyrin përditë marrjen e vendimeve për investimet dhe ku objektiv parësor është nxjerrja e përfitimeve për investorët

nga investimet e tyre, si në formë fitimi ashtu edhe në ndonjë formë tjetër (Neni 3 i ligjit 10198, 2009).

Pra, siç shikohet nga referimet e mësipërme kuadri ligjor shqiptar është përshtatur në atë lloj forme që i mundëson investimeve të huaja të njëjtën fushë veprimi dhe duke mos i kufizuar nga investimet vendase. Edhe pse e thënë kjo, kuptohet se investimi në një vend të huaj nuk është aq i lehtë sa investimi vendas me gjithë komoditetin që të ofrohet.

4.4. Krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të Licencimit

Një hap tjetër i ndërmarrë nga qeveria shqiptare, ndër të tjera, për krijimin e procedurave lehtësuese si dhe për të rritur tërheqjen e IHD-ve në Shqipëri është ai i cili mundëson, investuesit e huaj mund të regjistrojnë dhe licencojnë bizneset e tyre fare lehtë. Kjo pasi janë ndërmarrë dy iniciativa të një rëndësie të veçantë, të cilat synojnë krijimin e një klime të favorshme pro-biznesit. Këto iniciativa janë: *Krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit* (QKR) dhe krijimi i *Qendrës Kombëtare të Licencimit* (QKL). Legjislacioni në fushën e regjistrimit dhe licencimit të biznesit është në harmoni me standardet e parashikuara nga BE, me fokus primar atë të reduktimit të barrierave administrative për bizneset të cilat operojnë në Shqipëri.

Referuar ligjit, QKR (Ligji 9723, 2007)⁶⁷, regjistrimi i shoqërive tregtare në Shqipëri bëhet nëpërmjet QKR-së. QKR-ja gëzon statusin e institucionit publik, me personalitet juridik, në varësi të ministrit që mbulon çështjet e tregtisë, me seli qendrore në Tiranë.

Aplikimi për regjistrim mund të kryhet edhe në mënyrë elektronike, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik. QKR, nëpërmjet aplikimit të procedurës së regjistrimit të iniciuar nga subjekti tregtar i interesuar, jo vetëm mundëson regjistrimin në Regjistrin Tregtar, por njëkohësisht mundëson dhe regjistrimin përkatës në autoritetet kompetente për taksat, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe Inspektoriatin e Punës. Ligji për QKR-në ka pësuar ndryshime (fletore zyrtare nr. 135, 2012: 7714) falë “*Ndarjes së Re Administrative Territoriale*” në Shqipëri më 19 shkurt të vitit

⁶⁷ Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, fletore zyrtare nr. 135, 2012:7714.

2015⁶⁸. Konkretisht këto ndryshime lidhen më së shumti me terminologjinë. Bazuar në ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, i cili rregullon procedurat e licencimit në Shqipëri, QKL ka filluar aktivitetin e saj si institucion publik në varësi të ministrit që mbulon çështjet e ekonomisë, që në qershor 2009. Ky ligj ka për qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, duke garantuar, njëkohësisht, mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe në përdorimin e të mirave publike⁶⁹.

Sjellja e këtyre dy iniciativave është mirëpritur nga biznesi vendas dhe i huaj. Kjo falë transparencës që ofrohet duke i dhënë mundësi investuesit vendas e të huaj për të aplikuar për regjistrim në një mënyrë tanimë shumë më të thjeshtë e transparente. Kryerja e këtyre procedurave pa shumë vështirësi e bën akoma më tërheqës vendin drejt investitorëve të huaj.

4.5. Pronat në Shqipëri dhe investimet e huaja

Nuk mund të anashkalohet pa u trajtuar në këtë punim problematika e pronave në Shqipëri. Kjo për faktin se e tillë çështje ka krijuar hendeqe dhe problematika si juridike, shoqërore dhe ekonomike në Shqipëri, në periudhën e gjatë komuniste duke i reflektuar më pas këto problematika dhe në sistemin pasardhës.

Prona private në Shqipëri jo vetëm ka ekzistuar, por edhe ka qenë e dokumentuar dhe ruajtur në arkiva dhe kadastra për të gjithë periudhën para çlirimit në vitin 1944.

Me ndryshimin e regjimit dhe ardhjen në fuqi të pushtetit komunist, në vitet 1946-1950 u krye reforma mbi tokën, kjo do të thotë se pronarëve iu konfiskua prona duke e kaluar në shtet. Më pas rishpërndarja e tokës nuk u dokumentua dhe pronarët e rinj të tokës nuk u pajisën me dokumente për titull pronësie. Ky fakt solli konfuzion të gjithanshëm.

Më vonë, pothuajse e njëjta reformë u krye edhe me trojet-tokat në zonat urbane. Trojet private të pandërtuara kaluan krejtësisht në pronësi të shtetit. Gjatë 1991-1994,

⁶⁸ Marrë nga: <http://shtetiweb.org/ndarja-e-re-administrative-territoriale/>, parë më 7 dhjetor 2014.

⁶⁹ Marrë nga: <http://shtetiweb.org/ndarja-e-re-administrative-territoriale/>, parë më 7 dhjetor 2014.

programet e privatizimit dhe transferimi i pasurisë të pronarët e rinj bashkëthemelues, punëtorë, banorë të apartamenteve apo te pronarët e mëparshëm nëpërmjet kthimit të pronave, si dhe qiradhëniet afatgjata nga shteti për individët, krijuan 500.000 pronarë mbi rreth 3 milionë pasuri private të llojit toka bujqësore, banesa apo njësi tregtare. Prandaj menaxhimi i pronave publike dhe private për shumë vite ka qenë një situatë mjaft kaotike. Për këtë arsye u pa e nevojshme ndërmarrja një ristrukturim të gjerë të sistemit të menaxhimit të pronës, për ta kthyer atë në një sistem modern, efikas dhe transparent në përputhje me praktikatat më të mira të vendeve të tjera evropiane.

Pasi kjo lloj situatë kaotike nuk lidhej vetëm me ish pronarët dhe të drejtat e tyre por mbivendosja e pronave dhe shumë probleme të tjera që lidheshin me të drejtën e pronësisë, shpesh herë janë bërë pengesë dhe për investimet. Kjo pasi ishte shumë e vështirë për një investitor të huaj që të vinte në Shqipëri dhe të ndërtonte një fabrikë, hotel, apo çdo objekt tjetër pa ditur se kujt mund t'i përkasë toka. Dhe në fakt ka ndodhur që në të kaluarën, projekte të ndryshme nga investitorë të huaj nuk kanë përfunduar për shkak të problemeve me të cilat ata janë përballur në lidhje me pronësinë e tokës. Kjo për arsye se ka pasur pretendime nga persona të cilët janë përpjekur të përfitojnë nga paqartësitë e ligjit për pronësinë e tokës ku investimet e huaja ishin vendosur.

Rastet kur investitorët seriozë i janë larguar Shqipërisë për shkak të këtyre problemeve me pronën janë të shumta. Gjë që nuk ka qenë aspak e hijshme për vendin tonë dhe aq më tepër që ka sjellë dhe dëme ekonomike që kanë ardhur si pasojë e mosrealizimit të këtyre projekteve. Në këtë kuadër janë krijuar zyra për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të cilat pa dyshim janë një hap më i sigurt për investuesit të huaj si dhe vendas.

4.5.1. Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Kështu duke iu referuar për sa u përmend më sipër, në vitet e fundit Shqipëria ka bërë një progres të madh në një numër fushash të nevojshme për të lejuar mbarëvajtjen e financimit dhe transaksioneve të pasurive të paluajtshme. Një element shumë i rëndësishëm i cili garanton të drejtën e pronësisë është regjistrimi i pasurive në

Regjistrat e Pasurive të Paluajtshme. Në çdo qytet të Shqipërisë janë krijuar Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) të cilat për të funksionuar sa më mirë kanë bashkëpunim me Zyrën Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) në Tiranë e cila përgatit rregullore dhe urdhëresa dhe i propozon për miratim pranë Këshillit të Ministrave, në formën e akteve nënligjore, gjithashtu mbikëqyr punën dhe mban lidhje me ZVRPP-të pranë qarqeve, si dhe trajton dhe merr vendime për zgjidhjen në përputhje me ligjin, të konflikteve në rrugë administrative, duke mbajtur lidhje me institucionet qendrore e vendore për të siguruar dhe për të shkëmbyer informacionet.

Një zyrë tjetër e një rëndësie të veçantë është dhe Zyra Rajonale e Kthimit e Kompensimit të Pronave (ZRKKP) pranë çdo qarku, e cila pranon dhe përpunon dokumentet mbi origjinën e pronës si dhe komunikon me qytetarët për sigurimin dhe plotësimin e dokumenteve të pronave, si dhe përgatit vërtetimet për kthim dhe/ose kompensim të pronave në zonat urbane, zonat rurale, pyjet, kullotat dhe ullishtat. Të gjitha këto në favor të pronarëve dhe trashëgimtarëve të tyre, në mbështetje të dokumenteve të origjinës së saj. Është detyrë dhe përgjegjësi e kësaj zyre të përgatisë hartat topografike të vendndodhjes së pronës, duke ballafaquar dokumentet kadastrale me gjendjen në terren.

Gjithashtu dhe krijimi i Agjencisë së Kthimit e Kompensimit të Pronave (AKKP) në Tiranë⁷⁰, ka zgjidhur shumë probleme të pronave, e cila në kuadrin ligjor përgatit rregullore dhe urdhëresa dhe i propozon për miratim pranë KM, në formën e akteve nënligjore. Një tjetër nismë në mbështetje të kësaj çështjeje është ligji *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”*⁷¹ i cili ka marrë përsipër përfundimin e një procesi të ndërlikuar 25-vjeçar që ka nisur në vitin 1993. Ligji ka për qëllim të njoh pronësisë për të gjithë pronarët të cilët kanë pasur dikur në vitet e shpronësimit, pasuri, tokë bujqësorë, truall apo kategori të tjera pronash. Ky ligj synon të përfundojë procesin e njohjes së pronësisë për të gjitha aplikimet e bëra ndër vite në ish-Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sot Agjencia e Trajtimit të Pronës (ATP). Numërohen rreth 11 mijë aplikime, të cilat prej vitesh nuk kanë marrë

⁷⁰ VKM nr. 566, datë 23.8.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

⁷¹ Ligji nr. 133/2015.

një përgjigje nga ana e institucioneve kompetente, gjithashtu për herë të parë ligji synon të nisë një proces i cili është pothuajse i paprekur prej 25 vitesh, si ai i kompensimit të pronarëve, duke vënë në dispozicion të këtij procesi një fond të konsiderueshëm, si monetar, ashtu edhe fizik, me objektivin që brenda një afati 10-vjeçar mund ta mbyllë këtë proces. Ndaj është shumë i rëndësishëm fillimi nga puna i implementimit të këtij ligji, si një nismë shumë serioze e qeverisë për t'i dhënë fund kalvarit të gjatë të zvarritjes së çështjes së pronave.

Aktet nënligjore që janë miratuar së fundmi nga ana e qeverisë, janë shumë të rëndësishme për këtë proces dhe bëjnë të mundur fillimin nga puna të implementimit konkret të këtij ligji dhe të gjitha standardet që ky ligj krijon së bashku me të gjitha instrumentet në funksion të pronarëve për t'u implementuar përmes njohjes së pronësisë nga njëra anë, dhe fillimit të pronësisë së pronave nga krahu tjetër.

Një nga përgjegjësitë e ATP është të mbikëqyrë punën dhe të mbajë lidhje me Zyrën Vendore të Kthimit e Kompensimit të Pronave (ZVKKP) pranë qarqeve, si dhe të trajtojë dhe të marrë vendime për zgjidhjen sipas ligjit, të konflikteve në rrugë administrative. Specialistët e kësaj zyre, konfirmojnë ose anulojnë vendimet e ZVKKP, si dhe kjo zyrë propozon dhe menaxhon fondin për kompensimin e pronarëve. Një detyra të tjera të kësaj zyre janë dhe përgatitja e listave të pronarëve që kompensohen, kryen shpërndarjen e fondit të kompensimit, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, si dhe mban lidhje me institucionet qendrore e vendore për të siguruar dhe për të shkëmbyer informacionet.

Hallkat e përgjegjësive të zyrave të mësipërme janë të rregulluara më së miri, dhe për më tepër mund të thuhet se ZVRPP⁷² ka për detyrë të regjistrojë të gjitha veprimet ligjore që kanë lidhje me transferimin e pasurive të paluajtshme. Efiçenca e kësaj zyre duke dhe në përpunimin e regjistrimit të dokumente të pronave të lëshuara nga institucionet përgjegjëse dhe/ose të përfituara në të gjitha format e parashikuara nga KC, si dhe transaksionet e ligjshme me pronat (trashëgimi, shitje, dhurim, shkëmbim, kontrata etj.), në arritjen e një dokumentacion të plotë në lidhje me pronën dhe pronarin

⁷² ZVRPP, funksionon në mbështetje të ligjit: nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”; Rregullore 184 datë 08.04.1999 “Për punën në ZRPP”, Udhëzim i KM nr.1 datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në ZRPP”, Udhëzim i KM nr. 4 datë 21.11.07 “Fshirja e regjistrimit për mbivendosje” etj.

si një e drejtë e tij e patjetërsueshme. Specialistët e kësaj zyre komunikojnë me qytetarët për sigurimin dhe plotësimin e dokumenteve të pronave kur ato nuk janë të plota në përputhje me ligjin, duke përgatitur dhe lëshuar certifikatë pronësie dhe/ose vërtetim pronësie të shoqëruar me hartat treguese të vendndodhjes së pasurisë, për të vërtetuar titullin e pronësisë; tjetërsimet e pronave kur ato jepen për ndërtime, si dhe lejet e shfrytëzimit të lëshuara nga njësitë vendore dhe duke mbajtur lidhje me njësitë vendore për të siguruar dhe për të shkëmbyer informacionet.

Krijimi i ZVRPP-së, funksionimi i mirë i saj si dhe bashkëpunimi që kjo zyrë ka me institucione të tjera, janë zhvillime mjaft të rëndësishme të cilat duke zgjidhur çështjen e problematikave të pronës në Shqipëri, e kanë bërë tregun e pronave atraktiv si për biznesin vendas ashtu edhe për investitorët e huaj.

Gjithashtu, po në kuadër të zhvillimeve të rëndësishme për çështjen e pronës, përmendim një hap tjetër të ndërmarrë nga ligjvënësi në Shqipëri, që për t'u ardhur në ndihmë investimeve si dhe për të qenë sa më transparent dhe ndaj investuesve të huaj ka parashikuar mënyrën se si mund të përcaktohet vlera e truallit për m^2 e vënë nga pronarët e truallit në dispozicion të investitorëve të ndërtimit. Për këtë referohemi sa më poshtë:

- a) *Sipërfaqja e ndërtimit, në m^2 , që përfitojnë pronarët e truallit përcaktohet në bazë të kontratës së shkëmbimit të pasurisë truall me ndërtesën e ngritur mbi të;*
- b) *Kosto e ndërtimit, për m^2 , përcaktohet në bazë të kostos minimale fiskale të ndërtimit, sipas qyteteve apo zonave brenda qyteteve;*
- c) *Vlera e truallit, të vënë në dispozicion nga pronari, llogaritet si prodhim i kostos së ndërtimit, për m^2 , me pjesën e sipërfaqes së objektit, që kanë përfituar pronarët. Vlera e truallit (tokë), e llogaritur si më sipër, është shpenzim i zbritshëm për investitorin e objektit (Fletore zyrtare nr. 134, faqe 5985).*

4.6. Koncesionet, si mundësi të mëdha investimi

Në vitin 2006 është miratuar ligji “Për koncesionet”, për të krijuar një kuadër të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive, për investimet që realizohen si koncesione apo ndryshe partneritete publike privat.

Ky ligj rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionare apo partneritetesh publike private (PPP), për: investime të bazuara në koncesione; partneritete publike private, procedurat për dhënien e kontratave të tilla, si nënshkrimi, ndërprerja dhe ndryshimet e marrëveshjeve të koncesionit; partneritetit publik privat, çështjet që kanë të bëjnë me rregullimet financiare dhe mbështetjen, në lidhje me koncesionet/partneritetet publike private, politikën e këtyre koncesioneve e autoritetin për zbatimin e tyre, si dhe çështje të tjera që lidhen me koncesionet dhe partneritetet publike private (Neni 2 i ligjit 9663, 2006). Pas miratimit të këtij ligji shteti shqiptar ka ndjekur praktikën e dhënies me koncesion të pasurive natyrore apo shërbimeve publike duke i shitur ose dhënë në përdorim. Kjo gjë ka ngacmuar interesin e shumë investuesve si shqiptarë ashtu dhe të huaj duke qenë se fitimi nga një i investim i tillë është i garantuar.

Investuesit të huaj mund të marrin pjesë në procedurat e konkurimit duke zgjedhur për të investuar në një nga koncesionet e mëposhtme:

1. *“Koncesioni i punëve publike”*⁷³;
2. *“Koncesioni i shërbimeve publike”*⁷⁴;
3. *“Koncesion i përzier”*⁷⁵ (Neni 3 i ligjit 9663, 2006).

Ligji “Për koncesionet” parashikon se si mund të marrësh me koncesion një gamë të gjerë sektorësh, si: *transportin (sistemin hekurudhor, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, mjediset e parkimit, transporti publik); prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike dhe ngrohjes; prodhimin dhe shpërndarjen e ujit, trajtimin, mbledhjen, shpërndarjen dhe administrimin e ujërave të zeza, ujitjen,*

⁷³ Është një marrëveshje me interes financiar, e lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është kryerja e punimeve, ku shpërblimi për punimet që duhet të kryhen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar veprat që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.

⁷⁴ Është një marrëveshje me interes financiar në formë të shkruar ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është sigurimi i shërbimeve, ku shpërblimi për shërbimet që do të sigurohen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar shërbimet që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.

⁷⁵ Është një koncesion, objekti i të cilit është kryerja e punimeve dhe sigurimi i shërbimeve, që identifikohet si koncesion i punëve publike ose koncesion i shërbimit publik dhe ku vendimtar për të përcaktuar nëse një kontratë e tillë është koncesion i punëve publike apo një koncesion i shërbimeve publike është elementi nëse puna që do të kryhet është objekti kryesor i kontratës apo nëse puna është thjesht karakteristike për shërbimin publik që është objekt i kontratës

kullimin, pastrimin e kanaleve, digave; mbledhjen, transportimin, përpunimin dhe administrimin e mbetjeve të ngurta; telekomunikacionin; edukimin dhe sportin; shëndetësinë; turizmin dhe kulturën; infrastrukturën e burgjeve; projektet e riciklimit, rehabilitimit të tokës dhe pyjeve në parqet industriale, strehimit; ndërtesave qeveritare, shërbimeve të mirëmbajtjes së infrastrukturës së bazës së të dhënave dhe IT; shpërndarja e gazit natyror; kontratat e administrimit apo dispozitat mbi kryerjen e shërbimeve publike, duke përfshirë këtu ato që lidhen me sektorët e lart përmendur (Neni 4 i ligjit 9663, 2006). Pra siç e shohim, qeveria shqiptare vë në dispozicion shumë fusha të shërbimeve dhe ekonomisë, në funksion të IHD-ve me anë të koncesioneve.

Autoriteti kompetente për koncesionet dhe partneritetin publik privat dhe në këtë drejtim, është Agjencia e Prokurimit Publik⁷⁶ (APP).

APP ka për qëllim që të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj, që marrin pjesë në procedurat e konkurrencës si dhe të rrisë besimin, integritetin publik, transparencën në procedurat e prokurimit publik.

Gjithashtu me VKM⁷⁷ (VKM Nr. 469, 2010: 5166) në funksion të kësaj procedure është miratuar “Rregullorja për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura” duke ngarkuar Komisionin e Prokurimit Publik (KPP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ligji i njeh të drejtën e ankimit⁷⁸ çdo ofruesi, qoftë ai shqiptar apo i huaj në rastet kur ato kanë pretendime mbi shpalljen e fituesit apo zhvillimit të procedurave. KPP gjatë shqyrtimit të ankesave duhet të respektojë një sërë parimesh si më poshtë:

- a) parimi i ligjshmërisë;
- b) parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit;
- c) parimi i pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;
- ç) parimi i shqyrtimit brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme;

⁷⁶ Sistemi i prokurimit publik në Shqipëri është i rregulluar me ligjin “Për Prokurim Publik” nr. 9643, datë 20.11.2006, dhe nga VKM nr. 1 (VKM nr 1, datë 10.01.2007 mbi Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (ndryshuar me vendimin nr. 153 datë 22/03/2007, VKM nr. 135, datë 02/03/2008, VKM nr. 392, datë 8/04/2008, VKM nr. 398, datë 26.05.2010, VKM nr. 822, datë 18/06/2008, VKM nr. 46, datë 21/01/2009, VKM nr. 495, datë 15/05/2009, VKM nr. 917, datë 29/07/2009), datë 10.01.2007.

⁷⁷ VKM nr. 469, datë 16.6.2010 në Fletoren Zyrtare nr.97, datë 26.7.2010, faqe 5166.

⁷⁸ Ankimi të bërë sipas mënyrës së përcaktuar në VKM nr. 469, datë 16.6.2010.

d) parimi i transparencës dhe informimit të publikut;

dh) parimi i mbrojtjes së të dhënave personale, sekretit shtetëror ose tregtar.

4.7. Sistemi tatimor në Shqipëri

Një mjedis i dobët biznesi, i karakterizuar nga faktorë që imponojnë kosto të larta, vonesa dhe risk të lartë, pengojnë zhvillimin ekonomik dhe mund të frikësojnë dhe largojnë IHD-të. Qeveritë shpesh e shpërfillin rëndësinë e klimës së biznesit kur ftojnë investimet e huaja të drejtpërdrejta. Ato priren të përqendrohen në përmasat e tregut, niveli i burimeve natyrore dhe kostot. Edhe pse këta faktorë janë të rëndësishëm, klima e investimeve është një faktor vendimtar dhe nuk duhet nënvlerësuar. Klima e investimeve, përveç faktorëve të listuar më sipër, ndikohet dhe nga stabiliteti politik, shteti i së drejtës, kushtet makroekonomike, perceptimet e qeverisë dhe mjedisi rregullator si dhe niveli i taksave dhe incentivave fiskale të disponueshme për bizneset. Është kjo arsyeja pse nuk mund të anashkalohet pa u trajtuar në këtë punim, një çështje me kaq rëndësi si ajo politikave tatimore (PT). PT kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në prurjet e IHD-ve. Nëse PT janë transparente, të thjeshta dhe jodiskriminuese, janë tërheqëse për investuesit, sepse u mundësojnë sipërmarrësve të llogarisin kostot dhe fitimet e mundshme më lehtë sesa në një terren ku këto politika janë të ndërlikuara dhe jo transparente edhe pse tatimi mund të jetë më i ulët. Tatimi modern duhet të jetë më shumë sesa thjesht burim të ardhurash për funksionimin e një shteti pasi ai tatimi duhet të garantojë gjithashtu që autoritetet publike të kontribuojnë në mënyrë aktive për ndjekjen e synimeve të politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore. Tatimi është trampolinë e rëndësishme për një rishpërndarje të të ardhurave tek qytetarët. Garantimi i solidaritetit dhe kohezionit social në shoqëri kërkon transferime të mëdha sociale dhe nevoja tatimore për të luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm. PT nuk duhet të jenë instrumente konkurrence për qeveritë, me qëllim tërheqjen e investimeve. Politika të këtij lloji çojnë në konkurrencë tatimore dhe dëmtojnë synimet bazë të politikave tatimore operimi efektiv i shërbimeve publike ofrimi i shërbimeve të cilësisë për konsumatorët të këtyre shërbimeve.

Sistemi tatimor duhet të jetë i thjeshtë dhe transparent. Transparenca duhet të jetë e tillë që t'u japë mundësinë taksapaguesve të kuptojnë logjikën dhe mekanizmat e sistemit.

Sistemi tatimor shqiptar nuk diskriminon investitorët e huaj dhe nuk bën dallime mes tyre dhe investitorëve vendas. Reforma e taksave në formë elektronike po avancojnë gjithnjë e më shumë, ndërkohë që edhe tatimi mbi të ardhurat është reduktuar nga 20% në 10%, duke u klasifikuar si një nga më të ulëtat në rajon. Hapat e reformës fiskale të ndërmarra gjatë viteve 2007-2008 dhe politika ekspansioniste fiskale e ndjekur gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 e bënë sistemin tatimor shqiptar më të lehtë dhe më inkurajues për zhvillimin e biznesit.

Paralelisht, shpërndarja e barrës tatimore është bërë më e barabartë dhe më pak çorientuese. Reforma e politikës tatimore është bazuar mbi idenë e uljes së përqindjes tatimore dhe në të njëjtën kohë zgjerimin e gamës së tatimpaguesve. Legjislacioni shqiptar edhe në këtë reformë është kujdesur që të ketë një trajtim të barabartë midis investitorit shqiptar dhe atij të huaj duke i ofruar të njëjtit stimuj që rregullohen përmes ligjit *“Për asistencën shtetërore”*, (Ligji nr. 9374, 2005) i ndryshuar me ligjin *“Për zbatimin e projekteve me rëndësi prioritare”* (Ligji nr. 10183, 2009).

Tjetër aspekt i politikave tatimore është dhe efikasiteti në rimbursimin e vlerës së shtuar për importet, i cili ndihmon bizneset të shmangin problemet me fluksin e cash-it. Ndryshime të rëndësishme ka patur për akcizat gjatë viteve 2007-2008, në drejtim të ndryshimit të strukturës së akcizës për disa nga mallrat e forta dhe të lehtësimit të disa sektorëve të rëndësishëm. Më konkretisht, politika kryesore ka qenë ajo e rimbursimit të aksizës për lëndët djegëse të përdorura nga subjektet, të cilat ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, për nevojat e veta apo për shitje, sipas sasisë, kushteve dhe procedurave të përcaktuara me VKM. Për akcizën, rimbursohen për lëndët djegëse të konsumuara në serrat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasinë e produktit final, të shitur me faturë të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar⁷⁹ (TVSH) dhe sipas kushteve e procedurave të përcaktuara me VKM.

Për të dy skemat e rimbursimit të akcizës për këta sektorë, janë aplikuar të njëjtat standarde me ato që aplikohen aktualisht në vendet e BE-së, duke marrë miratimin edhe të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, si institucioni përgjegjës në Shqipëri për

⁷⁹ Tatimit mbi Vlerën e Shtuar është tatim neto gjithëfazësh dhe tatim neto shumëfazësh në qarkullim (Tafa, 2007:122).

aprovimin e tyre. Gjithashtu për sa i përket strukturës së taksimit të mallrave të forta verë dhe birrë, sipas sasisë së prodhuar në vit, nuk ka diferencim trajtimi për prodhuesit vendas dhe të huaj. Kjo pasi synohet të përafrohet legjislacioni ynë për akcizat me legjislacionin komunitar. Në vitin 2008, përjashtohet nga pagesa e akcizës gazoili i shitur për anijet e peshkimit duke i dhënë kështu një mbështetje të plotë zhvillimit të sektorit të peshkimit në Shqipëri. Me këtë ndryshim, skema e mbështetjes e cila i ofrohet sektorit të peshkimit, është e njëjtë me atë që aplikohet aktualisht në vendet e BE-së paguajnë taksat përmes disa bankave. Kjo ka sjellë investime të mëdha në këtë fushë pasi janë hapur fabrika të pastrimit të peshkut, të cilat kanë mundësuar hapjen e vende të shumta pune.

TVSH mbetet tatimi më i rëndësishëm i sistemit tonë tatimor, me një bazë të gjerë dhe normë unike, si dhe me një prag përjashtimi, tipik për vendet në zhvillim. Ndryshimet kryesore që ka pësuar TVSH-ja kanë qenë të tipit administrativ duke shfuqizuar disa lloj përjashtimesh nga skema e TVSH-së, e duke bërë disa ndryshime në skemën e taksimit në import për disa mallra të forta, si karburantet. Gjithashtu importuesit e makinerive do të përjashtohen nga TVSH-ja nëse këto makineri do të shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit të tyre të taksueshëm. Edhe prodhuesit e veshjeve janë të përjashtuar nga TVSH mbi lëndët e para për sa kohë që produktet e tyre përfundimtare janë të destinuara për eksport. Në zhvillimet më të rëndësishme theksohen përpjekjet për zgjidhjen e problemit të rimbursimit të TVSH-së, përmes vendosjes së rimbursimit automatik, sipas kriterëve dhe procedurave të vendosura me akte nënligjore.

Që nga maji i vitit 2009 kontributi i sigurimeve shoqërore të paguara nga punëmarrësit është reduktuar nga 20% në 15%, vlera shumë më të ulëta këto sesa 29% që ishin në 2006. Nisur nga ky fakt, investuesve i ngjallet interes për një sistem të tillë sigurimesh tatimore duke qenë se i ofrohet një kosto e ulët për të paguar punonjësit.

Çdo person fizik ose juridik, që kryen veprimtari tregtare në Shqipëri, që nga 1 janari i vitit 2010, është i detyruar të regjistrohet për pagesën e TVSH-së⁸⁰, nëse qarkullimi vjetor i kalon 5 milionë lekë në një vit kalendarik.

⁸⁰ Norma e TVSH-së është 20% e vlerës së tatueshme. Bazuar në ligjin nr. “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (Ligji Nr.7928, 1995), përjashtimi nga TVSH-ja zbatohet kur kemi të bëjmë me: - import të mallrave në regjimin transit; import të mallrave të deklaruar nën regjimin e lejimit të përkohshëm;

Një lehtësim tjetër është gjithashtu edhe përjashtimi nga taksat i dividendëve të destinuar për t'u riinvestuar. Bizneset mund të regjistrojnë rimbursimin e taksave dhe deklaratën e sigurimeve shoqërore elektronikisht në Tiranë në njëmbëdhjetë qytete të tjera dhe kanë mundësinë e pagimit të taksave në bankë. Ndryshime në skemën e TVSH janë bërë edhe me qëllimin e përkrahjes së disa sektorëve të veçantë për të nxitur investimet e huaja dhe për të ndihmuar biznesin vendas.

Pra siç duket dhe më lart rëndësia e tatimeve është një element thelbësor në ndikimin e prurjes së IHD-ve. Pasi janë ato që ndikojnë në lehtësimin e të bërit biznes duke tërhequr investime ose mund të ndikojnë negativisht duke larguar investimet në ato rast kur janë të larta dhe të papërballueshme.

4.8. Sistemi doganor në Shqipëri

Një burim tjetër tepër i rëndësishëm i të ardhurave të një vendi dhe që luajnë rol domethënës dhe në prurjen e IHD-ve, janë doganat. Roli i tarifave doganore është mjaft i rëndësishëm, pasi ato mund të ndikojnë pozitivisht në për rritjen e investimeve apo negativisht në uljen e tyre, pasi investuesit para nisjes së një aktiviteti marrin informacion dhe në lidhjen me tarifat doganore të vendit pritës.

Një pjesë e mirë e formave të investimeve, kanë të bëjnë patjetër gjatë veprimtarisë së tyre dhe me importimin apo eksportimin e mallrave jashtë vendit të investimit. Administrimi i mirë i sistemit doganor ngjall tek investuesit e huaj edhe më shumë siguri për investimet e tyre. Në Shqipëri, Administrata Doganore, përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoritë Rajonale dhe nga Degët Doganore, e cila varet nga ME dhe është nën mbikëqyrjen e saj, por duke pasur kompetenca dhe organizim të saj in të cilat përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të “Kodit doganor të Republikës

import të mallrave në regjim aktiv; import të mallrave dhe shërbimeve që lidhen me realizimin e fazave të kërkimit dhe zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët apo nënkontraktorët; importi i kafshëve të gjalla të racës, të ardhura nga donatorët të ndryshëm; importi i mallrave të ardhura nga NATO; importi i mjeteve të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve. TVSH-ja është në fuqi për shitjen e mallrave dhe shërbimeve ose importin e mallrave në një normë standarde prej 20%. TVSH zbatohet në normën zero (0%) në rastet kur furnizimin e mallrave të eksportuara jashtë territorit të Shqipërisë; furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve. TVSH-ja llogaritet, zbatohet dhe paguhet në momentin kur mallrat hyjnë në territorin e RSH.

së Shqipërisë”⁸¹ (www.dogana.gov.al). Në Shqipëri përjashtohen nga pagesa e akcizës produktet e destinuara për t’u përdorur:

- a. Për nevoja zyrtare dhe personale në kuadër të misionëve diplomatike dhe konsullore;
- b. Për nevoja zyrtare dhe personale të organizmave ndërkombëtare të njohura si të tilla nga RSH;
- c. Për forcat e armatosura të çdo vendi anëtar të (NATO);
- d. Produktet e akcizës të importuara në bagazhin personal të pasagjerëve sipas limiteve të parashikuara në legjislacionin doganor⁸².

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) që prej shtatorit të vitit 2000. Me anëtarësimin e Shqipërisë në këtë organizatë nisi procesi i harmonizimit të legjislacionit tregtar, në përputhje me rregullat ndërkombëtare të tregtisë e të OBT-së. Niveli i tarifave doganore përcaktohet në bazë të Nomenklaturës së Kombinuar të Klasifikimit të Mallrave në nivel 8 shifror. Ky klasifikim është në përputhje të plotë me nomenklaturën e klasifikimit të mallrave që zbaton Bashkimi Evropian. Sistemi tarifar është mjaft i thjeshtë. Tarifat doganore të kombit më të favorizuar që zbatohen janë: 0%, 2%, 5%, 6%, 10% dhe 15%. Në zbatim të marrëveshjeve të tregtisë së lirë, Shqipëria zbaton Tarifa Preferenciale Importi me vendet e Marrëveshjes së Tregtisë të Lirë së Evropës Qendrore (CEFTA), dhe me ato të Marrëveshjes së Tregtisë të Lirë me Shoqatën Evropiane të Tregtisë (EFTA), Bashkimin Evropian dhe Turqinë. Për produktet industriale këto tarifa janë 0%, ndërsa për produktet bujqësore në përputhje me përcaktimet në marrëveshjet përkatëse. Trajtimi tarifar favorizues (TTF), prej të cilit mund të përfitojnë disa mallra për shkak të natyrës së tyre ose të përdorimit të tyre të

⁸¹ Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë” është miratuar me ligjin nr. 8449, datë 27.01.199, i ndryshuar.

⁸² Gjithashtu përveç përjashtimit nga akciza, nga administrata doganore kryhet dhe rimbursimi i saj në rastet kur: akciza është e paguar, prodhuesi i produkteve me akcizë, ka marrë produkte të cilave i është paguar akciza më parë, dhe i ka përdorur ato për të prodhuar produkte të reja akcize, produktet me akcizë të paguar shkojnë në një destinacion në të cilin këto mallra janë të përjashtuara ose me një nivel taksimi të reduktuar, mallrat me akcizë të paguar rikthehen në magazinën fiskale, mallrat me akcizë të paguar eksportohen, mallrat me akcizë të paguar janë përdorur për të prodhuar mallra të cilat nuk i nënshtrohen akcizës, në rastet kur autorizohen procese përzierje nga të cilat përfitohet një produkt, akciza e të cilit është më e ulët se e ajo e paguar për komponentët e tij, mallrat me akcizë të paguar shkatërrohen nën mbikqyrjen e autoriteteve doganore.

veçantë. Ai i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të Kodit Doganor. Këto hapa në kuadrin ligjor mundësojnë lehtësira për IHD-të.

4.9. E drejta e autorit

E drejta e autorit është pjesë e këtij studimi pasi legjislacioni për të është i aplikueshëm si për personat vendas ashtu edhe për të huaj të cilët mund të kenë për objekt kryerjen e një lloji të veçantë investimi atë të regjimit të pronësisë intelektuale.

Aktet kryesore ligjore shqiptare që rregullojnë të drejtën e autorit dhe të drejtën e pronësisë intelektuale janë “*Për pronësinë industriale*” (Ligji nr. 9947, 2008), i cili rregullon të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në aktivitete krijuese, prodhuese dhe tregtare dhe “*Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të*”, i ndryshuar (Ligji nr. 9380, 2005), i cili rregullon përvetësimin e të drejtave të pronësisë industriale mbron veprat letrare, artistike e publicistike dhe veprat e tjera, ku futet çdo krijim origjinal intelektual i kësaj natyre, pavarësisht nga forma e shprehjes si patentat, markat tregtare, pullat, shenjat e origjinës, dizenjot industriale dhe treguesit gjeografikë.

Dispozita e ligjit zbatohen për personat e huaj ose personat juridikë të cilët janë rezidentë të vendeve anëtare të: traktateve dhe konventave ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale ku Shqipëria është anëtare; vendeve të cilat janë anëtare të OBT-së vendeve ku aplikohet me Shqipërinë parimi i reciprocitetit në fushën e pronësisë industriale. Për më tepër, Shqipëria ka ratifikuar Marrëveshjen e Marrakeshit dhe është bërë nënshkruese e Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI) që nga viti 1992 dhe ajo ka njohur disa marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë. Shqipëria është angazhuar për zbatimin e Marrëveshjes TRIPS dhe gjithë legjislacionin për të drejtat e autorit, si dhe ka nënshkruar edhe memorandumin përkatës në lidhje me Regjimin e Pronësisë Intelektuale.

Nisur nga problematikat që janë hasur në fushën e administrimit kolektiv, por dhe të parashikimit më të qartë të të drejtave për komunitetin e krijuesve, është parë e nevojshme që të çohet për miratim në Kuvend projektligji për ndryshimet e ligjit të vitit 2005⁸³. Fokusi i projektligji është tek strategjia kombëtare e pronësisë intelektuale. Për sa u përket të drejtave ekonomike, është bërë parashikim për elementet kontraktuale mes palëve të zhanreve të ndryshme: për autorët e filmave, producentët, interpretuesit,

⁸³ Ligji “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

ekzekutuesit etj. Për të gjitha zhanret bëhet pozicionimi me elementët juridikë, sikundër është kontrata që do të jetë e certifikuar nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit, e cila do të zëvendësojë Zyrën Shqiptare të së Drejtës së Autorit, pra kontratat për kalimin e të drejtave ekonomike mes palëve do të regjistrohen. Qëllimi kryesor i ngritjes së këtij organi do të jetë vendosja dhe metodologjia e tarifave për t'i dhënë fund konfliktit midis agjencive ose përfaqësuesve të tjerë të mbajtjes së të drejtës, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, subjekteve përdoruese, por dhe për të certifikuar këtë marrëdhënie që deri tani ka çaluar, sepse subjektet përdoruese refuzojnë të paguajnë tarifat, që i quajnë shumë abuzuese.

4.10. Investimet strategjike në Shqipëri

Një nga hapat më të fundit të qeverisë për sa i përket përmirësimit të kuadrit ligjor në lidhje me IHD-të, është dhe miratimi i ligjit *“Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”*⁸⁴ (Nr. 55/2015). Projektligji *“Për investime strategjike në Republikën e Shqipërisë”* është iniciuar nga KM, pas një debati kolegjal jo vetëm për rolin e investimeve por, edhe për të lehtësuar jetën e investitorëve vendas e të huaj dhe të gjithë investitorëve potencialë që vijnë në Shqipëri dhe tentojnë ose arrijnë të realizojnë investimet e tyre, me qëllim strategjik, të drejtpërdrejtë, rritjen e shifrës së investimeve vendase dhe të huaj, qoftë private (e mbi të gjithë private), qoftë publike. Ligji është një format i cili tenton të bëjë shumë lehtësime, por mbi të gjitha synon afrimin për herë të parë të një modeli të bashkëpunimit të paracaktuar të shtetit dhe investitorëve privatë si dhe dyta, përshpejton procesin administrativ të aplikimit dhe të zbatimit të investimeve strategjike në Shqipëri.

⁸⁴ Më datë 1 janar të vitit 2016, hyri në fuqi Ligji i ri *“Për Investimet Strategjike”*, nr 55/2015 dhe legjislacioni sekondar me VKM : VKM nr. 1023, datë 16.12.2015 *“Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi”*; VKM nr. 1024, datë 16.12.2015 *“Për Miratimin e Projekteve me Statusin “Projekt me Potencial Strategjik”*; VKM nr. 1025, datë 16.12.2015; *“Për Shërbimet e Promovimit dhe Përfaqësimit të Investimeve Strategjike”*; VKM nr. 1026, datë 16.12.2015 *“Për Vlerësimin e Dokumentacionit të Investimeve Strategjike”* VKM nr. 1027, datë 16.12.2015 *“Për Tarifën e Shërbimeve për Investimet Strategjike”*; VKM nr. 1029, datë 16.12.2015 *“Për bashkëpunimin ndërinstitucional në procedurat e investimeve strategjike”*; VKM nr. 1031, datë 16.12.2015 *“Për Përcaktimin e Rregullave për funksionimin, Krijimin, Administrimin dhe për Formatin, Përmbajtjen e Procedurat për Sigurinë e Regjistrimit të Investimeve Strategjike”*; VKM nr. 1032, datë 16.12.2015; *“Për Dokumentimin e Marrëveshjeve të Investitorëve Strategjikë me Pronarët e Pasurive të Paluajtshme, Pronë Private”*.

Qëllimi i këtij ligji është nxitja dhe tërheqja e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja, në sektorët e ekonomisë, të identifikuar prej vetë ligji si sektorë strategjikë, nëpërmjet vendosjes së procedurave të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtuese të mbështetjes e të shërbimeve ndaj investitorëve. Kriteret e përcaktimit të investimeve strategjike si investime me interes publik do t'i referohen vlerës së investimit dhe në draft ligj përcaktohet se për sektorë të ndryshëm ka vlera të ndryshme, qoftë për të investimin e asistuar, qoftë për atë strategjik; është koha e realizimit të investimit; produktiviteti dhe vlera e shtuar e investimit; hapja e vendeve të reja të punës; prioriteti ekonomik sektorial; zhvillimi ekonomik rajonal dhe lokal; zhvillimi apo përmirësimi i kushteve apo standardeve për prodhimin e mallrave apo ofrimin e shërbimeve; ofrimi i teknologjive të reja për të rritur konkurrueshmërinë dhe efektivitetin e investimit; rritja e nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve; patjetër mbrojtja e mjedisit dhe konsumatorit. Ligji konsideron strategjikë investimet: në energjetikë dhe në miniera; në transport, në infrastrukturë e komunikimeve elektronike dhe mbetjet urbane; në turizëm; në fermat bujqësore dhe peshkim; në zona ekonomike; në zona me përparësi zhvillimi⁸⁵. Ka afërsisht 17 definicione bazë të cilat do të ndihmojnë investitorët dhe do të “detyrojnë” administratën që të jetë shumë e shpejtë në përgjigjet ndaj investitorëve, të jetë ndihmë ndaj investitorëve dhe gjithashtu të jetë një eskortë administrative gjatë të gjithë procesit teknik dhe administrativ që investitorët vendas apo të huaj, apo projektet e ndryshme në tërësi, të kalojnë në procesin burokratik duke mos i penguar, duke mos i vonuar por përkundrazi, duke i ndihmuar dhe duke përshpejtuar të gjithë atë përpjekje që investitorët bëjnë kur kalojnë në procesin administrativ. Ky ligj për herë të parë vendos kushte kohore dhe cilësore për administratën dhe përcakton edhe rrugën e përshpejtuar dhe institucionet që do të duhet të kalojë investimi, investitori ose projekti. Gjithashtu, krijohet Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), që është një organ kolegjal pranë KM dhe drejtohet drejtpërsëdrejti nga Kryeministrit. AIDA⁸⁶ përcaktohet si Sekretariati i këtij Komitetit dhe si dritare unike si dhe do të konceptohet si eskorta administrative

⁸⁵ Për energjetikën dhe minierat, kërkohet që këto projekte të jenë 30 deri në 50 milionë euro, ndërsa për turizmin, mjaftojnë 5 milionë euro dhe hapja e 80 vendeve të punës. Më pak para kërkohen për fermën bujqësore strategjike, e cila mund të bëhet me 3 milionë euro, me kusht që të hapen 50 vende pune.

⁸⁶ Nëpërmjet këtij ligji AIDA merr të drejta të vendosë gjobë mbi punonjësit e administratës publike kur ata definohen si shkaktarët e vonesave apo shkaktarët e mos ecjes së projektit.

për të lehtësuar jetën e investorëve, qoftë vendas, qoftë të huaj. Risia që sjell ky ligj shikohet edhe në procedurën e asistuar, dhe procedurën e veçantë, të cilat varen nga definicioni dhe nga statusi që do të marrë investitori strategjik⁸⁷. Për sa i përket përjasjes me administratën, janë caktuar dhe definuar procedura shumë të qarta dhe afate të definuar, shumë të qartë kohorë, të përgjigjeve, të përgatitjes së dokumentacionit, të marrjes së lejeve dhe të përgjigjes përfundimtare për investimin strategjik.

Qëllimi i këtij ligji është sigurisht rritja e investimeve duke sjellë kështu dhe rritjen e punësimit për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor të ekonomisë shqiptare.

4.11. Shqipëria dhe normat e së drejtës ndërkombëtare (ICSID, OBT, CEFTA, EFTA, NATO, SEECP, NAFTA, MSA)

4.11.1. Konventa e ICSID-së

Sikurse u trajtua dhe në kapitullin e tretë, në vitin 1991⁸⁸ qeveria e asaj kohe vendosi të pranojë anëtarësimin në FMN duke u autorizuar për të nënshkruar “*Konventën e ICSID*” e zgjidhjes së konflikteve në investimet midis shtetit dhe shtetasve të huaj. Shqipërisë është palë e Konventës “*Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për investimet*”, ratifikuar me ligjin nr. 7515, datë 01.10.1991, “*Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim,*

⁸⁷ Për sektorët e përcaktuar jepen dy lloje statusesh për investorët strategjikë: me procedurë të asistuar; dhe me procedurë të veçantë. Shërbimet ndaj investorit në rastin e procedurës së asistuar janë: kryerja e veprimeve përgatitore dhe përgatitja e dokumenteve administrative nga agjenti asistues; konsolidimi i tokës; programe mbështetëse; mbështetja me infrastrukturë ndihmëse; vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve, në formë të ndryshme si shitblerje, qira, kontrata të vënies në dispozicion. Diferenca midis të dyjave qëndron dhe tek shpronësimi publik që i bëhet, në rastin e investorit strategjik me procedurë të veçantë, dhe në rastin kur investitori kërkon garanci juridike maksimale, kur merr statusin si investitor strategjik, ka të drejtën t’i kërkojë qeverisë shqiptare që kontrata e tij, investimi i tij, të kalojë në Parlament. Kjo zgjidh dhe një nga elementët të debatueshëm që ka pasur Shqipërisë për sigurinë juridike në këto 20 vite.

⁸⁸ Ligji “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtimin dhe Zhvillimin, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konflikteve në Investimet” 10.01.1991.

Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investimet”. Bazuar në këtë Konventë, është krijuar një institucion autonom ndërkombëtar (ICSID), i cili ka si funksion zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera. Qëllimi i këtij institucioni është të sigurojë lehtësira për pajtimin dhe arbitrimin e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërkombëtare. Kjo qendër ka natyrën e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, por përfshirja e saj në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën tregtare kushtëzohet nga dy gjëra: së pari, nga fakti nëse shteti shqiptar ka lidhur marrëveshje për mbrojtjen e investimeve me shtetin nga i cili është pala paditëse, dhe së dyti, nga fakti nëse pala paditëse është investuese. Pra Konventa e ICSID-së nuk parashikon asnjë lloj detyrimi ndaj palëve për problematika të aspektin penal. Me fjalë të tjera nuk mundet që një shoqëri që ndërton infrastrukturë publike me fondet e shtetit shqiptar ta padisë atë në ICSID, ndërkohë që një shoqëri që ndërton një projekt infrastrukturë në bazë të një leje apo koncesioni mundet, sepse financimi i projektit është investim privat.

4.11.2. Shteti shqiptar dhe paditë në ICSID

Historia e ICSID-së për Shqipërinë fillon me një çështje të vitit 1994, ku shoqëria “Tradex Hellas” paditi, pa sukses, shtetin shqiptar për shpronësim në kundërshtim me ligjin “Për investimet e huaja”, për të vijuar me një çështje tjetër të vitit 1995, e cila u mbyll me marrëveshje pajtimi në vitin 1997. Një rast tjetër është dhe padia paraqitur nga shoqëria “Pantehniki S.A. Contractors & Engineers” kur pas gjykimit të çështjes, ICSID e rrëzoi padinë. Kushdo që përballët me humbje të investimit do të kërkojë të gjejë rrugë për dëmshpërblim, ndaj dhe ekziston mundësia që për këto raste të shtohen paditë. Juridiksioni i Gjykatës së Arbitrazhit ICSID nuk i përfshin në juridiksionin e saj çështjet penale. Për këtë arsye, ky vendim nuk mund të shtrijë efektet e tij mbi procesin penal që u zhvillua në Gjykatën e Tiranës kundër Beketit dhe disa bashkëpunëtorëve të tij, të akuzuar se janë të përfshirë në një skemë mashtruese financiare me vlerë rreth 40 milionë euro. Po ashtu, qëndrimi i Gjykatës ICSID nuk shtrin efektet as tek masa e

sigurisë e karakterit penal për sekuestron preventive ndaj pasurive të Beketit⁸⁹ dhe bashkëpunëtorëve të tij në Shqipëri.

4.11.3. OBT, CEFTA, EFTA, NATO, SEEC, NAFTA, MSA

Vëmendje e veçantë i kushtohet marrëveshjeve ekonomike dhe atyre të tregtisë, nënshkrimi i të cilave midis dy ose disa shteteve që ndodhen në një zonë gjeografike të caktuar gjithnjë e më shumë vjen në rritje. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve në përgjithësi është eliminimi i pengesave ekzistuese për tregtinë lirë midis vendeve që e nënshkruajnë ose ai i lëvizjes së lirë të kapitalit dhe faktorëve të tjerë të prodhimit. Shfaqja e marrëveshjeve të tilla ndikon si në marrëveshjet e tregtisë së jashtme, ashtu edhe në hyrjet e IHD-ve në një vend. Por këto efekte do të jenë të ndryshme në varësi të faktit nëse vendi është pjesë e marrëveshjes, apo është një vend i tretë, në varësi të zhvillimit ekonomik të vendit, apo nga lloji i investimit të huaj.

OBT është një organizatë ndërkombëtare me qendër në Gjenevë të Zvicrës, e cila merret me nxitjen dhe vënien në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve tregtare ndërkombëtare, me autoritetin të administrojë dhe mbikëqyrë marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe praktikat tregtare botërore, si dhe të shqyrtojë dhe rregullojë mosmarrëveshjet tregtare midis vendeve anëtare. Ajo u krijua për të zëvendësuar GATT-in dhe filloi aktivitetin e saj në 1995. GATT-i dhe OBT-ja bashkëjetuan deri në dhjetor 1995 kur vendet anëtare të GATT-it u mblodhën për herë të fundit. Një moment i rëndësishëm

⁸⁹Çështja ICSID nr. ARB/15/28 – Hydro Srl, Costruzioni Srl, Francesco Bechetti, Mauro De Renzis, Stefania Grigolon dhe Liliana Condomitti, kundër Shqipërisë: Përfaqësues të Beketit në Tiranë shpërndanë njoftim zyrtar, ku theksohej se “Me një urdhër unanim dhe historik të lëshuar të premtën në Uashington DC, pas një seance dëgjimore të arbitrazhit përpara ICSID, Qeverisë së Shqipërisë i është kërkuar të ‘ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të pezulluar’ procedurat e ekstradimit në Londër të Francesco Bechetti-t, pronarit të Agon Channel TV dhe Mauro De Renzis, administratorit. Trupa e Gjykatës së Arbitrazhit e përbërë nga tre anëtarë, rekomandoi që Shqipëria të pezullojë procedurat vijuese penale kundër paditësve të kësaj çështjeje dhe që të dyja palët të arrijnë në një marrëveshje mbi ruajtjen e aseteve të paditësit, që kanë qenë të sekuestruara nga shteti shqiptar, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së arbitrazhit. Avokatura e Shtetit, që ka pasur përfaqësues të saj gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje në Gjykatën e Arbitrazhit, shprehen se vendimi i datës 04.03.2016 i ICSID është një opinion i ndërmjetëm, në pjesën përfundimtare të tij shpreh rekomandimet e saj për autoritetet shqiptare, të cilat nuk kanë fuqi detyruese për autoritetet që i drejtohen. Për këtë arsye, Avokatura e Shtetit, në procesin e arbitrazhit me Francesco Beketin, nuk e konsideron të arsyeshme t’u përcjellë autoriteteve penale shqiptare opinionin e ndërmjetëm dhe rekomandimet e Gjykatës së Arbitrazhit ICSID.

për Shqipërinë, është ai i anëtarësimit të saj në OBT (WTO)⁹⁰ në vitin 2000 pas zhvillimit të procesit të negocimit me vendet anëtare të saj. Procesi i negocimit para anëtarësimit dhe më pas, procesi i zbatimit të angazhimeve ndaj OBT, janë shoqëruar me ndërmarrjen e reformave dhe rritjen standardeve, të domosdoshme për t'u përshtatur ndaj rrjedhave të sotme të tregtisë globale. Nismat e marra nga shteti shqiptar për të plotësuar angazhimet në kuadër të OBT-së po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme jo vetëm pse ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe sepse ato përbëjnë “kushte” për integrimin europian dhe atë rajonal. Ky ndërgjegjësim vjen dhe si rezultat i rritjes së efekteve që vijnë nga liberalizimi i tregut, të cilat, me fjalë më të thjeshta, mund të përmbledheshin në rritjen e konkurrencës, shkëmbin dhe ofrimin më të madh të produkteve dhe shërbimeve, të cilat prekin drejtpërdrejt interesat e biznesit vendas dhe të konsumatorit (Aida Gugu, 2009).

Shteti shqiptar ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me qëllim nxitjen dhe rritjen e numrit të investimeve, ku ndër më të rëndësishmet përmendin **CEFTA**, e cila përfshin tetë vende: Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi, Kosovë, Moldavi, Kroaci, Serbi, Bosnje-Hercegovina. Objektivat kryesore të CEFTA-s janë ndër të tjera, zgjerimi i tregtisë në mallra dhe shërbime dhe nxitja e investimeve, eliminimi i barrierave të tregtisë mes palëve, sigurimi i mbrojtjes së duhur të së drejtave të pronësisë intelektuale në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimi i dispozitave për sa i përket çështjeve të politikave tregtare, të tilla si: rregullat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore. Ajo gjithashtu përfshin procedura të qarta dhe efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

⁹⁰ World Trade Organization WTO, 2014, e themeluar në vitin 1994 kur vendet anëtare të General Agreement on Tariffs and Trade (GATT), firmosën një pakt të ri tregtar. Edhe pse OBT zëvendësoi GATT-in, marrëveshjet tregtare të arritura në kuadër të tij deri në 1994 janë pjesë e Marrëveshjes së OBT. Kjo e fundit ka një kuadër shumë më të gjerë se GATT-i, i cili përfiqej të rregullonte vetëm tregtinë e mallrave. OBT e zgjeroi kuadrin e GATT-t duke përfshirë edhe tregtinë e shërbimeve dhe mbrojtjen e pronës së intelektuale. OBT është gjithashtu një organizatë e strukturuar në mënyrë formale rregullat e të cilës janë të detyrueshme për zbatim nga vendet anëtare dhe përfaqëson edhe një trupë gjykuese në tregtinë ndërkombëtare. Vendet anëtare mund t'i referojnë mosmarrëveshjet e tyre para një paneli arbitrazhi të përbërë nga zyrtarë të OBT. Më tej ekziston edhe një trupë apelimi ku vendet anëtare mund të apelojnë vendimet e arbitrazhit. Vendimet e apelit janë të formës së prerë. Të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen brenda afateve të caktuara në rregulloret e funksionimit të OBT.

Më 19 dhjetor 2006, të gjitha marrëveshjet dypalëshe që Shqipëria kishte lidhur me vendet e rajonit u transformuan në një marrëveshje shumëpalëshe, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore (CEFTA, 2006).

Në dhjetor 2009, Shqipëria nënshkroi **EFTA**⁹¹. Kjo marrëveshje ndërmjet RSH dhe shteteve të EFTA përqendrohet në liberalizimin e tregtisë së mallrave. Ato do të shfuqizojnë të gjitha tarifatat doganore mbi produktet industriale, përfshirë peshqit dhe produktet e tjera detare. Marrëveshjet dypalëshe për produktet bujqësore ndërmjet shteteve të EFTA-s (individualisht) dhe Shqipërisë bëjnë pjesë gjithashtu tek instrumentet krijuese të zonës së tregtisë së lirë ndërmjet të dy palëve.

Shqipëria gjithashtu është pjesë e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Turqinë, të nënshkruar në 2006, e cila ka hyrë në fuqi në maj 2008. Nëpërmjet kësaj marrëveshje dy vendeve u krijohen mundësi për rritjen e shkëmbimeve tregtare ndërmjet tyre. Sipas marrëveshjes, nuk do të ketë tarifa për mallrat industriale shqiptare të eksportuara në Turqi dhe tarifatat për produkte të caktuara turke do të reduktohet përfundimisht brenda pesë vitesh. Lidhur me produktet bujqësore palët i kanë akorduar reciprokisht njëra-tjetrës kuota tarifore.

Shqipëria ka fituar një status dhe rol të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare, rrjedhojë logjike e partneritetit në rritje me të gjithë strukturat e sigurisë rajonale dhe globale pas anëtarësimit në NATO në prill të vitit 2009.

Aktualisht Shqipëria është në një proces të rëndësishëm me Bashkimin Evropian, pas hyrjes në fuqi më 1 prill 2009 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, liberalizimit të vizave dhe aplikimit për statusin e vendit kandidat. Shqipëria është një vend strategjik për sigurinë, paqen dhe prosperitetin e Ballkanit, Mesdheut dhe Evropës.

Politika e jashtme e RSH-së është e vendosur të rrisë këtë rol dhe kontribut, si një faktor me peshë rajonale për forcimin e sigurisë dhe për të garantuar stabilitet politik dhe ekonomik rajonal. Kjo politikë është e orientuar për t'u angazhuar maksimalisht në forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe integritetit të rajonit.

Shqipëria është anëtare aktive e **SEEC**⁹². Kjo organizatë rajonale synon forcimin e dialogut politik, fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes rajonal,

⁹¹ Shtetet anëtare të EFTA-s janë Islanda, Zvicra, Norvegjia dhe Lihtenshtajni.

⁹² Fillimet e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC), datojnë në qershor të vitit 1996, me Takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të Evropës Juglindore, që u mbajt në Sofje, të Bullgarisë, më synim promovimin dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe transformimin e rajonit në

rritjes së sigurisë etj. SEECIP përbëhet nga 12 vende anëtare si: Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Turqia.

Një tjetër marrëveshje me rëndësi është **NAFTA**⁹³ e cila ka për qëllim të eliminojë barrierat jo-tarifore të tregtisë dhe për të mbrojtur të drejtën e pronësisë intelektuale të produkteve⁹⁴. Kjo marrëveshje është një lloj stabiliteti për të arritur eliminimin e pengesave të problematikave të tarifave.

Në fushën e liberalizimit të tregtisë si edhe nxitjes së investimeve dhe eksporteve janë arritur progres të dukshme nga Qeveria e Shqipërisë përmes përpjekjeve efektive të METE dhe Agjencive shtetërore përkatëse, në bashkëpunim me partnerët e tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (**MSA**), parashikon krijimin e një zone të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe BE në një periudhë kohore 10-vjeçare. Shqipëria angazhohet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë ose shtetasit e vendeve të BE-së, pa qenë nevoja për tu vendosur në territorin Shqiptar duke u angazhuar bashkë me KE të autorizojnë, në monedha të këmbyeshme lirisht, në përputhje me dispozitat e Nenit

një zonë të paqes, sigurisë, stabilitetit. Objektivi parësor i SEECIP është forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë mes vendeve të rajonit, transformimi i rajonit në një zonë të paqes, sigurisë, stabilitetit dhe bashkëpunimit, nëpërmjet frymës së solidaritetit dhe në të mirë të qytetarëve të vendeve të rajonit. Së dyti, krijimi i një Evropë Juglindore, e ardhmja e së cilës projektohet në paqe, demokraci, prosperitet ekonomik dhe integrim në strukturat evropiane dhe euro-atlantike, duke qenë të përkushtuar në vazhdimin e reformave demokratike dhe ekonomike në vendet përkatëse. Së treti, përgjegjësia e vendeve të rajonit dhe vullneti i tyre për të punuar ngushtësisht me komunitetin ndërkombëtar me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të përbashkëta për stabilitetin rajonal, për t'ju përgjigjur sfidave të reja të sigurisë dhe eliminimin e shkaqeve rrënjësore, si forcimi i solidaritetit ndërkombëtar, që përfshin pjesëmarrjet në parandalimet e konflikteve, aktivitetet e menaxhimit të krizave, mbështetjen e operacioneve paqësore të ndërmarra nga organizmat e komunitetit ndërkombëtar, veçanërisht në kuadër të UN, NATO, OSBE, dhe institucioneve Euro-Atlantike. Rritja e bashkëpunimit ekonomik, nëpërmjet bashkëpunimit dy dhe shumëpalësh, mes rajonit dhe pjesës tjetër të Evropës, që përbën një dimension esencial të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, sigurisë dhe stabilitetit. Zgjerimi i bashkëpunimit në fushën e dimensionit human, demokracisë, drejtësisë dhe luftës kundër aktiviteve të paligjshme.

⁹³ Negociatat diplomatike për të datojnë që në 1986 mes tre kombeve. NAFTA është një marrëveshje e nënshkruar nga qeveritë e Kanadasë, Meksikës dhe Shteteve të Bashkuara, duke krijuar një bllok trepalësh tregtisë në Amerikën e Veriut. Marrëveshja hyri në fuqi më 1 janar të vitit 1994. Zbatimi i NAFTA më 1 janar 1994 solli eliminimin e menjëhershëm të tarifave në më shumë se gjysma e eksporteve Meksikës në SHBA dhe më shumë se një e treta e eksporteve amerikane në Meksikë. Brenda 10 viteve të zbatimit të marrëveshjes, të gjithë SHBA-Meksikë tarifat do të eliminohen, përveç për eksportet disa bujqësore amerikane në Meksikë që ishin të ndarë në faza brenda 15 viteve. Më SHBA-Kanada tregtare tashmë ishte pa taksa.

⁹⁴ <http://www.naftanow.org>

VIII të Neneve të Marrëveshjes së FMN, çdo pagesë apo transfertë në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë. Në lidhje me transaksionet në llogarinë kapitale dhe atë financiare të bilancit të pagesave, me hyrjen në fuqi e Marrëveshjes, Shqipëria dhe Komuniteti do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investime direkte në shoqëritë e krijuara në përputhje me legjislacionin e vendit pritës, si dhe likuidimin ose riatdhesimin e këtyre investimeve dhe të çdo përfitimi që rrjedhin prej tyre. MSA u ratifikua në prill 2009 (Stabilization and Association Agreement 2006). Ajo nënkupton, të drejtën për të ndjekur veprimtari ekonomike si persona të vetë-punësuar dhe për të krijuar sipërmarrje (për sa u përket shtetasve) si dhe të drejtën për të ndjekur veprimtari ekonomike duke ngritur filiale dhe degë në Shqipëri (për sa u përket shoqërive komunitare). Shqipëria detyrohet të lehtësojë fillimin e veprimtarive në territorin e saj nga shoqëri dhe shtetas komunitar, duke u garantuar, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, shoqërive komunitare, filialeve dhe degëve të tyre, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar shoqërive të saj ose shoqërive të një vendi të tretë si dhe degëve dhe filialeve të tyre. Në këtë mënyrë, shoqërive komunitare të vendosura në Shqipëri do tu jepet "trajtim kombëtar" ose trajtim i "kombit më të favorizuar", cilito qoftë më i favorshëm.

Programi i Sistemit të Gjeneralizuar të Preferencave (**GSP**) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ky program ofron trajtim pa doganë për rreth 3.400 lloje të eksporteve nga Shqipëria dhe Kosova. Qëllimi i programit GSP⁹⁵ është që t'u japë këtyre eksporteve një natyrë konkurruese në tregun e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Kompanitë dhe konsumatorët e SHBA janë veçanërisht të interesuar në blerjen e mallrave përmes programit GSP sepse eksportet nuk ngarkohen me barra tarifore, me të hyrë në SHBA.

Nuk ka qenë e lehtë për vendin tonë të jetë pjesë e këtyre marrëveshjeve, por lehtësitë që janë krijuar duke qenë palë tyre kanë qenë të shumta. Ndikimi që kanë pasur këto marrëveshje ka qenë mjaft pozitiv e inkurajues si për investimet hyrëse ashtu dhe për ato dalëse. Të jesh pjesë e NATO-s do të thotë jo vetëm bashkëpunim dhe mbështetje në situata kaotike por dhe ofrim garancie për biznesin vendas dhe të huaj. Gjithashtu duke nënshkruar marrëveshjet e sipërpërmendura janë hequr një sërë barrierash tatimore,

⁹⁵ Shumë artikuj kanë të drejtë për trajtim GSP pa tarifë doganore. Këto përfshijnë shumicën e mallrave të prodhuara; lëndët e përdorura në prodhim, bizhuteri, shumicën e llojeve të qilimave, disa produkte bujqësore dhe produkte të tjera të peshkut, si dhe në shumë lloje të kimikateve, mermerit, dhe mineraleve.

doganore etj. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve ka sjellë ndikim në rritjen e investimeve, vendi është bërë më i sigurt për klimën e biznesit (dhe jo vetëm) si dhe ofron më shumë lehtësi në të bërit biznes.

4.11.4. E drejta Ndërkombëtare Private dhe Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar për zgjidhjen e konflikteve

Sistemi i të drejtës së një shteti përbëhet nga një sërë disiplinash të së drejtës të cilat me normat juridike të tyre rregullojnë marrëdhënie të ndryshme shoqërore. Pjesë e sistemit të së drejtës sonë është dhe e Drejta Ndërkombëtare Private, e cila përbëhet nga një tërësi normash juridike, të cilat përcaktojnë nëse një marrëdhënie juridike civile e karakterizuar nga elementi i huaj, duhet të rregullohet në bazë të rendit juridik të një shteti të dhënë apo të një shteti tjetër me të cilin ajo paraqet pika kontakti. Marrëdhëniet ndërkombëtare private me karakter juridiko-civil janë ato marrëdhënie që në përmbajtje të tyre kanë “elementin e huaj”. Në burimet e së drejtës ndërkombëtare private përfshihen norma që rrjedhin nga marrëveshje ndërkombëtare të marrëdhënieve juridike civile midis subjekteve të ndryshme të së drejtës. Aspektet e kësaj të drejte kanë vlerë të përgjithshme d.m.th informojnë në vetvete për sistemet komplekse të së drejtës që sjellin në fushën e disiplinës një karakter rinovues të terminologjisë juridike duke sjellë “parime informuese” të cilat ndihmojnë gjyqtarin në interpretimin e normave për zgjidhjen e konflikteve. Nga interpretimi i normave të së drejtës sonë ndërkombëtare private rezulton se, një shtetas për të qenë subjekt i një marrëdhënie juridike (vendas apo i huaj) duhet të ketë një gjendje juridike të caktuar, ose dy cilësi të domosdoshme, zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar⁹⁶ (Kalia, 2006: 13-80).

Për zgjidhjen e konflikteve të krijuara midis shtetit tonë dhe investuesve të huaj vjen në ndihmë dhe Arbitrazhi ndërkombëtar Tregtar. I cili në vendet më të zhvilluara njihet sot si metoda më efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve tregtare.

Një numër i madh mosmarrëveshjesh që lidhen me infrastrukturën, tregtinë ndërkombëtare dhe kontratat e përgjithshme tregtare, si dhe mjaft mosmarrëveshje të lidhura me të drejtën e detit dhe të mallrave, janë zgjidhur dhe vazhdojnë të zgjidhë.

⁹⁶ Problemi i zotësisë juridike dhe zotësisë për të vepruar të të huajve merret në analizë duke iu referuar ligjit 3920 “Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt” datë 21.11.1964.

Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar të Londrës (London Court of International Arbitration) është një nga institucionet kryesore të arbitrazhit në botë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

Siç u përmend më sipër, arbitrazhi tregtar lind si pasojë e një marrëveshjeje të palëve për të zgjidhur çështjet në mënyrë private jashtë kuadrit ligjor të gjykatave shtetërore. Disa nga veçoritë e arbitrazhit tregtar, që përbejnë edhe avantazhet e tij, konsiderohen përgjithësisht:

1. Neutraliteti: palëve të përfshira në mosmarrëveshje tregtare u krijohet mundësia që të zgjedhin një gjykatë ose gjyqtar neutral (të paanshëm) të arbitrazhit, i cili interpreton dhe zbaton normat e çdo legjislacioni material të përzgjedhur prej tyre sipas ligjit përkatës dhe parimeve e praktikës së pranuar gjerësisht të së drejtës tregtare;
2. Forma e prerë dhe zbatueshmëria e vendimeve: një vendim arbitrazhi ka për qëllim të prodhojë një rezultat që do të ketë një efekt të detyrueshëm dhe përfundimtar për palët, duke dhënë një mundësi të kufizuar për ta kundërshtuar dhe apeluar atë.
3. Autonomia e palëve/fleksibiliteti procedural: palët, ose nëse ato nuk bien dakord mes tyre, arbitrat, janë të lirë të caktojnë mënyrën se si do të drejtohet arbitrazhi.
4. Shpejtësia, kostot dhe konfidencialiteti: fleksibiliteti procedural ka si rezultat kursimin e kohës dhe të shpenzimeve, edhe pse kjo e fundit është në varësi të numrit të arbitrave të zgjedhur, kompleksitetit të çështjes dhe shkallës së bashkëpunimit midis palëve. Arbitrazhi është një proces privat, dhe kjo i jep mundësinë që të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit mbi mosmarrëveshjen dhe palët e përfshira, çka përbën dhe një avantazh thelbësor në krahasim me procesin gjyqësor në gjykatat e zakonshme.

Legjislacioni shqiptar aktual mbi arbitrazhin është mjaft modern dhe siguron zhvillimin e një procesi të paanshëm, ku palëve u garantohet e drejta e barazisë dhe e drejta për t'u dëgjuar në një procedurë kontradiktore dhe përgjithësisht ky kuadër rregullator është në përputhje me parashikimet e rregullores UNCITRAL (rregullore e Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi ligjin Ndërkombëtar Tregtar - United Nations Commission on International Trade Law).

Pra, duke e përmbledhur të gjithë situatën shohim se Shqipëria angazhohet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë ose shtetasit dhe për më tepër lidhur me investimet direkte ofron një sërë ligjesh, lehtësira në taksa, fleksibilitet në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, dhe nëpërmjet marrëveshjeve me shtete ofron një stabilitet, siguri në lidhje me investues që duan t'i ofrojnë Shqipërisë aktivitete të tyre.

4.12. Reforma e re administrative territoriale në Shqipëri

Vende të zhvilluara të Europës por jo vetëm, të cilat më herët janë bërë pjesë e reformave territoriale kanë parë një lulëzim jo vetëm qyteteve, por dhe të zonave rurale. Mbas shumë, përpjekjesh dhe kontestimesh edhe në Shqipëri u miratua ndarje e re territoriale. Ky projekt si fillim po kalon në fazën e tranzicionit në konsolidimin financiar dhe administrativ të Njësive të Qeverisjes Vendore aktuale (NJQV). Për realizimin e këtij projekti është kërkuar të rishikohet “Kuari Ligjor” duke rishikuar legjislacionin ekzistues në lidhje me çështjet e qeverisjes vendore⁹⁷.

Projekti ka vëmendjen e shumë institucioneve⁹⁸, duke përfshirë jo vetëm bashki e komuna. Kjo reformë, duke qenë se mbart me vete më shumë transparencë nga këto institucione normalisht i detyron ato të kenë dhe më shumë përgjegjësi, rritet pritshmërisë ndaj detyrave dhe kjo sjellë edhe më shumë kërkesa ndaj tyre, më shumë përgjigje për qytetarët, si dhe më shumë transparencë në çdo nismë institucionale. Ndarja e re territoriale pritët të sjelli një situatë ku shumë problematika të mbartura ndër vite nga komunat do të trajtohen tanimë më vëmendjen e duhur nga bashkitë.

Duke pasur një menaxhim të mirë të fondeve, pritët të ketë më shumë zhvillim në mbarë vendin. Kjo nënkupton më shumë vëmendje për mjedisin, më shumë vëmendje ndaj lehtësisë së të bërit biznes, më shumë përkujdesje për zhvillimin e turizmit në zonat rurale ku pasuritë dhe bukuritë natyrore ta mundësojnë një gjë të tillë. Përmirësimi i

⁹⁷ Kuadri ligjor që do të rishikohet: Ligji Nr. 8652, datë 31.07.200 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji Nr. 115/2014 datë 31.07.2014 “Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”; 34 ligje të sektorëve të industrisë; 5 VKM; 2 Udhëzime të Institucioneve të Qeverisjes Qendrore.

⁹⁸ Agjencinë e inventarizimit dhe Administrimit të Pronës Publike në Ministrinë e Brendshme; Ministrinë e Arsimit; Zyrat Rajonale të Thesarit; Zyrën Rajonale e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme; Ministrinë e Mjedisit.

këtyre faktorëve do të tërheqë vëmendjen e investorëve jo vetëm shqiptarë, por dhe të huaj. Nga kjo reformë përfitime merr dhe buxheti i shtetit. Përlllogaritet një kursim rreth 60 milionë USD, shumë e cila parashikohet të investohet në përmirësimin e infrastrukturës në vend, përmirësimi i të cilës ka ndikim në rritjen e IHD-ve.

Sfida më e madhe për vendin është rritja e IHD-ve, gjë që pritet të ndodhi nga shfrytëzimi i “potencialeve të pazbuluara ende”, për të cilat kanë filluar të interesohen seriozisht kompani të rëndësishme gjermane, shoqëri industriale italiane etj. Interesimit aktual i investorëve potencialë të huaj dhe përfitimeve të shumanshme e mjaft të efektshme për vendit nga investimet e qëndrueshme të tyre këtu, do t’u hapte horizonte të gjera hartës së re territoriale, e cila pa ngurrim mund të konsiderohet si një arritje e madhe në këtë kohë ndryshimesh. Këto arritje, pa dyshim, do të konsolidohen dhe shumëfishohen sidomos prej reformës në drejtësi, e cila pritet të krijojë dhe të shtrijë efekte në rritjen sigurisë juridike si për shtetasit shqiptar ashtu edhe për ata të huaj, dhe kjo përkthehet në rritje të IHD-ve. Për investorët që parashikohet të kryejnë këtu investime direkte në mjaft sektorë, deri në ata strategjikë.

KAPITULLI V. ANALIZË E STUDIMIT EMPIRIK

Sikurse është thënë dhe në hyrje të këtij punimi, në qendër të këtij kërkimi është analizimi i ndikimit të aspektet ligjore në nxitjen e IHD-ve në vend. Studimi u realizua nëpërmjet fazave si më poshtë:

Fillimisht u bënë kërkime rreth literaturës më të përshtatshme që ka lidhje me temën e studimit, e më pas u bë e mundur gjetja e saj në librari, biblioteka, internet etj.

Në këtë fazë u ndërtuan instrumentet matëse, analiza përshkruese në kapitullin dytë të tretë ku teori të ndryshme u renditën duke u interpretuar në kohë dhe lidhjet me IHD-të në Shqipëri, në kapitullin e katërt, vend i rëndësishëm i jepet kuadrit ligjor në Shqipëri dhe ndryshimeve që ai ka pësuar, e më pas u kalohet tek intervista për studimin empirik, për të vërtetuar ose hedhur poshtë hipotezën e studimit, pasi përveç analizës dhe interpretimit të kuadrit ligjor që është bërë në kapitullin paraardhës është menduar të merret opinioni i vetë investuesve rreth kësaj çështjeje.

Për marrjen e këtij opinioni pas një reflektimi të gjatë në lidhje me faktin se cila metodë do të ishte më e përshtatshme në arritjen e rezultateve u përzgjedh intervista e strukturuar me pjesëmarrje të investitorëve të huaj, pasi kjo metodë të lejon marrjen e informacioneve, opinioneve nëpërmjet përdorimit të pyetjeve dhe dialogut ndërveprues. Gjetja e kontakteve me investitorët e huaj e më pas marrja e përgjigjeve prej tyre, ishin disa prej vështirësive të kësaj përzgjedhjeje. Kjo për shumë arsye ku ndër më të rëndësishmet do të përmendja vendndodhjen e investuesve dhe angazhimet të përditshme në aktivitetin e tyre, të cilat kufizonin komunikimin me to. Pra, si shikohet, kampioni i studimit përbëhet nga subjekte që i përkasin grupit investuesve të huaj që investojnë në Shqipëri. Administrimi i intervistimit është bërë nga autori dhe kërkimi është zhvilluar gjatë periudhës mars 2015 – maj 2015. Në kuadër të kësaj analize janë përdorur tabela dhe grafikë për të ilustruar më mirë përfundimet dhe nga ana empirike me anë të intervistës. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur metoda e përzier duke bërë kombinimin e asaj cilësore me atë sasiore për të arritur më mirë projektin kërkimor. Zgjedhja e kampionit ka qenë e fokusuar tek zgjedhja e rasteve të një numri të vogël që kanë bërë të mundur eksplorimin e pyetjeve hulumtuese në thellësi dhe përpunimin e mbledhjen e të dhënave, pra kampioni ka qenë i qëllimshëm (homogjen).

Nisur nga fakti se IHD-të ndikohen nga legjislacioni e kryesisht nga lehtësitë që i krijohen prej tij, analiza më tej thellohet në situatën e marrjes së opinionit të investorëve të huaj për disa IHD aktive në vend, si dhe në përcaktimin e faktorëve të tjerë lehtësues të tyre, mbështetur në perceptimin dhe vizionin e vetë kompanive të huaja. Pyetjet e ngritura në këtë kërkim, janë analizuar duke përdorur metodat e statistikës përshkruese të të dhënave në një formë për t'i interpretuar më pas edhe në tabela dhe grafikë. Intervista është ndërtuar në dy lloje pyetjesh: në pyetje të mbyllura dhe në pyetje të hapura. Pyetjet e mbyllura janë analizuar duke përdorur metodat statistikore, siç u përcaktua dhe në literaturën më sipër. Përfshihen pyetje në lidhje me kapitalin e investuar, sektori në të cilën vepron, numri i personave të punësuar, të ardhurat vjetore që përfituara krahasuar me vitin paraardhës; shtypa e investimit në Shqipëri; disponueshmëria e fuqisë punëtore, kostoja e ulët e pagave, faktorët që kanë rëndësi për të investuar; burimet financiare që ka përdorur kompania për investime, dhe një vend të rëndësishëm zë kuadri ligjor i cili vitet e fundit gjithë një e më shumë është përmirësuar, duke marrë informacion se sa ndikim kanë këto përmirësime apo lehtësira të krijuara nga legjislacioni në aktivitetin e investuesit të huaj. Investuesve të huaj paraprakisht iu kërkua leje për realizimin e intervistës nëpërmjet e-mailit dhe numrave të telefonit që u gjenden në faqet zyrtare në internet të këtyre firmave. Për të përfunduar plotësimin dhe përvijimin në tabelë të të dhënave e më pas dhe interpretimin e tyre, u deshën dymbëdhjetë javë. Të dhënat e grumbulluara pasi u analizuan me anë të Excel-it u përpunuan në tabela e grafikë për llogaritjen e numrit të përgjigjes e më pas konvertimin e këtij numri në përqindje.

Duke iu referuar pjesës më me rëndësi të studimit mund të thuhet se gjatë aplikimit përveç vështirësive të përmendura më sipër për të kontaktuar me të intervistuarit, për pjesën tjetër nuk është hasur vështirësi madje të intervistuarit në të shumtën e rasteve kanë qenë mikpritës duke u treguar mjaft të disponueshëm për të ndihmuar në një hulumtim të tillë. Pas prezantimit u tha, se intervista ishte pjesë e një hulumtimi për studime doktorate, të intervistuarit pas kësaj dhanë informacionin e nevojshëm. Zgjedhja për aplikimin e intervistës ka qenë për të gjithë firmat e huaja e qëllimshme për të për zgjedhur firma që kryejnë aktivitete të ndryshme nga njëra tjetra. Realizimin i këtij studimi shkencor u mbështet në zbatimin e rregullave të kodit të etikës profesionale të një studimi shkencor gjatë gjithë zhvillimit të intervistës dhe konkretisht

u zbatua e drejta për të mbetur anonim, konfidencialiteti, pa e shkelur vullnetin e pjesëmarrësve. Intervista është e formuluar në dy pjesë. Pjesa e parë siguron informacion të përgjithshëm për përvojën individuale të investimit duke marrë informacion në pyetjen e parë se cili është sektori ku firma operon (duke e ndarë atë në tri alternativa: në prodhimin; tregti; shërbime), si dhe sa vite kanë që investojnë në Shqipëri. Pyetja e dytë ka të bëjë me vlerën e kapitalit të investuar (shumë të lartë, të lartë, apo minimal). Në pyetjen e tretë kalojmë në një aspekt të rëndësishëm të intervistës dhe studimit tonë duke bërë pyetjen: “A ka qenë favorizues kuadri ligjor në fillimet e investimit?”. Pyetja e pestë e intervistës lidhet me numrin e personave të punësuar (5-50; 51-100; më shumë se 101). Në pyetjen e gjashtë dhe të fundit të këtij seksioni të intervistuarit i listohen faktorët e mëposhtëm dhe i kërkohet të përzgjedhë pesë prej të cilëve kanë pasur ndikim në ecurinë e aktivitetit:

- Kualifikimi i punonjësve (cilësia e arsimit profesional; disponueshmëria e fuqisë punëtore; korrektësia në punë);
- Liria në të bërit biznes;
- Siguria, transparenca dhe zbatueshmëria e kuadrit ligjor në fuqi;
- Stabiliteti politik dhe ekonomik;
- Niveli i ulët i burokracisë;
- Kostoja e lëndës së parë;
- Infrastruktura;
- Apo të gjitha bashkë?

Në pjesën e dytë, B, kërkohet një informacion më i detajuar për firmën për të siguruar informacion në lidhje me pyetjet e kërkimit, por duke u përqendruar në rëndësinë e studimit atë të kuadrit ligjor në Shqipëri për IHD-të. Pyetja e parë e këtij seksioni pyet të intervistuarin se cila ka qenë arsyeja që ai ka investuar në Shqipëri:

- Marrëveshjet, konventat, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara në Shqipëri;
- Sistemi bankar;
- Politika qëndrueshme monetare dhe fiskale;
- Infrastruktura;
- Puna: cilësia e arsimit profesional; disponueshmëria e fuqisë punëtore; korrektësia në punë;

- Politikat qeveritare;
- Stabiliteti ekonomik,
- Vendndodhja gjeografike dhe burimet natyrore,
- Tjetër, specifiko.

Duke iu dhënë këto alternativa të intervistuarve, u jepet mundësia të shprehin mendimin e tyre dhe nëse përgjigjja e tyre nuk është dhënë në njërin prej alternativave të mësipërme, i lihet hapësirë për të dhënë një përgjigje tjetër nga ajo e alternativave. Një nga pyetjet e cila krahason gjendjen e klimës së përthithjes së investimeve të huaja të dekadës së fundit të shekullit XX me dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XXI është pyetja e dytë e cila synon të marrë informacion për pengesat kryesore për investimin në fillim duke listuar 5 (pesë) alternativat më kryesore si për shembull: infrastruktura; vendndodhja gjeografike, burimet natyrore; sistemi gjyqësor, mbrojtja e të drejtave tuaja si investues; burokracitë administrative; sistemi bankar; korrupsioni dhe nepotizmi; vështirësitë e biznesit në hyrjen në treg; stabiliteti ekonomik dhe politik; kualifikimi i punonjësve; vlera e tarifave të taksave dhe doganave.

Pyetja e tretë ka të bëjë me mendimin që ka investuesi për praktikën që po ndiqen në Shqipëri në pesë vitet e fundit për të përmirësuar klimën e biznesit dhe kjo pyetje mbështetet më tej nga e pyetja katërt e cila ka sfond ligjor duke pyetur, nëse investuesi ka dijeni në lidhje me legjislacionin e miratuar së fundmi që ka ndikuar pozitivisht në investimin të tij. Pyetja e pestë ka të bëjë me ecurinë e IHD-ve në Shqipëri, nëse këto IHD janë në rritje apo në ulje, duke i përfshirë këto të dhëna nga matësi i të ardhurave vjetore. Në pyetjen e gjashtë kërkohet informacion për burimet financiare që ka përdorur kompania, apo firma për të ushtruar aktivitetin e saj. Treguesit e kësaj pyetje janë të lidhur me ato të pyetjes në vazhdim. Nuk është e lehtë të zgjerosh aktivitetin, nëse nuk njeh situatën ekonomike të vendit pritës, pra pyetja e shtatë kërkohen informacion nëse investuesi ka ndërmend në vitet në vazhdim të rrisë numrin e punonjësve. Më pas, në pyetjen e tetë merret informacion rreth mendimit që ato kanë për situatën ekonomike aktuale. Një rëndësi të konsiderueshme për një biznes ka dhe fusha e shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit dhe në rastin tonë tatimet, gjë që është e lidhur dhe me burokracitë që shpesh i japin trysinë e vet investuesve, pikërisht këtë informacion do të marrim nga investuesit e huaj në pyetjen e nëntë. Një pjesë e vështirë

për një biznes është dhe bashkëpunimi me të tjerë mbi këtë është ndërtuar pyetja e dhjetë: për shembull lënda e parë, shpërndarësit e tjerë nuk janë apo janë korrekt në pagesa. Në lidhje me pyetjen e njëmbëdhjetë kërkohet opinioni i investuesit, për progresin që është bërë nga ligjvënësi shqiptar në përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon marrëdhënien midis investitorëve të huaj dhe shtetit shqiptar. Pyetja e dymbëdhjetë nxjerr në pah transparencën e sistemi tatimor në Shqipëri, nga këndvështrimi i një investitori të huaj. Pyetjen e trembëdhjetë është formuluar për të marrë sërish informacion në lidhje me kuadrin ligjor, duke pyetur se si konsiderohet siguria që përcjell ai tek investuesi, e cila mund të ndahet në përqindje nga fakti nëse është e keqe, disi, apo e moderuar, dhe në fund atë që çdo shtet do të donte të arrinte, faktin që siguria ligjore ka arritur shkallën më të lartë. Së fundmi, investuesit në pyetjen e katërbëdhjetë i kërkohet të shprehet nga përvoja që ai ka pasur në investimin e tij nëse do ta rekomandonte apo jo Shqipërinë si destinacion për të investuar. Në fund të intervistës, për të respektuar opinionin dhe mendimin e të intervistuarit, atij i jepet mundësia nëse dëshiron të shtojë komente në lidhje me klimën e biznesit dhe investimeve, ose diçka tjetër që mendon se mund të jenë të dobishme për investimet në Shqipëri.

5.1. Përgjigjet e subjekteve

Ky hulumtim bazohet në përgjigjet e dhëna nga vetë të intervistuarit, të cilët në rastin tonë janë investuesit e huaj në Shqipëri, përfaqësues të firmave të huaja apo persona të tjerë të autorizuar për të qenë pjesë e intervistës. Për këto përgjigje konsiderohen të rëndësishme për karakteristikat e analizës përmbledhëse në lidhje me perceptimet e tyre për situatën në Shqipëri në lidhje me investimet e huaja. U morën në intervistë një kampion prej 30 investuesish të huaja, i cili mbulon afërsisht 1.5% të investimeve aktive të huaja në vend. Në sondazh pati së paku 29 përgjigje të vlefshme për secilën pyetje të sondazhit.


U përcaktuan në mënyrë të qartë nga intervista mbi faktorët kryesorë që kanë ndikuar në vendimet e firmave për të vepruar në tregun shqiptar. Jepen mendime mbi përvojën e tyre në Shqipëri krahasuar me pritshmëritë. Firmat u pyetën në lidhje me numrin e të punësuarve, gjendjen e tregut, mundësitë për kërkim, zhvillim, si dhe pritshmëritë e tyre

për të ardhmen, të cilat në një farë mënyre japin orientime për investimet e huaja në Shqipëri. Rreth 40% (12 të tilla) e firmave të intervistuar gjenden në Tiranë, e lidhur kjo dhe me kushtet reale të vendndodhjes së tyre. Në Elbasan 60% (18 të tilla), kjo për faktin sepse për autorin ka qenë më e lehtë t'i kontaktojë e t'i takojë duke u nisur dhe nga vendbanimi i tij. Investuesit e intervistuar i përkasin kombësive të ndryshme, si: italiane, greke, turke etj. Këta investues ushtrojnë aktivitetin në fusha të ndryshme, si: në telekomunikacion, në energjetikë, në hidrosanitare, transport ajror, punime ndërtimi, realizimi i programeve informatike, tregti me shumicë e produkteve të ndërmjetme, pastrim, heqje të mbeturinave, trajtim të hedhurinave dhe aktivitete të tjera të ngjashme, mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të transportit, institute të bukurisë etj.

Qyteti	Elbasan	Tiranë
Kampioni (numër)	18	12
Përqindja	60%	40%

Tabela 5.1.1 Numri i investuesve të intervistuar, sipas vendit të investimit.


Tabela e mësipërme 5.1.1 tregon numrin e investuesve të intervistuar për këtë studim, si dhe vendin e investimit të tyre, duke pasur parasysh që nga pikëpamja etike e mbledhjes së të dhënave shumë prej tyre nuk duan të bëhen të ditura, të dhënat e tyre, veçse ato që janë në janë publike (për shembull në faqet e internetit).



Grafiku 5.1.1 Vendi ku ushtrojnë aktivitetin investuesit e intervistuar (në numër).

Nga grafiku 5.1.1 shohim që pjesa më e madhe e të intervistuarve është në qytetin e Elbasanit, 18 të tillë, nga 30 gjithsej dhe kjo përveç asaj që u përmend më sipër dhe për shkak se këta investues u treguan të gatshëm në dhënien e përgjigjeve në lidhje me faktorë ndihmues dhe pengues të aktivitetit të tyre duke i dhënë prioritet pyetjeve për aspektet ligjore. Për më tepër, vendin që zënë ato në zhvillimin e IHD-ve, duke parë në këtë mënyrë ndikimin që kanë këto aspekte në ecurinë e një investimi. Në Tiranë u morën në intervistë 12 investues (në disa raste përfaqësues të tyre apo persona të autorizuar për të qenë pjesë e intervistës).

Siç do ta shohim dhe nga të dhënat e tjera, secili nga këta investues ka zgjedhur një fushë të caktuar. Autori i intervistës është kujdesur të përzgjedhë fusha të ndryshme investimi për të parë ndikimin që ka kuadri ligjor në investime të sektorëve të ndryshme. Me sa shohim ka një gamë të gjerë dhe në përmasa të ndryshme të investimeve në Tiranë dhe Elbasan. Disa, janë në bashkëpunim shqiptarë dhe të huaj, por në këtë studim, të tilla raste nuk i kemi marrë parasysh.



Grafiku 5.1.2 Vendi ku ushtrojnë aktivitetin investuesit e intervistuar (në përqindje).

Grafiku 5.1.2 tregon se 60% e studimit empirik, siç është përshkruar më lart, kemi marrë në intervistë, investues të cilët e ushtrojnë aktivitetin në Elbasan dhe 40% në Tiranë. Edhe pse Tirana është kryeqytet dhe numri i investuesve është shumë herë më i madh, i është kushtuar rëndësi, llojeve të ndryshme të bizneseve, jo vendit, pavarësisht se intervista është përqendruar vetëm në këto dy qytete. Investuesve të huaj u jepen mundësi të shumta për të investuar në Shqipëri, duke përmendur këtu pozitën gjeografike që vendi ka e shumë faktorë të tjerë të cilët janë shqyrtuar dhe në kapitujt e

tjerë paraardhës. Firmat për të kryer investim jashtë shtetit të tyre janë nisur nga arsye dhe interesa të ndryshme. Atyre i është dhënë mundësia të marrin vendime me prioritet të ndryshme për të investuar në Shqipëri si për shembull duke përmendur këtu: burimet natyrore, kosto e ulët e punës, aftësia e punonjësve (mjaft të rinj shqiptar janë njohës shumë të mirë të gjuhëve të huaj. Kohët e fundit po shikohet një prirje e hapjes së call center me origjinë italiane në Shqipëri. Ky lloj investimi që po hap mundësi të shumta punësi për të rinjtë ka lidhje pikërisht me faktin se ato janë njohës shumë të mirë të gjuhës italiane) etj.


5.2. Analiza e përgjigjeve të të intervistuarve

Kompanitë e intervistuar rreth kushteve/faktorëve të të bërit biznes në vend janë të mendimit që ka vend për përmirësime të dukshëm në disa drejtime. Le të interpretojmë përgjigjet e të anketuarve me radhë sipas pyetjeve të bëra. Së pari, firmat investuese të huaja janë me kombësi të ndryshme, si: italiane, greke, turke etj., të cilat ushtrojnë aktivitetin në fusha të ndryshme, si: në telekomunikacion, në energjetikë, në hidrosanitare, transport ajror; punime ndërtimi, realizime të programeve informatike, pastrime, heqje të mbeturinave, trajtimi i hedhurinave dhe aktivitete të ngjashme, mirëmbajtje e riparime të mjeteve të transportit automobilistik, institute të bukurisë etj. Tabela e mëposhtme 5.2.1 përfshin informacionin për pjesën e parë të pyetjes, në të cilën kërkohet informacion në lidhje me sektorin ku vepron investuesi i huaj në Shqipëri. Shpesh ndodh që një investues të ketë filial në një vend tjetër, për të zgjeruar veprimtarinë e tij.

Pyetja A1/1. Në cilin sektor vepron kryesisht firma juaj (në prodhimin, tregti apo shërbime)?			
Alternativat	a) Prodhim	b) Tregti	c) Shërbime
Numri i përgjigjeve	9	12	9
Përgjigje në %	30%	40%	30%


Tabela 5.2.1 Sektori ku vepron investuesi i huaj.

Në tabelën e sipërpërmendur jepen të dhënat si në numër ashtu edhe në përqindje në lidhje me sektorin ku vepron kryesisht firma e intervistuar. Shohim qartë se investues të huaj në Shqipëri kanë zgjedhur sektorë të ndryshëm (sikurse dhe u dëshirua në fillim të intervistës). Nga kjo marrim një informacion paraprak se në Shqipëri ka një liri veprimi në lidhje me të bërin biznes pra shteti nuk e sanksionon dhe kufizon llojin e investimit.



Grafiku 5.2.1 Investuesve të huaj sipas sektorit që ushtron aktivitetin (në numër).

Siç e shohim më sipër në tabelën 5.2.1 dhe në grafikun 5.2.1 në Shqipëri investuesit e huaj ushtrojnë aktivitetin e tyre duke shfrytëzuar burimet për prodhim, duke kryer shërbime, dhe në tregti. Nga numri i marrë në intervistë kemi 9 investues të huaj që merren me prodhim, 12 të tillë që merren me tregti dhe 9 investues të huaj që merren me shërbime.



Grafiku 5.2.2. Investuesit e huaj sipas sektorit që ushtrojnë aktivitetin (në përqindje).

Në grafikun 5.2.2 shikojmë se për sa i përket sektorit të ushtrimit të aktivitetit, investuesit e huaj ndahen pothuajse në mënyrë proporcionale. Nga ku 30% e tyre merren me prodhim produktesh dhe në të njëjtën përqindje me shërbime, për shembull dentist, parukiere si dhe 40% me tregti. Pra, siç duket në Shqipëri investuesit e huaj nuk janë kushtëzuar vetëm nga burimet, apo krahu i lirë i punës, por edhe nga shumë faktorë të tjerë, të cilët do të qartësohen më tej deri në fund të intervistës.


Tabela e mëposhtme 5.2.2 jep të dhëna në lidhje me kohën që investuesi i huaj ushtron aktivitetin në Shqipëri. Kjo pyetje synon me faktin nëse kuadri ligjor i rregulluar në vitin 2010, është një faktor për nxitjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri.

Pyetja A1/2. Sa kohë keni që investoni në Shqipëri?			
Alternativat	Më pak se 5 vjet	5-10 vjet	Mbi 10 vjet
Numri i përgjigjeve	6	15	9
Përgjigjet në %	20%	50%	30%

Tabela 5.2.2 Koha që investuesi i huaj ushtron aktivitetin në Shqipëri.


Pra siç shihet në tabelën e mësipërme dhe grafikët e mëposhtëm informacioni i përgjithshëm në pyetjen e parë në lidhje me sektorin ku vepron kryesisht firma.

Kjo është pjesa e dytë e pyetjes së parë dhe ka të bëjë me kohën që firma ka investuar në Shqipëri.



Grafiku 5.2.3 Koha që investuesi i huaj ushtron aktivitetin në Shqipëri (në numër).

Edhe në grafikun 5.2.3 shohim që investuesit e huaj që u intervistuan ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri për kohë të ndryshme. Për sa i përket investuesve të marrë në intervistë 6 të tillë me më pak se 5 vjet, 15 të tillë kanë 5-10 vjet që e ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri.




Grafiku 5.2.4 Koha që investuesi i huaj ushtron aktivitetin në Shqipëri (në përqindje).

Për më tepër, 9 investues të huaj që kanë investuar në Shqipëri kanë mbi 10 vjet që e ushtrojnë aktivitetin e tyre këtu. Për sa u përket të dhënave në grafikun 5.2.4 shohim në përqindje se intervistues të ndryshëm e kanë hapur aktivitetin e tyre në periudha të ndryshme. Për sa u përket të intervistuarve shohim se 20% e tyre e kanë hapur për më pak se 5 vjet, një pjesë e konsiderueshme e tyre 50% e kanë hapur në një periudhë 5 deri 10 vjet më parë, si dhe 30% e të intervistuarve e kanë hapur aktivitetin e tyre që para 10 vitesh e më shumë.

Tabela e mëposhtme 5.2.3 tregon vlerën e kapitalit të investuar nga investuesi në Shqipëri. Në lidhje me investuesit e intervistuar, studimi më tepër ka qenë i fokusuar tek investuesit që kanë investuar një kapital të lartë dhe minimal në Shqipëri.


Pyetja A2. Si e gjykoni kapitalin që ju keni investuar (shumë të lartë, të lartë, apo minimal)?			
Alternativat	a) shumë të lartë	b) të lartë	c) minimal
Numri i përgjigjeve	7	14	9
% e investuesve sipas sasisë të kapitalit	20.1%	47.6%	23.3%

Tabela 5.2.3 Kapitali i investuar nga investuesit e huaj.



Grafiku 5.2.5 Kapitali i investuar nga investuesit e huaj (në numër).

Grafiku i mësipërm 5.2.5 tregon numrin e përgjigjeve të investuesve sipas vlerës së kapitalit të investuar në Shqipëri dhe në rastin e të investuarve tanë, kemi 7 investues të cilët kanë investuar një kapital shumë të lartë, të lartë 14 të tillë që kanë investuar kapital të lartë si dhe 9 të cilët kanë një investim minimal dhe kjo mendohet sepse në rastin e shërbimeve nuk është e nevojshme për një kapital të lartë.




Grafiku 5.2.6 Kapitali i investuar nga investuesit e huaj (në përqindje).

Grafiku i mësipërm 5.2.6 tregon përgjigjet e të intervistuesve sipas vlerës së kapitalit të investuar në Shqipëri por tashmë në përqindje dhe në rastin e të investuarve tanë, shohim se 20.1% e investuesve kanë investuar një kapital shumë të lartë, investim të lartë ka përqindje 47,6% dhe që kanë investuar kapital minimal shohim vlerën 23.3% të të intervistuarve.

Pyetja A3. A ka qenë favorizues kuadri ligjor në fillimet e investimit tuaj?			
Alternativat	a) Po	b) Jo	c) Disi
Numri i investuesve	6	15	9
% e përgjigjeve për kuadrin ligjor	20%	50%	30%


Tabela 5.2.4 Favorizimi i kuadrit ligjor në fillim të investimit.

Në tabelën e mësipërme 5.2.4 pyetja e tretë e pjesës së parë kërkon informacion për sa i përket kuadrin ligjor sa sa ka qenë ai favorizues në fillim të investimit. Siç e shohim në faktin se investime të ndryshme janë hapur në kohë të ndryshme në Shqipëri, pohojmë se dy janë moment të rëndësishme për sa i përket legjislacionit vendas, viti 1993 dhe 2010, dhe po të shohim nga të dhëna të tjera tek koha e nisjes së veprimtarisë, vërejmë që investues të huaj e kanë shfrytëzuar këtë favor ligjor për të investuar. Nga të dhënat e grafikut të mëposhtëm 5.2.7 në lidhje nëse kuadri ligjor ka qenë favorizues në fillim të investimit, shohim se jo të gjithë investuesit janë pro këtij fakti.



Grafiku 5.2.7 Favorizimi i kuadrit ligjor në fillim të investimit (në numër).

Pra, siç u përmend dhe më lart vetëm ata investues që kanë hapur veprimtarinë pas vitit 2010 janë të kënaqur me kuadrin ligjor. Nga ana tjetër mund të pohojmë se investuesit e huaj shprehen se baza ligjore në Shqipëri ekziston (pra, kuadri ligjor është i plotësuar), por zbatimi i saj ashtu si duhet lë për të dëshiruar.



Grafiku 5.2.8 Favorizimi i kuadrit ligjor në fillim të investimit (në përqindje).


Pra nga grafiku 5.2.8 tregohet se 20% e investuesve të huaj janë pro legjislacionit favorizues, 50% e të intervistuarve nuk mendojnë se kuadri ligjor ka qenë favorizues për ta duke marrë parasysh këtu dhe kushtet e konkurrencës me ata në vend, dhe 30% e të intervistuarve mendojnë se kuadri ligjor nuk i ka ndihmuar fare ato në fillimet e investimit. Kjo tregon se për ato nuk ka qenë legjislacioni në fuqi në fillimet e investimit të tyre ai që i ka shtyrë për të investuar, duke pasur motivacion nga faktorë të tjerë të përmendur më poshtë.

Tabela e mëposhtme e pjesës së parë, 5.2.5 tregon se cili është numri i personave të punësuar, në aktivitetet e marra në studim.

Pyetja A4. Sa është numri i personave që keni punësuar?			
Alternativat	5-50	51-100	më shumë se 101
Numri i personave të punësuar	13	14	3
% e personave të punësuar	47%	43%	10%


Tabela 5.2.5 Numri i personave të punësuar.

Duke iu referuar dhe pyetjeve të tjera, si për shembull asaj në lidhje me kapitalin apo llojin e veprimtarisë, shohim se më tepër investues të intervistuar kanë punësuar 5-50 punonjës.



Grafiku 5.2.9 Numri i personave të punësuar (në numër).

Grafiku 5.2.9 tregon se 13 investues kanë të punësuar 5 deri 50 punonjës, 14 investues të intervistuar kanë punësuar 51-101 dhe 3 investues kanë punësuar më shumë se 101 punonjës në aktivitetin e tyre. Por kuptohet që investuesit e huaj në fillim hapin një aktivitet në përmasa vlerësimi të biznesit të tyre, më pas pasi fitojnë pozicionin e tyre konkurrues në treg rrisin, zgjerojnë aktivitetin e tyre duke rritur dhe numrin e punonjësve dhe duke iu referuar dhe pjesës së dytë të pyetjes së parë kuptohet pse janë këto të dhënat pasi pjesa më e madhe e të intervistuarve kishin 5-10 vjet që ushtronin aktivitetin.



Grafiku 5.2.10 Numri i personave të punësuar (në përqindje).

Grafiku 5.2.10 tregon se përqindja më e madhe e investuesve në rastin tonë, 47% kanë 5 deri 50 të punësuar, 43% e investuesve kanë të punësuar 51 deri 100 të punësuar, dhe vetëm 10% e investuesve të huaj të marrë në intervistë kanë të punësuar më shumë se 101 persona.

Tabela e mëposhtme 5.2.6 i referohet pyetjes së pestë dhe të fundit për pjesën e parë që ka të bëjë me vlerësimin e karakteristikave për kompaninë, duke renditur 5 më kryesoret.

Pyetja A5. Vlerëso karakteristikat e mëposhtme për nga rëndësia që ato kanë në ecurinë e aktivitetit tuaj (listo 5 më kryesoret):	
1	Liria në të bërit biznes
2	Stabiliteti politik dhe ekonomik
3	Kostoja e lëndës së parë
4	Niveli i ulët i burokracisë
5	Kualifikimi i punonjësve, cilësia e arsimit profesional; disponueshmëria e fuqisë punëtore; korrektësia në punë

Tabela 5.2.6 Karakteristikat më të rëndësishme për ecurinë e aktivitetit.

Siç e shohim nga 7 karakteristika që iu përmendën investuesve të huaj të intervistuar, ata u shprehën kryesisht se në ecurinë e aktivitetit të tyre ka pasur më shumë rëndësi liria e të bërit biznes që vendi ynë ofron, të dytën kanë renditur stabilitetin politik dhe ekonomik. Siç është trajtuar dhe në kapitujt paraardhës, vendi ynë ka ruajtur një stabilitet ekonomik dhe përgjatë krizës ekonomike globale. Shikohet që ky faktor nuk ka kaluar pa u vërejtur nga investuesit e huaj. Në vendin e tretë renditet kosto e lëndës së parë që ofrohet në Shqipëri. Në të katërtin investitorët kanë renditur nivelin e ulët të burokracisë në vend. Pra shikohet që opinion i tyre e karakterizon Shqipërinë si një vend me burokraci të ulët. Dhe në fund, nga alternativat e dhënë ato kanë përzgjedhur kualifikimin e punonjësve duke futur këtu: cilësia e arsimit profesional; disponueshmëria e fuqisë punëtore; korrektësia në punë. Ky është një faktor mjaft i rëndësishëm pasi dhe nga të dhënat e tjera që janë marrë gjatë gjithë këtij hulumtimi është vërejtur se për investues në vende të ndryshme të botës ky faktor listohet si përcaktues në ecurinë e investimit.

Në lidhje me pjesën e dytë, B, kërkohet një informacion më i detajuar për investuesin, por duke u përqendruar sikurse është thënë dhe më sipër në rëndësinë e kuadrit ligjor në

Shqipëri. Mjedis i biznesit është një tjetër faktor i rëndësishëm që ndikon në vendimmarrjen e investitorëve të huaj, por ende në vendin tonë nuk mund të flitet për mjedis biznesi të favorshëm. Për të krijuar një klimë më të mirë për investitorët e huaj janë ndjekur një sërë politikash dhe janë marrë një sërë masash. Regjistrimi i biznesit, transparenca në prokurimet publike, reformat tatimore, politikat tregtare, reformat rregulluese për përmirësimin e transparencës janë disa nga masat që janë kryer për përmirësimin e mjedisit të investimeve.

Me gjithë përmirësimet e kryera, ende ka vend për përmirësimin e klimës favorizuese për IHD-të në Shqipëri. Një përqindje e madhe e të intervistuarve (60%) besojnë se vendi është i rëndësishëm në realizimin e si një mënyrë për një avantazh të qëndrueshëm konkurrues.

Është e rëndësishme që produkti të jetë në dispozicion, kjo duke u bazuar në përgjigjet, mund të arrihet në përfundimin se krijon një avantazh të IHD-ve. Kjo është e rëndësishme pasi mund të dalim në përfundimin se të gjitha këto faktorë kanë një ndikim mbi njëri-tjetrin kur merret në konsideratë fakti se këmbimi mund të krijojë një avantazh konkurrues të qëndrueshëm. Faktorët e lidhur me fuqinë punëtore dhe koston, sigurimin e lejes së qëndrimit e ndërtimit, si dhe lehtësinë për t'u regjistruar dhe për të filluar veprimtarinë kanë dalë pothuajse njëllor sikurse ishin pritshmëritë, herë-herë edhe më mirë.


Pyetja e parë e pjesës së dytë ka të bëjë me informacionin se cila qenë arsyeja kryesore që ka ndikuar te investuesi për të për të investuar në Shqipëri. Duke vënë në listë disa alternativa të intervistuarit i jepet mundësia të shprehë opinionin e tij, madje dhe duke e konkretizuar atë. Ndoshta primare për investuesin kanë qenë marrëveshjet ndërkombëtare, apo politikat qeveritare e kështu me radhë. Kështu duke iu referuar tabelës së mëposhtme 5.2.7 në lidhje me karakteristikat nxitëse, të intervistuarit përmendën: marrëveshjet ndërkombëtare, sistemi bankar, politikat e qëndrueshme monetare dhe fiskale, infrastruktura, koston, politikat qeveritare, stabilitetin ekonomik, vendndodhjen gjeografike, burimet natyrore etj.

Pyetja B1. Cila ka qenë arsyeja që ju ka shtyrë për të investuar në Shqipëri (listo 5 më kryesoret)?	
Alternativat	
Marrëveshjet, konventat, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.	35%
Sistemi bankar	39%
Politika e qëndrueshme monetare dhe fiskale	37%
Infrastruktura	32%
Puna: cilësia e arsimit profesional; disponueshmëria e fuqisë punëtore; korrektësia në punë; kostot e pagave	30%
Politikat dhe nismat qeveritare	42%
Stabiliteti ekonomik	39%
Vendndodhja gjeografike, burimet natyrore	33%

Tabela 5.2.7 Tiparet kryesore të nxitjes së investuesve të huaj.

Në grafikun e mëposhtëm 5.2.11 janë renditur sipas përmbledhjes sasiore duke parë që rëndësi i kushtojnë investuesit e huaj nëse Shqipëria është pjesë e marrëveshjeve ndërkombëtare (35%), sepse kjo tregon se si një vend kandidat i Europës po ndjek praktika pozitive nxitëse si të vendeve të tjera të saj tashmë zhvilluara, duke përafëruar dhe legjislacionin me to.

Sistemi bankar (39%), fakti që bankat operojnë, nuk falimentojnë do të thotë që ekonomia me treguesit e saj është në lëvizje duke siguruar politika të qëndrueshme monetare dhe fiskale (37%). Një pikë tjetër e rëndësishme për zhvillimin e investimeve është infrastruktura (32%), gjithashtu nuk është lënë pa përmendur puna, aftësitë profesionale, niveli arsimor, kostot (30%), stabiliteti ekonomik (39%) dhe vendndodhja gjeografike e burimet natyrore (39%).



Grafiku 5.2.11 Tiparet kryesore të nxitjes së investuesve të huaja.

Një nga pyetjet e cila krahason gjendjen e klimës së përthithjes së investimeve të huaja të dekadës së fundit të shekullit XX me dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XXI është pyetja e dytë e cila synon për informacion për barrierat kryesore që ka hasur investuesi në fillim të investimit duke listuar 5 alternativat më kryesore si për shembull: korrupsioni dhe nepotizmi; kualifikimi i punonjësve; stabiliteti ekonomik dhe politik; vlera e tarifave të taksave dhe doganave; infrastruktura etj.

Të njëjtët faktorë u analizuan duke matur përvojën me pritshmëritë e firmës përpara se të investonte, që është edhe një tregues i studimit të mirë të tregut nga ana e tyre. Gjithashtu, firmat u pyetën nëse ishin përfshirë në kërkime dhe në zhvillime, në studimin e tregut për të ardhmen, për rritjen apo uljen e xhiros dhe të pjesës së tregut, për pritshmëritë e tyre për tre vitet e ardhshme, si dhe për të dhëna përshkruese që kanë lidhje me kuadrin ligjor, veprimtarinë e firmës, kombësinë e firmës mëmë, vitin e themelimit në Shqipëri etj.


Paqëndrueshmëria e politikat, konfliktet e pazgjidhura të pronësisë së tokës, korrupsioni i lartë etj. janë faktorë që ndikojnë negativisht në imazhin e një vendi për të tërhequr investime të huaja, që do të thotë se krahasuar me analizën e faktorëve të pozitës gjeografike, burimeve natyrore, infrastrukturës dhe hyrja në treg lehtë, vihet re që lidhjet e këtyre faktorëve me flukset e IHD-ve janë të kundërta. Kjo do të thotë se pavarësisht se burimet natyrore dhe pozicioni gjeografik i Shqipërisë janë mjaft tërheqës për investitorët e huaj, infrastruktura e dobët bëhet shpesh pengesë.

Tabela e mëposhtme 5.2.8 liston se cilat kanë qenë barrierat kryesore për investuesit në fillimet e aktivitetit të tyre.

Nr.	Pyetja B2. Cilat ishin barrierat kryesore që keni hasur në fillim të investimit (listo 5 më kryesoret, nga 1 në 5)?	
	Alternativat	
1	Korrupsioni dhe nepotizmi	40%
2	Kualifikimi i punonjësve	30%
3	Stabiliteti ekonomik dhe politik	40%
4	Vlera e tarifave të taksave dhe doganave	23%
5	Infrastruktura	20%

Tabela 5.2.8 Barrierat kryesore në fillim të investimit.

Tabela 5.2.8 tregon se pikë së pari kuadri ligjor është ai që duhet të mbrojë investuesit, që në rastrin më të keq duke qenë të huaj nuk e njohin mirë terrenin për të bërë një investim në këtë mënyrë bëhen pre e korrupsionit, si dhe në raste konfliktesh, ligji është ai, për më tepër zbatueshmëria e tij, sjell tek investuesit sigurinë.



Grafiku 5.2.12 Barrierat kryesore në fillim të investimit.

Megjithatë nuk mund të lëmë pa përmendur dhe faktorë të tjerë pengues si kualifikimi i punonjësve, stabiliteti ekonomik dhe politik (për shembull pasiguria e krijuar në vitin 1997 për shkak të firmave piramidale), detyrimet tatimore, dhe infrastruktura. Kjo e fundit shpesh herë është bërë pengesë për investimet e huaja por nga ana tjetër shumë

herë ka qenë objekt i tyre. Pasi ndërtimi i shumë rrugëve është realizuar nga investitorë të huaj. Ndaj dhe për disa investues infrastruktura ka qenë pikënisje e investimeve të tyre në Shqipëri.

Siç mund të shohim nga tabela 5.2.9 jepen mendime dhe opinione nga investuesit e huaj nëse po zbatohen praktika të mira në pesë vitet e fundit për të përmirësuar klimën e biznesit në Shqipëri.


Pyetja B 3. A po zbatohen praktika të mira në pesë vitet e fundit për të përmirësuar klimën e biznesit (në rastin tuaj)?			
Alternativat	Po	Disi	Jo
Numri i investuesve	7	16	7
% investuesve	21.5%	57%	21.5%

Tabela 5.2.9 Zbatimi i praktika të mira në 5 vitet e fundit.

Siç duket në tabelën 5.2.9 ka një përpjesëtim të barabartë të investuesve që pohojnë se nuk ka praktika të mira në Shqipëri dhe atyre që pohojnë se ka. Ndoshta kjo vjen nga perceptimi i investuesve të huaj dhe nga eksperiencat e ndryshme që ato kanë pasur gjatë investimeve të tyre. Kjo pasi ecuria e një aktiviteti fitim prurës nuk varet vetëm nga faktorët e jashtëm por dhe nga ato të brendshëm. Disi aktiviteti mund të mos kenë pasur ecuri të kënaqshme dhe kjo gjë i atribuohet vendit pritës dhe pse mund të ketë ardhur dhe falë keqmenaxhimit që ka bërë vetë investuesi. Por ka dhe faktorë të jashtëm që kanë ndikim negativ duke përmendur këtu taksën progresive, pasi për një biznes që i rriten fitimet dhe njëkohësisht i rriten dhe detyrimet duke u tatuar në varësi të përqindjes së fitimeve, kjo gjë nuk pritët mirë. Prandaj ndoshta kjo nuk pritët s praktikë e mirë edhe pse ndoshta është e drejtë që ai që fiton më shumë duhet të tatohet më shumë.

Më poshtë janë dhënë grafikët 5.2.13 dhe 5.2.14 në lidhje me pyetjen e tretë të pjesës B, ku relativisht u shprehën vlerësime disi pozitive për lehtësimin e fillimit të procedurave të biznesit, të sigurimit të lejeve të punës dhe të rregullores së punësimit, sepse Shqipëria ka bërë progres në shumë fusha të ndryshme gjatë këtyre viteve, megjithatë ende ka shumë për të bërë. Gjithsesi ato që sot shihen si sfida për ekonominë e vendit tonë, duhet medoemos të kthehen në përparësi për të ardhmen prandaj nëse në grafikun


e mëposhtëm shohim se 7 investues mohojnë faktin se ka praktika të mira, në të ardhmen kjo duhet të jetë anasjelltas.



Grafiku 5.2.13. Zbatimi i praktika të mira në 5 vitet e fundit (në numër).

Parashikimet për ekonominë shqiptare në krahasim me vitin e kaluar paraqesin përmirësim, ose duhet të presin përmirësime. Në grafikun 5.2.13 praktika të mira në 5 vitet e fundit intervistuesit pohojnë 21.5% të tyre, 57% deklarojnë se janë disi dakord dhe 21.5% mendojnë se jo.

Kjo ka të bëjë me mendimin që ka investuesi për praktikën që po ndiqen në Shqipëri në pesë vitet e fundit për të përmirësuar klimën e biznesit, për të bërë të mundshme tërheqjen e investitorëve të huaj. Forcimi dhe zbatimi i ligjit, sigurimin e titujve të pronësisë, zvogëlimi i shkallës së korrupsionit, rregullimi i lejeve të ndërtimit, zbatimi i kontratave janë disa nga problemet që shihen si pengesa kyçe nga investuesit e huaj.




Grafiku 5.2.14. Zbatimi i praktika të mira në 5 vitet e fundit (në përqindje).

Tabela e mëposhtme, 5.2.10 ndërtohet për të marrë informacion se sa këta investues janë të informuar në lidhje me ndryshimet që ka pësuar kuadri ligjor. Duke iu kërkuar

atyre nëse kishin dijeni për ndonjë ligj, udhëzim apo VKM të miratuar së fundmi, i cili ka pasur ndikim pozitiv në rritjen e aktivitetit të tyre.


Pyetja B 4. A jeni të informuar për ndonjë ligj, udhëzim apo VKM të miratuar së fundmi që po ndikon në rritjen e investimit tuaj?			
Alternativat	Po	Jo	Nuk e di
Numri i investuesve	9	12	9
Përqindja investuesve	30%	40%	30%

Tabela 5.2.10 Ndikimi i kuadrit ligjor (i miratuar së fundmi).



Grafiku 5.2.15 Ndikimi i kuadrit ligjor (i miratuar së fundmi) (në numër).

Siç e shikojmë dhe në përgjigjet e investuesve, 9 prej tyre pohojnë se njohin, apo kanë dijeni rreth kuadrit ligjor të miratuar së fundmi i cili ka ndikim pozitiv në investime. Por nga ana tjetër 9 të tillë nuk kanë dijeni rreth tij. Ndërsa 12 investues mohojnë një fakt të tillë. Grafiku i mëposhtëm 5.2.16 tregon se 30% e investuesve në të vërtetë kanë dijeni për ndryshimet që ndodhin në legjislacion të cilat kanë ndikim dhe në veprimtarinë e tyre. Si dhe 40% janë përgjigjur jo dhe 30% tjetër janë indiferentë rreth këtij fakti duke deklaruar se nuk kanë dijeni për diçka të tillë.




Grafiku 5.2.16 Ndikimi i kuadrit ligjor (i miratuar së fundmi) (përqindje).

Pyetja e pestë e paraqitur në tabelën 5.2.11 ka të bëjë me ecurinë e investimit të huaj në Shqipëri, dhe konkretisht u referohet të ardhurave të përfituara nga ky investim. Të intervistuarve i është kërkuar informacion nëse të ardhurat vjetore që përfitojnë nga investimi janë në rritje, në ulje, apo kanë ngelur të pandryshueshme ndër vite. Një përmbledhje e gjetjeve është paraqitur më poshtë që rezulton në nivele jo të larta në lidhje me fitimet.


Pyetja B5. Të ardhurat vjetore që përfitoni nga ky investim i konsideroni në rritje, në ulje apo të pandryshueshme?			
Alternativat	Në rritje	Në të njëjtin nivel	Në ulje
Numri i investuesve	6	12	12
Përqindja e investuesve	20%	40%	40%

Tabela 5.2.11 Të ardhurat vjetore.



Grafiku 5.2.17 Të ardhurat vjetore (në numër).

Për sa u përket përfitimeve të vitit të fundit që është kryer intervista, krahasuar me ato të një viti më parë, të intervistuarit shprehen se këto të ardhura kanë ardhur në ulje. 40 % e të intervistuarve raportojnë se këto të ardhura për vitin 2015 nuk ndryshojnë. Ndërsa kuota e investuesve që kanë në rritje fitimet e tyre për vitin 2015 është relativisht e vogël siç e shohim dhe nga tabela e grafikët 5.2.17 dhe 5.2.18 e që vetëm 6 prej tyre janë përgjigjur me po.




Grafiku 5.2.18 Të ardhurat vjetore (në përqindje).

Në pyetjen e gjashtë kërkohet informacion për burimet financiare që ka përdorur investuesi, për hapjen e aktivitetit të tij në Shqipëri. Pyetja B.6 kërkon të marrë informacion për llojet e kapitalit të përdorur. Gjatë intervistës u vu re se në lidhje me këtë pyetje të intervistuarit ishin pak më të rezervuar gjatë momentit të dhënies së përgjigjes. Dhe për të respektuar të drejtat e tyre iu tha se nëse dëshironin këtë pyetje mund ta kalonin. Megjithatë ato edhe pse pak skeptikë, vendosën të japin përgjigjet e tyre.


Pyetja B 6. Cilat nga burimet financiare ka përdorur kompania juaj për të investuar?				
Alternativat	Aksione	Kursime	Hua	Të tjera
Numri i investuesve	5	5	8	12
Përqindja e investuesve	16.5%	16.5%	27%	40%

Tabela 5.2.12 Burimet financiare të investimit.



Grafiku 5.2.19 Burimet financiare të investimit (në numër).

Siç e shohim dhe në grafikun 5.2.19 ajo që u tha më sipër është pasqyruar dhe në përqindje më të lartë në krahasim me përgjigjet e tjera, që do të thotë se 12 investues nuk parapëlqejnë të japin deklarata rreth kapitalit të investuar.




Grafiku 5.2.20 Burimet financiare të investimit (në përqindje).

Treguesit janë të lidhur me njëri-tjetrin, që do të thotë se nuk është e lehtë të zgjerosh aktivitetin, nëse nuk njeh situata financiare e firmës është në rritje dhe pritshmëritë për të ardhmen po ashtu. Për të marrë këtë informacion dhe për të kuptuar nëse investuesit kanë qëllim të hapin vende të reja pune i referohemi pyetjes B7 duke iu kërkuar të intervistuarve nëse kanë në plan të hapin vende të reja pune në tre vitet e ardhshme. Kjo pyetje, edhe pse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me temën ka një rëndësi të madhe shoqërore, pasi ndikon në uljen e papunësi në vend. Pyetja B7 është pyetje e mbyllur dhe e aplikuar në tri shkallë.


Pyetja B7. A ka në plan kompania juaj të hapë vende të reja pune në tri vitet e ardhshme? Nëse po, sa (1-10; 11-50; më shumë se 50)?			
Alternativat	1-10	16-50	Më shumë se 50
Numri i punonjësve që mund të shtohen në tre vitet e ardhshme	6	15	9
Përqindja e punonjësve që mund të shtohen në tre vitet e ardhshme	20%	50%	30%

Tabela 5.2.13 Numri i punonjësve që mund të shtohen në tri vitet e ardhshme.



Grafiku 5.2.21 Numri i punonjësve që mund të shtohen në tre vitet e ardhshme (në numër).

Siç e shohim nga grafikët 5.2.21 dhe 5.2.22 për të hapur vende pune, pra për të zgjeruar aktivitetin kanë parashikuar, 6 investues, në rastin tonë 20% e të intervistuarve, 15 investues, pra 50% e të intervistuarve si dhe 9, që përbëjnë 30% të të intervistuarve.



Grafiku 5.2.22 Numri i punonjësve që mund të shtohen në tre vitet e ardhshme (në %).


Tabela e mëposhtme do të na japin të dhëna në lidhje me pyetjen e tetë të pjesës B. Pyetje kjo e cila ka lidhje dhe me pyetjen B 7 pasi është situata ekonomike ajo që në një farë mënyre a në tjetrën ndikon dhe në të ardhurat e investimeve e më pas dhe në zgjerimin e aktivitetit.

Pyetja B8. Si e vlerësoni situatën aktuale ekonomike në Shqipëri?			
Alternativa	Të qëndrueshme	Disi të qëndrueshme	Të paqëndrueshme
Numri i përgjigjeve	21	6	3
Përqindja e përgjigjeve	70%	20%	10%

Tabela 5.2.14 Vlerësimi i situatës ekonomike aktuale në Shqipëri.

Mendime të tjera të investuesve të huaj janë prosperiteti ekonomik dhe investimet vazhdojnë të pengohen nga mungesa e besimit në sistemin gjyqësor, burokracia dhe korrupsioni i administratës së doganave dhe tatim-taksave dhe çështje të tjera administrative që kanë të bëjnë me biznesin, si ndalesat e furnizimit me energji elektrike, infrastruktura e dobët dhe ekzistenca e një niveli të lartë të ekonomisë informale, dobësojnë në mënyrë të konsiderueshme investimet, rrisin kostot e bizneseve dhe pengojnë në këtë mënyrë zhvillimin e biznesit.


Firmat mund të diversifikojnë rrezikun e tyre të huaj duke investuar në shumë vende të ndryshme të huaja, por kjo kërkon ndërmarrjen e investimeve që nuk mund të kenë një vlerë aktuale neto pozitive. Së fundi, vendimet e financimit në nivel filiali mund të jenë për të ndarë rrezikun me investitorët vendas.



Grafiku 5.2.23 Vlerësimi i situatës ekonomike aktuale e huaj në Shqipëri (në numër).

Siç e shohim nga përgjigjet e dhëna nga tabela dhe në grafikët 5.2.23 dhe 5.2.24 ka opinione të ndryshme nga të intervistuarit rreth vlerësimi i situatës aktuale ekonomike të vendit. Në lidhje me perceptimin e investuesve si një situatë e qëndrueshme në Shqipëri japin përgjigje pozitive 21 investues të cilët janë të kënaqur në lidhje me ndryshimet e fundit. Në lidhje me përgjigjen disi të qëndrueshme u përgjigjën 6 të tillë dhe vetëm 3 janë të mendimit se situata është e paqëndrueshme.

Kjo korrespondon saktësisht me faktin se 70% janë për një situatë të qëndrueshme, 20% janë disi të qëndrueshëm dhe vetëm 10% mendojnë se situata në Shqipëri për investimet e huaja është e paqëndrueshme.



Grafiku 5.2.24 Vlerësimi i situatës ekonomike aktuale e huaj në Shqipëri (në përqindje).


Një rëndësi të konsiderueshme për një biznes ka dhe fusha e shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit dhe në rastin tonë tatimet, gjë që është e lidhur dhe me burokracitë që

shpesh i japin trysninë e vet investuesve, pikërisht këtë informacion do të marrim nga investuesit e huaj në pyetjen e nëntë.

Qëllimi i pyetjes B 9. është për të testuar opinionin e të intervistuarve në lidhje me detyrimet tatimore në Shqipëri. Atyre i është bërë pyetja nëse për to janë të përballueshme taksat e aplikuara në vendin tonë. Përgjigjet e dhëna në këto pyetje kanë dalë jashtë pritshmërisë, pasi momenti i kryerjes së pagesave është një moment i papëlqyer. Megjithatë të intervistuarit janë treguar objektivë në dhënien e kësaj përgjigjeje, duke e vlerësuar këtu Shqipërinë me detyrime tatimore të ulëta.


Pyetja B 9. A janë të përballueshme taksat për ju (Po; Jo)?		
Alternativat	Po	Jo
Numri i përgjigjeve	19	11
Përqindja e përgjigjeve	63%	37%

Tabela 5.2.15 Përballimi i taksave nga investorët e huaj.



Grafiku 5.2.25 Përballimi i taksave nga investorët e huaj (në numër).

Tabela 5.2.15 dhe grafiku 5.2.25 tregon përballimin e taksave nga investorët e huaj. Kjo pyetje e mbyllur tregon me anë të numrit të përgjigjeve se 19 investues arrijnë të përballojnë pagesën e taksave dhe 11 të tjerë japin përgjigje për jo. Nëse do t'i referoheshim përqindjes së përgjigjeve 63% e investuesve të huaj në Elbasan dhe Tiranë deklarojnë se arrijnë t'i përballojnë detyrimet tatimore dhe 37% mendojnë se ato janë të larta për t'u paguar.



Grafiku 5.2.26 Përballimi i taksave nga investitorët e huaj (në përqindje).

Një pjesë e vështirë për një biznesin është dhe ai i bashkëpunimit me të tjerët. Për shembull, furnizimi më lëndë të parë, shpërndarësit, e tjerë nuk janë apo janë korrekt në pagesa, gjë që mësohet nga pyetja e njëmbëdhjetë.


Pyetja B 10. A janë korrekt në shlyerjen e pagesave bashkëpunëtorët shqiptarë (Po, Disi, Rrallëherë, Jo)?				
Alternativat	Po	Disi	Rrallëherë	Jo
Numri i përgjigjeve	10	14	3	3
Përqindja e përgjigjeve	33.3%	46,7%	10%	10%

Tabela 5.2.16 Korrektësia e shlyerjes së pagesave.

Pyetja B 10, e cila tregohet dhe në tabelën e mësipërme 5.2.16, i referohet informacionit nëse janë korrekt në shlyerjen e pagesave, debive për shembull bashkëpunëtorët shqiptarë. Për sa i përket përgjigjes 10 të tillë janë dakord duke u shprehur po, 14 investues janë disi dakord, 3 shprehin mendimin se ndodh rrallëherë ka korrektësi nga ana e shqiptarëve në lidhje me pagesat dhe tre investues janë totalisht të pakënaqur në lidhje me shlyerjen e pagesave apo me bashkëpunimin.


Siç e shikojmë dhe nga grafiku i mëposhtëm 5.2.27 në lidhje me përgjigjet e pyetjeve të korrektësisë së shlyerjes së pagesave shohim se pjesa më e madhe e investuesve të huaj

të marrë në intervistë japin përgjigjen se janë disi dakord në lidhje me korrektësinë e shlyerjes së pagesave.



Grafiku 5.2.27 Korrektësia e shlyerjes së pagesave (në numër).

Kjo duket qartë edhe nga përqindja e përgjigjeve në grafikun e mëposhtëm 5.2.28 ku 33.3% janë dakord, 46,7% janë disi dakord për korrektësinë në lidhje me pagesat, ndërsa 10% janë rrallë dakord dhe 10% nuk janë fare dakord me korrektësinë e shlyerjes së pagesave.



Grafiku 5.2.28 Korrektësia e shlyerjes së pagesave (në përqindje).

Pyetja e njëmbëdhjetë kërkon informacion, për progresin në përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon marrëdhënien midis investitorëve të huaj dhe shtetit shqiptar duke pyetur nëse nga ana e ligjvënësit shqiptar është bërë progres në këtë drejtim. Kjo tregohet në tabelën 5.2.17.

Pyetja B 11. Mendoni se vitet e fundit ligjvënësi shqiptar ka bërë progres në përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon marrëdhënien midis investitorëve të huaj dhe shtetit shqiptar?			
Alternativat	Disi	Po	Jo
Numri i përgjigjeve	3	24	3
Përqindja e përgjigjeve	10%	80%	10%


Tabela 5.2.17 Mendimi lidhur me progresin e kuadrit ligjor.



Grafiku 5.2.29 Mendimi lidhur me progresin e kuadrit ligjor (në numër).

Tabela 5.2.17 na paraqet një tregues pozitiv. Pasi 24 nga 30 të intervistuar mendojnë se vitet e fundit është bërë përmirësuar kuadri ligjor që nxit investimet pra, rregullon marrëdhënien midis investitorëve të huaj dhe shtetit shqiptar. Pjesa tjetër është e opinionit është ndarë në mes ku 3 prej tyre mendojnë që jo dhe 3 të tjerë shprehen disi.

Në lidhje me përqindjen e përgjigjeve pasqyruar në grafikun 5.2.30, 80% pohojnë se Shqipëria ka bërë progres, 10% mendojnë se kjo nuk është e konsiderueshme dhe 10% e mbetur mendojnë disi.




Grafiku 5.2.30 Mendimi lidhur me progresin e kuadrit ligjor (në përqindje).

Pyetja e dymbëdhjetë nxjerr në pah transparencën e sistemit tatimor shqiptar. Kjo është pasqyruar në tabelën e mëposhtme 5.2.18.

PyetjaB12. A është mendoni se sistemi tatimor në Shqipëri është transparent (Disi, Po, Jo)?			
Alternativat	Disi	Po	Jo
Numri i përgjigjeve	9	21	0
Përqindja e përgjigjeve	30%	70%	0%


Tabela 5.2.18 Transparenca e sistemit tatimor në Shqipëri.

Duke iu referuar shikojmë se investues janë të ndërgjegjshëm në lidhje me faktin se ky sistem tani nëpërmjet një sistem kompjuterik i cili është dhe online, lehtësisht i aksesueshëm, që do të thotë një nivel i papërfillshëm gabimi apo korrupsioni. Këtë e kanë konfirmuar 21 nga 30 të intervistuar.



Grafiku 5.2.31 Transparenca e sistemit tatimor në Shqipëri (në numër).

Grafiku i mëposhtëm 5.2.32 tregon transparencën në përqindje të sistemit tatimor shqiptar ku 70% e të intervistuarve mendojnë se ky sistem është transparent dhe 30 % e tyre mendojnë që jo.




Grafiku 5.2.32 Transparenca e sistemit tatimor në Shqipëri (në përqindje).

Pyetja e trembëdhjetë iu referohet sërish aspekteve ligjore. Të intervistuarve i është kërkuar të shprehen se si ato e konsiderojnë sigurinë ligjore në Shqipëri. Sikurse është thënë dhe në fillim të punimit ajo që i përcjellë më shumë siguri e garanci investuesve të huaj në një vend tjetër për kryerjen e aktivitetit të tyre janë aspektet ligjore.

Pyetja B13. Si do ta konsideroni sigurinë ligjore në Shqipëri? (disi e mirë, e moderuar, e mirë, shumë e mirë.)				
Alternativat	Disi e mirë	E moderuar	E mirë	Shumë e mirë
Numri i përgjigjeve	3	24	3	0
Masa e sigurisë ligjore në %	10%	80%	10%	0%


Tabela 5.2.19 Sigurisë ligjore në Shqipëri.



Grafiku 5.2.33 Sigurisë ligjore në Shqipëri (në numër).

Sigurinë ligjore mund të themi se përfshin një gamë të gjerë çështjesh dhe ka lidhje me bashkëveprimin e një sërë institucionesh. Një shtet që të ketë siguri ligjore nuk mjaftohet vetëm nga normat që ka në fuqi, por duhet me doemos dhe respektimi i tyre. Gangrenë në vendin tonë prej vitesh ka qenë korrupsioni dhe një nga arsyet e ekzistencës së këtij fenomeni është dhe mosdenoncimi i tij. Fatkeqësisht shumë investues në një farë mënyre a në tjetrën kanë rënë pre e tij.

Nga kjo pyetje e bërë shikojmë në tabelën 5.2.19 e në grafikët 5.2.33 dhe 5.2.34, se nga 30 të intervistuar 24 prej tyre pra 80% mendojnë se në Shqipëri ka masë të mirë të sigurisë ligjore. Dhe ky është një fakt i pëlqyeshëm pasi tregon se institucionet që duhet ta ofrojnë atë funksionojnë. Opinioni tjetër është ndarë në disi e mirë me 3 përgjigje pra 10% dhe e mirë po më 3 përgjigje 10%. Por fatkeqësisht asnjë nga të intervistuarit nuk e konsideron sigurinë ligjore në Shqipëri shumë të mirë.




Grafiku 5.2.34 Sigurisë ligjore në Shqipëri (në përqindje).

Pyetja e fundit ajo e katërmbëdhjeta, duke bërë krahasimin e Shqipërisë së djeshme dhe të sotme, iu kërkon të intervistuarve të shprehin nëse e konsiderojnë vendin tonë si një vend të duhur për investime, kjo duke u nisur nga përvoja që ato kanë pasur në vendin tonë. Qëllimisht është përfshirë kjo pyetje në këtë intervistë pasi gjatë pjesëve të tjera të hulumtimit është mësuar se shumë investime nisin dhe nga rekomandimet e nga eksperiencia e atyre që kanë investuar më parë në një vend të caktuar.


Pyetja B14. Nga eksperiencia që keni në investimin tuaj, a do ta rekomandonit Shqipërinë si një destinacion për të investuar?			
Alternativat	Po	Jo	Ndoshta
Numri i përgjigjeve	16	6	8
Përqindja e përgjigjeve	53.3%	20%	26.7%

Tabela 5.2.20 Rekomandim i Shqipërisë për investim.



Grafiku 5.2.35 Rekomandim i Shqipërisë për investim (në numër).

Siç duket nga pyetja B 14 nëse do ta rekomandonin Shqipërinë si një destinacion për të investuar, nga eksperiencia në investimin e tyre, numri i përgjigjeve është relativisht i kënaqshëm. E thënë kjo pasi nga 30 të intervistuar, 16 prej tyre janë përgjigjur për po. Kjo shërben dhe si një reklamë shumë e mirë që i bëhet vendit. Me jo janë përgjigjur 6 nga të intervistuarit dhe 8 prej tyre ende janë të paqartë e të pasigurt për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje. Kjo pasqyrohet dhe në grafikët e mëposhtëm 5.2.36 dhe e kthyer në përqindje 5.2.37 ku 53.3% për po, 20% e përgjigjeve janë jo dhe 26.7% e përgjigjeve janë ndoshta.



Grafiku 5.2.36 Rekomandim i Shqipërisë për investim (në përqindje).

Në fund të intervistës është lënë hapësirë për të shtuar komente në lidhje me klimën e biznesit dhe investimeve, ose sugjerime për Shqipërinë. Ndër faktorët më me pak rëndësi për firmat, për të investuar ose për t'u zgjeruar në Shqipëri, cilësohen: sigurimi i

zonave të lira ekonomike. Ndër faktorët shumë të rëndësishëm në vendimin e firmave, për të investuar ose për të zgjeruar veprimtarinë e tyre, janë të lidhur kryesisht me sistemin ligjor, me atë të taksave, me ndërveprimin me autoritetet vendase, si dhe me aftësitë profesionale të forcës punëtore. Këta faktorë qëndrojnë në nivel shumë të lartë për pjesën më të madhe të firmave që morën pjesë në studim. Analizimi i faktorëve të njëjtë, për secilën firmë, të cilët krahasojnë përvojën e fituar me pritshmëritë fillestare, nxjerr në dukje se faktorët që janë të lidhur kryesisht me anën ligjore, korrupsionin, qartësinë dhe lehtësirat e krijuara nga aspektet ligjore etj., janë ndër faktorët që nga përvoja tregojnë se kanë dalë në rezultate jo të kënaqshme.

Përpyjekjet për të menaxhuar riskun politik fillojnë përpara se të bëhet investimi, vazhdojnë ndërsa investimi negociohet me qeverinë pritëse, të shtrira gjatë kohës së investimit dhe veprimtarisë dhe të përfunduara disa kohë pasi investimi është likuiduar apo shitur. Por rrezikshmëria që një investues i huaj së pari të shmanget është korrupsioni si abuzim i pushtetit nga ana e zyrtarëve qeveritarë për të përfituar ryshfet nga sektori privat për përfitime personale. Kjo ndodh kur në shumë fusha të procedurave specifike gjatë fillimit dhe zhvillimit të një biznesi ka trajtime të njëanshme, arbitrare dhe kosto të larta duke përfshirë këtu dhe “pagesat jo zyrtare” të shpeshta.

5.3. Diskutime rreth rezultateve të përgjithësuara

Shqipëria është një vend me potenciale të mëdha ekonomike dhe njerëzore, një vend i cili në kohë rekord po bën përpjekje maksimale për një mjedis të sigurt pro biznesit. Me përparësi të mëdha të cilat vërehen gjatë viteve të fundit. Me ritme të shpejta po modernizohet ekonomia dhe po punohet për ndërtimin e një infrastrukture moderne. Po bëhen gjithnjë e më shumë përpjekje për të përafruar legjislacionin e vendit sa më shumë me atë të vendeve të Bashkimit Europian dhe duke qenë pjesë e marrëveshjeve, konventave, traktateve.

Të gjitha këto si dhe në çështjet e diskutuara më lart ndihmojnë në drejtim të bizneseve të suksesshme vendas dhe të huaj.

Sipas mendimeve të investuesve të huaj, Shqipëria sot ofron potenciale të rëndësishme për zhvillimin e bizneseve si rezultat i pozitës së saj gjeografike, aksesit në tregjet rajonale, forcës së kualifikuar punëtore dhe mbi të gjitha shtetit ligjor. Me anë të këtyre informacioneve kuptojmë se shteti shqiptar ka ndërmarrë hapa galopantë rreth lehtësive dhe përparësive për të përthithur investime të huaja në Shqipëri vitet e fundit.

Bazuar në sa thamë më sipër në lidhje me faktin, sesa duhet të ndërhyjë shteti në ekonomi është se nuk ka një përcaktim të vetëm dhe të saktë në këtë drejtim, sepse kjo varet nga shumë faktorë si: sistemi politik, pozita dhe shtrirja gjeografike, historiku i konflikteve të pronësisë, marrëdhëniet tregtare, kapaciteti i sektorit privat etj.

Ndër faktorët më ndikues në vendimet e firmave të huaja për të investuar në vendin tonë përmendim: sistemin e taksave, aspektet ligjore, duke përfshirë këtu kryesisht zbatueshmërinë e tyre, stabilitetin politik dhe atë ekonomik, rregullat e punësimit si dhe faktorë të tjerë të lidhur me fuqinë punëtore si koston e punës dhe aftësitë profesionale etj.

Ndër faktorët më me pak të rëndësishëm për të investuar ose për t'u zgjeruar aktivitetin në Shqipëri, cilësohen: sigurimi i zonave të lira ekonomike dhe sigurimi i granteve të trajnimeve, ndërtimi i parqeve industriale, apo sigurimi i shkollimit ndërkombëtar, në shumicën e rasteve.

Kompanitë e huaja në disa raste veprojnë në një fushë të re të tregut shqiptar dhe në të shumtën e rasteve kompanitë hartojnë plane të qarta për të ardhmen, por pjesa më e madhe e tyre kanë parasysh përmirësimin dhe zgjerimin e veprimtarisë që ushtrojnë. Rreth 60% e kompanive të huaja, në mënyrë të vazhdueshme, monitorojnë tregun për mundësi të tjera për zhvillimin dhe zgjerimin e biznesit të tyre. Nga intervista u rezultoi se këto firma nuk planifikojnë të rrisin ndjeshëm numrin e punonjësve për tre vitet e ardhshme.

Ndër problemet më kryesorë që investorët e huaj hasin në Shqipëri mund të përmendim të drejtat e pronësisë mbi tokën (që shpesh ndikon dhe në zgjerimin e aktivitetit), mundësinë për të gjetur burime lokale dhe mundësinë për të gjetur punonjës të kualifikuar dhe të trajnuar sipas aktiviteteve përkatëse që firmat kryejnë.

Në mbyllje të këtij punimi, mund të arrijmë në përfundimin se IHD-të në vendin tonë, falë flukseve hyrëse në rritje, kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen ekonomike të vendit.

Reformat që janë marrë deri tani për heqjen e barrierave administrative kanë qenë mjaft të suksesshme dhe për këtë arsye do të vazhdojnë të merren masa për reduktimin e mëtejshëm të barrierave administrative, në të bërit biznes dhe në investime. Gjithashtu dhe reformat në regjistrimin dhe licencimit të biznesit, të cilat kanë ndikuar në heqjen e barrierave të biznesit dhe reduktimin e kostove të regjistrimit do të vazhdojnë të thellohen në procedurat e licencimit dhe të regjistrimit.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në përthithjen e IHD-ve në vendin tonë analizohen nëpërmjet këndvështrimit nga ana e investitorëve të huaj. Firmat e intervistuar kanë dhënë ndihmesë të vlefshme për mënyrën si e perceptojnë ato mjedisin tonë, për të investuar dhe si ndikojnë faktorët ligjor në planet e tyre afatmesme dhe afatgjata. Shqipëria ka thithur një numër të ndjeshëm të investimeve të huaja direkte, krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe kjo falë përparësive që vendi ynë zotëron dhe politikave qeveritare. Pasi sikurse duket IHD-të zënë një vëmendje të rëndësishme tek politikëbërësit, duke hartuar kështu vazhdimisht strategji për përthithjen e IHD-ve

Reformat e shumta që janë ndërmarrë kanë patur si qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e kushteve të të bërit biznesi në Shqipëri. Klima e biznesit dhe investimeve të çfarëdo shteti, ku liberalizimi i tregut, sistemi tatimor i thjeshtë dhe i drejtë, dialogu midis sektorit privat dhe publik, zhvillimi i infrastrukturës dhe nxitja e investimeve me objektiva të qarta kontribuojnë në vendin pritës.

Duke theksuar se roli i qeverisë nuk është që të menaxhojë ekonominë apo të ndërhyjë në dinamikën e tregut, por të sigurojë një kuadër të nevojshëm për ndërmarrjet, që ato të lulëzojnë nëpërmjet një klime të fuqishme biznesi. Për këtë shteti duhet t'i mëshojë gjithë një e më shumë kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij si mundësi për rritjen IHD-ve.

Përmirësimi i klimës së biznesit dhe investimeve është alternativa më e mirë për zhvillimin ekonomik dhe nëse një qeveria e ka një vullnetin të tillë, ky përmirësim është i arritshëm dhe jo i pamundur.

KAPITULLI VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1. Përfundime

Në këtë kapitull të fundit do të ndalemi në dy çështje: në përfundimet e nxjerra nga hulumtimi i aspekteve ligjore të IHD-ve në Shqipëri; dhe në rekomandimet përfundimtare të cilat do të ndalen në problematikat kryesore të konstatuara gjatë këtij studimi.

Prania e IHD-ve ka ndikim pozitiv në zhvillimin e një vendi. Në botën e sotme të globalizuar, rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion, varen nga dy faktorë kryesorë: nga zhvillimi i IHD-ve dhe zhvillimi i NVM-ve. Influenca e kësaj dukurie dhe e faktorëve që lidhen me të është mjaft e gjerë ndaj kjo ka çuar dhe në zhvillimin e teorive të ndryshme ndër vite të cilat ndahen në dy grupe kryesore atë të *Teorisë Makroekonomike* dhe atë të *Teorisë Mikroekonomike*, qëllimi i cilave është të shpjegojnë krijimin dhe shfaqjen e ndërmarrjeve shumëkombëshe.

Në Shqipëri, IHD-të kanë qenë dhe janë një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen ekonomike duke ndikuar dhe në zhvillimin e mëtejshëm të të gjithë hallkave të shoqërisë. Kjo pasi ato kanë sjellë avantazhe në uljen e papunësisë, përmirësimin e teknologjive dhe shkëmbimet e eksperiencave si dhe në rritjen e standardeve të jetesës, sjelljen e produkteve të reja, ofrimin e shërbimeve më cilësore. Në vendin tonë prejardhja e tyre kryesisht është nga vendet fqinje pjesë e Bashkimit European, ku kryeson Italia dhe Greqia. Por nuk ngelen pas dhe vende të tjera si Austria, Gjermania, Turqia etj.

Për një vend të vogël si Shqipëri dhe me mbartje të shumë problematikave të krijuara kryesisht nga faktorët politikë, prurjet e IHD-ve ndër vite mund të cilësohen të kënaqshme. Kjo situatë ndoshta lidhet dhe me faktin se vendi është i begatuar me pasuri natyrore të shumta si nafta, gazi natyror, kromi, hekur-nikeli, bakri, qymyri, burimet ujore etj., si dhe me potenciale të mëdha ekonomike dhe njerëzore, të cilët kanë bërë të mundur zbehjen e problemeve të vendit.

Qeverisja e një vendi në tranzicion, që të tregojë se është duke funksionuar në mënyrë optimale për të promovuar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, krahas faktorëve të tjerë si, kushtet fillestare, probleme të trashëguara nga e kaluara, niveli i të ardhurave për frymë, prania e sektorit privat etj., ajo duhet t'i kushtojë vemendje dhe mënyrës së implementimit të sistemit politik, mënyrës së ndërtimit dhe monitorimi i institucioneve publike, vazhdimsisë dhe vullneti politik në zbatimin e reformave, përfshirjes sa më të madhe të shoqërisë civile në vendimarrje, kontrollit të rreptë ndaj korrupsionit, kapjes së shtetit nga interesa private dhe zbatimi rigoroz i ligjit.

Zona ku janë përqendruar më shumë investimet e huaj në Shqipëri, janë zonat ku dominojnë të ardhura të larta dhe infrastrukturë më të zhvilluar si Durrësi dhe Tirana. Ndërsa pjesa e brendshme qendrore dhe verilindore janë zonat më pak të preferuar nga investitorët e huaj. Pjesa kryesore e IHD-ve orientohen drejt tregtisë, duke u ndjekur më pas nga industria (kryesisht atë përpunuese), ndërtimi dhe transporti. Por me rëndësi këto vitet e fundit zënë investimet në sektorin e hidrokarbureve dhe atë të ndërtimit. Niveli i investimeve të huaja vitet e fundit ka qenë i lartë në Shqipëri, kryesisht në sektorë të tillë si: miniera, banka dhe telekomunikacion. Ndër sektorët më problematik për investimet është bujqësia. Kjo lidhet kryesisht me problemet e pronësisë (që vendi e ka të mbartur që me ardhjen e sistemit komunist), si dhe me faktin se tokat nga një sërë faktorësh janë kthyer në të shkretuara dhe kërkojnë kosto për transformimin dhe rehabilitimin e tyre në toka bujqësore.

Politikat e ndërmarra në këtë çerek shekulli kanë pasur si qëllim qasjen e Shqipërisë gjithnjë e më shumë drejt praktikave të ndjekura nga vendet europiane në shumë drejtime dhe sigurisht dhe për atë të IHD-ve. Duke qenë se vendi ynë synon të jetë shtet anëtar i BE-së, lindi nevoja për të krijuar një kuadër ligjor sa më afër atij të vendeve anëtare të BE-së si dhe domosdoshmërinë për të aderuar në një sërë marrëveshesh dypalëshe e shumëpalëshe. Gjithashtu nga ana e qeverisë shqiptare janë hartuar dhe janë zbatuar një sërë politikash nxitëse për të inkurajuar investitorët e huaj. Vitet e fundit për sa u përket aspekteve ligjore që rregullojnë marrëdhënien midis shtetit shqiptar dhe investuesve të huaj, është bërë mjaft progres pasi kanë qenë të shumta nismat e ndërmarra për tërheqjen e IHD-ve, për krijimin e një mjedisi sa më komod për investimet si dhe për ofrimin e garancisë nëpërmjet çdo instance shtetërore.

Legjislacioni për funksionimin e IHD-ve në Shqipëri është i plotë dhe mjaft favorizues ndaj investuesve. Gjithashtu shteti shqiptar është pjesë e një sërë konventash, marrëveshesh dypalëshe e shumëpalëshe, traktatesh të cilat kanë ndikuar në përafrimin e mjedisit shqiptar të bërit biznes me atë të vendeve të zhvilluara të BE-së.

Sot, falë përparimeve të mëdha të bëra gjatë viteve të fundit vendi konsiderohet i sigurt për zhvillimin e biznesit, pasi ka modernizuar ekonominë dhe po punon në ndërtimin e një infrastrukture moderne për të krijuar akses në tregjet rajonale. Shqipëria është një vend me potenciale të mëdha ekonomike dhe njerëzore, një vend i sigurt për biznes, që ka bërë përparime të mëdha në sektorë të ndryshëm gjatë viteve të fundit. Ndër të cilët përmenden: në rang ndërkombëtar karakteristikat që duhet të ketë vendi pritës për të gjeneruar fitime më të larta për firmën dhe që përcaktojnë vendimin e saj për të investuar jashtë, janë të shumtë dhe të ndryshme; politikat e nxitjes së investimeve, nëpërmjet rritjes së tyre si një objektiv kyç për zhvillimin ekonomik të vendit.

Por jo gjithmonë ka qenë kjo situata e IHD-ve në Shqipëri. Pas rënies së sistemit diktatorial vendi ishte i izoluar dhe shfaq problematika të mëdha në shumë aspekte, dhe në atë të legjislacionit për IHD-të. Nisur nga rëndësia që ky fenomen ka dhe vëmendja ndaj tij ka qenë shumë e madhe dhe falë bashkëpunimit të një sërë institucioneve si dhe vëmendjen e politikëbërësve, legjislacioni për funksionimin e IHD-ve në Shqipëri ka marrë trajtimin e duhur. Tashmë të huajt investojnë në një mjedis shumë më komod për biznesin, duke i dhënë atyre më shumë liri në të bërin biznes, duke i ofruar një mjedis shumë më të sigurt, mbrojtje më të madhe nga ana e shtetit duke i përfaqësuar ato në raste të caktuara dhe në gjykatë etj.

Megjithatë të shumta janë problematikat që investorët e huaj hasin në vendin tonë dhe kjo konstatua dhe gjatë kërkimit të bërë për këtë punim por dhe gjatë zhvillimit të intervistës e cila falë bashkëbisedimit me investuesit e huaj arriti të nxjerrë në pah se cilat çështje janë të papëlqyeshme apo shqetësuese për biznesin e huaj, duke u bërë pengesë për kryerjen e aktivitetit të tyre. Nga intervista e bërë rezultoi se pjesa më e madhe e investuesve kanë zgjedhur sektorin e tregtisë për të investuar në vendin tonë. Ndër faktorët më dominues në vendimet e tyre për të investuar në vendin tonë kanë rëndësi: pozita gjeografike e vendit, burimet natyrore; stabiliteti ekonomik dhe politik; marrëveshjet, konventat, traktatet ndërkombëtare ku Shqipëria bën pjesë; politikat dhe

nismat qeveritare; punësimi me elementët përbërës së tij (cilësia e arsimit profesional; disponueshmëria e fuqisë punëtore; korrektësia në punë; kosto e ulët e pagave). Ndër faktorët që kanë më pak influencë në vendimin e një firme për të investuar në Shqipëri janë: sigurimi i zonave të lira ekonomike dhe sigurimi i granteve të trajnimeve; ndërtimi i parqeve industriale; apo sigurimi i shkollimit ndërkombëtar. Investuesit që operojnë në vendin tonë shprehen se në hapat e parë të investimit të tyre, legjislacioni nuk ka qenë mjaft favorizues dhe ndër barrierat e tjera që kanë hasur ka qenë korrupsioni i lidhur dhe me nepotizmin, infrastruktura e vendit tonë, dhe shumë herë dhe kualifikimi i punonjësve. Ndër problemet më kryesore që investorët e huaj hasin në Shqipëri mund të përmendim të drejtat e pronësisë mbi tokën (që ndikon dhe në zgjerimin e aktivitetit). Gjithashtu investuesit shprehen të pakënaqur dhe për korrupsionin ndërmjet bizneseve lokale, që në disa raste tregojnë për konkurrencë jo të ndershme. Problemi tjetër lidhet me barrierat administrative, në të bërit biznes dhe në investime. Edhe pse, duhet thënë se vitet e fundit këto barrierat janë reduktuar ndjeshëm duke qenë se dhe vete reformat për heqjen e tyre kanë qenë mjaft të suksesshme.

Nisur nga fakti se rreth 60% e kompanive të huaja, në mënyrë të vazhdueshme, monitorojnë tregun për mundësi të tjera për zhvillimin dhe zgjerimin e biznesit arrijmë në konkluzionin se në të shumtën e rasteve kompanitë hartojnë plane të qarta për të ardhmen, por pjesa më e madhe e tyre kanë parasysh përmirësimin dhe zgjerimin e aktivitetit që ushtrojnë se sa atë të hapjes së një aktiviteti të ri.

Janë të qarta hapat që janë bërë në drejtim të përthithjes së IHD-ve në, duke modernizuar ekonominë e vendit dhe duke punuar në ndërtimin e një infrastrukture moderne gjë që çon në zhvillimin e bizneseve të suksesshme. Aktualisht, procedurat e lejeve të ndërtimit janë rishikuar dhe është planifikuar një sistem reformimi i tërë, i cili do të lehtësojë procedurat, reduktojë kostot dhe rritjen e transparencës. Megjithatë ka ende shumë për të bërë pasi legjislacioni mbetet akoma një mangësi jo për formulimin e tij por për sa i përket zbatimit.

Imponimi dhe mbarimi i kontratave nga ana e investorëve të huaj, zbatimi i këtij trajtimi, mbarimi i kontratave të biznesit ka mjaft kompleksitet çka e vështirëson shumë përmbushjen e kontratave nga ana e investorëve të huaj.

Legjislacioni shqiptar për investimet e huaja direkte është i hapur në pikëpamjen e së drejtës së krijimit të shoqërive apo ndërmarrjeve të reja por zbatimi i këtij trajtimi liberal ka sjellë efekte negative për hyrjen në vend të investimeve. Përvoja ndërkombëtare tregon për sa kohë që kontaktet personale mbizotërojnë mbi ligjet dhe procedurat ligjore, atëherë ekziston mundësia që investuesit të tërhiqen nga investimi.

Pavarësisht përpjekjeve dhe dëshirës së mirë të shtetit, vihet re mungesa e një infrastrukture financiare të zhvilluar (ku përfshihen tregjet kapitale e monetare dhe ndërmjetësit financiar) e cila do të të shërbente si nxitje për IHD-të. Sot, vendi po tregon ndryshime rrënjësore. Po vërtetohet se ka krijuar një mjedis shumë komod për tërheqjen e IHD-ve dhe po punon që të përmirësojë edhe më shumë këtë mjedis. Po tregon se po ecën në një shteg të ri, që di të besojë në pasuritë e paçmueshme natyrore, dhe që gjithnjë e më shumë synon të lidhet me pjesën tjetër të botës.

Në qoftë se kërkojmë që të huajt të investojnë në Shqipëri duhet të jemi të qartë se si fillim duhet që Shqipëria të investojë për vetë.

6.2. Rekomandime

Nisur nga fakti se një prej qëllimeve më kryesore të vendit tonë ka të bëjë me rritjen ekonomike e rrjedhimisht dhe me përmirësimin e faktorëve të tjerë të jetës sociale, kulturore, teknologjike, si dhe në uljen e papunësisë, vëmendja shkon tek IHD-ve.

Edhe pse ky fenomen ka marrë vëmendjen e duhur në kohë nga çdo qeverisje, gjatë këtij studimi dhe gjatë kryerjes së intervistës me subjekte të ndryshme, investues në vend, rezultoi se ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim. Ka një sërë problematikash që lidhen me investimet e huaja në vendin tonë. Këto problematika do të grupoheshin në:

1. Problematika e legjislacionit shqiptar për funksionimin e IHD-ve;

Objektivi strategjik për investimet e huaja e ka kthyer Shqipërinë në një destinacion kryesor për investimet e huaja në Evropën Juglindore duke tërhequr, mbajtur dhe maksimizuar fluksin e tyre. Arritja e këtij qëllimi kërkon përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit institucional dhe ligjor. Edhe pse legjislacioni shqiptar ofron trajtim të barabartë dhe mbrojtje ndërmjet firmave si vendase ashtu edhe atyre të huaja, është e

nevojshme marrja e masave të tjera nevojiten për të garantuar konkurrencë të ndershme në treg ndërmjet firmave të huaja me ato lokale.

Vazhdimisht duhet të jetë në vëmendje të ligjvënësit marrja e masave kundër evazionit fiskal dhe korrupsionit ndërmjet bizneseve lokale pasi ky lloj korrupsioni tregon për konkurrencë jo të ndershme ndaj investitorëve të huaj. Stabiliteti legjislativ është një nga elementët kyç për një mjedis politik që mbështet klimën e fuqishme të biznesit dhe investimeve. Ligjet, që ndryshohen vazhdimisht, ndikojnë negativisht në aftësinë e investuesve për të parashikuar fitimet. Gjithashtu, edhe kur kushtet janë të favorshme në një moment të caktuar, një mjedis i paqëndrueshëm legjislativ mund t'u japë investuesve përshtypjen se është i lartë rreziku i thellimit të kushteve të pafavorshme, që mund t'i bindin ata, që të heqin dorë nga investimi. Prandaj do të cilësohej si një hap pozitiv vendosja e një kalendarit i cili tregon ndryshimet periodike legjislative. Për shembull, mund të parashikohej se sa herë në vit do të bëhej rishikimi i nivelit të taksave duke informuar kështu paraprakisht dhe investuesit. Kështu firmat janë të përgatitura me rastin e çdo eventualiteti pasi transparenca është shumë e rëndësishme për ekonominë në zhvillim dhe në tranzicion.

Gjithashtu është e nevojshme miratimi i legjislacionit tregtar të krahasueshëm ose të ngjashëm me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, pasi nënvizohet nevoja për ligje tregtare që janë të njohura për investuesit dhe në linjë me standardet ndërkombëtare. Në BE, *acquis communautaire* siguron një kornizë të njohur ligjesh të cilat investuesit i njohin dhe i kuptojnë mirë.

Privatizime dhe tendera transparentë dhe konkurrues: Nëse investuesit e huaj nuk besojnë se do të kenë mundësi të drejta për të konkurruar për privatizimet dhe tenderat e shtetit, normalisht që nuk do të priren të besojnë se do të trajtohen me drejtësi nga autoritetet fiskale, inspektorët e shtetit, apo sistemi gjyqësor. Kur privatizimet dhe tenderat bëhen të hapur dhe konkurrues, ku përzgjedhja është e hapur për opinionin publik, atëherë investuesit do ta kuptojnë që qeveria po kërkon mjedisin sa më konkurrues të mundshëm. Kjo situatë mund të kontrollohet vetëm nga zbatimi i legjislacionit përkatës.

Zbatimi dhe ekzekutimi i ligjeve kundër korrupsionit: Një nga forcat më shkatërruese që kërcënon zhvillimin ekonomik dhe shoqërinë e shëndetshme është korrupsioni. Por fatkeqësisht, korrupsioni publik në ekonominë në zhvillim dhe tranzicion cilësohet si një fakt i jetës. Megjithatë ka një sërë hapash që mund të ndërmerren për t'i dhënë zgjidhje kësaj problematike. Shtetet mund ta zbusin korrupsionin duke miratuar ligje të përshtatshme dhe duke ngritur institucione të pavarura jo vetëm për hetimin dhe ndjekjen ligjore të korrupsionit, por që të veprojnë për të kontrolluar ushtrimin e paligjshëm të pushtetit qeveritar, mund t'i garantohen nëpunësve civilë rroga “të denja”, mund të krijohet një dhe organ antikorrupsion, i cili merret vetëm me çështjet e korrupsionit etj.

Përmirësimi i kuadrit ligjor në fuqi si dhe zbatimi i tij, do të ishte një shërbim shumë i mirë që do t'i bëhej rritjes së IHD-ve në vendin tonë me anë të heqjes së pengesave të biznesit dhe reduktimit të kostove të regjistrimit si dhe thellimit në procedurat e licencimit dhe të regjistrimit të taksave. Këto dhe të tjera praktika të mira qeverisjeje, u japin një sinjal të qartë bizneseve vendëse dhe të huaja se vendi e çmon kontributin e tyre për të mirën e shoqërisë dhe se do të punojë me ta për arritjen e përfitimeve të ndërsjella. Edhe kur një shtet është i sigurt dhe qeveritë pasojnë njëra-tjetrën në mënyrë të qetë, kompanitë duan të jenë të sigurta që të drejtat e tyre mbrohen. Investuesi duhet të bindet që investimi është i sigurt, që do të trajtohet me drejtësi dhe pa diskriminim, dhe që mosmarrëveshjet do të zgjidhen në mënyrë të drejtë. Kështu shteti mund të marrë masa për këtë nëpërmjet një ligji që përcakton mbrojtjen ligjore që i garantohet investuesit duke mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe të kufizojë, dhe rregullojnë masat e shpronësimit, si dhe sigurojë kompensim të drejtë në rast shpronësimi, të realizojë shpronësimin në mënyrë transparente dhe të arsyeshme.

Qeveritë mund të përmirësojnë transparencën dhe stabilitetin legjislativ duke e afruar legjislacionin tregtar me standardet rajonale dhe globale; duke botuar ligje, rregullore dhe vendime të qeverisë; dhe duke lejuar një periudhë njoftimi dhe komentesh përpara miratimit përfundimtar të ligjeve dhe rregulloreve

2. Problematika për çështjet e punësimit dhe të arsimit: Për sa i përket numrit të papunësisë nga vendi ynë mund të ndiqet model Irlanda. Numri i popullsisë të së cilës arrin 3.8 milionë banorë dhe numër papunësisë së këtij vendi është më të vogli në

Europë. Politikat dhe strategjitë që ky vend ndjek janë të shumta. Së pari ato i mëshojnë gjithnjë e më shumë idesë se “kur je i vogël është më mirë të jesh inteligjent”. Në mbështetje të kësaj ideje ato aplikojnë që prej viteve 70-të politika arsimore me qëllim që të arrijnë nxjerrjen e të rinjve sa më të arsimuar dhe cilësor në profesionin e tyre për atë që kërkon tregu i punës. Strategjia Irlandeze, gjithashtu mbështeten në katër elemente: politikat tregtare; politikat industriale; politikat fiskale; politikat arsimore e edukuese. Irlanda gjithashtu punon me një nga sistemet fiskale nga më të thjeshtët e më të ulët në botë, në raport me investimet e huaja direkte, por dhe për çdo lloj investimi privat dhe një treg pune nga më fleksiblet në botë. Nëse kjo strategji do të aplikohet dhe në Shqipëri, do të kishte ndikim si në rritjen e investimeve vendase ashtu edhe në ato të huaja. Gjithashtu nëse arsimi do të orientohej drejt asaj që tregu i punës kërkon dhe numri i papunësi në vend do të ulej ndjeshëm. E thënë kjo për vetë faktin se një nga pakënaqësitë që investuesit e huaj kanë shprehur ka pikërisht lidhje me kualifikimin i punonjësve të tyre. Siç është ilustruar edhe nga transformimi ekonomik i Republikës Irlandeze, edhe ato vende me nivele të ulëta IHD-je mund të rrisin konsiderueshëm prurjet e tyre me përpjekje të përqendruara për përmirësimin e klimës së biznesit. Sikurse u përmend më lart duhet të ndërmerren reforma në fushën e edukimit dhe trajnimit profesional, duke përmirësuar cilësinë e edukimit dhe duke nxitur lidhjet ndërmjet akademisë me biznesin, duke i kushtuar vëmendje njohurive të specializuara në menaxhim, inxhinieri dhe fusha teknologjike në përgjithësi.

Shqipëria ende ofron kosto të ulët të punës prandaj duhet të bëhen investime me punësim intensive pasi shumë lloje të investitorëve do të jenë të interesuar për të përfitur nga ky avantazh, në veçanti në tekstile të përpunimit të brendshëm dhe industrinë e lëkurës (investime këto të pranishme në vendin tonë).

3. Problematika për infrastrukturën: Ekzistenca një plani për përmirësimin në zhvillimin e infrastrukturës së të gjithë vendit dhe kryesisht atyre segmenteve që janë më të rëndësishme për zhvillimin e biznesit vendas dhe të huaj. Përmirësimi i transportin lokal dhe ndërkombëtar arrihet duke i kushtuar vëmendje korridoreve të rrugëve kryesore. Vëmendje gjithashtu duhet t'i kushtohet porteve të vendit duke investuar në to dhe duke i ristrukturuar. Qeveritë duke ndërmarrë këto hapa duhet të kenë parasysh nëse partneriteti publik-privat mund të arrijë qëllimet e politikave të

infrastrukturës. Pas ndërtimit të infrastrukturave është e nevojshme dhe mirëmbajtja e tyre kjo kërkon planifikime afatgjata.

4. Problematika me çështjen e pronave në Shqipëri: Kjo është një çështje më shumë rëndësi jo vetëm për vendin por ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe në investime. Qeveria duhet të punojë shumë në këtë drejtim dhe kjo problematikë duhet të zgjidhet një herë e përgjithmonë. Duhet të përcaktojë hartën dhe të përmirësojë të gjitha aspektet e vendndodhjes së mundësisë së investimit, duke përfshirë identifikimin dhe blerjen e tokës, regjistrimin e pronësisë së tokës, zhvillimi i territorit, lejet e ndërtimit, lidhja me burimin e furnizimit të utilitareve, inspektimi dhe lejet e punësimit, do të identifikojë tokat publike që do të jenë të disponueshme për t'u dhënë me qira apo shitje për investitorët e huaj, duke përfshirë edhe tokën bujqësore;

5. Problematika e barrierave administrative: Reformat që janë ndërmarrë deri tani për heqjen e barrierave administrative kanë qenë mjaft të suksesshme dhe për këtë arsye ato me doemos duhet të vazhdojnë të merren për të reduktuar akoma më shumë këto barrierave administrative duke ndihmuar në të bërit biznes dhe në investime. Reformat në regjistrimin e biznesit, të cilat kanë ndikuar në heqjen e barrierave të biznesit dhe reduktimin e kostove të regjistrimit duhet të vazhdojnë të thellohen në procedurat e licencimit dhe të regjistrimit të taksave.

6. Promovimi i vendit: Për të patur një përdorim sa më eficient të burimeve natyrore, tani falë dhe “Reformës së re administrative territoriale”, duhet që t’i jepet mundësi për t’u zhvilluar, jo vetëm qyteteve me infrastrukturë, e zonave bregdetare, por edhe zonave malore për apo dhe zonave të tjera ku mund të shërbejnë dhe për zhvillimin e turizmit. Kjo do bënte të mundur gjallërimin e jetës në këto zona, do të rriste mundësinë për shkëmbim të kulturës, dokeve, zakoneve dhe do t’i bënte këto zona të njohura edhe nga të huajt që do mund t’i vizitonin duke mundësuar investimin e huaj në këto zona.

Fenomeni i turizmit në Shqipëri paraqitet sezonal por konstant, kjo dhe në aspektin numerik, apo dhe në aspektin kohor. Ky fakt duhet të nxis programimin e këtij sektori drejt një oferte më konkurruese dhe të diferencuar e cila të qëndrojë e tillë gjatë gjithë vitit. Shqipëria sot ofron potenciale të rëndësishme për zhvillimin e bizneseve si rezultat i pozitës së saj gjeografike, aksesit në tregjet rajonale, forcës së kualifikuar punëtore dhe

mbi të gjitha shtetit ligjor. Në shtesë të kësaj politike, është edhe ngritja e zonave industriale që mund të ofrojnë tokën, infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse të biznesit. Pranë porteve dhe aeroporteve do të krijohen zona të lira tregtare. Nxitja dhe zhvillimi i projekteve të investimeve të përbashkëta në sektorin privat dhe aplikimi i skemave konçesionare, do të ndikojnë dukshëm në rritjen e nivelit të investimeve të huaja. Promovimi i mjedisit të biznesit shqiptar në tregjet ndërkombëtare, në këtë drejtim duhet të diskutohet dhe të promovohet një rol i ri për misionet diplomatike shqiptare. Fokusi duhet të jetë në bashkëpunim mes Ministrisë së Punëve të Jashtme, AIDA-s dhe Bashkimit të DHTI-së për promovimin e mjedisit të biznesit shqiptar në tregjet ndërkombëtare nëpërmjet misioneve të përbashkëta dhe stafit të kualifikuar. Duhet përmirësimi i imazhit të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare. Investimet dhe strategjitë për investitorë të synuar kanë provuar se kanë qenë shumë të suksesshme në Shqipëri dhe disa nga investimet më të mëdha dhe më të rëndësishme të huaja në vend janë siguruar nëpërmjet synimeve specifike. Në përputhje me përmirësimet e politikës, një drejtim i rëndësishëm i strategjisë së IHD-ve të qeverisë duhet jetë nxitja për klimën e biznesit për investime dhe mundësitë për investitorët ekzistues dhe ato potencial. Për këtë arsye, strategjia e vendit duhet të fokusohet në dy drejtime kryesore: ndërtimin e imazhit të vendit si një destinacion për investime, duke theksuar avantazhet e Shqipërisë për mjedisin e lidhur me investimet; dhe promovimin e drejtpërdrejtë të mundësive për investime tek investitorët, në lidhje me avantazhet e veçanta të vendit me nevojat e investitorit të synuar. Nxitja e IHD në zona më pak të zhvilluara për të reduktuar pabarazitë e zhvillimit rajonal.

7. Problematika e detyrimeve tatimore: Duhet t'i kushtohet vëmendje administrimit të taksave, doganave si dhe rregullave të punësimit, duke u i rishikuar dhe i përmirësuar ato. Kjo pasi politika e taksave (duke vendosur një sistem taksash të thjeshtë, një administratë tatimore të modernizuar, duke mbajtur nivel të ulët taksash, duke ofruar incentivë dhe përmirësimin e administrimit të tyre si dhe duke shkëmbyer informacion me investitorët) dhe menaxhimi është një nga faktorët e rëndësishëm në tërheqjen e investimeve të huaja dhe në përmirësimin e klimës së biznesit. Gjithashtu qeveritë duhet të garantojnë që taksat e vendosur ambi punëdhënësin të jenë të arsyeshme dhe jo mbirënduese. Nxitja e investimeve kombinon mbrojtjen dhe argumentimin e politikave, nxitjen e imazhit, gjenerimin e investimeve dhe shërbimet për investuesit.

8. Rekomandime në lidhje me problematika të tjera: Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për tërheqjen e IHD-ve. Një mjedis i dobët biznesi, domethënë i karakterizuar nga faktorë që imponojnë kosto të larta, vonesa dhe risk të lartë, pengojnë zhvillimin ekonomik dhe mund të frikësojnë dhe largojnë IHD-të duke sjellë problematika në ekonominë e një vendi nisur nga fakti se IHD janë burimi më i madh i financave të jashtme në ekonominë në zhvillim dhe në tranzicion.

Shteti duhet të bashkëpunojë me investuesit vendas që investojnë në vende të huaja duke marrë në konsideratë dhe eksperiencën e investuesve shqiptarë që kanë investuar në vendet e tjera dhe kanë pasur sukses në drejtime të ndryshme përgjatë veprimtarisë së tyre. Duke hulumtuar rreth eksperiencave të tyre, si për shembull çfarë i ka tërhequr ato në shtetin ku kanë investuar, pse ka qenë pikërisht ai vendi më tërheqës për të investuar, arrihet në përfundime të rëndësishme të cilat ndihmojnë në përmirësimin e kushteve që kërkohen nga investitorët vendas dhe të huaj.

Të paktën një herë në vit duhet të duhet të ndërmerret një raport i detajuar për sa i përket ecurive të IHD-ve në Shqipëri si dhe shtrimin të problematikave që lidhen me to. Ky raport duhet të shërbejë dhe si temë diskutimi në parlament, duke i dhënë kështu rëndësinë e nevojshme dhe nga instancat më të larta shtetërore, për seriozitetin dhe rëndësinë si një nga burimet kryesore e cila sjell shumë të ardhura në vend.

Edhe pse tashmë dihen se kush janë pikat më të forta të vendit tonë për tërheqjen e IHD-ve, duhet të punohet akoma më shumë rreth tyre duke i promovuar tek investuesit e huaj.

Rekomandohet krijimi i një agjencie rajonale për IHD-të, e cila të japë informacione dhe rekomandime për investimet e huaja në sektorët prioritarë të ekonomisë së rajoneve dhe mund të qëndrojë në kontakt me investitorët e huaj duke ndarë përgjegjësitë me AIDA (si “agjenci qendrore”) për të evidentuar problemet dhe për të mundësuar zgjidhjen e tyre.

Një përthithje e investimeve duhet të bëhet me emigrantët që jetojnë e punojnë jashtë Shqipërisë, duhet të krijohet lidhje në mënyrë që të nxiten të vijnë e dhe të investojnë këtu. Kjo mund të arrihet duke ju ofruar kushte lehtësuese për të zhvilluar aktivitete këtu të suksesshme, qofshin këto.

Shteti në bashkëpunim edhe me komunitetin e biznesit vendas dhe të huaj duhet të hartojë një strategji më të plotë dhe specifike për nxitjen e investimeve të huaja në turizëm si një faktor i rëndësishëm në rritjen ekonomike të rajonit.

Duke qenë se shpërndarja e IHD-ve në vend nuk është uniforme, për këtë arsye duhen vendosur kushte që të thithen IHD me vlerë të shtuar të lartë. Kjo kërkon standarde më të larta trajnimi dhe përmirësime të kompetencave të burimeve njerëzore.

Politikat qeveritare duhen të punojnë për të krijuar kushte që ndihmojnë kompanitë e vogla e të mesme vendase që të zhvillohen sa më shumë në mënyrë që të nxiten dhe IHD-të dalëse.

Hartimi i një strategjie afatmesme bën që bizneset ta kenë më të lehtë planifikimin. Gjithashtu, niveli më i lartë i transparencës dërgon sinjale pozitive te investuesit dhe grupet e tjera të interesit.

Qeveritë duhet të mos japin preferenca dhe as të vendosin kushte rënduese mbi pronarët e kompanive të sapoprivatizuara, por të lejojnë forcat e tregut dhe aftësitë administruese të përcaktojnë suksesin apo dështimin e kompanisë.

Së fundmi, hapat që duhet të ndërmerren një vend për tërheqjen e IHD-ve duhet të jenë konkrete, duke u ofruar investuesve të huaj komoditet në terren dhe jo vetëm përmes kuadrit ligjor që tashmë më shumë se kurdo është i plotë. Rritja e nivelit teknologjik dhe nxitja e rritjes ekonomike janë çështje komplekse dhe të vështira, por ndryshimi i legjislacionit për punësimin, thjeshtimi i procedurave të dhënies së lejeve dhe licencave, përpilimi i regjistrimit kombëtar të tokës, apo mbështetja e zhvillimit të infrastrukturës, të gjitha këto janë çështje që u takojnë qeverive për t'u bërë. Qeverisja e mirë, transparenca, stabiliteti dhe parashikueshmëria janë baza thelbësore për zhvillimin ekonomik. Interneti siguron mundësi me kosto të ulët për të hedhur dritë se si funksionojnë qeveritë, si bashkëveprojnë me biznesin dhe si e rregullojnë atë.

Nëse këto tipare bazë politike dhe ligjore kanë mangësi, atëherë ndërmerren masa për nxitjen e rritjes ekonomike, si për shembull: burimet e bollshme natyrore, taksat e ulëta apo krahu i lirë i punës, nuk rezultojnë efikase sa duhet. Meqë mungesa e stabilitetit politik dhe sigurisë cenojnë shumicën e bizneseve të ligjshme, u takon qeverive që

mbrojtjen e të drejtave dhe lirive civile, politike dhe ekonomike të tyre, ta bëjnë prioritet kryesor. Përveç garantimit të të drejtave të njeriut dhe parandalimit të krimit, qeveritë duhet të mbrojnë si investimet e huaja, ashtu edhe ato vendëse kundër arbitraritetit apo bllokimeve të pakompensuara, sanksioneve diskriminuese dhe nga ndërhyrjet qeveritare me shtysë nga ngjarjet politike.

LITERATURA

Akte normative:

1. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2009.
2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998, 2008.
3. Ligji nr. 7515, datë 01.10.1991 “Për anëtarësinë e Republikës së Shqipërisë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtimin dhe Zhvillimin, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investimet”.
4. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të ardhurat”.
5. Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.
6. Ligji nr. 115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
7. Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Ligji nr.10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”.
8. Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.
9. Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”. Ligji nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.
10. Ligji nr. 9348, datë 24.02.2005 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile”.
11. Ligji nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”
12. Ligji nr.9060 datë 08.02.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”.
13. Ligji nr. 9374, datë 21.04. 2005, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” Ligji nr. 10183, datë 20.10.2009, “Për ndihmën shtetërore”.

14. Ligji nr. 7980 datë “Për shitblerjen e trojeve”. Ligjit nr.8337 datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”.
15. Ligji nr. 7764 datë 02.11.1993 “Për Investimet e huaja”.
16. Ligji nr.10 150 datë 28.9.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së themelimit të Korporatës Islamike për Sigurimin e Investimeve dhe të Kredive të Eksportit”.
17. Ligji nr.10 198 datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.
18. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit,12.06. 2006.
19. VKM nr.482, datë 16.7.2004, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve”.
20. VKM nr.81, datë 10.2.2010 “Për miratimin e protokollit shtesë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë, për ndryshimet në marrëveshjen “Për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve”.
21. VKM nr.537, datë 1.8.2007 “Për rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare”.
22. VKM nr.1129, datë 5.8.2008 “Për mënyrën e përcaktimit të vlerës së truallit, të vënë, nga pronarët e tij, në dispozicion të investitorëve të ndërtimit”.

Literaturë e huaj:

1. Acocella Nicola, “Strategic Foreign Direct Investment in the EC, Economic Notes”, 1991.
2. Acocella Nicola, “L’impresa Multinazionale: Prospettive per una Teoria”, LINT, Trieste, It., 1994.
3. Alfaro Laura, “FDI and Growth: Does the sector matter?”, Harvard Business School, 2003.
4. Aliber Robert Z., “The mulinational paradigm”, MIT Press, Cambridge, Massachussets, 1993.
5. Antonella Mariarita R., “Le Aggregazioni Aziendali”, 2007.

6. Baudenbacher, Carl & Orlygsson Thorgeir, “The EFTA Court: Ten Years On Hardcover”, 2005.
7. Buckley Peter & Casson Mark, “The Economic Theory of Multinational Enterprise”, London, 1985.
8. Borko Handjiski and Lazar Sestovic, Barriers to Trade in Services in the CEFTA Region, 2011.
9. Dunning John H., The Globalization of Business. London: Routledge, 1993.
10. Dunning John H., Theories and paradigms of international business activity, in The Selected Essays of John H. Dunning. Cheltenham: Edward Elgar, 2002.
11. Capuano Paulo “La crisi finanziaria internazionale”, Asterios, 2013.
12. Carl Baudenbacher & Thorgeir Orlygsson “The EFTA Court: Ten Years On Hardcover”, 2005.
13. Carl Baudenbacher, Tresselt and Thorgeir Orlygsson, The EFTA Court: Ten Years On Hardcover, 2005.
14. Coase Ronald.H., “The nature of the firm”, Economica, 1937.
15. Falco, Ricardo, “Storia Economica, Dalla Rivoluzione alla Globalizzazione”, 2012.
16. Ferraro Guido “I Fondamenti di Teoria Sociosemiotica. La visione neoclassica”, 2012.
17. Fitz Garret & Building Gerald “Competitive Advantage in Nations – Increasing Transparency, Combating Corruption and Improving Corporate Governance”, Budapest, 2002.
18. Handjiski Borko & Sestovic Lazar “Barriers to Trade in Services in the CEFTA Region”, 2011.
19. Heyne Paul “The economic way of thinking”, 1994.
20. Imbriani Cesare & Pittiglio Rosanna, “Economia Internazionale di Base ed Investimenti Esteri, Teorie e Politiche”, 2014.
21. John H. Dunning, Sarianna M. Lundan, Multinational Enterprises and the Global Economy, 2008.
22. Magnoli, Alessandro, “La Banca mondiale”, 2007.
23. Michele Tempera “Le piccole e medie imprese nei Balcani occidentali”, 2013.

24. Morisset, Jacques & Lumenga Oliver N., “Administrative Barriers to Foreign Investment in Developing Countries”, 2002.
25. Porter Michael, “Competitive Advantages of Nations”, 1990.
26. Postono Moishe “Prospettive della crisi globale”, Asterios, 2013.
27. Tempera Michele, “Le piccole e medie imprese nei Balcani occidentali”, 2013.
28. Kozul-Wright Richard , & Rowthorn Bob “Transnational Corporations and the Global Economy”, 1998.
29. Romeo Mariarita A. , “Le Aggregazioni Aziendali”, 2007.
30. Rugman Alan M. & Richard M. Hodgetts, “International Business”, New York, McGraw Hill, 1995.
31. Salvatore Dominick, “Microeconomia: teoria e applicazioni, 2012.
32. Sader Frank, Attracting Foreign Direct Investment into Infrastructure, World Bank & The International Finance Corporation, 2000.
33. Sacerdoti Giorgio & Yanovich Alan and World Trade Organization, WTO at Ten: “The Contribution of the Dispute Settlement System” (WTO Internal Only), 2006.
34. Sezer, Haluk, “International business economics: a European perspective” Palgrave Macmillan, 2006.
35. Yerak Beck, “Firm Looks to Top Chinese Capital: Us-China Owned Company Focuses on Merges, Acquisition”, 2007.
36. William W. Park, “The United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards”, 2001.

Literaturë vendase:

1. Angjeli, Anastas, “Ditari i tranzicionit ekonomik”, UMSH dhe TOENA, Tiranë Shqipëri, 2013.
2. Bakiu, Vjollca “Turizmi në Shqipëri” 2006.
3. Civici, Adrian “Globalizimi” , 2009, UET-Press, Tiranë Shqipëri.
4. Çuri, Petraq & Jaupi, Enkelejda “E drejta tregtare”, 2009.

5. Galgano, Francesco; Dauti, Alban (përkth); Fida, Artan (përkth); Luarasi, Aleks (red). “E drejta tregtare: sipërmarrësi-shoqëritë: botim kompakt”, Tiranë (AL), 2009.
6. Gugu, Aida. “Disa reflektime mbi Organizatën Botërore të Tregtisë dhe mekanizmat mbrojtës në kuadër të saj”, 2009.
7. Gjata, Rustem “E drejta civile: sendet dhe pronësia”, Tiranë (AL): Albpaper, 2011.
8. Hashi, Iraj. “Ristrukturimi dhe Privatizimi i Ndërmarrjeve të Mëdha Shoqërore dhe Publike në Kosovë”, Staffordshire University, Stoke on Trent, UK, 2002.
9. Haxhi, Paskal. “Regjimi juridik i tokës në Shqipëri: Vështrim historik”, Tiranë (AL): Albin, 1992.
10. Haxhi, Paskal. “Regjimi juridik i tokës në Shqipëri: vështrim historik”, Tiranë (AL): Albin, 2002.
11. Hetemi, J. Mehdi. “E drejta ndërkombëtare tregtare-afariste: ligjërata të autorizuar”, 2007, Prishtinë (KS): Universiteti “Fama”.
12. Kalia, Ardjan. E drejta Ndërkombëtare Private, FLASH, 2008.
13. Kondili, Valentina. “E drejtë civile”, 2008.
14. Mënëri, Suela, “E drejta e arbitrazhit dhe e ndërmjetësimit ndërkombëtar tregtar”, Dudaj, 2012.
15. Semini, Mariana. “E Drejta e detyrimeve dhe e kontratave”, Pjesa e Përgjithshme, Skanderbeg books, 2007.
16. Seferi, Kasem. “Politika fiskale dhe administrimi fiskal: Investimet e huaja: Shkollat e mendimit ekonomik: Diplomacia ekonomike”, Tiranë (AL): Redona, 2010.
17. Tafa, B. Genta. “Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare”, Ilar, 2009.
18. Velija, Vehbi. “Për ku je nisur Shqipëria ime?”, 1996.

Artikuj:

1. Alfaro Chanda & Kalemli-Ozcan & Sayek, “How does FDI Promote Economic Growth? Exploring the Effects of Financial Marketson Linkages”, Journal of Development Economic, vol.16, 2006.

2. Barrell Ray & Pain Nigel, "Domestic institutions, agglomerations and foreign direct investment in Europe, "European Economic Review, Elsevier, vol. 43 (4-6), 1999.
3. Blomstrom Magnus & Kokko Ari, "Multinational Corporations and Spillovers", Journal of Economic Survey, vol. 12. Stockholm, Sweden, 1998.
4. Borenstein De Gregorio, "How does foreign direct investment affect economic growth?", Journal of International Economics, vol. 45, 1998.
5. Buckley Peter & Casson Mark "An Economic Model of International Joint Venture Strategy", Journal of International Business Studies, Palgrave Macmillan, 1996.
6. Buckley Peter & Casson Mark, "The internalization theory of the multinational enterprise: A review of the progress of a research agenda after 30 years", Journal of International Business Studies, 2009.
7. Clague Christopher, Rausser C. Gordon "The Emergence of market economies in Eastern Europe" Oxford: Blackwell, Cambridge MA, 1992.
8. Campos Nauro, "FDI as Technology Transferred: Some Panel Evidence from the Transition Economies", William Davidson Working Paper, Nr 438, 2002.
9. Caves Richard E., "Multinational enterprise and economic analysis", Cambridge University Press, Cambridge, Massachusetts, 1996.
10. Caves, Richard E., International Corporations: The Industrial Economics of Foreign Investment", Economica, Vol.38. N.2, 1971.
11. De Jonquires, G. & Peel, Q. "Flow of Capital rising despite regional crisis". Financial Times, 1998.
12. Donald J. Brean, "The Canadian Journal of Economics / Revue canadienne d'Economie", The Economics of Multinational Enterprise by Neil Hood; Stephen Young, 1980.
13. Dunning John H., "The strategies of Japanese and US manufacturing investment in Europe", Oxford, 1994.
14. Dunning John H., "The eclectic (OLI) paradigm of international production: past, present and future", International Journal of the Economics of Business, vol. 8, 2001.

15. Dunning John H. “Explaining changing patterns of international production: a search for the eclectic theory”, Oxford Bulletin of Economics and Statistics, fq. 269-295, 1979.
16. Dunning John H, “Towards an eclectic theory of international production”, Journal of International Business Studies, 1980.
17. Dunning John H., “The eclectic paradigm of international production: and some possible extension”, Journal of International Business Studies, 1988.
18. Lorraine, Eden, “A Critical Reflection and Some Conclusions on OLI”. In International Business and the Eclectic Paradigm: Developing the OLI Framework, London, 2003.
19. Multilateral Investment Guarantee Agency (MIGA) annual report – 2001.
20. Obstacles to Trade, Growth, Investment and Competitiveness, Chesapeake Associates-Washington, 2001.
21. Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Reforma e Shërbimeve Publike, Raport Hulumtues, Riinvest, 2002.
22. Private Capital Flows to Developing Countries – ECOSOC, 2000.
23. Vernon, Raymond, “International investment and international trade in the product cycle”, Quarterly Journal of Economics, 1966.
24. Xu Bin, “Multinational Enterprises, Technology Diffusion, and Host Country Productivity Growth”, Journal of Development Economics, fq. 477-493, 2000.

Burime nga Interneti:

1. [http://unctad.org/en/Pages/DIAE/Foreign-Direct-Investment-\(FDI\).aspx](http://unctad.org/en/Pages/DIAE/Foreign-Direct-Investment-(FDI).aspx).
2. http://unctad.org/Sections/dite_dir/docs/WIR2014/wir14_fs_mk_en.pdf.
3. <http://www.imf.org/external/index.html> “The International Monetary Fund’s Balance of Payments Manual” .
4. <http://www.oecd.org/corporate/mne/statistics.html>, Foreign Direct Investment Statistics–OECD, Analysis and Forecast.
5. <http://www.vodafone.al/>.
6. https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_multinational_corporations .
7. <http://www.albtelecom.al>.

8. <http://www.pak-ks.org/> .
9. <http://www.hygeia.al/> .
10. <http://www.albtelecom.al>.
11. <http://www.spitaliamerikan.com/al/>.
12. <http://www.elbasanfactory.com/>.
13. <http://shtetiweb.org/ndarja-e-re-administrative-territoriale/>.
14. <http://www.aida.gov.al/> 2013.
15. <http://www.arkivalajmeve.com>.
16. <http://www.qkr.gov.al>.
17. <http://www.naftanow.org> .
18. <http://www.aida.gov.al> .
19. <http://www.oecd.org/corporate/mne/statistics.html>.
20. <http://www.imf.org/external/index.html>.
21. [http://unctad.org/en/Pages/DIAE/Foreign-Direct-Investment-\(FDI\).aspx](http://unctad.org/en/Pages/DIAE/Foreign-Direct-Investment-(FDI).aspx).
22. <http://www.ambasadat.gov.al/belgium/sq/investoni-në-shqipër>.
23. <http://www.financa.gov.al>.
24. <http://www.imf.org>.
25. <http://www.oecd.org/corporate/mne/statistics.html>.

Burime të tjera:

1. Doing Business in Albania, 2014.
2. EBRD (2010a), Transition report: Recovery and reform”, London: EBRD, 2010.
3. EBRD (2010b), Commercial Laws of Albania: An Assessment, London: EBRD, 2010.
4. Economic Reform Today, CIPE, Washington D.C., no. 4, 1997.
5. FMN, 2010, Washington (D.C): FMN.
6. Pasha A., Tanku, Irma. Probleme të rritjes ekonomike në Shqipëri: Strategji apo spontanitet: Përmbledhje e referate të mbajtura në konferencën kombëtare të organizuar nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike 12-13 Mars 1999, Tiranë.
7. Raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë, 2009.

8. Raporti i investimeve të huaja direkte, Shqipëri, 2012.
9. Razin et “Excessive FDI flows under Asymmetric Information”, 1999, Working Paper.
10. UNCTAD (WIR02). World Investment Report 2002: Transnational Corporations and Export Competitiveness. New York and Geneva: United Nations.
11. UNCTAD (WIR06). World Investment Report 2006: FDI from Developing and Transition Economies - Implications for Development. New York and Geneva: United Nations.
12. World Trade Organization, Appellate Body Annual Report for 2008, 2009.
13. World Trade Organization WTO, WTO Dispute Settlement, 2014.
14. World Bank “Investing across borders 2010, Indicators of foreign direct investment regulations in 87 countries”. Washington, D.C.: World Bank, 2010.
15. World Trade Organization (WTO), Dispute Settlement: One-page Case Summaries, 2014.
16. World Trade Organization (WTO), “Trade Policy Review - Albania 2010”, Geneva, 2010.

SHTOJCA 1

Nr.	Komponentët	2006	2007	2008	2009	2010	2011
1	IHD totale	259	481	665	717	793	742
2	Kapital aksionere	199	487	420	516	600	755
3	Fitime të riinvestuara	0	0	182	229	186	64
4	Kapital tjetër	60	-6	63	-27	7	-77

Tabela 3.3.1 Përbërja e prurjeve të IHD-ve për periudhën 2006-2011. (Burimi i të dhënave Banka e Shqipërisë)

Nr.	Aktivitetet	2006	2007	2008	2009	2010	2011
1	Bujqësi, gjueti, peshkim	2	2	-54	-9	0	0
2	Ndërtim	8	51	147	19	44	0
3	Industri	69	56	349	300	394	351
4	Energji, Gaz	0	4	2	143	88	103
5	Telekomunikacionet	62	196	-61	84	97	67
6	Ndërmjetësim financiar	30	136	167	120	138	110
7	Shërbime të tjera	88	25	95	59	33	111
8	Total	259	480	665	717	793	742

Tabela 3.3.2 IHD-të hyrëse sipas aktivitetit kryesor ekonomik. Të përcaktuara si industri nxjerrëse dhe hyrëse.
(Burimi i të dhënave Banka e Shqipërisë)

Nr.	Aktivitetet	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	total
1	Nxjerrje	2	0	0	0	0	1	0	0	0	3
2	Manifakturë	3	4	3	1	3	5	0	1	2	22
3	Energji elektrike	1	0	0	1	3	2	0	0	0	7
4	Ndërtim	0	0	1	1	1	0	0	1	0	4
5	Shitje, marketing, pakica	1	1	3	5	0	7	4	2	3	26
6	Transport, shërbime biznesi	2	2	6	3	1	1	3	2	2	23
7	Total	9	7	13	11	8	16	7	6	7	84

Tabela 3.3.3 Numri i projekteve të IHD-ve sipas aktiviteteve të biznesit.
(Burimi i të dhënave Banka e Shqipërisë)

Viti	2014	2015	2016
Deficiti i përgjithshëm fiskal të PBB-së %	6.7	4.8	3.4


Tabela 3.3.4 Deficiti i përgjithshëm fiskal të PBB-së %.

Nr.	Banka	Emri i aksionerëve	% e Aksioneve	Pronësia	Vendi i origjinës së aksionerëve
1	Raiffeisen Bank	Raiffeisen International Bank - Holding AG	100	Private e Huaj	Austria
2	Banka Italiane e Zhvillimit	Veneto Banca Holding S.c.p.A.	100	Private e Huaj	Italia
3	Alpha Bank	Alpha Bank of Greece	100	Private e Huaj	Greqia
4	Emporiki Bank	Emporiki Bank of Greece	100	Private e Huaj	Greqia
5	ProCredit	Pro Credit Holding Commerzbank AG	80 20	Private e Huaj Private e Huaj	Gjermania
6	Banka Popullore	9 Individe	25	Private e Huaj	Shqipëria
7	Union Bank	EBRD 2 Individuals	12.5 4.37	Private Vendase	Institucion Ndërkombëtar Shqipëria
8	First Investment Bank	First Finance Brokerage House LTD	0.0001	Private e Huaj	Bullgaria
9	Intesa San Paolo	Italian Society for Foreign Enterprises	1.5	Private e Huaj	Italia

Tabela 3.3.5 Tabela e bankave si investime të huaja.
(Dokumenti PEF 2014 – 2016)

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Totali investimeve publike	38.266	38.375	51.108	57.040	93.783	95.881	67.492	70.679	61.655	65.477	60.749	61.622	59.988
Rritja me baze vjetore	-	0,28	33,18	11,61	64,42	2,24	-29,61	4,72	-12,77	6,20	-7,22	1,44	-2,65

Tabela 3.3.6 Totali investimeve publike (Burimi: Ministria e Financave)




Grafiku 3.3.1 Totali investimeve publike.
(Burimi: Ministria e Financave)

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Financimi i brendshëm në milion	27.590	24.321	35.440	48.220	50.046	75.600	46.642	41.097	27.398	36.701	33.964	38.133	31.619
Financimi i jashtëm në milion	10.676	14.054	15.668	8.819	43.587	20.281	20.850	27.982	34.257	28.776	26.785	23.489	28.369
Totali i investimeve publike	38.266	38.375	51.108	57.040	93.783	95.881	67.492	70.679	61.655	65.477	60.749	61.622	59.988

Tabela 3.3.7 Financimi i IHD-ve.

(Burimi: Ministria e Financave)



Grafiku 3.3.2 Financimi i IHD-ve.

(Burimi: Ministria e Financave)

Prejardhja e kapitalit të IHD-ve	Përqindja e ndërmarrjeve	Stok i kapitalit të huaj
Kapitali italian	51	34.2
Kapitali grek	24	48
Kapitali turke	4	2
Kapitali amerikan	3	1
Kapitali nga vende të BE-Së	87	82
Kapitali gjerman	1.3	1
Kapitali francez	1.3	1.1
Kapitali anglez	1.1	1.2

Tabela 3.4.1 Prejardhja e IHD-ve.

(Burimi: Banka e Shqipërisë 2014)

SHTOJCA 2

Intervista

Përshëndetje. Quhem Aida Saraçi, doktorante në Universitetin Europian të Tiranës. Kjo intervistë është pjesë e një hulumtimi për studimet doktrate, që e ndërmarrë për mbledhjen e të dhënave në lidhje me situatën e investimet e huaja direkte në Shqipëri.

Paraprakisht ju falënderoj për kontributin tuaj.

Pjesa A

1. Në cilin sektor vepron kryesisht firma juaj (në prodhimin, tregti apo shërbime), dhe sa kohë keni që investoni në Shqipëri?
2. Si e gjykoni kapitalin që ju keni investuar (shumë të lartë, të lartë, apo minimal)?
3. A ka qenë favorizues kuadri ligjor në fillimet e investimit tuaj (po, jo, disi)?
4. Sa është numri i personave që keni punësuar (5-50; 51-100; më shumë se 101)?

Vlerëso karakteristikat e mëposhtme për nga rëndësia që ato kanë në ecurinë e aktivitetit tuaj (listo 5 më kryesoret):

- Kualifikimi i punonjësve (cilësia e arsimit profesional; disponueshmëria e fuqisë punëtore; korrektësia në punë);
- Liria në të bërit biznes;
- Siguria, transparencja dhe zbatueshmëria e kuadrit ligjor në fuqi;
- Stabiliteti politik dhe ekonomik;
- Niveli i ulët i burokracisë;
- Kostoja e lëndës së parë;
- Infrastruktura;
- Apo të gjitha bashkë?

Pjesa B

1. Cila ka qenë arsyeja që ju ka shtyrë për të investuar në Shqipëri (listo 5 më kryesoret)?

- Marrëveshjet, konventat, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria;
- Sistemi bankar;
- Politika e qëndrueshme monetare dhe fiskale;

- Infrastruktura;
- Puna: cilësia e arsimit profesional; disponueshmëria e fuqisë punëtore; korrektësia në punë; kostot e pagave;
- Politikat qeveritare;
- Stabiliteti ekonomik;
- Vendndodhja gjeografike dhe burimet natyrore;
- Tjetër, specifiko.

2. Cilat ishin barrierat kryesore që keni hasur në fillim të investimit tuaj (listo 5 më kryesoret, nga 1 në 5)?

- Infrastruktura;
- Vendndodhja gjeografike, burimet natyrore;
- Sistemi gjyqësor, mbrojtja e të drejtave tuaja si investues;
- Burokracitë administrative;
- Sistemi bankar;
- Korrupsioni dhe nepotizmi;
- Vështirësitë e biznesit në hyrjen në treg;
- Stabiliteti ekonomik dhe politik
- Kualifikimi i punonjësve;
- Vlera e tarifave të taksave dhe doganave;
- Tjetër, specifiko.

3. A po zbatohen praktika të mira në pesë vitet e fundit për të përmirësuar klimën e biznesit (në rastin tuaj)?

4. A jeni të informuar për ndonjë ligj, udhëzim apo VKM të miratuar së fundmi që po ndikon në rritjen e investimit tuaj?

5. Të ardhurat vjetore që përfitoni nga ky investim i konsideroni në rritje; në ulje apo të pandryshueshme?

6. Cilat nga burimet financiare ka përdorur kompania juaj për të investuar?

7. A ka në plan kompania juaj të hapë vende të reja pune në tre vitet e ardhshme? Nëse po, sa (1-10; 11-50; më shumë se 50)?

8. Si e vlerësoni situatën aktuale ekonomike në Shqipëri (të qëndrueshme; disi të qëndrueshme; të paqëndrueshme)?

9. A janë të përballueshme taksat për ju (po; jo)?

- 10.** A janë korrekt në shlyerjen e pagesave furnitorët shqiptarë (po; disi; rrallëherë; jo)?
 - 11.** Mendoni se vitet e fundit ligjvënësi shqiptar ka bërë progres në përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon marrëdhënien midis investitorëve të huaj dhe shtetit shqiptar?
 - 12.** A është mendoni se sistemi tatimor në Shqipëri është transparent (disi; po; jo)?
 - 13.** Si do ta konsideroni sigurinë ligjore në Shqipëri? (disi e mirë; e moderuar; e mirë; shumë e mirë.)
 - 14.** Nga eksperiencia që keni në investimin tuaj, a do ta rekomandonit Shqipërinë si një destinacion për të investuar?
- Jeni të lirë të shtoni komentet tuaja në lidhje me klimën e biznesit dhe investimeve të huaja direkte në Shqipërinë.
- Ju faleminderit!